*Besoj gjithashtu se ky lloj mendimi shoqëron jo vetëm përpjekjet e mia por edhe ato të poetëve të tjerë, më të rinj. Përpjekjet e atyre që, me yje artificiale që valëviten mbi kokat e tyre, të pastrehuar as edhe nën tendën tradicionale të qiellit, të zbuluar në një mënyrë të pamenduar, të tmerrshme, e mbartin ekzistencën e tyre në brendësi të gjuhës, të rrënuar nga realiteti dhe në kërkim të tij.*

– Pol Selan, “Fjalim në Bremen”

Fraza që përuddh reflektimet tona me këtë rast më kthen tek një tekst që i ka munduar të gjithë reflektimet e mia mbi pedagogjinë dhe universitetin gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit (dhe kësaj gjithçka që shkruajta tek *Pretendimi i gjuhës*,<sup>1</sup> një libër që do të doja t’i rikthehesha shkurtimisht në këto faqe). E kam fjalën për një sprovë të shkurtër të Zhan-Fransua Liotarit që u publikua për herë të parë tek *Critique* në 1978-n nën titullin “Qëndresa dhe profesioni.”<sup>2</sup> Është një tekst enigmatik qoftë vetëm për faktin se ajo që quhet “qëndresë” nuk përkufizohet asnjëherë në çka është, në pamje të parë, një reflektim i errët dhe dëshpërues – sikur “qëndresa” të kishte zënë vendin e asaj së cilës mund t’i shërbente, por që nuk mund t’i gjendet emri, pak shpresë, për shembull. Edhe sot e kësaj dite kjo sprovë më shtang dhe më bën kureshtar, por besoj se tanimë kuptoj diçka rreth arsyes pse ajo më ka munduar, prandaj dua të prihem prej saj. Edhe nëse nuk jam i saktë në intuitat e mia, të paktën mund ta ofroj atë si një shembull kureshtar të asaj që ne ndoshta do të donim ta quanim një “pedagogji shkatërrimi” – ose të paktën një shembull të çka mund të përbënte një hap drejt diçkaje të tillë.<sup>3</sup>

Shkatërrimi të cilit ky tekst i referohet shfaqet fillimisht në nivel institucional. Forcat përtharëse që janë bërë shkak për rrethanat e rënda në të cilat ndodhemi ishin qartësisht në rritje në dhjetëvjeçarin pas 1968-s. Citoj rreshtat e parë:

Ditët e sotme, përfitim i një rroge në këmbim të asaj lloj ligjërata që zakonisht quhet filozofi është bërë diçka e rrallë dhe për t'u patur zili. Ndërsa shekullit të 20-të i vjen fundi, burrat e shtetit dhe familjet që drejtojnë sistemin arsimor të mesëm në Francë nuk duan të kenë fare të bëjnë me të. Pasi, sipas frymës së kohëve në të cilat jetojmë, që është e tyrja, të bësh do të thotë të prodhosh; domethënë të prodhosh me mbivlerë. Kësisoj ata që japin mësim në filozofi janë të destinuar të përgjysmohen ose më keq, kurse ata që e kanë studiuar atë mbeten të papunë ose bëhen peng të profesioneve të tjera. (EP 72)

Asokohe Liotar nuk kishte hezituar t'i bashkohej atyre që ndodheshin në skajin më ekstrem të shkatërrimit që po përhapej, domethënë, grupit të filozofisë në Vincennes, që, kur Zhan-Fransua përshkroi përvojën e tij atje, kishte humbur të drejtën për të dhënë diploma. Aty gjenim një universitet pothuajse *sans titres* dhe *sans condition(s)*.<sup>4</sup> E megjithatë studentët vinin. Mungesa e kushteve (mungesa e çdo lloj justifikimi formal ose strukture të detyruar, mbështetja tërësisht minimale nga shteti), së bashku me këmbënguljen e çuditshme të studentëve, nxitën Liotar të vinte në pikëpyetje radikale qëndrimin e tij pedagogjik. Në këtë situatë lirie dhe skamje radikale, ai ishte shpërvetësuar prej çdo autoriteti institucional të paradhënë ose të aprovuar si profesor. Një bashkëbisedues imagjinari e pyet se çfarë do të thotë gjithë kjo:

Do të thotë se çdo mësues në Departamentin tënd flet për çfarë t'i dojë qejfi? – Jo, do të thotë se askush nuk është i mbrojtur, dhe mbi të gjitha në sytë e vet, nga rregulla të përcaktuara. Dhe se gjithëkush duhet t'i japi emrin e vet asaj që ai ose ajo thotë, pa i bërë apel domosdoshmërisë; dhe gjithëkush, si të ishte gagaç, duhet të ecë drejt asaj që ai ose ajo dëshiron për të arritur ta thojë atë. – Po ekzagjeron. – Mos harro se ata të presin javë pas javë, dhe pa të thënë se çfarë presin. – Sidoqoftë, ti e di se ku do të dalësh. (EP 72–3)

Por jo, shpjegon Liotar, ai nuk e di. Ajo që e ka nxitur është më pak se një ide – ajo ngjan më tepër me një shtysë, “një pikë e fortë ose e dobët,” e ka shtyrë të ndërmarrë shqyrtime të imëta të retorikës së lashtë, si për shembull “makineria e një antistrefoni të vënë në gojën e Protagorasë nga Diogjen Learti.”

Bashkëbiseduesi është mosbesues:

– E megjithatë, ti, gjithashtu, do diçka. – Kur ishe më i ri mund të kesh dashur të kënaqësh, të ndihmohesh, ose të prish me argument ose zbuluesë [*revelation*]. Tani gjithçka ka marrë fund. Ti nuk e di më se ç'duhet. Si mund të bësh të tjerët të kuptojnë atë që t'i vetë nuk e ke kuptuar tamam. Por kur kursi ecën mbarë, ti e di gjithashtu se meqë ti i ke bërë të kuptojnë atë që ti vetë nuk kuptoje, ai në fakt nuk doli mirë. Ankthi, kur hyn në klasë, veçanërisht në fillim të vitit, nuk është frika që aktori ose oratori ka nga skena (ndonëse mund të ndodhë të jetë), ndjesia e klaustrifobisë (të gjithë në këtu kemi për t'u pëcëlluar), ose shtrëngesa e mosditjes së gjithçkaje (disi ngrohëse). Është presioni sovran i një “Ti duhet të shkosh atje” të marrë që nuk thotë se ku. (EP 73)

Ndjenja mbizotëruese është angjështia dhe shtysa merr formën e një urdhëri këmbëngulës por të errët: “il faut y aller” – “y”-ja (atje-ja) tërësisht e papërcaktuar.

Situatës nuk i mungon absurditeti, të cilin Liotar e ilustron me një anekdotë që unë e di mirë se ai e donte:

Vetëm dy vjet më parë, ky apo ai komando i majtë hynte tërë potere, denonconte funksionin e gjykatës, sistemin e yjeve, tëhuajësimin, apatinë, priste dritat, ngrinte grushtat, kyçte mësuesin për ca kohë, dhe abuzonte studentët. [...] Të bluash në mendje një metalepsis në tregimin e Librit 9 të *Ligjet* nuk është humbje kohe, është krim. Ata e dinë se ku duhet të shkojnë.

E kishim zakon të ziheshim ndopak. Vetëm një herë çoi drejt diçkaje me vlerë.  
(EP 73–4)

Pas kësaj ai tregon se si grupi i tij, gjatë një greve në Vincennes, filloi të studioje retorikën e gjuhës së përdorur në grevë. Të ballafaquar me militantët, ata patën mundësinë të tregojnë se puna e tyre nuk ishte në fakt e dallueshme, minus një manovër reflektuese ose dy, prej punës apo veprimtarisë së vetë grevistëve. Militantët, duke tundur kokën, nuk i ngacmuan.

Mund të sugjerohet se me këtë histori Liotar ilustron diçka të lidhur me lojën e një antistrefoni, që siç do të na thojë më vonë, një herë e një kohë ka mundësi ta kishte marrë si një manovër të vlefshme politike. Do t’i kthehem kësaj pike sepse ajo është kyçe për kuptimin e qëndrimit çuditërisht apolitik që përshkruan Liotar – ndjellja [*evocation*] e çuditshme e një lloj kotësie, madje edhe një asnjësi që disave, dhe sigurisht grevistëve, mund t’iu dukej “akademike” deri në masë ofenduese. Por dua të vazhdoj të merrem fillimisht me përshkrimin e Liotarit të eksperiencës pedagogjike, që është e mbushur me ankth:

Ritmi i punës në vazhdim duket provues dhe i paqtë. Por me rastin e këtyre klasave pa pikë kuptimi, ai shndërrohet në asketizëm, padurim dhe frikë. Ti ngrihesh kohë para se të agojë dhe i thua vetes: kjo pjesë e punës duhet mbaruar sonte. Për shembull: shprehja e logjikës kohore të antistrefonit të Protagorasë para mesnatës. Sepse të pasnesërmen duhet t’ia shpjegosh atyre që të presin. Me sytë e ngulur mbi ta dhe jo mbi shënimeve të tua. Dhe, meqë nuk je i mbrojtur nga asnjë institucion, t’i bësh për më tepër të kuptojnë se pse u dashka folur për kesi gjërash. (EP 74)

Thesoj se ai ndjen se i duhet ta zotërojë argumentin deri në atë pikë ku të jetë i aftë ta komunikojë atë pa shmangje, pa iu drejtuar shënimeve (përsëris, kjo është një situatë zbulimi [*exposure*]), dhe ai duhet të jetë i aftë të komunikojë se si mund të përligjet ky ushtrim. Ndershmëria e jashtme e kësaj përpjekje, me çka dua të them natyra e çiltër e adresës dhe përpjekjes për të legjitimuar pa asnjë legjitimitet ekzistues, që më pas përputhet, ai na thotë, me një kërkesë të njëmendtë ndaj vetes: puna duhet ndërmarrë pa u mbështetur në komentime të pranuar dhe në një mënyrë të tillë që ne të transformohemi prej saj.

*Të transformohemi prej saj.* Liotar, ju kujtoj, po flet për analizën e një antistrefoni të Protagorasë apo dikujt tjetër, e megjithatë vazhdon ta trajtojë këtë si një formë *përvoje*,











një *prove* madje. Jeta e mendjes është diçka e çuditshme që kurrë nuk do të rreshtë së na habituri, por unë prapë besoj se të gjithë ne dimë diçka rreth asaj që ai ka ndjellur këtu, që është përjetimi i një kalimi, në mendim, që në një farë mënyre ka ndryshuar qenien tonë intelektuale. Gjendja jonë si mësues është modeste, por nëse dhe kur japim mësim, nëse vërtetë japim mësim, mënyra se si ne ndërveprojmë me botën që na rrethon ndryshon; ne përjetojmë një zhvendosje horizontesh. Shpeshherë ne imagjinojmë se mësimdhënia jonë po ndryshon botën – gjë që bën për të qeshur edhe ata që na ndodhen pranë. *Dhe ne e kemi bërë*, ose le të themi se ne kemi prekur dhe kështu ndryshuar, sadopak, botësinë [*worldhood*] e botës për veten tonë, dhe deri në një farë mase edhe për ata që na kanë shoqëruar. Asgjë nuk ka ndryshuar, të paktën jo në dukje, e megjithatë gjithçka, në një kalim të shkurtër, ka ndryshuar, është vulosur me shenjë e druajtur të kësaj zhvendosjeje të paprovueshme, këtij fërkimi të shkurtër me atë që ndoshta do të donim ta quanim shkatërrim. Liotar nuk e thotë këtë, por unë besoj se këtu gjejmë një prej çelësave të qëndresës, dhe kemi një aluzion të vogël të çfarë do të thotë të shkosh, atje.

Patjetër që gjithë kjo ndërmerret nën dyshimin më ekstrem:

Ti nuk je prerë për të menduar; ti je një filozof. Ti beson se nuk është e natyrshme të mendosh. Ti i ke zili – por në fund të fundit i përçmon – kolegët dhe miqtë e tu të cilët punojnë në shkencat humane, që duket sikur janë në simbiozë me punën e tyre, që kanë një korpus, një metodë, një bibliografi, një strategji, shkëmbime. Kjo është ajo që të bën të ndryshëm madje edhe nga ata që janë pranë teje, si historianët e filozofisë, të cilët ti megjithatë i admiron. Ty të pëlqejnë gjërat e papërfunduara. Asgjë që ti shkruan nuk ka për të qenë autoritative. Ti i dorëzohesh, vullnetarisht, këtij udhëzimi: “të shkosh atje, pa e ditur se ku.” Ti je i bindur se askush nuk mund ta arrijë këtë, aq më pak ti vetë. Ti e di se po bën një punë për të cilën nuk je prerë. Ti je një mashtrues. Ti e urren gjithë këtë. Pak nga pak do pushosh së marri mendjemadhësi prej saj. (EP 75)

Dhe çfarë është gjithë kjo? Edhe një herë, nënvizoj se ai po studionte operatorët retorikë në mënyrën më të hollësishme të mundshme – të hollësishme, ndonjëherë të mërzitshme, sepse ai po zhbënte çdo presupozim që mund të bazohej mbi pozicionin e tij të mëparshëm në qarqet intelektuale pariziane ose mbi pritshmëritë në lidhje me praktikimin e filozofisë në Vincennes në shoqërinë e figurave si Zhil Dëlëz [*Gilles Deleuze*]. Ai po minonte çdo pozicion dhe çdo pozë që mund t’i atribuohet në këtë skenë, duke refuzuar të deklaronte se çfarë duhej menduar në konjunkturën e atëhershme (siç do të bënte një *maitre à penser*) dhe duke refuzuar të prononcohej mbi atë që nuk mund të mendohej (siç do të bënte një *maitre à penser*). Ai do t’ia linte të tjerëve, kështu tha, detyrën e emërtimit të të paemërtueshmes, e thënies së të pathënëshmes, e mendimit të të pamendueshmes, e shqiptimit të të pashqiptueshmes, ose e vendosjes të të pavendosshmes (sot mund të shtonim “mësimi të shkatërrimit”). Detyra e tij ishte pa angazhime të tilla dhe i bindej një tjetër lloj ekzigjence.

Çfarë, pra, ishte duke bërë ai? Pse imagjinonte se këto analiza të retorikës mund t’i shërbenin ndonjë qëllimi të ndershmë që ai refuzonte ta identifikonte përveçse në mënyrën më minimale të mundshme? Në faqen e parafundit ai i afrohet një përgjigjeje:

T’i përpiqesh të arrish dy lloje kuptimi; fillimisht, atë që të nesërmen të lejon të vendosësh antistrefonin e Protogorasë në shkrimin e një logjike kohore. Një kuptim i fortë e megjithatë i kotë. Tjetri është komplet i ndryshëm: të mësosh, errëtazi, pas muajsh, vitesh studimi, pse ky argument i çuditshëm të interesoi. E përfshive fillimisht në një analizë të përgjithshme të hiles, për shembull, dhe ajo të kishte tërhequr sepse të ishte dukur si një armë kundër të fuqishmëve. Ne jemi të dobët, e kishe zakon të thoje si për justifikim [do të dalloni këtu një aluzion ndaj titullit të një prej sprovave më të njohura të Liotarit: “Mbi Fuqinë e të dobtëve”<sup>5</sup>]. Gjithë kjo dukej sikur kishte një qëllim politik, ti po inspektoje arsenalin. [...] Antistrefoni gjeti vendin natyrshëm në këtë strategji të përgjithshme dhe ti e studiove si të tillë. Tani, dy vjet e gjysëm me vonë, t’i rrefen mendjemadhësinë e manikeizmit tënd. Antistrefoni vërtetë që mund të jetë një armë në dispozicion të të dobtëve; ai është gjithashtu pika e fuqishme e ligjëratës filozofike, pasi kjo e fundit përbëhet nga konstatime refleksive (ose spekulative) e të cilave ai është një lloj. Qasja jote ndaj paradokseve në përgjithësi modifikohet prej tij, si dhe “politika” jote. Kështu thua. Dëgjuesit e tu, veçanërisht ata të huajtë nga vende të varfëra, besojnë se me këtë lëvizje ti ke humbur edhe më tepër nga shpirti luftarak, se ti je bërë edhe më tepër një produkt i atij mendimi të ftohtë dhe atij stili të rafinuar që e quajnë francez dhe që i lodh. (EP 76-7)

Liota nuk ishte në pozitë t’iu ndërronte mendjen atyre të huajve. Ai kishte zhvendosur lidhjen e tij me vetë politikën, duke ofruar, në vazhdë të asaj që do të mund ta quanim një çndërtim [*deconstruction*] të presupozimeve të mëherëshme mbi politikën, një gjest pohimi të dyshimtë kundrejt filozofisë, duke propozuar se një *dispositif* politik të cilin ai e përdorte prej kohësh i përkiste gjithashtu resurseve spekulative të asaj praktike. “Vajtja atje” e kishtë shpënë deri në caqet e asaj që ai nënkuptonte me politikë, e kuptuar si një formë agonistike, dhe mbrapsht te një takim me mendimin spekulativ, që mund të jetë tronditur disi, ose jo, prej këtij ushtrimi. A mundet kjo çështje, ky rezultat, t’i shërbejë ndonjë ekzigjence politike – nëse presupozojmë se ajo çka ai kërkonte, atje, mund të thuhet se i përkiste një rendi politik?

Liota nuk ndalon tek kjo çështje. Përkundrazi, ne paraqitemi menjëherë me një tjetër hap në procesin joteleologjik të vetëshpërvetësimit që kemi ndjekur nën emrin e “qëndresës brenda profesionit.” Do ta mbyll përmbledhjen time të sprovës së Liotarit me një citim që paraqet një lloj hedhjeje të përgatitur nga takimi i tij turbullues me filozofinë në caqet e mendimit të tij politik:

Lëshimet ndaj asaj që ti beson se pritet rrallohen. Do të doje të neglizhoje madje edhe atë që dëshiron vetë mendja jote, ta bësh të kapshme për mendimin që ajo nuk e pret. Ti nuk lexon më për të zhveshur autorët, por vetëm për të vjedhur nga vetja. Ke për qëllim këtë shkulturim në çdo drejtim: fantastiko-shkencorja, kinemaja alternative, gjuhësia dhe logjika vetëqenësore [*singular*], përbindësha plastikeje dhe zëri, banalitet habitëse, rilexime të pjerrëta. Je i pabesë në aleancat e tua si barbarët e Clastres-it, por për tjetër arsye, të kundërt më së pakti. Je në luftë me institucionet e vetë mendjes tënde dhe të identitetit tënd. Dhe e di se megjithëkëtë, ekziston mundësia që ti veç po çon përpara filozofinë perëndimore,

libertinazhin e saj të lodhshëm, dhe vetëpërbajtjen e saj të gjindshme. Por të paktën ti di gjithashtu se i vetmi shans (ose shans i keq) për ta bërë këtë bie mbi vënien e filozofisë pranë vetvetes. (EP 77)

E kam quajtur këtë proces një proces shpërvetësimi; Liotar e përshkruan me ngjyra më të forta këtu, si një lloj lufte të brendshme që ndërmerret me shpresën se kesisoj ai do të mund të zhvendosë vetë filozofinë, të cilën ai tanimë e shihnte si horizontin e politikës siç ai e kishte praktikuar deri në atë pikë si militant dhe filozof. Ai nuk e thotë në këtë sprovë, dhe ndoshta nuk mundej ende ta thoshte, por duket qartë në punën e tij të mëpasshme se ai po përgatiste mendimin e tij për eventin.

Do t'i kthehem kësaj pike më vonë. Por tani dua t'i drejtohem asaj që propozova tek *Pretendimi i gjuhës*, dhe që jam i bindur se fare mirë mund të thuhet se ofronte një pedagogji shkatërrimi. Nuk dua ta përsëris argumentin për hir të ndonjë justifikimi retrospektiv, por dua ta marr edhe një herë.

Në fakt, kjo konferencë më bën ta shikoj me atë me tjetër sy, dhe duke iu kthyer sprovës së Liotarit mbi qëndresën, kuptoj se e kam shkruar në rrethana të ngjashme. Në një gjendje thuajse të dëshpëruar, po kërkoja të dëshmoja për dështimin e institucioneve që kishin formuar jetën time intelektuale dhe abstraksionin e dhimbshëm të kontekstit politik në të cilin përpqesha të gjeja një copë vend. Tepër i pasigurt për të thënë se mendimi im më kishte çuar drejt vënies në pikëpyetje të çdo konstrukti politik (në termat e disponueshëm për momentin) në aktin e mësimdhënies, kërkoja të përshkruaj një praktikë mendimi dhe mësimdhënie që do të ishte jo pa efekte politike (sepse kjo nënkuptonte shndërrimin në atë që Dëlëz dhe Fuko [*Foucault*] e kanë quajtur një “intelektual lokal”), por që do të hiqte dorë nga qëllime politike të përcaktuar në përpjekje, një përkpjekje domosdoshmërisht e errët, për të shtyrë deri në ekstrem atë që unë shihja si “qenësinë” e punës në humanitete. Në kushte të perceptimit të shkatërrimit (në nivel institucional dhe politik), po shtyja drejt shkatërrimit në caqet e arsyes që kisha spikatur në veprën e Blanshosë [*Blanchot*] dhe Lakanit [*Lacan*], duke kërkuar, kesisoj, ndonjë çështje të re, ndonjë “realitet” të ri në kuptimin që i jep Selani këtij termi në epigrafin e kësaj sprove.

Teza ime tek *Pretendimi i gjuhës* ishte se humaniteteve do t'iu duhej të rifitonin statusin e një forme kërkimi thelbësor nëse donin t'i mbijetonin kontekstit aktual. Kjo nënkuptonte, pikësisht, siç u përpoqa të sugjeroj, se ato duhet të pohonin se ajo çka ato përpiqen të sjellin me hulumtimet e tyre lidhur me përvojën njerëzore dhe gjuhën (në kuptimin e gjerë të fjalës) është e një rëndësie thelbësore për çdo fushë të orvatjes profesionale dhe çdo dimension të jetës sociale – me çka dua të them se çdo profesion presupozon në një farë mase atë që shtjellohet brenda humaniteteve (duke filluar me vetë nocionin e njerëzores). Shqetësimi im në këto hapa të parë të argumentit ishte pjesërisht pragmatik – po përpqesha të paraqisja një “arsyetim” pro humaniteteve. Por në vazhdim argumentova se ky hap i parë “legjitimues” predikohej mbi eksplorimin e udhës së veçantë gjatë së cilës humanitetet ndoshta do të mund të ofronin një përshkrim konkret të përvojës njerëzore. Doja t'i afrohesha asaj që Hajdeger [*Heidegger*] kishte quajtur një qasje ekzistenciale, por po e bëja këtë duke u nisur nga hulumtimi ontologjik që analitika ekzistenciale duhej të përgatiste. Do t'ju çoja në rrugë të gabuar po të sugjeroja se mora një hap që Hajdeger e kishte skualifikuar haptazi me

“kthesën” e tij të famshme kundër ontologjisë themelore [*fundamental ontology*] në fillim të viteve të 30-të. Por nuk jam tërësisht i sigurt se nuk e ndërmorra, në fakt, atë hap me Hajdegerin kur propozova të mendoj çështjen e njerëzores prej bazamentit të asaj që ai kishte quajtur udha drejt gjuhës, duke hipotezuar se praktika e kësaj udhe, që unë e kam quajtur një pragmatikë, mund të kuptohet si mirëfilli “humanistike.” Këtu, unë pohoj. Humba shumë prej bashkëbiseduesve të mi të mundshëm (kështu mendoj të paktën), sepse në atë udhëkryq që Fuko kishte identifikuar në fund të *Renditja e gjërave* [*Les mots et les choses*], unë mora udhën e një mendimi të *énoncé-së* që Fuko shtjelloi më pas tek *Arkeologjia e dijes* [*Archéologie du savoir*] (e thënë ndryshe, udhën e një mendimi të gjuhës). E bëra këtë, ama, me ndjesinë se po kaloja njëkohësisht mospërmas udhës tjetër që ai pretendonte se ndryshonte prej kësaj të parës – d.m.th. një udhë drejt çështjes së njerëzores.<sup>6</sup> Duhet pranuar se shumica e lexuesve të Fukosë thjesht morën udhën e studimeve kulturore, dhe unë u shkëputa prej shumicës së këtyre përfundimisht.<sup>7</sup> (Humba madje edhe Derridanë në një moment të këtij procesi, sepse vetëm nga fundi i viteve 1990 u bë ai i gatshëm të pohonte çështjen e njerëzores.<sup>8</sup>) Për mua ishte e qartë ama se një mendim rrjedhues i qenies së gjuhës do të na kthente pas tek çështja e njerëzores në një mënyrë që do të tejkalonte caqet e humanizmit. Këtu takova Lakanin, që fliste për “njeriun që vuan shënjesin [*signifier*],” si dhe Blanshonë dhe Liotarin – të tre ishin të vëmendshëm ndaj çështjes së shkatërrimit si në kuptimin socio-politik ashtu edhe në kuptimin e një forme *zbulimi* [*exposure*] të mendimit ndaj diçkaje që tejkalon kapacitetet e tij. Tek mendonin këtë nocion të dytë të shkatërrimit, qëllon që të tre i kushtuan vëmendje të veçantë rolit të fëmijërisë, që Liotar e trajtoi në një nga volumet e tij nën emrin “çnjerëzorja.” Nga njëra anë, argumentoi Liotar, “çnjerëzorja” mund të emërtojë ato procese që veprojnë në rendin bashkëkohor socio-politik si dhe ç’bëhet me njeriun në një rend të tillë, duke qenë se këto forca kërkojnë një zbatim të manifestimeve të padobishme ose të paasimilueshme të fundmësisë [*fnitude*] njerëzore. Nga ana tjetër, ajo mund të emërtojë atë ndaj të cilës njeriu gjendet i zbuluar, pikërisht përmes përjetimit të fundmësisë së tij. Struktura e atij zbulimi, siç unë kisha arritur të kuptoja, i jepej mendimit deri në një farë mase falë rrokjes së asaj që si Benjamin dhe Hajdeger, secili në mënyrën e vet, e kishin quajtur qenësinë e gjuhës.

Argumenti që u përpoqa të zhvilloj këtu ishte relativisht i thjeshtë. Hajdeger kishte treguar se për të menduar qenësinë e gjuhës, të paktën të asaj njerëzore, duhet menduar se si njeriu i falet gjuhës. Nëse “eventi” i gjuhës është i pamendueshëm në mungesë të diçkaje që Hajdegeri e quajti një “përdorim” të njeriut për këtë “ngjarje,” rrjedhimisht udha drejt qenësitë të gjuhës është gjithashtu një udhë në brendësi të këtij përdorimi. E folura ose prania e gjuhës, siç e përshkroi Fuko, gjithmonë mbart një gjurmë të këtij “përdorimi,” kësaj pjese njerëzore në aktualizimin e gjuhës që tejkalon vetë gjuhën. Kuptohet se duke u nisur prej kësaj çdo komunikim i gjuhës, siç e kuptonte Benjamin me nocione si “komunikueshmëria,” ose “përkthyeshmëria,” gjithmonë nënkupton komunikimin e diçkaje nga fundmësia njerëzore, ose nga ajo që unë kam quajtur strukturën e zbulimit që fundmësia njerëzore nënkupton. Pedagogjia që propozova mbi këto baza ishte një pedagogji që nënkuptonte marrjen me komunikueshmërinë e gjuhës në manifestimin e saj material sa herë që ajo shfaqet si *gjuhë*; që është një event që përsëritet kurdoherë që arti, jo vetëm letërsia por çdo art, ndodh. Liotar e përshkroi këtë event si një gjest artistik; por unë mendoj se jam dakort me të në mendimin se vetë mendimi

është gjithashtu i aftë për një gjest të tillë kur mbështetet tek gjuha për të arritur caqet e konceptit.

E thënë ndryshe, duke ndjekur Hajdegerin, po zmbarsesha prej çështjes së gjuhës, që unë e marr si mjetin e punës tonë brenda humaniteteve, drejt pyetjeve rrënjësore rreth qenies së njerëzores, dhe vura re se po i afrohesha pyetjeve rrënjësore që ngre psikanaliza në lidhje me eksperiencën e dallimit seksual, hapjen ndaj realitetit, e kështu me rradhë – ato çështje të origjinës që janë pjesë e ndrydhjes parësore [*primal repression*] dhe pyetjeve të para që bëjnë fëmijët. Po i afrohesha edhe çështjes së *Mitsein*, meqenies, dhe kësaj komunitetit. Që do të thotë se po kapërceja rendin e subjektivitetit dhe çdo marrëdhënie politike që predikohet mbi të. Po shtelloja një pedagogji të shkatërrimit që do të linte pas horizontin e politikës, që unë e kuptoja të ishte horizonti qeverisës i referimit në punën teorike dhe kritike bashkëkohore.<sup>9</sup> Në thelb unë i isha bashkangjitur pedagogjisë së shkatërrimit të Liotarit, duke i kthyer shpinën këtij horizonti të kuptimit për hir të një tjetër mendimi të marrëdhënies.

Kam nënvizuar në përshkrimin e Liotarit të “qëndresës” brenda profesionit mënyrën se si ajo nënkuptonte për të një zhvendosje të asaj që ai quante “politikën e tij” dhe konceptimin e tij të marrëdhënies politike. Dikush mund ta kuptonte këtë zhvendosje si një lloj ndryshimi në qëndrim ose pozicion. Por unë besoj se ai po përshkruante diçka më radikale në përpjekjet e tij për t’u arratisur prej pozicioneve të mëparshme, si ato politikat ashtu edhe ato filozofiket. Ai po kërkonte pragun e kuptimit në një praktikë që në 1988-n e quajti një praktikë “çarrese” – një praktikë që më pas kishte për ta quajtur gjithnjë e më tepër *anamnesis*. Çfarë kërkonte të arrinte ai me këtë? Qysh në 1988-n, ai deklaroi se po kërkonte një dimension të përvojës njerëzore që ishte, siç thoshte ai, i pabindur në raport me çdo rend kuptimi, dhe ai e bëri mjaft të qartë se kjo nënkuptonte qasjen ndaj një dimensionit të përvojës që shmangte politikën tërësisht. Politika, tha ai, nuk mund të mos harronte zbulimin ndaj dallimit që ndodh në marrëdhënien e të-qenit-me në nivelin që jam përpjekur të sjell para jush.

Ajo që nuk mund të trajtohet, që është e pamenaxhueshme një herë e përgjithmonë, dhe ajo që harrohet nga trajtimi politik në krijimin e një “bashkësie” njerëzish falë përkitjes së tyre të njëjtë poli [*polis*], është vetë ajo që nuk mund të ndahet mes tyre, që është e pakomunikueshme apo e përbashkët apo e zakonshme. Quaje lindje dhe/ose vdekje, apo edhe vetëqenësi.<sup>10</sup>

Për shkak të rastit, Liotar citon Nansinë [*Nancy*] në këtë moment, por është e qartë se rreptësia e konstatimit që Liotar po bën rreth politikës këtu e çon më pranë Blanshosë se sa Nansisë. Duke marrë një infleksion më psikoanalitik se Blansho ama, Liotar ndolli një raport me “gjënë,” *la chose*, duke insistuar se ajo nuk mund të përfaqësohet në asnjë ligjëratë, filozofike apo politike, edhe nëse ajo mundon çdo konstrukt, duke përfshirë edhe vetëpërfaqësimin e polit.

Gjëja nuk ka vend, duke qenë se ajo nuk ka ndodhur dhe është “e pranishme” vetëm jashtë përfaqësimit: në lindje, varësia absolute dhe vetëqenësore e dikujt, që pengon çdo prirje të aktualizuar [*instantiated disposition*] të vetvetes të jetë e bashkuar dhe totale. Mund edhe të thosha “dallim seksual,” në kuptimin më

radikal të një heteronimie që nuk i përket kohë-hapësirës së përfaqësimit. Ja pse ajo rrallëherë mund të ndihet në “shpirtin e polit.”<sup>11</sup>

E megjithatë, ai vazhdon me pohimin se ndonëse ajo mezi ndihet brenda polit, ajo mundon ose insiston në formën e një afekti, atë që Frojd quajti një “emocion të pavetëdijshëm,” dhe përsakohë që ajo ndihet në nivel social, ajo angazhon diçka të ngjashme me “shpirtin” e polit, “nëse me ‘shpirt’ ne nënkuptojmë atë pjesë të shpirtit që mbetet peng i gjësë, që mbetet e ndjeshme ndaj ankthit, dhe e pambrojtur.”<sup>12</sup> Këtu, sugjeron Liotar, është terreni i “pakënaqësisë së qytetërimit” dhe në fund paranoja që manifestohet në përpjekjet për ta pastruar trupin social nga kjo rezistencë e pabindur kundrejt rendit të qytetëruar. Do citoj edhe një herë:

“Pakënaqësia e qytetërimit,” ndjesia e mprehtë dhe e vagullt se qytetarët nuk janë të qytetëruar dhe se diçka nuk është e mirë-predispozuar drejt qytetarisë, e gjithë kjo lehtësisht krijon dyshimin se po thuren komplete. Krijohen gjithashtu gjyqje, denoncimi i kokave të turkut, përjashtimi i ksenit [*xenos*], akuzat që bëhen kundër partive kundërshtare, shpife, mllef. Dhe gjithashtu ideja e revolucionit. Polemi [*Polemos*] nuk është babai i gjithçkaje, ai është pjella e këtij raporti të mendjes me diçka që nuk ka lidhje me mendjen. Dhe Polemi është një mënyrë për mendjen për ta harruar atë, për të harruar *coitus impossibilis* që e krijoi atë dhe që nuk rresht ta krijojë atë.<sup>13</sup>

Thashë më herët se vënia në provë mes qëndresës e Liotarit (e kuptuar si rezistencë, e brendshme dhe e jashtme, kundër çdo pritshmërie dhe çdo interesi që kishte ndikuar mbi pozicionin e tij publik në Vincennes) e bëri të vërë në pikëpyetje agonistikën së cilës ai i ishte kushtuar si një mendimtar politik. Kur shkroi fjalët të cilat unë kam cituar, ai ndërkaq kishte arritur kuptimin levinasjan se “të shkosh atje” në një shkrim apo pedagogji të shkatërrimit nënkuptonte të gjeje një qëndrim kryekëput tjetër, një tjetër lloj beteje. Kjo do të qe një punë mosharrimi ose *anamnesis*-i që ndoshta nuk mund të quhej tamam punë.

Kam sugjeruar se “pedagogjia e shkatërrimit” që Liotar ndoqi në Vincennes nën emrin e “qëndresës” ishte në fakt përgatitore. Analiza e tij asketike e formave të retorikës ishte hapi i parë në një arrati që përshpejtohej prej zakoneve të mendjes së tij dhe mekanizmave të mbrojtjes që e çuan drejt një forme radikale shpërvetësimi që ai e identifikoi si një fëmijëri të mendjes. Ishte një pedagogji e ndërsmarrë në një kontekst më të gjërë “shkatërrimi” që çoi në një lloj shkatërrimi. Ishte një proces, siç kam sugjeruar, që nuk ishte dhe aq i ndryshëm me atë që ai ua atribonte artistëve, por edhe pacientit të psikanalizës, një punë thotë ai, që presupozon “të lëmë hapur rrugën falë së cilës mund të vijë ajo që ende nuk ka ardhur,” përmes së cilës mund të ketë një hapje ndaj asaj që vjen.<sup>14</sup> Siç shprehet për Pikason në të njëjtën sprovë prej të cilës sapo kam cituar: “Ai duhet ta lejojë veten të arrijë deri në kufirin e asaj që është përtej atij vetë.”<sup>15</sup> Sigurisht që një pjesë e mirë e shkrimeve të mëvonshme të Liotarit e përvijojnë këtë në veprën e të tjerëve. Por kjo nuk qe thjesht një veprimtari, një punë, komentuese; ajo zhvillohej prej zbulimit të atij vetë ndaj atyre formash zbulimi që ai i përvijoi në muzikë, pikturë ose letërsi – hapjen e tij ndaj “fëmijërisë së mendjes” që kërkonte tek

arti. Shkrimet e tij, mësimdhënia e tij, ishin kësajsoj një përpjekje për të komunikuar atë zbulim, me supozimin apo presupozimin se një komunikim i tillë qe i mundur. Sikur të ishte i mundur, do të thoshte ai. Ai po përpiquej të mendonte atë komunikim dhe ta ekzekutonte atë, sa herë që shkonte atje, tek ai kufi. Dhe kjo praktikë është ajo që unë do ta quaja së fundmi një pedagogji shkatërrimi.

Dikush do të donte ndoshta të theksonte përherë faktin se ai e ndërmori këtë pedagogji për t'i rezistuar një "shkatërrimi" rrethues në nivelin e botës tonë (nëse mund të vazhdojmë ta quajmë rrënimin e shkaktuar prej *Technik*-ut nën motorrin e Kapitalit "botësor") duke iu qasur "shkatërrimit" në nivelin e vetë botës, duke kërkuar një formë rezistence ndaj njëse, duke iu përqsuar tjetrit dhe duke prirë të tjerët (përmes shkrimit dhe mësimdhënies) drejt saj. Dhe dikush mund të pohojë se, për sa kohë që ai u përpoq të praktikonte apo të mësonte njërin për t'i rezistuar tjetrit, praktika e tij, pedagogjia e shkatërrimit, kishte një orientim politik, pavarësisht gjithçkaje tjetër. Nuk do t'i kundërvihesha kësaj pike, por nuk do ta përshkruaja këtë orientim si një orientim të prirë nga ndonjë fund apo *telos* të cilesueshëm. Përkundrazi, do të insistoja se Liotar po praktikonte një ndërprerje brenda një raporti të tillë nëse e kuptojmë atë si një kalim prej dhe përmes një lloj ekzili drejt kthimit eventual tek një rend politik që do të mund ta quanim "njerëzor." Raporti midis çnjerëzores dhe çnjerëzores siç e kuptonte dhe praktikonte ai, nuk lejonte një rikuperim të tillë dialektik. Raporti ishte i tillë që Blansho do ta kishte quajtur të ndërprerë ose asnjansës. Dhe kjo na sjell tek pika thelbësore që dua të ofroj në lidhje me nocionin e një pedagogjie të shkatërrimit, domethënë, se nëse ajo ka për t'ia vlerë, ajo duhet të jetë mërgimtare në kuptimin që Edit Doron i jep këtij termi në këtë volum; e "vërteta" e saj e vetme, qëndron vetëm në kalimin e saj pambarimisht të përsëritur jashtë, drejt asaj që Liotar e cilesoi errësisht me termin minimal "atje." Besoj se ne duhet të jemi të patundur në këtë pikë dhe t'i rezistojmë tundimit për të rifutur kontrabandë pak ngrohtësi politike.

Do të shtoj, megjithatë, se në ato momente kur kam menduar se kam anagazhuar një pedagogji të shkatërrimit (duke eksploruar, për shembull, atë që Blansho thotë kur mbështetet tek fjalët rrënuese të Rober Antelmë [*Robert Antelme*] tek *Specja njerëzore* [*L'Espèce humaine*] "njeriu është i pashkatërrueshëm, dhe kjo do të thotë se ai mund të shkatërrohet pambarimisht") – në ato momente kam përjetuar praninë e pagabueshme të një nguti që sa vjen e zmadhohet etiko-politik.<sup>16</sup> Që do të thotë: sa më shumë i jam qasur asaj që i jam referuar gjerësisht si "shkatërrim," sa më shumë urgjenca e një reagimi të drejtë ndaj vuajtjes njerëzore dhe brishtësisë ka dalë në plan të parë, dhe sa më shumë e kam përjetuar një liri për të trajtuar çështjen e asaj drejtësie. Kjo është arsyeja pse unë besoj se një pedagogji shkatërrimi njëherazi çliron dhe orienton drej mendimit të një raporti etiko-politik që do të mbarte një lloj mosharrese në raport me tjetrin.

Dikush mund të kundërpërgjigjet: po sa gjatë mendon se do të mund ta durojmë këtë kalim në shkretëtirë, duke pasur parasysh efektin e shkatërrimit tjetër që po shpalolet në sferën socio-ekonomike dhe që kërcënon të shkatërrojë kushtet e kësaj forme pedagogjie? Nuk kam një përgjigje të thjeshtë për atë pyetje përveç asaj që ofroi Blansho kur pohoi se qëndrimi pedagogjik që ndërhyt në skenën e përfaqësimit me një qëllim politik është i paevitueshëm. Duhet që gjithmonë të praktikojmë pra një qëndrim të dyfishtë. Të analizojmë dhe të reagojmë ndaj shkatërrimit rrethues në terma kritikë edhe ndërsa ndjekim një rrugë më të pasigurt, mërgimtare. Duhet ta mbar-

tim barrën e kësaj urgjence të dyfishtë dhe kundërshtuese. Edhe një herë, nuk është se nuk bie dakord me këtë, por do të sugjeroja se detyra jonë është të gjejmë mënyra për të menduar fillimisht rrugën (që është rruga e kritikës sociale dhe luftës) prej së dytës, ta bëjmë pedagogjinë e shkatërrimit terrenin për një lëkundje të vazdueshme të konstrukteve tona politike dhe për një rikonceptualizim të tyre. Duhet t'i zëmë besë lëvizjes çliruese që jepet në pedagogjinë e shkatërrimit dhe të bëjmë zbulimin [*disclosure*] e fakticitetit të meqenies faktorin *përgatitor* në të gjithë punimet tona. Rruga është e rrezikshme, por besoj se është pikërisht ajo që na tregon nga një pedagogji shkatërrimi.



## Shenime

- 1 *The Claim of Language: A Case for the Humanities* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 2004).
- 2 *Critique* 369, “La philosophie malgré tout.” Një përkthim në anglisht nga Christophe Gallier, Steven Ungar dhe Barbara Johnson u botua në *Yale French Studies* 63, “The Pedagogical Imperative” (1982), 72–7. Referenca të mëpasshme të kësaj sprove në trupin e tekstit do të paraprihen nga shkurtimi EP.
- 3 Përgjatë kësaj sprove, do ta përdor termin “shkatërrim” kryesisht në dy kuptime. I pari, që reflekton zhvillimet në sferën socio-ekonomike, përshtatet me diagnozën e Liotarit të manifestimeve të atij që ai e quajti thjesht “zhvillim” ose “kompleksifikim” (për këto procese, shih, për shembull, *The Inhuman*, përkth. Geoffrey Bennington dhe Rachel Bowlby [Stanford University Press, 1988]). I dyti është shumë më i vështirë për t’u përkufizuar dhe mbështetet mbi *Shkrimi i Shkatërrimit* (*The Writing of the Distaster*, përkth. Ann Smock [Lincoln: University of Nebraska Press, 1986]). Tepër shpesh, përdorimi i këtij termi nga Blanshoja kuptohet kryesisht në lidhje me Shoahun, kur në të vërtetë ai e përdor më gjerësisht për të ndjellë zbulimin ndaj asaj që ai e quan “asnjanësen e fragmentuar.” Leslie Hill ofron një shpjegim të hollë të këtij termi si dhe një shpjegim të bazave për keqkuptimin e tij të shpeshtë tek *Maurice Blanchot and Fragmentary Writing* (Londër: Continuum, 2012), 279–300. Nga perspektiva e një reflektimi mbi nihilizmin (me të cilin Blansho u morr në vitet 60), është e mundur t’i përafrojmë këto dy kuptime të termit. Ndjellja nga Celani e një qielli që nuk ofron strehim (dëgjojmë këtu *dés-astre* të Blanshosë) na jep gjithashtu një ide të udhës. Duhet të pranoj, megjithatë, se jashtë kontekstit të shkrimeve të Blanshosë termi më duket i tepërt, i bezdisshëm, pasi ai bëhet lehtësisht objekt hipostaze, ose përdoret ca si tepër lehtë, ndonëse ai është shumë i pasur në ndjellje. Por ndoshta ne na duhet të kalojmë një periudhë “qëndrese” para se t’i shpëtojmë barrës së tij.
- 4 Po i aludoj këtu meditimit të Zhak Deridasë tek “The Future of the Profession or the University Without Condition (Thanks to the “Humanities,” What Could Take Place Tomorrow),” në *Jacques Derida and the Humanities*, red. Tom Cohen [Cambridge: Cambridge University Press, 2001], 24–57) dhe kësaj të përmend rrethanat e para në të cilat u përpoqa ta përshkruaj këtë “kundërlëvizje” që shihja të formohej në mendimin e Liotarit mbi pedagogjinë. Dua të falenderoj Simon Morgan që nxiti këto reflektime të para, të cilat kanë ndenjur me mua në formën “munduese” të cilës i jam referuar.
- 5 Jean-François Lyotard, “On the Strength of the Weak,” në *Toward the Postmodern*, Robert Harvey dhe Mark S. Roberts (red.) (New Jersey: Humanities Press, 1993), 62–72.
- 6 I shtraj këto hapa në faqet 62–5 të *The Claim of Language*.
- 7 Po flas pak shkujdesshëm këtu. Në fakt, kthesa drejt studimeve kulturore mu duk mjaft entuziazmuese në fazat e saj të para. Por shumë shpejtë, në Amerikën e Veriut, një doxa politike mori dorën e sipërme që kërkonte një lloj spastrimi të asaj që u bë e njohur si “teori e lartë.” Nuk më duket e arsyeshme t’i rikthehem këtyre debateve këtu por do të theksoja se në këtë kontekst apeli ndaj “teorisë” mu duk gjithnjë e më i varfër e abstrakt. Isha gjithashtu mjaft i shqetësuar për “bërjen socio-shkencore” të një pjesë të mire të punës në humanitete. Sprova që mban titullin e *Pretendimit të gjuhës* u përpoq të trajtonte këtë zhvillim

të mëvonët duke ofruar një version filozofik të natyrës specifike të praktikave të mësimdhënies dhe shkrimit brenda humaniteteve.

*Steps: Maurice Blanchot's Exilic Writings* (Nju-Jork: Fordham University Press, 2013), 34–54.

- 8 Më kujtohet këtu në incident zbatimës që ndodhi në 1993-shin gjatë një konference mbi çndërtimin në Alabama. Sugjerova gjatë kësaj konference se leximit të Hajdegerit në qarqet çndërtuese i mungonte një nocion i “njerëzores” në mendimin e Hajdegerit që nuk mund të përmbahej brenda metafizikës së humanizmit. Argumenti provoki një reagim nga Derrida që do të mund ta përshkruaja vetëm si pasionant (pas ai u ndje i detyruar të kalonte nga anglishtja në frëngjisht gjatë një prononcimi që zgjati ndoshta dhjetë minuta). Termi *l’homme*, tha ai, kishte tepër bagazh dhe nuk mund të shpëtohet. Iu pergjigja në mënyrë modeste se po flisja për “njerëzoren,” dhe jo *l’homme*, por dëmi ndërkaq ishte kryer. Dhjetë vjetë më pas, ama, Derrida do të ndryshonte qëndrim në lidhje me këtë çështje.
- 9 I referohem, në këtë kontekst, specifikisht fushës që në përgjithësi quhet “teori,” dhe dua të ndjell atë që për mua është një dukuri e dukshme, veçanërisht në atë që do të mund ta quaja “tregun” e teorisë – domethënë se që puna të jetë e dobishme, të “ketë vlerë” në mendimin bashkëkohor, ajo duhet të tregojë dobinë e saj politike.
- 10 Jean-François Lyotard, “Unbeknownst,” *Postmodern Fables*, përkth. George Van Den Abbeele (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1997), 186.
- 11 Po aty, 188.
- 12 Po aty, 189.
- 13 Po aty, 190.
- 14 Jean-François Lyotard, “La peinture, anamnèses du visible,” në *Misère de la philosophie* (Paris: Editions Galilée, 2000), 99.
- 15 Po aty, 108.
- 16 E diskutoj fjalinë e Blanshosë tek *Last*



# DESOCIALIZING THE SCHOOL EDUCATION AND THE ACTION-ZONE

Oliver Feltham

## Introduction: Schooling Appearances

When Plato sets out to think the possibility of a just city-state his inaugural gesture is to name a practice that rivals philosophy and its ambition: theater. He then bans its very existence from the republic: theater in-exists in the just city. In his *Eloge de théâtre*, Alain Badiou identifies the rivalry with theater as constitutive for philosophy. That is to say, philosophy does not merely position itself with regard to theater, but comes to a sense of its own identity by excluding the theatrical.<sup>1</sup> The stakes of this rivalry concern none other than the *aisthēsis* – the presentation or appearing – of the city-state itself. In philosophy's attempt to bring order to the appearances of the city-state, it proves impossible to accommodate the practice of theater, precisely because theater consists in an intervention into those appearances. For Plato, theater is a form of degraded imitation. The actor imitates the professions of the city, he presents the mere appearance of *savoir-faire* without being actually anchored in any productive exchange. Both the actor and the playwright are thus subtracted from Plato's grand rule of justice: every person to his or her place and function. It is for this reason that the tragedians are expelled from the city.

For philosophy any rivalry must come to an end; the competitor must be disqualified, silenced, or eliminated. Yet the rivalry with theater, despite Plato's decisive gesture, is not easy to terminate. After banishing theater in Book III of *The Republic*, Plato returns to the question at the end of the dialogue, in Book X, as if he were not quite sure that the question was closed. This time he reinforces his decision with an entire metaphysics, distinguishing three kinds of production anchored in Ideas, copies, and simulacra, theater being relegated to the last category, vehicle of simulacra, copies of copies of Ideas. Yet despite this reinforcement, Plato does not prevent his own dialogue from having a certain theatrics, as generations of commentators have recognized: he populates his stage with tyrants, democrats, sycophantic disciples, young cosmopolites, angry sophists, and the philosopher-king. As Nietzsche notes, Epicurus was the first to

denounce Plato and the Platonists as a bunch of actors.<sup>2</sup> On the other side of the rivalry, theater has often given itself an educational or philosophical role. One can even name certain playwrights – Machiavelli, Sartre, Badiou – who also happen to be philosophers. But in the inaugural Platonic articulation of theater, philosopher and the city-state, any contamination between philosophical and theatrical practice remains implicit if not disavowed. The philosopher – Plato in this instance – would prefer to end this uncomfortable rivalry with theater, he would prefer to win the battle and to have done with theater. To terminate the rivalry the philosopher simply assigns ends – both destinies and goals – to itself and its rival.

Hence, the end of this rivalry for theater is an oscillation between the position of banishment and the position of fusion with the spectacle of society. If philosophy manages to have its way, theater will find itself scapegoated and exiled from the city, roaming the hinterland, or it will find itself relegated to the fate of endless repetitions of the comedy of manners; theater as mere mirror of society.

On the other hand, the end of this rivalry for philosophy – again, if philosophy manages to have its way – is the construction of the school, an institution devoted to the practice of education. However, and this is the crucial caveat, the school can only be properly constructed if the rivalry with theater has come to an end. Philosophy conceives of the school as a distinct space within the city designed to effectuate an induction into its own discipline; that is, the school reproduces philosophy, but not simply by turning out a new generation of philosophers complete with their own original metaphysics. Rather, a school will produce citizens, where a citizen is someone not only capable of acting for the city-state, of sharing office, but also capable of distinguishing, like the philosopher, between the reign of opinion and true knowledge. The citizen, in other words, is capable of *right or true action*. In its attempt to construct and conceptualize the school, philosophy has oscillated between positioning the school as a propaedeutic, as a prophylactic preparation for society, and positioning the school as microcosm, as a mini-society. Despite this oscillation, philosophy has remained constant with regard to one basic proposition: *we school to set the city-state right*.

When it comes to the situation of the contemporary school in Europe we are still thinking in Plato's footsteps. One thing, however, has changed: modernity has overlaid the ancient Greek configuration with another concept, a mediating body: society. We no longer school to set the city-state to rights – that project has been abandoned, at the very least since Hobbes. Under modernity *we school to better society*. Yet at the dawn of the twenty-first century, modernity having drawn to a close, this project has ostensibly failed. The set of phenomena called “society” remain obdurate – they will not enter into any teleology, any story of progress guided by a regulative idea. Educators fail to better society.

If we are to stand on the threshold of a new epoch, then it is time to construct a more adequate concept of the school. The first task in this construction will be to peel back the layer of modernity and remove the school from its position in society: in short, we need to de-socialize the school. The second task, barely begun in this paper, is to resituate this school in what I call the *action-zone*, the space of politics: a concept inspired both by an investigation of political action during the English Revolution and by a reading of Aristotle's theory of factionalism.<sup>3</sup>

To desocialize the school we must first understand how the school is intricated with mass-society under modernity. Two texts, separated by two centuries, will serve to crystallize this relationship: Ivan Illich's anarchist diagnosis of the ills of mass public education in *Deschooling Society* (henceforth, DS), and Adam Smith's construction of the modern concept of society in *An Inquiry into the Origins of the Wealth of Nations*.

### Ivan Illich's Critique of the School in Society

In the 1970s Ivan Illich develops a critique of mass public education as an unnecessary and bureaucratic institution that substitutes formalized procedures, standardized assessments and prepackaged content for genuine learning. He argues, in a jarring anticipation of the neoliberal critique of the welfare state, that mandatory schooling in the form of public institutions is a waste of money. It is inefficient because it does not secure learning experiences for the people. However, what the institutional school does succeed in doing, is creating a social hierarchy, dividing those who make it through standardized school from those who do not. Institutionalized schools create a whole series of social rankings according to just how much school an individual succeeds in completing. The quantity of years spent in school supposedly indicates the exact level of an individual's abilities. In terms of employment opportunities, those citizens with only six years of schooling are divided *de facto* from those who succeed in completing high school. Illich compares the socially divisive power of the school to Durkheim's analysis of the sacred as constituted through a division of society. Note that Illich's argument presumes that society is an organic whole, which is natively non-hierarchical or indivisible. The second major function of the institutionalized school is that it secures its own reproduction by instilling an artificial need in its students, a perceived necessity for even more bureaucratic schooling.<sup>4</sup> Illich goes so far as to claim that "Certification constitutes a form of market manipulation and is plausible only to a schooled mind" (DS 22). This is to borrow an argument from Adam Smith, who, in the *Wealth of Nations* argues that if universities lost their monopoly over the issuing of certifications, academic lecturers would start to actually work hard and become as effective as dance and fencing masters in the transmission of skills.

Illich constructs his argument through a series of antinomies:

- The institution says: "In standardized instruction, teachers judge what students must learn"
- Illich says: "Each individual can decide what to learn"
- The Institution says: 'Only in school can children learn'
- Illich says: "Everyone learns to live outside school" (DS 34).

Elsewhere, Illich does allow that there is a place for planned curriculum and for traditional rote-learning in the transmission of specific skills, such as competence in "algebra, computer programming, chemical analysis, or of manual skills like typing, watch-making, plumbing, wiring, TV repair; or for that matter dancing, driving and diving" (DS 21). However, a preplanned curriculum and rote-learning does not constitute an institutional school. Indeed Illich immediately qualifies this admission by stating that none of these skills should stand as prerequisites for the acquisition of other skills. In

parentheses, let me add that this claim would be fine except for the fact that he begins his list with reading and writing.

Illich continually foregrounds his own conception of learning in contrast to the artificial and uniform imposition of standard curriculum. For Illich, learning happens informally. He claims:

Most learning happens casually, and even most intentional learning is not the result of programmed instruction. Normal children learn their first language casually, though faster if parents pay attention to them. (DS 20)

Learning is the human activity which least needs manipulation by others. Most learning is not the result of instruction. Rather it is the result of unhampered participation in a meaningful setting. Most people learn by being 'with it', yet school makes them identify their personal cognitive growth with elaborate planning and manipulation. Personal growth is growth is disciplined dissidence [ ... ] the learning I prize is immeasurable re-creation. (DS 44-5)

nistrata e Nikolas Sarkozisë kaloi ligjin “Pecresse” që iu jep një farë lirie prej shtetit universiteteve publike franceze në nivelin e buxheteve, burimeve njerëzore, dhe pronave të tyre. Kjo është cilësuar nga disa komentatorë si fija e perit që i ndan ato nga faturat e parregulluara. Në nivelin e studimeve master, e domosdoshmja më e fundit për çdo student amerikan dhe evropian që do të gjejë një punë, shohim një rritje të kurseve profesionale mjaft të specializuara. Fakultetet e humaniteteve ose e pranojnë këtë lojë ose detyrohen të shkurtojnë buxhetet e tyre dhe të humbasin departamentet më pak fitimprurës. Disa nga ata që i kanë ndërprerë studimet e larta – dhe që qëllon që janë edhe multimilionerë, si Mark Zuckerberg – kanë filluar kohët e fundit t’i shtojnë presionit të tregut mbi universitetet duke pretenduar se arsimit i lartë nuk është i domosdoshëm për të arritur sukses. Një nga sloganet më të përhapur të arsimit bashkëkohor është mësimi i tërëjshëm – që nënkupton mësim që ose mundësohet nga kompanitë private ose që krijohet për të përmbushur nevojat e tyre.

### Projekte bashkëkohore mbi të ardhmen e arsimit

Gjithë kjo dihet: ajo që është më treguese në diagnozën e gjendjes së sotme të arsimit është analiza e projekteve bashkëkohore mbi të ardhmen e arsimit. Mënyra më e shpejtë për të kuptuar konfiguracionin e tanishëm është të përcaktojmë se si edukuesit profesionistë e shohin të ardhmen e tyre. Po të mund të shihnim pas me teleskopët e tyre rozë, ndoshta do të mund të shihnim tmerret e të tashmes. “E ardhmja e arsimit” që projektohet në këto momente ngjan me një regjistrim pa tel, të fuqizuar nga mediat sociale, nga poshtë-lart, me hierarki të sheshtë, jomedituese, të rrjetëzuar afekt-ngjarjesh. Mund të presim një epokë përtej *tweeting*-ut mosvijues tek një vijimësi përditësimesh të formës “uaa! Sapo mësova këtë + vegëzë,” ku link shpie tek një fushë-eksperiencë edukative dhe personalisht transformativë, traumatike dhe pastraumatike rryfuese dhe e fiksuar [embedded].

Por ndoshta kjo është të shohim tepër larg: le të përqëndrohemi tek e ardhmja e sotme. Të gjithë kanë dëgjuar për universitetet amerikane që po eksperimentojnë në botën e re dhe të guximshme të “MOOC-ve,” ose *Massive Online Open Courses*. Qindra mijra studentë rreth globit që kanë një lidhje interneti relativisht të shpejtë mund të regjistrohen falas, ose për një pagesë të vogël, ose të konsiderueshme, në një kurs në rrjet që konsiston në një seri leksionesh të xhiruara, disa *Google Groups* për të diskutuar me shokë, dhe ndoshta një provim të automatizuar me shumë zgjedhje që bëhet në rrjet. Nëse ti je dekan i një kolegji të vogël të arteve liberale, mund të jetë shumë më e lirë të blesh hyrje për studentët e tu në Kimi 101 prej një “MOOC” privat se sa të punësosh një profesor kimie.

Akoma më e habitshme, kohët e fundit Bill Gejts ka rekomanduar publikisht një website të quajtur “Khan’s Academy.” Kan kishte qenë një sipërmarrës mjaft i suksesshëm por e la atë botë për të investuar aftësitë e tij sipërmarrëse dhe njohuritë e tij në veprimtarinë shoqërisht të dobishme të edukimit. Rezultati është një platformë kursesh “MOOC” të bëra me porosi për nxënës të shkollave të mesme dhe fillore që sa vjen e zgjerohet dhe që konsiston në video në rrjet të cilat zbërthejnë çdo përfitim aftësie në hapa që janë të thjeshtë për tu asimiluar. Gjenialiteti i Kanit qëndron në integrimin e një sistemi të tillë me strukturën ekzistuese të shkollës publike. Ai e arrin këtë duke bërë një përmbysje. Nëpërmjet videove online të Kanit nxënësi mund të instruktohet

në informacion dhe aftësi në një hapësirë private, në kohën e vet, nën kontrollin e vet: mirazhi i lirisë, lirisë prodhimore. Ajo që mund të ndodhë tani në hapësirën joefikase dhe të regjimentuar të klasës është që mësuesi të mbikëqyrë detyrat e shtëpisë që lidhen me ato video. Kështu, mësuesi jep asistencë të individualizuar me problemet që nxënësit ndeshin gjatë plotësimit të ushtrimeve. Kjo përmbysje e përkryer është shenjë e një ideologjie të re: shkolla bëhet në shtëpi, detyrat e shtëpisë bëhen në shkollë. Kan zëvendëson mësuesin dhe mësuesi prindin.

Slogani publicitar kyç që përdor Kan është se me këtë sistem çdo student mund të ecë me ritmin e tij kur mëson. Nëse një student nuk e kupton një hap, ai mund ta ndalojë videon, ta kthejë pas dhe ta përsërisë hapin. Përndryshe, ai mund të ecë përpara nëse i ka kuptuar ndërkaq hapa të caktuar të mësimit. Ideja, përsëri e marrë nga Adam Smithi, është se individualizimi është efikasitet. Pretendimi i nënkuptuar por më joshës është se për nxënësin individual mësimi nuk do të pengohet më nga nxënësit e tjerë dhe ritmet e tyre më të shpejtë apo më të ngadaltë. Me fjalë të tjera, askush nuk ka për t'u poshtëruar më nga eksperiencia e të qenit i vetmi në klasë që nuk e pranon formulën për mbledhjen e dy numrave negativë apo bezdisur dhe bërë i paduruar nga paaftësia e nxënësve të tjerë për të kuptuar numrat negativë.

Çfarë përvojash humbet nxënësi kania? Është e thjeshtë: mundësinë për të ndihmuar, ose për t'u ndihmuar nga nxënësit e tjerë. Ajo që mungon tek akademia e Kanit është çdo lloj përvoja kolektive e mësimit. Nën thirrjen që i bëhet interesit individual dhe efikasitetit është kritika e barazisë, dhe barazia ka qenë aksiomatike në ndërtimin pasrevolucionar të arsimit publik. Gjithashtu në lojë në akademinë e Kanit është fshirja dhe shuarja e të vetmit zot që rivalizon zotin kapitalist: mësuesi.

Nën dritën e këtij portreti të gjendjes së sotme të edukimit, analiza e Illiçit duket anakroniste, e vjetëruar, madje edhe reaksionare. Para se radikalët dhe mendjendriturit të ndërhyjnë për t'u përgjigjur thirrjes së Illiçit për të shthemeluar shkollat, erdhën neoliberalët, dhe shthemelimi i tyre i rrejtëzuar, i fuqizuar nga mediat sociale, nga poshtë-lart, kundërhierarkik, krijimtari-lehtësues, i shkollës është më tërësor dhe më i rrezikshëm nga çdo të mund të kishte imagjinuar ndonjëherë Illiç. Të jesh progresiv në arsim ditët e sotme do të thotë të bëhesh kundërshtemeltar.

Por Ivan Illiç nuk është tërësisht anakronist; diçka mund të shpëtohet prej analizës së tij.

### Vetëpërtëritja [*sublation*] dialektike e Illiçit

Një këndvështrim më historik dhe më krahasues mbi gjendjen e sotme të arsimit mund të na tregojë shumë gjëra. Nuk është çështja të zgjedhim midis universalizmit burokratik social nga njëra anë dhe universalizmit të mallit [*commodity*] të neoliberalizmit nga ana tjetër. Ka në fakt një farë përputhje midis këtyre dy konfiguracioneve, një përputhje që Illiç e kishte zbuluar. Nga pikëpamja historike, institucionet burokratike të shtetit evropian të mirëqenies sociale të pasluftës krijuan tregje që ishin të përkryer për privatizim nga këndvështrimi i kapitalit: sisteme të plotë shpërndarjeje, një infrastrukturë që po vjetërohej nga pikëpamja teknologjike por të paktën ndërtesat ekzistonin, pronat lokale që ishin siguruar, dhe më së rëndësishmi një treg absolutisht të magjepsur që kishte pikërisht zakonet dhe pritshmëritë e duhura nga pikëpamja e dërgimit të të gjithë pasardhësve në shkollat lokale.

Illic e paraprin këtë përputhje duke bërë lidhjen e tij midis logjikës standardizuese të institucionit, prodhimit të nevojave artificiale, dhe shtrirjes së procedurave të tij në konsumin e mallit. Ai shkruan, “Një shoqëri e tërë futet në Mitin e Konsumit Pambarim të Shërbimeve” (ÇSH 48). Nën këtë dritë, është interesante të vërejmë rritjen e certifikimeve në biznes. Ka standarde ISO për efikasitet dhe madje edhe për përgjegjësi sociale dhe mjedisore – disa kompani bëjnë para duke testuar bizneset për zgjedhshmërinë e tyre për këto certifikata, dhe biznese të tjera bëjnë para duke iu mësuar bizneseve si të marrin provimin për këto certifikata. Kështu pra prej këndvështrimit të Illicit ne nuk duhet të flasim vetëm për mallëzimin [*commodification*] e institucionit, por duhet gjithashtu të pohojmë institucionalizimin e biznesit. Biznesmenët kanë gjithashtu nevojë të lirohen.

Megjithatë, fakti se ai paraprin përputhjen midis institucionalitetit burokratik dhe kapitalizmit nuk është ajo që i jep diagnozës së tij të shkollës së sotme rëndësi. Një tjetër hap duhet bërë.

Përsa i përket parimit të barazisë të trashëguar nga revolucionet franceze dhe angleze, duhet të kujtojmë kritikën e Marksit të kuptimit formalist të barazisë tek *Kritika e programit të Gotës* [*Critique of the Gotha Programme*]. Vetë Illic vëren “rezistenca që Karl Marksi ngriti kundër programit të Gotës që [...] donte të bënte të jashtëligjshme punën e fëmijëve. Ai iu kundërvu propozimit në interes të edukimit të të vegjëlve që mund të ndodhte vetëm në vendin e punës” (ÇSH 30). Në parafrazën e Illicit, *edukimi i të vegjëlve mund të ndodhte vetëm në vendin e punës*.<sup>5</sup> Marksi nuk i kritikoi masat egalitare formaliste në programin e Gotës për të braktisur barazinë në vetvete.

Përkundrazi, ajo që mbetet për t’u menduar, ajo që mbetet një pyetje e hapur për edukimin bashkëkohor progresiv është se si barazia mund të ndodhë jo si matja, krahasimi dhe nivelimi institucional i individëve, por si një eksperiencë kolektive.

Në diagnozën e tij të universitetit burokratik të orientuar si të ishte një shërbim, Illic e krahason atë me modelin origjinal:

Universiteti i vjetër ishte një zonë e çliruar për zbulim dhe diskutimin e ideve të reja e të vjetra. Mjeshttra dhe studentët mblidheshin për të lexuar tekstet e mjeshtrave të tjerë, prej kohësh të vdekur, dhe fjalët plot jetë të mjeshtrave të vdekur u jepnin një perspektivë të re mbi rrejtshmëritë e të sotmes. Universiteti ishte atëherë një komunitet kërkimi akademik dhe trazire të brendshme. (ÇSH 41)

Është e vështirë të kuptosh se si Illic mund të përqafojë autoritetin dhe madje vetë ekzistencën e mjeshtrave, të gjallë apo të vdekur, nëse marrim parasysh parapëlqimin e tij për mësimin informal dhe shkëmbimin e barabartë të aftësive. Por Illic nuk bën thirrje për një ripërtëritje të universitetit të vjetër, ai thjesht përmend pikëmbërritjen e tij. Ajo pikëmbërritje është të jetë një komunitet kërkimi akademik dhe trazire të brendshme. Duhet pranuar se kjo komandë ka një tingull vetëmohues, por më mirë të mendojmë nën shenjën e Servantesit se asaj të shkollës së ekonomisë të Çikagos.

Çfarë, pra, mund të marrim prej Illicit? Një zbulim të thjeshtë. Institucionalizmi i arsimit ndodh sepse ne mendojmë se *shkollojmë për të përmirësuar shoqërinë*. Kjo është bindja themelore në zemrën e shkollës së institucionalizuar. Në momente krize, gjatë periudhave kur çdo institucion publik që ende nuk është privatizuar duket sikur po











shkërmoqet, ne vazhdojmë të besojmë se shkollojmë për të përmirësuar shoqërinë; jo vetëm për të përmirësuar individë të caktuar, por për t'i përmirësuar ata për sa kohë që ata do të bëhen pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë. Arsimesi nuk mund ta fshijë perspektivën komunitare holistike nga institucionet e shoqërisë tonë individualiste. Është pikërisht kjo bindje që na çon në shumë rrugë pa dalje, si pedagogjike, lidhore dhe financiare.

Të ballafaquar me këto impase, ne duhet të përmbysim komandën e Illiçit. E thënë ndryshe, çështja nuk është më që të çshkollojmë shoqërinë, çështja është të *çshoqëri-zojmë shkollën*. Problemi nuk është shkolla, problemi është shoqëria, dhe mbajtja e saj e shkollës. Shkolla ka nevojë të hiqet nga shoqëria, dhe të zbulohet ndaj asaj që unë e quaj zona e aksionit.

Kjo komandë prodhon tre pyetje:

- Çfarë është shoqëria për shkollën?
- Çfarë është zona e aksionit? Dhe,
- Si mundet një shkollë të zbulohet ndaj një zone aksioni?

### Çfarë është shoqëria?

Tek *Teoria e ndjenjave morale*<sup>6</sup> (që këtej e tutje, TNM), dhe *Një Hulimtim mbi origjinat dhe pasurinë e kombeve* të Adam Smithit gjejmë një kritikë të arsimit nën feudalizëm (për të qenë të saktë, një sulm ndaj gildave dhe punës së çirakut si shtrembërime të tregut) dhe ndërtimin e një koncepti të shoqërisë. Koncepti i shoqërisë i Smithit ka tre elemente bazë:

- Shoqëria lind nëpërmjet ndërveprimeve njerëzore kur çdo individ gjykon veprat e tjetrit;
- Shoqëria është një institucion skalar në kuptimin se ajo përfshin shkallët mikro ose lokale në atë makro ose globale.
- Ideja rregullatore e shoqërisë është progresi, progresi për individin në formën e lëvizjes sociale, e ngjitjes në shoqëri; dhe progresi për shoqërinë në formën e kompensimit për, ose eliminimin e, lëngatave kolektive.

Shoqëria lind si rezultat i ndërveprimit njerëzor për sa kohë që çdo person gjykon veprimet e tjetrit sipas kriterëve morale. Në teorinë e ndjenjave morale, Smith argumenton se ne i formojmë gjykimet tona mbi veprimet e njerëzve të tjerë, dhe të veprimeve tona duke imagjinuar se si një spektator asnjans do ta gjykonte veprimin. Spektatori asnjans është kështu një version modern *imagjinar* i *phronimos*-it të vërtetë të Aristotelit, një burrë i matur ose i urtë si model për gjykimin e mënyrës se si duhet vepruar në situata të ndërlukuara dhe të pazakonta. Spektatori i imagjinuar është kështu një lloj norme e përbrendësuar. Kështu, shoqëria nuk është një bashkësi njerëzish por një garanci e ndërveprimit të lëmuar të një grupimi koherent normash.

Shoqëria është një konstrukt skalar në kuptimin se ndërveprimet lokale prodhojnë cilësi globale si norma apo zakone morale. Vendimi për të blerë apo mos blerë një mall me një çmim të caktuar çon në luhatje në treg, duke ndryshuar normat e fitimit e më pas të investimit, dhe pastaj ato të prodhimit tregtar, duke shkaktur “korrigjime” të tregut. Me fjalë të tjera, ndërveprimet lokale shkaktojnë dukuri makro si dora e pa-dukshme.<sup>7</sup> Ndërtimi skalar i shoqërisë është po ashtu një komandë normative. Duke vendosur një mekanizëm të menjëhershëm që lidh mikron me makron – dorën e pa-

dukshme – Smith zëvendëson funksionin e trupave të ndërmjetëm korporativ ose racionalë, si gildat, ose “çifligjet” dhe “korporatat” në terminologjinë e Hegelit. Qëllimi i Smithit është të verë në vend një individualizëm atomik dhe të çlirojë veprimin e dorës së padukshme për të prodhuar kolektiva që janë tërësi të pastra të veprimit strukturalisht unifom individual, pa asnjë trup ndërmjetësues. Sigurisht që në shoqërinë e Smithit ka tre kategori të përgjithshme aktorësh ekonomik – tregtarët, pronarët dhe punëtorët. Megjithatë, këto grupe nuk krijojnë faksione ose klasa, por përkundrazi i përkasin zonave të ndërvarrura të praktikës ekonomike.

Vetitë skalare të shoqërisë lindin falë përfshirjes zig-zage, bishtdallëndyshe dhe ndërvarrësisë të praktikave të ndryshme ekonomike dhe ligjore mbi modelin e zinxhirit të furnizimit. Kujtoni panegjirikun e Robert Smithit për bashkëpunim tregtar në fund të kapitullit të parë të librit të parë të *Pasurisë së kombeve*. Imagjinoni numrin e prodhuesve që duhet të bashkëpunonin, pa u takuar asnjëherë, për të prodhuar gjithë pjesët përbërëse të palltos së punëtorit. Le të kremtojmë bashkë me Smithin ndërvarrësinë ekonomike të praktikave sociale mbi modelin e zinxhirit të furnizimit, dhe të kristalizuar tek produkti si mikrobota themelore e bashkëpunimit social. Çdo praktikë ekonomike përforcon kësaj ekzistencën e praktikave të tjera ekonomike, pa bërë të domosdoshme ekzistencën e ndonjë praktikanti individual. Që do të thotë, vërtetë se që fabrika ime të funksionojë unë kam nevojë për një llogaritar, një avokat, dhe shërbime pastrimi, ama unë nuk varem mbi ndonjë llogaritar të caktuar, apo ndonjë avokat të caktuar, apo ndonjë shërbim pastrimi të caktuar sepse asnjë veprues nuk ka monopol në asnjë prej atyre tregjeve. Ky është vizioni liberal i riprodhimit institucional *avant la lettre*. Para ndërtimit të institucioneve masive sociale që kritikon Illic, si shërbimi kombëtar shëndetësor, ose arsimit publik, vetë shoqëria angazhohet në riprodhimin e saj formal. Të drejtosh një fabrikë është të sjellësh në jetë një shërbim llogaritar dhe një shërbim ligjor dhe një shërbim pastrimi, e kështu me rradhë. Së fundmi, për Smithin, ekzistenca e cilësive si dora e padukshme është provë e synimit dhe teleologjisë në përbërjen e kozmosit.

Elementi i tretë në konstruktin e konceptit të shoqërisë së Smithit është ideja rregullatore e progresit: progresi për individin në formën e lëvizjes sociale; progresi për shoqërinë në formën e reformës dhe të eliminimit të problemeve kolektive. Për sa i përket individit, Smith pohon shkallët shoqërore jo për t’i shndërruar në gjëra konkrete, si në feudalizëm, por për të ankoruar lëvizjen sociale si premtimin kyç të një shoqërie tregtare. Premtimi i lëvizjes sociale është efektiv sepse njerëzit kanë dëshirë të barazohen me ata që gjoja janë sipër tyre (TNM, I, III, 2). Ai premtim, për turmën e individëve, është, Smith pohon, një iluzion. Për sa i përket progresit për shoqërinë në tërësi, shembulli kyç nga Smith do të ishte rekomandimi i tij i arsimit universal të detyruar si një panacea, një kompensim për degradimin e pashmangshëm mendor e një pjese të mirë të popullatës që rezulton nga aplikimi i gjerë i ndarjes së punës. Smith e fillon *Pasurinë e kombeve* duke rekomanduar një intensifikim të menjëhershëm të ndarjes së punës në interes të rritjes së efikasitetit të prodhimit dhe të pasurisë së kombit, ose rezervave ekzistuese të mallit. Edhe në vetë veprën e Smithit, e vërteta e llahtarshme duket qartë – sigurisht, ne shkollojmë për të përmirësuar shoqërinë, por në të vërtetë shoqëria nuk ka për t’u përmirësuar ndonjëherë. Dhe kështu ne duhet të vazhdojmë të shkollojmë.

Nëse shoqëria përcaktohet si një cilësi që lind, si skalare dhe si premtimi i progresit, si atëherë pozicionohet shkolla në lidhje me të?

### Pavendosmëria e shkollës

Mbi bazat e një hulumtimi në konceptimin e Lakanit [*Lacan*] të aktit psikanalitik, dhe të shkollës analitike në seminarin e tij të 1967/8-s, bëhet e qartë se shkolla pozicionohet në raport me shoqërinë në një nga dy mënyra:

- a. Një shkollë mund ta pozicionojë veten si një propedeutik ndaj shoqërisë, si një përgatitje e mbrojtur për shoqërinë. Kësisoj shkolla mbron nxënësin e vogël nga të këqijat shoqërore ndërsa e pajis atë me aftësi dhe resurse të mjaftueshme për t'i kapërcyer këto të këqija kur del në shoqëri.
- b. Mënyra e dytë se si shkolla mund ta pozicionojë veten në raport me shoqërinë është si një mikrobotë. Kjo duket qartë si në kopshtin e lojrave dhe në klasën e mësimt, dhe në korridor. Si mikrobotë, shkolla jo vetëm riprodhon të gjitha të këqijat shoqërore, ajo edhe i koncentron disa prej tyre, ajo përdor gjithashtu disa prej mekanizmave rregulluese të vetë shoqërisë dhe premtimin për progres individual.

Për shkollën, problemi që paraqesin këto dy pozicione është se ato programojnë dështimin e saj. Nëse një shkollë e kupton veten si propedeutike, ajo krijon një mjedis të mbrojtur artificialisht, si një serë për lule ekzotike, dhe kësaj nuk i përgatit nxënësit e saj për realitetet e shoqërisë. Ndonëse ata mund të vazhdojnë të jetojnë dhe të punojnë në fusha të tjera artificiale dhe të mbrojtura, si në komunitete të rrethuara dhe në kompani të teknologjisë informatike. Nëse, nga ana tjetër, shkolla kuptohet si një mikrobotë, ajo i zbulon nxënësit e saj tepër herët ndaj realiteteve të shëmtuara të shoqërisë, që pengojnë procesin e duhur të arsimit. Në përpjekje për t'i korrigjuar këto dështime një shkollë thjesht hidhet tek pozicioni tjetër, ai propedeutik, dhe kësaj nuk i nënshtrohet problemeve të propedeutikut.

Duke pasur parasysh këtë cikël dështimi të nxitur strukturalisht, ka ardhur koha për ta ripunuar komandën e Illiçit, dhe për ta hequr shkollën nga shoqëria. Të heqësh shkollën nga shoqëria do të thotë të zhbësh mikro-makrobotën, hierarkinë gjoja dinamike, dhe ndërmjetësimet midis individit dhe imazhit të rremë të tërësisë, ose të zotit. Në një shkollë të çshoqërizuar nxënësit nuk do të grupoheshin në bazë të moshës, as të aftësive të matura, as të profesorit por të organizimit të tyre të shkëmbimit të aftësive dhe projekteve. Ta heqësh shkollën nga shoqëria nuk do të thotë ta lësh të varet në një boshllëk individualizmi. Përkundrazi, shkolla duhet të futet në zonën e aksionit; që do të thotë, në realitetin e jetës politike që gjithmonë ka qenë i fshehur në sipërfaqen e shoqërisë.

### Zona e aksionit

Hetimi, tek *Anatomi Dështimi* [*Anatomy of Failure*], i një epizodi të veçantë gjatë Revolucionit Anglez, aleanca e pasigurtë midis aktivistëve të Rrafshuesve [*Levellers*] dhe *New Model Army*, çoi në një pragmatikë spekulative të aksionit politik dhe krijimit të konceptit të domenit të politikës si një zonë aksioni. Një zonë aksioni është një shumësi veprimesh që përkohet pjesërisht që janë ontologjikisht dhe epistemologjikisht të paplota. Domethënë, brenda zonës së aksionit çdo gjykim i ekzekutuesit, natyrës dhe synimit të një veprimi dështon plotësisht të rrokë shumësinë e plotë të kapacitetit të

tij veprues dhe pasojave të tij. Në zonën e aksionit të gjitha kapacitetet për veprim janë pareduktueshmërisht të shumëfishta dhe nuk është e qartë se ku mbaron përgjegjësia ime e ku fillon e jotja. Pritja e çdo veprimi përbën pasojat e tij, por pritja e një veprimi mund të ndodhë vetëm nëpërmjet veprimesh të mëtejshme. Nuk ka asnjë moment kur të gjitha veprimet pushojnë, dhe dikush mund të vlerësojë se çfarë po ndodh, apo atë që sapo ka ndodhur, pasi të vlerësosh është në vetvete një veprim, dhe veprimet nuk pushojnë kurrë.

Ta vësh shkollën brenda zonës së aksionit është t'i zbulosh studentët ndaj realitetit ontologjik të zonës së aksionit. T'i zbulosh studentët ndaj këtij realiteti do të thotë t'i bësh të kuptojnë paraqitjen, shfaqjen, e zonës së aksionit, dhe t'i bësh të rindërtojnë këtë shfaqje me fjalët e tyre.

Detyra e rradhës është kësaj që kuptojmë se si zona e aksionit paraqitet. A ndodh që vetë qenia e një veprimi politik, përtej gjykimit, nënkupton një lloj të caktuar paraqitjeje? Në një sprovë të kohëve të fundit mbi statusin e teatrit dhe estetikës në filozofinë e Alen Badiusë dhe tek Aristoteli unë tregoj se është e mundur ta mendosh shfaqjen e një aksioni politik që zbulon zonën e aksionit si një lloj *arqiteatri* [*architheater*].<sup>8</sup> Si tek Aristoteli, ky arqiteater përfshin paraqitjen e *praksit*, paraqitjen e një aksioni të zgjatur.

### **Poetika e Aristotelit**

Në përkufizimin e tij të tragjedisë tek *Poetika*, Aristoteli cilëson se një tragjedi është pikësëpari imitimi i një veprimi, dhe jo i njerëzve. Kjo do të thotë se njerëzit që po luajnë, personazhet, janë në vend të dytë, ndahen në dukuri (Kreu 6, 1450b1). Kjo përputhet plotësisht me konceptin tim të zonës së aksionit ku çdo kapacitet i fundëm veprimi është gjithmonë një mbifenomen [*epiphenomenon*].

Më së tepërmi, Aristoteli shpjegon se ky imitim i një veprimi nuk ndodh nëpërmjet historisë [*narrative*] por krijohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga njerëzit në veprim:

Ka një dallim të tretë midis këtyre arteve që ndodh për shkak të mënyrës së imitimit. Duke përdorur të njëjtat mjete dhe objekte dikush mund të imitojë duke treguar një histori (ose nëpërmjet gojës së dikujt tjetër [duke marrë rolin e një personazhi përveç tëndit], siç bën Homeri, ose duke ruajtur personalitetin e tij pa e ndryshuar atë) ose duke i paraqitur të gjithë personazhet sikur të ishin duke luajtur (ose të përfaqësosh personazhet sikur të ishin duke e kryer gjithë aksionin vetë.) (Kreu 3, 1448a20)

Kështu pra veprimet janë parësore por paraqiten nëpërmjet “personazheve” që aktivizohen nga këto veprime. Këto personazhe na lejojnë që t'i cilësojmë ose t'i kuptojmë veprimet nga pikëpamja ose e personave ose e mendimit (Kreu 6, 1450a1). Me fjalë të tjera, ne pashmangshmërisht i kuptojmë veprimet sipas kategorive të *kush* dhe *çfarë*: kush po vepron (për çfarë lloj personi bëhet fjalë), dhe çfarë po mendonte ai ose ajo nëpërmjet këtyre veprimeve (për çfarë lloj qëllimi bëhet fjalë). T'i transferosh këto cilësime aristoteliane tek zona e aksionit, veprimet paraqiten kësaj si një mendim, një plan ose strategji, ose si efekti i një kushi, një lloj personi, me zakone dhe pasione të caktuara, një pozicion subjektiv të caktuar, qoftë tiran apo dashnor, etj. Shumësia e

papërcaktuar e aksioneve të ndërthurura mund kësisoj të *mbulohet* ose *homogjenizohet* me një person, fiksohet në një emër të përveçëm, ose me një strategji, ku një strategji është një vijimësi ideale veprimesh që supozohet se përfundon në një fund të fundëm dhe të qëndrueshëm.

Aristoteli cilëson gjithashtu se tragjedia është imitimi i një veprimi fisnik. Trajtimi më i drejtpërdrejtë i veprimit konkret politik nuk është përkufizimi i famshëm i veprimit vullnetar tek *Etika e Nikomakut* por teoria e faksionalizmit që zhvillohet tek Libri v i *Politikës*.

#### **Faksionalizmi tek *Politika* si paraprirje e zonës së aksionit.**

Aristoteli e nis teorinë e tij të faksionalizmit duke vënë në dukje se pasuria, përkryeshmëria, dhe liria janë vlera që grupe të veçanta brenda qytetit mund të thonë se i kanë për karakteristikë: fisnikët kanë përkryeshmërinë, pasanikët pasurinë, dhe populli lirinë. Secili prej këtyre grupeve pretendon se shpërndarja e të mirave në qytet nuk është e drejtë pasi ajo nuk rregullohet sipas vlerës ose karakteristikës së tyre. Si pikë referimi këto pretendime marrin gjithmonë barazinë dhe pabarazinë. Për shembull, fisnikët pretendojnë se ata nuk janë të barabartë me të tjerët, ose se ata janë superiorë, për shkak të përkryeshmërisë së tyre. Siç thotë Aristoteli:

Njerëzit janë dakord se drejtësia, e menduar në mënyrë abstrakte, është e përpjesshme, por ata nuk bien dakord se nëse janë të barabartë në ndonjë aspekt, janë absolutisht të barabartë; të tjerët se nëse nuk janë të barabartë në ndonjë aspekt, duhet të jenë të pabarabartë në të gjithë aspektet. (v, 1, 1301b35–8)

Meqenëse fisnikët pretendojnë se janë superiorë nga pikëpamja e virtytit ata mund të pretendojnë gjithashtu se janë superiorë nga pikëpamja e vlerave të tjera të rëndësishme politike, si pasuria, liria, dhe pjesa e pushtetit politik që iu takon. Pasanikët nga ana tjetër, theksojnë se ata janë superiorë nga klasat e tjera për shkak të pasurisë së tyre. Ata pretendojnë pas kësaj se duhet të jenë superiorë ndaj klasave të tjera nga pikëpamja e lirive të tyre, pushtetit politik, dhe pohimit të përkryeshmërisë së tyre. Populli, nga ana tjetër, bën një pretendim të përmbysur: ata thonë se ne jemi të barabartë me të gjitha klasat nga pikëpamja e lirisë tonë, dhe kësisoj duhet të jemi të barabartë me to edhe nga pikëpamja e pasurisë, përkryeshmërisë, dhe ushtrimit të pushtetit politik.

Është pretendimi që lidhet me ekzistencën e padrejtësisë brenda qytetit ajo çka garanton solidaritetin dhe përbashkësinë brenda grupit. Për shembull, nëse pasanikët nuk gëzojnë fuqi politike në përpjestim me nivelin e pasurisë që kanë, kjo do të thotë se grupet e tjera brenda qytetit, fisnikët dhe të varfërit, po gëzojnë tepër pushtet politik. Fisnikët dhe të varfërit janë ata që gëzojnë pushtetin politik që me të drejtë i takon pasanikëve: ata janë faktorë për shpronësim, vjedhje. Unë kam solidaritet për të gjithë bashkëqytetarët e mi të pasur për sa kohë që të gjithë ne jemi robtuar nga pjesa jonë e saktë në pushtetin politik.

Për pasojë, çdo grup formon atë që Aristoteli quan një faksion (*stasis*). Një faksion ekziston si një veprim kolektiv që kërkon ndreqjen e një padrejtësie dhe një kthim tek drejtësia. Fisnikët kërkojnë pushtet politik në përpjestim me përkryeshmërinë e tyre, dhe të zvogëlojnë pushtetin e tepërt politik, pasurinë dhe lirinë e pasanikëve dhe të

varfërve. Pasanikët kërkojnë pushtet politik në përpjestim me pasurinë e tyre, dhe kërkojnë të zvogëlojnë pushtetin e tepërt politik, të ashtu-quajturën përkryeshmëri dhe liritë e fisnikëve dhe të varfërve. Të varfërit kërkojnë pushtet politik në përpjestim me lirinë e tyre dhe kërkojnë të zvogëlojnë pushtetin e tepërt politik, të ashtu-quajturën përkryeshmëri dhe pasurinë e fisnikëve dhe pasanikëve.

Secili prej këtyre projekteve është në konflikt me projektet e faksioneve të tjera: është vetë përpjekja për të ndrequr padrejtësinë nga ana e popullit që çon në perceptimin e rritjes së padrejtësisë kundrejt tyre nga pasanikët ose fisnikët. Për sa kohë që këto pretendime kundërshtuese për drejtësi janë aktive, konflikti nuk mund të marrë fund. Ky është rezultati më i befasishtëm i teorisë së Aristotelit të faksionalizmit: drejtësia duhet të jetë përgjigja ndaj konfliktit politik: ajo duhet të sigurojë paqe dhe një fund relativ të mosmarrëveshjeve politike kur vendoset, përkundrazi, me teorinë e tij Aristoteli tregon se si perceptime të caktuara të drejtësisë janë në fakt vetë shkak i konfliktit politik.

Mund të nxjerrim gjashtë pasoja nga teoria e Aristotelit të faksionalizmit për konceptin e zonës së aksionit.

1. Çdo faksion përbën atë që unë quaj një kontekst për pritjen e veprimeve. Çdo kontekst përbëhet nga shumë veprime të kaluara, të tashme dhe të ardhme. Një kontekst bashkohet nga një projekt politik që pretendon për drejtësi duke u bazuar në një vlerë të caktuar qytetare (pasuria, përkryeshmëria ose liria për Aristotelin, liria e ndërgjegjes për disidentët anglezë).
2. Për sa kohë që secili prej këtyre projekteve politike prodhon padrejtësi të mëtejshme nga perspektiva e konteksteve të tjera, këto kontekste nuk janë thjeshtë të ndryshëm por “ndarë.” Një qytet-shtet është shumës – siç pohon Aristoteli kundër përpjekjes së Platonit për bashkim tek *Republika* – jo vetëm për shkak të larmisë së llojeve të njerëzve që banojnë në të, por për shkak të ndarjeve midis konteksteve të tij, faksioneve.
3. Veprimet politike përshkojnë kontekste të shumta, por ato shfaqen ndryshe në çdo kontekst. Rrjedhimisht, midis konteksteve të ndryshme nuk mund të ketë mirëkuptim në lidhje me veprimet që duhen ndërmarë për të përmirësuar situatën e të gjithë trupit politik.
4. Nëse përpjekje të ndryshme për të ndrequr padrejtësinë e qytetit prodhojnë padrejtësi të mëtejshme për shkak të veçantive të tyre, atëherë ato rrisin gjithashtu nevojën për dëmshprëblim dhe kompensim. Rrjedhimisht, gjithë veprimtaria politike çon pashmangshmërisht në më tepër veprimtari politike; ky proces nuk përfundon asnjëherë me një gjendje të qëndrueshme apo të kënaqshme. Siç vë në dukje Aristoteli, veprimi, në kundërshtim me prodhimin, nuk rezulton në mëvetësinë e një substance të identifikueshme dhe ontologjikisht të qëndrueshme.
5. Nëse çdo faksion e kupton një veprim kryesisht prej perspektivës së tij: nuk ka një regjistrim të ndonjë qenie të tërthortë të një veprimi apo të një të mire të “përbashkët.” Nuk ekziston pra mundësia e një mirëkuptimi jo vetëm mbi çfarë duhet bërë, por gjithashtu mbi atë që ndërkaq është bërë.
6. Meqenëse ka më shumë se dy faksione – tre në modelin e Aristotelit, që është relativisht i thjeshtë – ajo që ndodh është një garë që është më e ndërlikuar se një cikël



hakmarrje, ose lufte klasash, të dyja prej të cilave kanë një strukturë dyjare [*binary*]. Në zonën e aksionit nuk ka humbës dhe fitues të qartë.

### Paraqitja e zonës së aksionit dhe shkollës

Nëse zona e aksionit përbëhet nga një shumësi veprimesh të cilat pozicionohen si reagime ndaj njëra-tjetrës, nëse nuk ka një mirëkuptim midis atyre që i kryejnë ato, natyrës së tyre, synimeve të tyre, dhe shtrirjes së pasojave të tyre, atëherë paraqitja e këtyre veprimeve nuk do të mund të ishte asnjëherë koherente dhe organike. Nuk do të japë një unitet sintetik. Paraqitja e këtyre veprimeve do të zhbëjë dhe do të zbulojë caqet dhe dështimin e çdo përpjekje për t'i caktuar një unitet organik si qytet-shtetit ashtu edhe veprimeve nga të cilat ai përbëhet. Aristoteli thotë se veprimet paraqiten nga pikëpamja e “kush-it” dhe e “mendimit.” E thënë ndryshe, teatri i veprimeve ka të bëjë me *kush i bëri çfarë kujt?* dhe, më së tepërmi, *çfarë po mendonin kur e bënë atë?*

Rrjedhimisht, një teatër i zonës së aksionit ka për të ndërlikuar dhe shumëfishuar termat e kësaj fjalie:

Kush/çfarë/kujt  
bëri/iu bë  
çfarë/kujt/kush  
ndaj/prej  
kujt/kush/çfarë?

Kjo fjali e ndërlikuar është një matrisë për mbipërcaktimin e veprimeve brenda zonës së aksionit. Avantazhi i këtij matrisë është se ai na lejon të rrokim disa paraqitje pozitive të zonës së aksionit:

- Për shembull, zona e aksionit shfaqet kur bëhet e qartë se kur unë veproj, të tjerët veprojnë nëpërmjet meje, se kapaciteti im për të vepruar parazitohet tek ose ndahet me të tjerët – ky është ai lloj zbulimi që mund të ndodhë gjatë psikanalizës, kur mekanizmat e dëshirës së tjetrit dalin në dritë nëpërmjet shfaqjes së kryeshënjesve nga pavetëdija.
- Zona e aksionit shfaqet gjithashtu kur bëhet e qartë se të tjerët e kanë pritur veprimin tim jo ashtu siç unë synoja dhe po përgjigjen në pajtim. Nuk është thjesht çështje keqkomunikimi këtu, e synimeve të keqkuptuara, ose edhe e predispozitave të këqia nga ana e tjetrit, keqinterpretimit të qëllimeve të mia, por të vetë shfaqjes së veprimit tim në një kontekst që ndryshon nga imi. Domethënë, pasi unë kuptoj shfaqjen dhe pasojat e veprimit tim në këtë kontekst jofamiljar, unë menjëherë kuptoj pse ai interpretohet kaq ndryshe.

Duke marrë parasysh këtë matrisë të paraqitjes të zonës së aksionit, çfarë do të thotë ta vësh shkollën në zonën e aksionit?

Më sipër thashë se ta vësh shkollën brenda një zone aksioni është t'i zbulosh të vegjëlit ndaj realitetit ontologjik të zonës së aksionit. T'i zbulosh të vegjëlit ndaj këtij realiteti është t'i bësh ata të kuptojnë paraqitjen, shfaqjen, e zonës së aksionit. Të kuptosh një paraqitje të tillë është ta rindërtosh atë sipas mënyrës tënde. Shkurt, foshnja dhe fëmija duhet të futen në realitetin e politikës pa maska ose norma ose spektatorë

asnjëanës ose funde të lumtura – në fund të fundit, kush më shumë se fëmija i njeh peripecitë e veprimit falë miqësive dhe armiqësive që ai ka?

Të rindërtosh paraqitjen e zonës së aksionit është thjesht të vësh në skenë një dramë, por një dramë të ankoruar në të kaluarën e vonëshme, në atë që sapo ka ndodhur në politikë. Të vësh në skenë një dramë, një dramë që rindërton kompleksitetin e plotë të punëve të qytetit, është t’i kuptosh ato punë dhe të jesh i aftë t’i rindërtosh ato. Të vësh në skenë një dramë është të zotërosh një mori aftësish. Shkolla e çshoqërizuar është periudha e punës si çirak në teatër, teatrin e zonës së aksionit.

Si arritëm deri këtu? Kërkoji një fëmije ta tregojë.

## Shënime

- 1 Alain Badiou, *Eloge du théâtre* (Paris: Flammarion, 2013), 31–2.
- 2 Sh. §7 në Friedrich Nietzsche, *Beyond Good and Evil*, përkth. R.J. Hollingdale (Londër: Penguin, 1973), 20.
- 3 Sh. Oliver Feltham, *Anatomy of Failure: Philosophy and Political Action* (Londër: Bloomsbury, 2013).
- 4 Illiç shkruan, “Shkolla e bën tëhuajësimin parapërgatitor për jetën, duke i mohuar shkollës realitetin dhe punës krijimtarinë. Shkolla përgatit për institucionalizimin tëhuajësues të jetës duke mësuar [teaching] nevojën për t’u mësuar [to be taught]” (ÇSH 51).
- 5 Në një intervistë të bërë disa vite më parë, Alen Badiu ndjek hapat e Marksit duke rekomanduar reformimin e shkollës së mesme franceze nëpërmjet masave në vijim. I gjithë shkollimi i detyruar do të hiqet për vitet e fundit të shkollës nëntëvjeçare. Midis moshës katërbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç, adoleshentët do të dërgohen në punë për të fituar një “orientim punëtor” të plotë dhe të thellë para se t’iu rikthehen, tashmë të motivuar, studimeve të larta. Kjo intervistë është publikuar në fund të Oliver Feltham, *Alain Badiou: Live Theory* (Londër: Continuum, 2008).
- 6 Vini re se Turgot është i pari që zhvillon një meditim mbi luhatjet e çmimit të rregulluara nga kërkesa dhe oferta. Turgot, *Le commerce des grains: Projet de lettre au contrôleur général Bertin sur un projet d’édit*, 1763. *Réflexions sur la formation et la distribution des richesses*, 1766: [http://fare.tunes.org/books/Turgot/refl\\_fdr.html](http://fare.tunes.org/books/Turgot/refl_fdr.html)
- 7 Oliver Feltham, “Aesthetics of Action: Theater in Badiou and Aristotle,” referatë e papublikuar dhënë tek Universiteti i Torinos (6 qershor 2013).

# SANDY HOOK UNIVERSITY

## POETIC VIOLENCE, SCOPE, AND STYLE OF IMAGINATION

Adam Staley Groves

*The aspirations of the student go beyond functionarian enclosure, it reaches from its self-other in technics and extends the term in this moment of silencing, to an opening. The term is the terminology evincing the teacher who aspires in relation to the student. This principle regards the relationality of the poetic, between the individuation and the possibility of reality, a silent respiration of shared imagination, thinking passages between technicians and the few.*

The user in technics marks a departure for the human side of an ambit. Academia follows the act: essays may be graded by software, e-readers track student eye movement reporting to an education manager what the student purportedly read. Increasingly, relation is deported to the online classroom or the hybrid space of Learning Management Systems.

Purportedly serving intellectual freedom and humanity, universities will inevitably collapse into technics. Our lingering delusion that state universities serve a national purpose and preserve this alongside the interest of global capitalism is well known. However this delusion, allusion, illusion is given, it is powered by imagination and the human task is to reclaim access and care for it. Technological order, what governs significantly the production of the world and the presentation of nature to human thought has quickly placed the imagination as its final prize. Conversely if the university mirage cast a shadow over the reality of technics, the other side of an imaginative ambit opens toward an ethics of imagination.

Today I will work through a few selections from Emmanuel Levinas and read a few prose philosophemes of Wallace Stevens.<sup>1</sup>

Levinas's remarks in the preface to *Totality and Infinity*, of the relationality of book, author, and reader: "The word by way of preface which seeks to break through the

screen stretched between the author and the reader by the book itself does not give out as a word of honor.”<sup>2</sup>

Relation to the book does not give the reader a promise of reality by its word, yet why would the preface? The book is a device with a screen of which the dubious word generates, or engenders, an appearance. The preface as an attachment represents a circling back to the screen; behind it yet equally joining it. However the joining of preface and book, it raises a question: if opening to exteriority generates interior self-references appearing in the book, this relation remarks of the *production of the infinite in relation to the other* as self-othering through the device. Levinas’s book is a device. Through self-referential exposition the device *others itself* in the screen of the text as it appears to thought (a matter of engendering thought). The experience of self-referentiality transcends “its term” by a permeative force in and out of metaphysical experience. The term is a thinking of the passage in technics of imaginative activity.

Two points to be made. First author and reader activity may track its own thinking as exemplified by Levinas. Today in technics, the writing of author and reader in the form of the user constantly gives this activity each time it generates the appearance with smart devices that record user activity and engender the image. The writing that constitutes (generates) the individuation under surveillance (and the possibility of thinking of this surveillance-engendering) is what we argue Stevens calls scope and poetic style.

Second regarding the book and preface, silence permeates through the experience of language; as writing in its immediate emergence is a matter of poetic style *creating* passages: the terms and conditions of *itself* and others. The stylus of writing and thinking the generative appearance may be further read in Levinas:

The aspiration to radical exteriority, thus called metaphysical, the respect for this metaphysical exteriority which, above all, we must “let be,” constitutes truth. It animates this work ... and evinces its allegiance to the intellectualism of reason. But theoretical thought, guided by the ideal of objectivity, does not exhaust this aspiration; it remains this side of its ambitions. If [...] ethical relations [of text] are to lead transcendence to its term, this is because the essential of ethics is in its *transcendent intention* [...]. Already *of itself* ethics is an “optics.”<sup>3</sup>

“Ambitions” otherwise an ambit, regards *aspiration to radical exteriority*. Imaginative respiration attenuates in the individuation’s crystalized content. The returns we either *let be* or think-through with the screen and dubious word. Imaginative activity, formative aspects of viewable content, what constitutes the vitality of the screen and its territorialization through the other side of an ambit remains on this *side of its ambitions*. Toward the ethical possibility of individuation in technics, as human, the self-referential datum experiences the intelligence of emotional movement, a meditative speculation.

I will try to unpack this in Stevens’s prose. I draw from “The Whole Man: Perspectives, Horizons,” a paper presented in October of 1954, less than a year before his death. And second Stevens’s concept of scope and poetic style found in “Two or Three Ideas,” a lecture given in April 1951.<sup>4</sup> Addressing the banality of modernity and technics Stevens writes:

It is plain that when, in this world of weak feeling and blank thinking, in which we are face to face with the poem every moment of time, we encounter some integration of the poem that pierces and dazzles us, the effect is an effect of style and not of the poem alone. The effective integration is not a disengaging of the subject. It is a question of the style in which the subject is presented.<sup>5</sup>

A few questions stand out. First, what does it mean to be face to face with *the poem* every moment of time? The second question concerns the effective integration of the poem. And third we may ask how by what pierces and dazzles that integration is established given that it regards poetic style?

The “Whole Man” addresses what Stevens calls the “general, all-round” thinker in steady decline since the mid-nineteenth century. Regarding the university and the thinkers it produces he prognosticates on a “neo-Platonic republic” comprising two classes to be governed by the truth. The first class he calls “technicians” steadily replacing the once predominant “all-round” thinker. Technicians would be “political and moral neuters” who “repose” in a few “the profoundest confidence.” The few “a group composed [...] with minds rapacious and benign” are the “over-all thinkers” capable of “different sights, the sturdy fathers of that very republic and the authors of its political and moral declarations.”<sup>6</sup>

By definition *reposed* means “something free from agitation or movement” a “body lying in state.” *Reposed confidence* I argue is the individuation in technics, toward *the few*, not two distinct classes, rather where the imagination returns in technics. That may be established by how Stevens defines the purpose of “Two or Three Ideas”:

The first [idea] is that the style of a poem and the poem itself are one; the second is that the style of the gods and the gods themselves are one; the third is that in an age of disbelief, when the gods have come to an end, when we think them as aesthetic projections of a time that has passed, [humans] turn to a fundamental glory of their own and from that create a style of bearing themselves in reality. They create a new style of a new bearing in a new reality.<sup>7</sup>

Stevens’s human task “that the style of man is man himself” is the technician’s ethical task of *the few* toward the self-styling human in technics.<sup>8</sup> A referentiality that constitutes a poetic ontological mode. If the technician constructs and references a poetic datum, scope is the adaptive aperture, or *receptacle* in Stevens for imaginative force toward the attenuation of possibilities of reality.<sup>9</sup>

In contemporary philosophy the technician as a *political and moral neuter*, what Stevens deems a *sexless poetic voice* anticipates the trans- and post-human thematic. If we face a governmentality toward the ungovernable in technics, what Enlightenment forms of governmentality can no longer control, Stevens’s technicians – “those whom we reposed the profoundest confidence would actually be a few [...] with minds rapacious and benign”<sup>10</sup> – run in stride with the infinite productions of self-othering. *The “few” are aspects of reality of the individuation, the uncountable unfamiliar in the familiar*, the remarks of the face in the screen of the device, to detect what the blindness of vanity reflecting in the window to the world of technics obscures. Poetic datum is initially

a rapacious historicization, organization, pillaging, and management of imagination as relation to natural force. Stevens's ethics regards a *principle active in us*, toward a benign satisfaction for the truth of reality; the few irrepressible absences ungovernable in technics rendered in scope. This is, I argue, Stevens's axiomatic thinking of an *ambitious* transcendence, the axial relation between historical material or what he calls "the usable past"<sup>11</sup> and the finitude of existence that opens to the exterior. If Stevens poetic subjectivity remarks of overcoming the cybernetic, self-enclosure – our neoliberal subjectification, in Levinas *what we must let be that constitutes truth* regarding the *already of ethics that is itself an optics* – such takes place at the limits of an imaginative ambit in the generation and form of poetic content.

Therefore in "Two or Three Ideas" the bodily stylus engages the imagination and renders it in scope through a type of writing, remarks Stevens:

One has to pierce through the dithyrambic impressions that talk of the gods makes to the reality of what is being said. What is being said must be true and the truth of it must be seen. But the truth about the poet in a time of disbelief is not that he must turn evangelist.<sup>12</sup>

It is not divine violence we abide by. One must "deny reality was ever monotonous" resisting indifference the un-usable past at first imparts. The technician "must assert [...] the source" when "reality returns [...] as if a shadow had passed and drawn after it [...] taken away whatever coating has concealed what lay beneath it."<sup>13</sup> This shadow opens to a "confidence" of the unseen poetic datum obscured by a vanity of the user extending, otherwise lingering in the destructive force of imagination. Writes Stevens if "the truth of [the future] must be seen, [...] the main characteristic of the poetry of the future, or near future will be an absence of the poetic. I do not think that. [...] If there is a logic that controls poetry it is not the narrow logic that exists on the level of prophecy."<sup>14</sup> The poetic would persist even in absence given that technics suspends relation to its activity.

Regarding the university and social form, Stevens's attitude about the figure of the national and relation to the historicization of poetic datum goes beyond what he calls "a factitious Americanism."<sup>15</sup> Continues Stevens that "[t]he material of the imagination is reality and reality can be nothing else except the usable past. In my own case this is wholly an American past. However, it does not follow that this or that particular figure of the past is relevant to the future."<sup>16</sup> Generation and form regard the appearance of reality and how one shapes it, writes Stevens:

Form itself is ever-youthful, ever-vital beauty. The vigor of art perpetuates itself through generations of form. But if the vigor of art is itself formless, and since it is merely a principle it must be, its form comes from those in whom the principle is active, so that generations of form come from generations of men.<sup>17</sup>

Given modern art is the "attempt" to "bridge fact and miracle" it is an ever forming principle of the uncertain of the other appearing in the self, a matter of scope constitutes a usable personal historicization. He continues:

The all-round [thinker] is certain to scrutinize form as he scrutinizes [others] [...] in relation to all past form. It is inevitable that, from his scrutiny of past form, some ideal should have been created, whether derived from something actual in the past or something desired to become actual in the future. Modern art is inescapably framed within these large horizons, which, certainly, are not the horizons of a school, whether of time or place.<sup>18</sup>

Many of us are not inbuilt to the traditional university with its background assumptions and easy answers on behalf of the humanities (which were never the right kinds of answers anyway). In effect, what we are concerned with here is survival plain and simple, an existential problem if there ever was one. Any viewer of zombie films also knows that something's being more worthy of survival is no guarantee that it *will in fact* survive in zombie world. Just because we have reasonable answers as to the worth of the humanities (its indispensable social value), it is a moot point in terms of our survival. Part of the task will be assessing the conditions for producing a "band of scholars" or "ship of fools." This task is not served, however, by appealing to an idyllic past – we might say the Golden Age of the Humanities – which even if it did once exist is irrecoverable after the disaster. Keeping with the image of zombie contagions or disease, this time from another artifact of the humanities: the point is *how not* to be seduced by the idylls of our own making, namely, "how to keep the seductive ghost of a bliss long absconded from baiting you and hooking you and pulling you back out and eating your heart raw."<sup>28</sup>

An analogy from Robert L. Dorit, a molecular biologist, is perhaps helpful here: "Evolution is a creative scavenger, taking what is available and putting it to new use."<sup>29</sup> In this way, evolution operates more like a third-world auto mechanic – piecing together whatever she finds lying around to "get your car running again" – than the well-designed products of first-world automotive engineering. We too, like Whitehead's "band of scholars" or Granel's "ship of fools," are trying to flesh out the protocols of this post-apocalyptic wasteland, picking up and putting to use *what-*, indeed, *whomever* we find around. Indeed, much of our efforts in this situation, because we cannot count on the traditional university, depend on the fact that we also continue to produce our own survival communities "on the fly." There is nothing necessary about the fact that we continue in this effort; we could simply quit. As long as we don't, however, it is incumbent upon us to find ways to survive. Now it will make a significant difference whether our post-apocalyptic humanities zombies are fast or slow, but I am optimistic that we will find the right sorts of protocols to create our "survival manual" because I am in great company here for testing out survival at the end of the humanities.











## Notes

- 1 Maurice Blanchot, *The Writing of the Disaster*, trans. Ann Smock (Lincoln: University of Nebraska Press, 1995), 1.
- 2 Here is a sampling of recent cases of disaster-speak applied by scholars to “our” current situation: Bill Readings, *The University in Ruins* (Cambridge MA: Harvard University Press, 1996); Gayatri Chakravorty Spivak, *Death of a Discipline* (New York: Columbia University Press, 2003); Christopher Fynsk, *The Claim of Language: A Case for the Humanities* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 2004); Isabelle Stengers, *Au temps des catastrophes: Résister à la barbarie qui vient* (Paris: Editions La Découverte, 2009); Paul Virilio, *The University of Disaster*, trans. Julie Rose (Cambridge: Polity, 2010).
- 3 Blanchot, *The Writing of the Disaster*, 105.
- 4 Alfred North Whitehead, *The Aims of Education and Other Essays* (New York: Free Press, 1985 [1929]), 99.
- 5 *Ibid.*, 100.
- 6 Fynsk, *The Claim of Language*, 15.
- 7 Slavoj Žižek makes this point asking about the “conspirators” in *The Wire* (2002–8): “Is not this group a kind of proto-communist cell of conspirators, or a group of eccentrics from a Charles Dickens novel or a Frank Capra film, with the dilapidated basement office they are allocated as their secret conspiratorial lair?” (*The Year of Dreaming Dangerously* [London: Verso, 2012], 98).
- 8 Quoted in Graeme Paton, “Michael Grove Backs Study of ‘French Lesbian Poetry,’” *The Telegraph* (November 14, 2012): <http://www.telegraph.co.uk/education/educationnews/9678834/Michael-Gove-backs-study-of-French-lesbian-poetry.html>. (Accessed May 27, 2013).
- 9 Quoted in Andrew Woodcock, “Tories Promise ‘Brazenly Elitist’ Approach to Education,” *The Independent* (January 18, 2010): <http://www.independent.co.uk/news/education/education-news/tories-promise-brazenly-elitist-approach-to-education-1871867.html>. (Accessed July 19, 2013).
- 10 Quoted in Geoffrey Walford, *Privatisation and Privilege in Education* (London and New York: Routledge, 1990), pp. 113–5.
- 11 Whitehead, *The Aims of Education*, 101.
- 12 *Ibid.*
- 13 *Ibid.*, 97.
- 14 For a discussion of disasters as “post-normal” events, see Stewart Williams, “Rethinking the Nature of Disaster: From Failed Instruments of Learning to a Post-Social Understanding,” *Social Forces* 87.2 (December 2008): 1115–38.
- 15 See, for instance, Enrico L. Quarantelli, “The Environmental Disasters of the Future Will Be More and Worse But the Prospect Is Not Hopeless,” *Disaster Prevention and Management: An International Journal* 2 (1993): 11–25.
- 16 Ulrich Beck, *Risk Society: Towards a New Modernity* (London: Sage, 1992).
- 17 To give only one example that made headlines, the Centers for Disease Control and Prevention (US) released a novella “Preparedness 101: Zombie Apocalypse” as a “fun” way to learn disaster preparedness: <http://emergency.cdc.gov/socialmedia/zombies.asp>. (Accessed July 20, 2013).
- 18 This is the thesis of Martin Rees, *Our Final Hour: A Scientists Warning: How Terror, Error, and Environmental Disaster Threaten Humankind’s Future in This Century – on Earth and Beyond* (New York: Basic Books, 2003).
- 19 Antonio Sánchez-Escalonilla, “Hollywood and the Rhetoric of Panic: The Popular Genres of Action and Fantasy in the Wake of the 9/11 Attacks,” *Journal of Popular Film and Television* (2010): 10–20.

- 20 Quoted in Noam Yuran, "Disaster Movies as the Last Remnants of Utopia," *Ha'aretz* (January 14, 2003): <http://www.haaretz.com/culture/arts-leisure/disaster-movies-as-the-last-remnants-of-utopia-1.22290>. (Accessed June 2, 2013).
- 21 Blanchot, *The Writing of the Disaster*, 1.
- 22 Fredric Jameson, "The Dialectics of Disaster," *South Atlantic Quarterly* 101.2 (Spring 2002): 297–304.
- 23 *Ibid.*, 304.
- 24 Blanchot, *The Writing of the Disaster*, 1.
- 25 *Ibid.*, 9.
- 26 *Ibid.*, 2.
- 27 Quoted in Fynsk, "A Pedagogy on the Verge of Disaster," this volume, 38.
- 28 David Foster Wallace, *Infinite Jest: A Novel* (London: Abacus, 1996), 374.
- 29 Robert L. Dorit, "A Review of Darwin's Black Box: The Biochemical Challenge to Evolution, by Michael J. Behe," *American Scientist* 85.5 (Sept.–Oct 1997): <http://www.americanscientist.org/bookshelf/pub/a-review-of-darwins-black-box-the-biochemical-challenge-to-evolution-by-michael-j-behe>. (Accessed July 19, 2013).



# RETORIKA E SHKATËRRIMIT T'I MBIJETOJMË FUNDIT TË HUMANITETEVE

Xhon Van Haut

*“Shkatërrimi rrënon gjithçka, por duke lënë gjithçka të paprekur.”*

– Moris Blansho, *Shkrimi i shkatërrimit*

## Paraqitje e shkatërrimit

Në këtë artikull do të paraqis një përdorim potencialisht kritik të retorikës së shkatërrimit, që herë pas here kam për ta quajtur edhe e folura e shkatërrimit, duke u mbështetur kryesisht mbi analizen e Blanshosë tek *Shkrimi i shkatërrimit*. Cili është “shkatërrimi” për të cilin jemi duke folur në këtë konferencë? Për ata që punojnë brenda ose rreth akademisë sot, është e vështirë të shpërfillësh ndryshimet e qenësishme që po kalon universiteti e veçanërisht humanitetet. Që do të thotë, ky ndryshim brenda universitetit, që në përgjithësi njihet, i ka hapur rrugën prognostikimeve serioze të “fundit” të universitetit. Në këtë pikë, humanitetet ia kanë kaluar vetë universitetit. Në disiplinën time, filozofi, për shembull, ka rreth një shekull që flitet për “fundin e filozofisë.” Ka shumë arsye pse e folura e shkatërrimit është kaq e përhapur në situatën në të cilën ndodhemi (shumë prej të cilave nuk kanë të bëjnë me universitetin); dhe sigurisht që shembuj të së folurës së shkatërrimit mbi situatën e universitetit në përgjithësi dhe të humaniteteve në veçanti nuk mungojnë.<sup>2</sup> Në çka vijon kam për të vënë mënjane pyetjen nëse fundi është vërtetë afër, duke u përqëndruar tek retorika e atij shkatërrimi që zëre se ka ardhur për të vlerësuar një strategji për të shfryrë ndjesinë katastrofike të fundit që provokon e folura e shkatërrimit.

Për ta arritur këtë, argumentoj se ne duhet të krijojmë “manualë mbijetese” për fundin e humaniteteve. Siç ndodh rëndom në tregime [*narratives*] të panumërta pas-apokaliptike, na duhet një grup procedurash, që unë do t'i quaj “protokollë,” për t'u marrë me atë që ne shohim si rastin më të keq në lidhje me fundin e humaniteteve. E them këtë me kushtin që vijon: ndonëse ne mund të marrim shembull nga shembuj të mëparshëm, institucione, tekste e parapëlqyer dhe mendimtarë, ky manual mund të bëhet vetëm nxitimthi, si të thuash. Që do të thotë, vetëm duke vënë në provë an-

gazhimet tona me bashkëudhetarët tanë gjatë praktikimit të mbijetesës do të arrijmë të kuptojmë praktikat e dijes që historikisht janë quajtur “humanitetet” në një botë të pashumaniteteve.

Meqenëse do të na duhet goxha mundim për t’i shpëtuar retorikës së shkatërrimit mendoj se na duhet të inskenojmë një lloj *prove të shkatërrimit* për të distiluar skenarin e duhur për të vënë në provë këto angazhime. Për ta mbyllur, kam për të përdorur modelin e tregimit me zombi si inskenimin e kësaj prove të shkatërrimit. E megjithatë unë nuk kam për të ofruar një protokoll të veçantë e të plotë për momentin e mbijetesës që propozuam më lart. Mendoj se për t’u marrë seriozisht me retorikën e shkatërrimit ky manual duhet të mbetet në ndërtim e sipër dhe i hapur për rishikime, pra “nxitimthi.” Shpresa është se, në rast se shkatërrimi i parashikuar vjen, ne do të jemi të përgatitur për të “mbijetuar” në kuptimin strikt të tejkalimit – “të jetuarit *përtej*” ose “*mbi*” – ngjarjes së shkatërrimit, siç nënkuptohet në theksin që Blansho vë mbi prefiksin tek “*mbi-jetesa*.”<sup>3</sup> Avantazhi i strategjisë së propozuar këtu është se edhe nëse shkatërrimi i presupozuar nuk vjen kurrë, në do të kemi arritur t’i shpëtojme mekanizmave të aparatit afektiv të së folurës së shkatërrimit dhe do të mund të vazhdojmë të merremi me punët tona të mbijetesës brenda humaniteteve.

Mendoj se strategjia më e mirë për një hulumtim kritik mbi të folurën e shkatërrimit, e veçanërisht përta të diskutimeve rreth humaniteteve, është ta marrim shkatërrimin si *një ndodhi të së kaluarës*: domethënë, të gjejmë një mënyrë për t’i shpëtuar shkatërrimit të ardhshëm duke e marrë atë si një ndodhi të kohës së shkuar me të cilën ne thjesht jetojmë në të tashmen. Për këtë arsye, ne duhet ta marrim shkatërrimin me gjithë peshën e tij apokaliptike, momenti shkatërrimtar i Fundit tashmë ka kaluar dhe ne, nënprodukte të humanizuara të humaniteteve, jetojmë në shkretëtirën postapokaliptike të objekteve të humaniteteve që nga T.S. Elliotti deri te trillimet me zombi.

### Zombitë pas derës

Shembulli i fundit, trillimet me zombi, është në fakt goxha elegant në thjeshtësinë e tij. Le të marrim pra versionin më popullor të tregimit të shkatërrimit, tregimin pas-apokaliptik të zombive, si modelin tonë për një “manual mbijetese” për humanitetet. Zombitë rrallëherë arrijnë deri tek universiteti (dhe nuk e kam fjalën këtu për zombitë jocilesorë të Dejvid Çalmers [David Chalmers], por për ata të zhvdekurit që ushqehen me mish njeriu). Arsyet për këtë janë të kuptueshme. Si mundet një universitet, një cep lluksi relativ, për shumë vetë një arrati nga “jeta e vërtetë,” të krahasohet me orgjinë ikonike të konsumit në një qendër tregëtare të sapo liruar prej kufomave mishngrënëse?

Mungesa relative e universitetit është megjithatë e çuditshme. Meqenëse shumë universitete (veçanërisht ata privatët) kanë mure rrethues dhe porta të mëdha hekuri si dhe forcat e tyre policore, këta universitete do të ishin vende ideale për t’u fshehur (veçanërisht gjatë muajve të verës). Por ndoshta do të ishte e tepruar, e neveritshme madje, të shihnim një grup të fshehur brenda, për shembull, një Harvardi të rrethuar, institucione që krenohen për *eksluzivitetin* e tyre, ndërkohë që ata që kanë mbetur përjashta janë në mëshirë të të zhvdekurve. Do të sugjeroja se në pjesën më të madhe të rasteve mungesa e zombive në universitete (disa filma fillojnë atje por shpejt largohen) lidhet me qëndrimin kulturor se universitetet janë që janë, në një kuptim, një privilegj, dhe se të shohësh njerëz të mbijetojnë *për shkak të atij privilegji*, ndërsa të

gjithë të tjerët hahen, shkon kundër funksionit demokratizues të zhanrit. Të gjithë janë të zbuluar ndaj mundësisë për t'u shndërruar në një zombi. Dhe ndonëse pasuria dhe statusi ynë social mund të na japin një avantazh në çastet e para, në "planin" afatgjatë të gjithë ne jemi të zbuluar ndaj mundësisë për t'u shndërruar në një zombi. Edhe kur mbyllemi brenda dhomës së panikut në një shtëpi të madhe (*Diaries of the Dead*, 2007) ose një qyteti të fortifikuar (*Land of the Dead*, 2005), herët a vonë, lukunia endacake ka për ta thyer mbrojtjen tonë dhe ne kemi për t'u zbuluar.

Një element që e ndajnë shumë prej këtyre tregimeve është ai i formimit të një komuniteti gjysëm koheziv mbijetese duke u bashkuar në grupe të vogla, një pikëpamje e ngjashme me atë të shumë njerëzve mbi funksionin e shkollimit, në veçanti brenda humaniteteve. A.N. Uajthed, për shembull, e imagjnon shkollimin si një "bandë dijetarësh" të cilët do të "stimulonin njëri-tjetrin, dhe do të cilësonin lirisht veprimtaritë e tyre të ndryshme."<sup>4</sup> Në fakt, retorika e Uajthed pasqyron vulltë e pasapokaliptikes: nuk ka "asnjë shpëtim" prej përqëndrimit të vëmendjes tonë mbi kushtet që do të "prodhojnë një bandë të tillë."<sup>5</sup> Si pjesëmarrës në projektin e universitetit, ne e kemi për detyrë jo vetëm të kultivojmë një "bandë" të tillë por gjithashtu edhe kushtet që do të mund ta prodhonin një bandë të tillë. Ky model i një "bande dijetarësh" i ngjan "anijes së budallenjëve" të Zherar [*Gérard*] Granelit, që do të ishte "një bandë endacake filozofësh kritikë që do të shfaqej lirisht dhe papritur gjithandej nëpër universitet apo institucione të tjera kulturore me qëllim për të zhvilluar një kritikë themelore të vendndodhjeve të ndërhyrjes."<sup>6</sup> Gjithmonë e më tepër një model i tillë konspiratorësh të çuditshëm po bëhet modeli i parapëlqyer për një politikë të majtë.<sup>7</sup>

Megjithatë, zhanri ka edhe një aspekt populist. Mësimi që tregimi pasapokaliptik i zombive përsërit vazhdimisht – veçanërisht në manifestimet e fundit që nga *Dawn of the Dead* (2004) e deri tek *The Walking Dead* (2010–) – është se pasi godet shkatërrimi e kufomat ngrihen prej varrit dhe të zhvdekurit ecin mbi tokë e hanë mishin e të gjallëve, janë pikërisht vlerat "e buta" tradicionalisht të lidhura me humanitetet (etika, arti, letërsia, etj.) ose vlerat që ato shprehin (dashuria, familja, besimi fetar, komuniteti, etj.) që kanë më pak shans për të mbijetuar dhe që janë në thelb të tepërta. Këto vlera "të buta" duhet të zëvendësohen me vlera më të forta, më jetëgjata, më praktike. Siç thotë Komandanti në krye të detyrës të një prej flotave të mbetura në *World War Z* (2013): "Hidhni një sy vërdallë Zoti Lejn. Secili prej këtyre njerëzve ndodhet këtu sepse ka një punë për të bërë. Nuk ka vend këtu për personel jo të domosdoshëm." Kjo mund të përshkruante një qëndrim të përhapur ndaj universiteteve.

Nëse retorika e shkatërrimit është për t'u besuar, nën kërcënimin e të ardhmeve ekonomike që varen mbi universitetet tona, qëndrimet tona (investimi ynë në) arsim duhet të ndjekin të njëjtën udhë. Në të njëjtën mënyrë se si në situatën pasapokaliptike u shërbejmë shanseve tona të mbijetesës më mirë duke iu bashkuar njerëzve që kanë training në mbijetesë, ish-ushtarë apo oficerë të rendit, ose ekspertë *par court*, Shteti duhet t'i "bashkohet," duke investuar në to, disiplinave që kanë aplikime praktike dhe të drejtpërdrejta, të ashtuquajturat disiplina STEM (shkenca, teknologjia, inxhinieri, matematika). Kur të vijë shkatërrimi, kur të godas apokalipsi i zombive, duhet të jemi të rrethuar nga njerëzit e duhur, dhe këta sigurisht që nuk janë tipat e humaniteteve. (A nuk janë këta tipa, sidoqoftë, disi të dyshimtë?)

Në fakt, ky qëndrim ka një gjenealogji shumë më të gjatë, që shkon pas në kohë deri të paktën tek debatet e periudhës së Theçerit dhe Rejganit që shkaktuan “luftat e kulturës” të viteve 80. Ronald Rejgan arriti ta rrokë këtë atmosferë në një fjalim elektorale të 1980-s: “Përse u dashka të subvencionojmë kuriozitetin intelektual?” Duke nënkuptuar në këtë rast, humanitetet; një këndvështrim që më pas gjeti një tjetër zë tek Xhejms Dajsoni [*James Dyson*] (shpikësi i fshesës me korent që mban të njëjtin emër): ka shumë njerëz sot që “shkojnë e studiojnë poezi lezbike franceze.”<sup>8</sup> Jo, kurioziteti nuk do të subvencionohet, ai do të rikthehet klasës që me të drejtë mund ta përballojë të jetë kurioze, sipas premtimit elektorale të Dejvid Kameranit [*David Cameron*] për shkurti-me buxhetore “paturpshëm elitiste” në arsim.<sup>9</sup>

Gjejmë një përshkrim të çuditshëm të stilit zombi nga një Ministër i Arsimit dhe Shkencës (MB) në vitin 1984 që portretizon turmat kërcënuese që do të krijoheshin nëse privilegjet arsimore nuk racionohen në mënyrë të përzgjedhur. Ia vlen ta citojmë plotësisht:

Duhe të ketë përzgjedhje pasi po fillojmë të krijojmë aspirata të cilat shoqëria nuk është e aftë t’i përmbushë. Në një farë mënyre kjo flet për suksesin e arsimimit, në kundërshtim me mitologjinë publike që është krijuar.

Kur të rinjtë dalin matanë linjës prodhuese të arsimit dhe nuk mund të gjejnë punë, ose punë që përputhet me aftësitë dhe pritshmëritë e tyre, atëherë ne po krijojmë pakënaqësi, ndoshta me pasoja turbulluese. Duhet të zgjedhim: të raciojmë mundësitë arsimore, në mënyrë që shoqëria të mund të përballtet me prurjet e arsimit [...] Ne ndodhemi në një periudhë ndryshimesh të konsiderueshme shoqërore. Mund të ketë trazira shoqërore, ama ne jemi të aftë t’i përballojmë ato. Por nëse kemi një popullatë tepër të arsimuar dhe të papunë, ekziston mundësia e një konflikti shoqëror më serioz.

Njerëzit duhen edukuar rishtazi të kuptojnë se ku e kanë vendin.<sup>10</sup>

Si lukunia e zombive mishngrënës që bëhen sa vjen e më të zgjuar pas mureve të qytetit të rrethuar në filmin *Land of the Dead*, vetë arsimiti përbën një rrezik pikërisht sepse ai nënkupton një proces *çarsimimi* (dëshmi e “suksesit” të tij). Falë “aspiratave” që ai ushqen, që nuk mund të përmbushen prej shoqërisë sipas kuotave ekzistuese, ai çedukon njerëzit prej “njohjes së vendit të tyre.” Programi arsimor duhet ribërë për të riedukuar individët që të kuptojnë *edhe një herë* vendin e tyre.

Whitehead thotë diçka të ngjashme rreth *imagjinatës*: “Ajo është një dhuratë e rreziqshme, që ka shkaktuar më shumë se një zjarrmi.”<sup>11</sup> Por siç shton ai: “Nëse jemi të ndrojtur karshi atij rreziku, rruga e drejtë është t’i vëmë kyçin universiteteve tona.”<sup>12</sup> Basti i Uajthedit këtu është se mundësia e dytë nuk do të merrej seriozisht; ai thjesht po paraqet një argument. Por, në situatën në të cilën ndodhemi, dhe për ministrin e përmendur më lart, kjo mund të jetë një hedhje zareshe që shumë do të ishin të gatshëm ta ndërmerrnin (të paktën, për programet që bien nën tehun e thikës se prerjeve “paturpshëm elitiste”).

Uvertura të tilla ndaj rreziqeve të arsimimit sigurisht që mund t’iu bëjnë qejfin atyre brenda humaniteteve që prej kohësh besojnë se janë mbartësit e një patogjeni zombie-shkaktues për ata në pushtet (*kritika* ose imagjinata si “sëmundja ngjitëse” e

Uajthedit<sup>33</sup>). Por nëse kjo kuptohet si një aprovim për humanitetet, një anëtar i administratës së universitetit ose ministri i lartpërmendur që do t'i shërbejë një “shoqërie” që ai e konsideron relativisht homogjene, në nevojë të mëtejshme për *më tepër* qëndrueshmëri, përgjigjia pa dyshim që ka për të rënë në vesh të shurdhër, nëse nuk shkakton alarm. “Pse doni të ushqeni paqëndrueshmëri kur *problemi* qëndron pikërisht tek paqëndrueshmëria? As që bëhet fjalë që ne nuk kemi për ta financuar *atë!*” Ne duhet të krijojmë vetëm individë që mund t'i menaxhojmë (një lloj tjetër zombi) dhe “bandat e dijetarëve” të Uajthedit apo “anijet e budallenjëve” të Granelit nuk shkojnë për shtat.

Tregimet zombi në veçanti mund të na hyjnë në punë këtu pasi ato na japin një protokoll të vetëm për të gjithë shtrirjen e veprimtarisë njerëzore: *Mos-bërjen-zombi*. Në këto tregime e gjithë shtrirja e veprimtarisë njerëzore bie nën *Occam's Razor* të këtij protokollit të vetëm. Përsa kohë që një veprimtari e caktuar (qoftë kjo imorale apo jo) rrit shanset për *mos-bërjen-zombi*, ajo ka një vlerë pozitive në botën zombi – çdo devijim prej këtij protokollit duket si pranim dobësie, e mbetjes lidhur me jetët tona të mëparshme, para shkatërrimit, dhe kështu nuk ka vlerë pozitive në botën zombi. (Kjo është arsyeja për kritikën mbi moskokëçarjen morale që priti manifestimet e para të zhanrit zombie.) Variacionet më të mira të këtij protokollit na ndihmojnë të shfaqim angazhimet tona më të thella, të provojmë se deri ku do të ishim të gatshëm të shkonim nën një protokoll të tillë, ose më vagullt, sa “njerëzor” do të mbeteshim në botën zombi.

Kjo na jep një model për testin e shkatërrimit për humanitetet: shkatërrimi duhet kuptuar si një protokoll (ose një grup i kufizuar protokolleesh) mbi modelin e protokollit të vetëm të *mos-bërjes-zombi* që ne të mund të fillojmë të vlerësojmë se për çfarë mund të zotohemi *edhe nëse* shkatërrimi ndërkaq ka ndodhur. Ose përkundrazi, të vlerësojmë *se nga se nuk do të ishim të gatshëm të hiqim dorë* në botën zombi. Pra nëse ky është modeli ynë i ri për manualin e mbijetesës, si mund të merremi me kërcënimin e shkatërrimit që zëre se ka ardhur?

### Retorika e shkatërrimit

Mund të ofrojmë një zgjidhje të pjesëshme duke parë vetë retorikën e shkatërrimit. Teoricienët e shkatërrimit na thonë se katastrofat janë ndodhi “të ulëta në numër, të mëdha në impakt” të një karakteri “pasnormal.”<sup>34</sup> Ideja e “normalitetit” në ndodhi “pasnormale” është disi e habitshme duke qenë se sot ne jemi të rrethuar nga mundësia e pragut të shkatërrimit. Duket sikur në vend që të jetë “pasnormal” në karakter, shkatërrimi është *Normaliteti* i ri, ashtu siç Gjendja e Përrjashtimit, e diskutuar nga teoricienë politikë dhe ligjorë, përdoret për t'i bërë masat e emergjencës gjendjen “normale” të gjërave. Diskutimet e shkatërrimit nga specialistë, politikanë, dhe policë-bërësit qarkullojnë nëpër ciklet normale mediatike; shpesh ne dëgjojmë për çmimin natyror, njerëzor dhe ekonomik të katastrofave natyrore, atyre njerëzore për mjedisin, katastrofave të shkaktuara nga terrorizmi, konfliktet etnike, genocide dhe lufta, madje dhe ato të “shteteve të dështuara” dhe të kolapsit ekonomik të përmasave të mëdha. Na paralajmërojnë madje se akoma “më shumë katastrofa, edhe më të rënda, kanë për të vijuar.”<sup>35</sup> (Ja ku ua harrua edhe “shpeshësia e ulët” e shkarërrimeve.) Mesa duket, ne kemi hyrë përfundimisht në “shoqërinë e rrezikut” të Ulrich Bekut: një shoqëri në të cilën kapaciteti teknologjik dhe dija shkencore kanë çuar drejt përhapjes dhe përkeqësimit të rreziqeve



shkatërruese në vend që t'i lehtësojnë ato.<sup>16</sup> Një pjesë e mirë e imagjinatës tonë politike dhe politikave tona merren tashmë me *menaxhimin*, nëse jo me shmangjen, e këyre shkatërrimeve të ardhshëm.

Këto ogure shkatërrimi përkojnë me skenarët e zakonshëm të fundbotës të parashikuar nga shkencëtarët: nga mundësia e përplasjes me asteroidë, shpërthime super-vullkanësh, pandemi bakteriesh, virusesh, dhe kërpudhash [*fungi*], kërcënimet e vjetra berthamore, si dhe një mori mundësish të tjera jo aq të spikatura shkatërrimesh në të ardhmen e afërt: pushtim nga jashtëtokësorët, krijimi i vrimave të zeza, apo murtaja nano-robotësh. Vetë *apokalipsi zombi* është bërë një objekt studimi gjysëm-serioz.<sup>17</sup> Shkencëtarët na thonë madje se ka gjasa që ky shekull të jetë shekulli i fundit i rracës njerëzore.<sup>18</sup>

Mediat popullore kanë mbajtur hapin, duke vepruar si kujdestarë të tregimeve dhe imazheve të shkatërrimit – 11 shtatori është rasti më i spikatur. Pasi imazhet e 11 shtatorit qenë përsëritur pafund në televizion, u bënë krahasime të shpeshta midis sulmit terrorist dhe skena filmash aksioni. Në këtë rast, shkatërrimi zbehu vijën ndarëse midis jetës reale dhe argëtimit. Nuk është pra për t'u habitur që Hollivudi e trajtoi temën e shkatërrimit në mënyrë më të drejtpërdrejtë, duke bërë *phobos* – tmerrin ose panikun – një kategori afektive qendrore në filmat e pas-11 shtatorit, për të skicuar ndjesinë mbizotëruese të brishtësisë së jetëve tona.<sup>19</sup> Siç ka thënë Sllavoj Žižek [*Slavoj Žižek*] në këtë kontekst: “Filmat e shkatërrimit ka mundësi të jenë zhanri i vetëm optimist shoqëror që na ka mbetur, dhe ky është një shëmbëllim i trishtë i gjendjes së dëshpëruar në të cilën ndodhemi.”<sup>20</sup>

Nuk është për t'u çuditur atëherë se ligjërata e “shkatërrimit” është kaq e përhapur, por është e vështirë ta shohim këtë ligjëratë si “pasnormale” në ndonjë mënyrë kuptimplotë. Të mbledhura bashkë, gjithë këtë llafosje mbi shkatërrimin mund ta quajmë më gjerësisht “retorika e shkatërrimit,” ashtu siç unë e kam përdorur [këtë term]. Rretorika e shkatërrimit, siç e kuptoj unë, nuk ka të bëjë me këtë apo atë shkatërrim që *tashmë* ka kaluar, që do kryhej nga puna e vajtimit [*mourning*], përkujtimit, dhe solidaritetit. Rretorika e shkatërrimit është një mënyrë për të menaxhuar të folurit për *atë që do të vijë*, d.m.th. një mënyrë monitorimi, po të përdornim zhargonin e *Homeland Security*, të nivelit të kërcënimit që përbën shkatërrimi.

Kësisoj, e folura e shkatërrimit kombinon dy tipare kyçe: a) *fjalosjen mbi të ardhmen*, me gjithë vështirësitë që shoqërojnë pretendime të çfarëdo shkalle sigurie në lidhje me ndodhi të kohës së ardhme; si dhe b) një mjet të fuqishëm për të *interpeluar subjektin nën rrezik*, me gjithë paqartësitë dhe pështjellimet e ndodhive të kohës së ardhme të përmasave të tilla që, duke pasur parasysh mënyrën se si ne flasim për to, (të gjithë?) ne *duhej* të shqetësoheshim për kalimin e tyre. Për të folurën e shkatërrimit, ne jemi të gjithë nën rrezikun e pragut të shkatërrimit. Për të shmangur akuza për zemërgurtësi morale, pakujdesi, apo mungesë ndjeshmërie në përgjithësi ndaj viktimave *eventuale* të shkatërrimit – në këtë rast, *të gjithë* – retorika e shkatërrimit paraqet një aparat afektiv mbresëlënës për interpelimin e subjekteve që kërcënohen nga pragu i shkatërrimit. Ky interpelim nën rrezik ndihmon në themelimin, veçanërisht në manifestimet e tij politike, të një pengmarrjeje intelektuale të së ardhmes; nuk na lejohet të flasim për të ardhmen pa menduar mbizotërimin e shkatërrimit, dhe kësisoj e ardhmja mbahet peng,

“e burgosur e imazhit” të shkatërrimit. Kështu Blansho pohon: “Të mendosh shkatërrimin [...] do të thotë të mos kesh kohë në të cilën ta mendosh atë.”<sup>21</sup>

E megjithatë, siç vëren Fredrik Xhejmson [*Fredric Jameson*] herë pas here, ka diçka mjaft cinike në gadishmërinë tonë për të imagjinuar vazhdimisht fundin e botës pa menduar ndonjë alternativë produktive sociale apo politike. Ajo që Xhejmson quan “dialektika e shkatërrimit”<sup>22</sup> është pikërisht kjo lloj e ardhmeje e marrë peng që shkaktohet nga e folura e shkatërrimit: “në këtë dialektikë, në të cilën çdo term i kundërshtimit përforcon tjetrin, nuk është e nevojshme të ketë një moment sinteze” – mjafton që ekziston “perspektiva e atij rrënimi të përbashkët që duhet tashmë të na mbushë me një parandjenjë të keqe.”<sup>23</sup> Nëse ky portret është sadopak i saktë, si do të mund ta kapërcenim impasin midis vetvetes nën kërcënimin e një rrënimi të përbashkët dhe të së ardhmes të mbajtur peng nga imazhi i shkatërrimit, e veçanërisht në lidhje me humanitetet? Besoj se nëse e trajtojmë retorikën e shkatërrimit siç e analizon Blansho kjo do të na jepte një mundësi të prekshme për të dalë jashtë këtij impasi, dhe do të mund të na hapte rrugën ndaj një protokollit të dobishëm për manualin tonë të mbijetesës.

E folura e shkatërrimit i hap letrat kur pretendon se ne anjherë nuk kemi si ta dimë, paraprakisht, se si do të vepronim në situata të tilla të rastit-më-të-keq; se ne nuk kemi se si ta dimë nëse do t’i mbijetonim shkatërrimit ose në ç’formë; se shkatërrimi është tepër radikal për t’u menduar prej situatës tonë të parashkatërrimit; dhe se kur shkatërrimi të vijë, ndonëse ai vonon çdo ardhje, *gjithçka* ka për të qenë ndryshe.<sup>24</sup> Për më tepër, kjo tregon mënyrën se si e folura e shkatërrimit përfshin një lloj mosbesimi, një mosbesim i lindur prej faktit se shkatërrimi *mund* të ndodhë dhe se ai në fakt *po ndodh*. Blansho e përshkruan këtë si shtrimin e një pyetje pa dëshiruar përgjigje: “Ka një pyetje dhe prapë pa dyshim; ka një pyetje, por jo dëshirë për një përgjigje; ka një pyetje, dhe asgjë që mund të thuhet, por vetëm kjo asgjë, për të thënë. Kjo është një pyetje, një zhbirim që tejkalon vetë mundësinë e pyetjeve.”<sup>25</sup> Për këtë arsye Blansho pohon se për shkatërrim-folësin: “Ai nuk beson tek shkatërrimi. [...] Në përpjestim me të nuk ka besim, dhe njëkohësisht një lloj moskokëçarje, larg prej shkatërrimit.”<sup>26</sup>

Por nëse bota e zombive mund të shërbejë si një provë shkatërrimi, siç sugjerova më sipër, ajo na jep mundësinë për të *imagjinuar veten* brenda asaj bote *pas* shkatërrimit. Kësisoj, tregimi i zombive na jep një lloj katarsisi kundrejt *phobos*-it, parandjenjës së kërcënimit, ja pra pse ai është “i vetmi zhanër shoqëror optimist” sipas Zizhekut. Pa dhënë një përshkrim konkret të shkatërrimit, sikur ai të ishte një ndodhi si gjithë të tjerat, ne mbetemi përherë nën kërcënimin e tij. Por, nëse do të mund të *fillonim* ta imagjinonim veten në peizazhin *passhkatërrim*, bota jonë e zombive, do të mund ta mendonim veten *jashtë* kërcënimit, dhe të *fillonim* jetesën tonë të imagjinuar në atë botë *passhkatërrimi*. Në rastin e protokollit zombi, ne e dimë ekzaktësisht se çfarë nënkupton ajo botë, të paktën në formën e fantazisë, *mos-bërjen-zombi*.

Ky protokoll ka për të qenë ndryshe në botë të ndryshme zombish. Kjo është një pikë e rëndësishme. Bën shumë ndryshim nëse zombitë janë të ngadaltë dhe iu merren këmbët si tek *Night of the Living Dead* (1968), apo nëse ata vërsulen me gjithë shpejtësinë e tyre pasi të pikasin (*28 Days Later*, 2002). Ose nëse shndërrimi-në-zombi ndodh për pasojë të një vetie misterioze të kafshimit dhe vdekjes (shumica e botëve zombi), rrezatim atomik nga një satelit që kthehet nga Venusi (*Night of the Living Dead*), një lëndë toksike që transportohet nëpërmjet ajrit nga një eksperiment i fali-

mentuar i qeverisë (*The Return of the Living Dead*, 1985), kurë e falimentuar për një sëmundje (*I Am Legend*, 2007), ose një virus që transmetohet përmes gjakut (*28 Days Later*). Ka rëndësi nëse zombitë mund të mësojnë, të përshtaten, ose të trainohen si në filmin e Romeros, *Day of the Dead* (1985) dhe *Land of the Dead* ose *I Am Legend*. Ka rëndësi nëse vetë zombitë vdesin nga uria (*28 Weeks Later*, 2007) ose nuk vdesin fare (*Day of the Dead*). Ka rëndësi nëse kur përhapja në masë godet jemi vetëm (*I Am Legend*), në grup (*Dawn of the Dead*), komunitet (*The Walking Dead*) ose një ndërtesë ushtarake (*The Dead*, 2010 apo *Black Hawk Down*, 2001; po, ai është një film zombi). Dhe, natyrisht, ka rëndësi se si i përgjigjemi pyetjes së përherëshme: Pse vallë zombit *hanë tru*?

Të gjithë këto interpretime të zombive dhe botëve të ndryshme të tyre nxjerrin në pah angazhime të ndryshme ideologjike, presupozimet që “bëjnë sens” në kuadrin e provës së shkatërrimit të fantazisë zombi. Për shembull, bota klasike e zombive që përputhet me botëkuptimin e neokonservativëve (dhe me gjasa edhe të ministrit tonë të arsimit) do të ishte *The Omega Man* (1971), ku një shkencëtar (Çarlon Heston) gjatë ditës vjen vërdallë me një makinë klasike amerikane duke dërdëllitur banalitete populiste kurse natën i duhet të kthehet në shtëpinë e tij të fortifikuar ku luan shah me veten, pi vera të shkëlqyera, dëgjon muzikë, dhe pëpiqet të “zgjdhë” problemin e zombive, duke zbrapsur një turmë zombish “ludit” dhe ekstremistë fetarë.

Kështu pra çështja qëndron tek fakti se nëse nuk shtjellojmë specifikat e botës zombi passhkatërrim, nuk mund të fillojmë të gjykojmë se si protokoll i vetëm zombi ka për të funksionuar *në praktikë*. Kjo është edhe arsyeja pse, me gjithë thjeshtësinë elegante të protokollit të vetëm zombi, ajo çfarë ky protokoll nënkupton në praktikë do të varet nga lloji i botës zombi në të cilën ne jetojmë. Ngjashmërisht, ne nuk duhet të mbetemi pengje të së folurës së shkatërrimit, ta marrim shkatërrimin që zëre se ka ardhur seriozisht, pa filluar të skicojmë se si bota jonë e pashumaniteteve do të dukej dhe pa përcaktuar se çfarë do të nënkuptonte krijimi i atij protokollit.

### Manualet e mbijetesës së pashumaniteteve

Këtu do t’i kthehem sugjerimit të mëhershëm se duhet të prodhojmë manualët tona të mbijetesës për humanitetet “nxitimthi.” Një grup i qartë problemesh në lidhje me “fundin e humaniteteve” del prej pozicioneve që shumë prej nesh kanë për momentin brenda apo për qark universitetit, diçka që, për mirë apo për keq, është quajtur “paraa-kademia” (duke na sjellë ndërmend imazhe të trupave paraushtarake). Në vazhdimësi të taktikës tonë shfryrëse për të luftuar të folurën e shkatërrimit, ne duhet ta mendojmë *këtë* si skenarin e shkatërrimit. Shkatërrimi ka ardhur tashmë dhe ne ndodhemi në botën e pashumaniteteve. Ai mund të përkeqësohet, por ndërkaq ne jemi duke e përjetuar ngjarjen që është zhdukja e humaniteteve. Tani na duhet prova jonë e shkatërrimit për të filluar të cilesojmë tiparet e ndryshme të botës sonë të pashumaniteteve në mënyrë që të mund të fillojmë të gjejmë protokollet e duhura për manualin tonë të mbijetesës.

Kristofer Finsk sugjeron, për shembull (dhe po parafrazoj), se edhe universiteti në rrënoja është një vend i mirë për të filluar punën pedagogjike të humaniteteve. Jam dakord; *nëse* dikush ka ose do të ketë një pozicion *brenda* universitetit në rrënoja. Ama, manuali i mbijetesës së atij personi do të jetë mjaft i ndryshëm nga ai i dikujt që nuk ka

një pozicion frytdhënës brenda universitetit. Me rritjen e numrit të lektorëve të jashtëm, për shembull, arritja e pozicioneve tradicionale brenda universitetit nuk është më një pritshmëri e arsyeshme (nëse ka qenë ndonjëherë e tillë). Ajo ngjanson më tepër me fitimin e një llotarie të vogël për të cilën individit i duhet të punojë vazhdimisht vetëm për të blerë një biletë. Nuk është një bast i zgjuar. Qysh në 1978 Liotar komentonte: “Ditët e sotme, përfitimi i një roge në këmbim të asaj lloj ligjërate që zakonisht quhet filozofi është bërë diçka e rrallë dhe për t’u patur zili. [...] Kësisoj ata që japin mësim në filozofi janë të destinuar të përgjysmohen ose më keq, kurse ata që e kanë studiuar atë mbeten të papunë ose bëhen peng të profesioneve të tjera.”<sup>27</sup> Përdorimi i regimit zombi që kam paraqitur këtu mund të lërë përshtypjen se unë jam i shqetësuar për *mosbërjen-zombi* në raport me këtë punë “pengu” në profesionet jashtë humaniteteve. Por unë nuk e kam hallin aty.

Mund të qëllojë që dikush ka një pozicion të mirë në humanitete brenda një universiteti relativisht frytdhënës (ose jo). Në botën zombi ama, ky fakt përbën një avantazh relativ. Mbyllja brenda dhomës së panikut, si tek *Diaries of the Dead*, është thjesht një avantazh relativ. Çdo shikues i filmave zombi e di fare mirë se pas shkatërrimit zaret janë hedhur tashmë dhe se avantazhet relative sa vijnë e zvogëlohen në rrethanat e duhura. Shkatërrimi tashmë ka goditur; lukunitë janë duke ardhur. Tani ne duhet të prodhojmë manualin tonë të mbijetesës. Në provën e shkatërrimit pikënisja padyshim që bën ndryshim në botën zombi, por gjithë çka ajo nënkupton është se ne na duhen manuale të ndryshëm mbijetese në varësi të shtrëngimeve të ndryshme. Kështu pra, përse kohë që ne vazhdojmë të ushtrojmë angazhimet tona kolektive dhe të ndryshme ndaj humaniteteve, shumë prej nesh jetojmë që tani në shkretëtirën pasapokaliptike të humaniteteve me apo pa universitetin. Por duke qenë se për shumë prej nesh kjo është një situatë relativisht e re (të paktën në lidhje me pritshmëritë tona), ku mund ta gjejmë versionin tonë të protokollit zombi?

Shumë prej nesh nuk i përkasim universitetit tradicional me presupozimet e tij të heshtura dhe përgjigjet e lehta në emër të humaniteteve (që nuk kanë qenë asnjëherë përgjigjet e duhura). Ajo me çka ne jemi duke u marrë këtu është mbijetesa vetë, një problem ekzistencial si asnjë tjetër. Çdo shikues i filmave zombi e di gjithashtu se fakti se diçka duhet të mbijetojë nuk është garanci se ajo *në fakt* ka për të mbijetuar në botën zombi. Fakti se ne kemi përgjigje të arsyeshme në lidhje me vlerën e humaniteteve (vlerën e tyre të patjetërsueshme shoqërore) nuk ka asnjë efekt mbi mbijetesën tonë. Pjesë e detyrës tonë ka për të qenë vlerësimi i kushteve për krijimin e një “bande dije-tarësh” ose një “anije budallenjsh.” Kjo detyrë nuk ndihet, ama, me apele ndaj një të kaluarë idilike – do të mund ta quanim atë Epokën e Artë të Humaniteteve – që edhe nëse ka ekzistuar ndonjëherë është e parikuperueshme pas shkatërrimit. Sipas imazhit të infektiveve zombi ose sëmundjeve, kësaj rradhe prej një tjetër objekti të humaniteteve: çështja është *si të mos* joshemi prej idileve të shpikura prej vetë nesh, domethënë, “si të mos lejojmë që fantazma e një lumturie të braktisur prej kohësh të na joshë e të na bëjë për vete e më pas të na flakë tutje e të na hajë zemrën përsëgjalli.”<sup>28</sup>

Një analogji nga Robert L. Doriti, një biolog molekular, mund të na ndihmojë këtu: “Evolucioni është një kërmangrënës krijues, që merr atë që gjen dhe e vë në punë.”<sup>29</sup> Kësisoj, evolucioni funksionon më tepër si një mekanik i botës së tretë – që vë bashkë ato pjesë këmbimi që gjen vërdallë “për ta bërë makinën tënde të punojë sërish” – se sa

një produkt i inxhinierisë së botës së parë. Ne, ashtu si “banda e dijetarëve” të Uajthedit ose “anija e budallenjëve” të Granelit, po përpiqemi të krijojmë protokollet e kësaj shkretëtire pasapokaliptike, duke marrë e duke përdorur *çfarë*- dhe, në të vërtetë, *cilindo* që na del përpara. Shumë prej përpjekjeve tona në këtë situatë, për shkak se ne nuk mund të mbështetemi tek universiteti tradicional, varen nga vazhdimi i prodhimit të komuniteteve tona të mbijetesës “nxitimthi.” Nuk ka asgjë të domosdoshme në faktin që ne vazhdojmë në këtë përpjekje; mund edhe të ndalojmë. Përsa kohë që ne nuk ndalojmë ama, e kemi për detyrë të gjejmë mënyra për të mbijetuar. Do të bëjë ndryshim nëse zombitë tanë pasapokaliptikë janë të shpejtë ose të ngadaltë, por unë jam optimist se ne kemi për të gjetur protokollët e duhur për të krijuar manualin tone të mbijetesës sepse këtu unë jam në shoqëri të shkëlqyer për të vënë në provë mbijetesën tonë në fundin e humaniteteve.

## Shënime

- 1 Maurice Blanchot, *The Writing of the Disaster*, përkth. Ann Smock (Lincoln: University of Nebraska Press, 1995), 1.
- 2 Më poshtë mund të gjeni një përzgjedhje të përdorimit të gjatë kohëve të fundit të të folurës së shkatërrimit nga shkol­larët tanë rreth situatës “tonë” të sotme: Bill Readings, *The University in Ruins* (Cambridge MA: Harvard University Press, 1996); Gayatri Chakravorty Spivak, *Death of a Discipline* (Nju-Jork: Columbia University Press, 2003); Christopher Fynsk, *The Claim of Language: A Case for the Humanities* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 2004); Isabelle Stengers, *Au temps des catastrophes: Résister à la barbarie qui vient* (Paris: Editions La Découverte, 2009); Paul Virilio, *The University of Disaster*, përkth. Julie Rose (Cambridge: Polity, 2010).
- 3 Blanchot, *The Writing of the Disaster*, 105.
- 4 Alfred North Whitehead, *The Aims of Education and Other Essays* (Nju-Jork: Free Press, 1985 [1929]), 99.
- 5 Po aty, 100.
- 6 Fynsk, *The Claim of Language*, 15.
- 7 Sllavoj Zhizhek e bën këtë pikë kur pyet në lidhje me “konspiratorët” tek *The Wire* (2002–8): “A nuk është ky grup një qelizë konspiratorësh proto-komuniste, ose një grup njerëzish të çuditshëm nga një novelë e Çarls Dikensit ose nga një film i Frank Kapras, me zyrën gjysëm të rrënuar në bodrum që iu caktohet si strofa e tyre konspiratoriale?” (*The Year of Dreaming Dangerously* [Londër: Verso, 2012], 98).
- 8 Cituar në Graeme Paton, “Michael Grove Backs Study of ‘French Lesbian Poetry,’” *The Telegraph* (14 nëntor 2012): <http://www.telegraph.co.uk/education/educationnews/9678834/Michael-Gove-backs-study-of-French-lesbian-poetry.html>. (Parë 27 maj 2013).
- 9 Cituar në Andrew Woodcock, “Tories Promise ‘Brazenly Elitist’ Approach to Education,” *The Independent* (18 janar 2010): <http://www.independent.co.uk/news/education/education-news/tories-promise-brazenly-elitist-approach-to-education-1871867.html>. (Parë 19 korrik 2013).
- 10 Cituar në Geoffrey Walford, *Privatisation and Privilege in Education* (Londër and Nju-Jork: Routledge, 1990), pp. 113–5.
- 11 Whitehead, *The Aims of Education*, 101.
- 12 Po aty
- 13 Po aty, 97.
- 14 Për një diskutim të shkatërtimeve si ndodhi “pasnormale,” sh. Stewart Williams, “Rethinking the Nature of Disaster: From Failed Instruments of Learning to a Post-Social Understanding,” *Social Forces* 87.2 (dhjetor 2008): 1115–38.
- 15 Sh. p.sh. Enrico L. Quarantelli, “The Environmental Disasters of the Future Will Be More and Worse But the Prospect Is Not Hopeless,” *Disaster Prevention and Management: An International Journal* 2 (1993): 11–25.
- 16 Ulrich Beck, *Risk Society: Towards a New Modernity* (Londër: Sage, 1992).
- 17 Për të dhënë vetëm një shembull që bëri bujë, Qendra për Kontrollimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (SHBA) publikoi një novelë të shkurtër “Preparedness 101: Zombie Apocalypse” as a “fun” way to learn disaster preparedness: <http://emergency.cdc.gov/socialmedia/zombies.asp>. (Parë 20 korrik 2013).
- 18 Kjo është teza e Martin Rees, *Our Final Hour: A Scientists Warning: How Terror, Error, and Environmental Disaster Threaten Humankind’s Future in This Century – on Earth and Beyond* (Nju-Jork: Basic Books, 2003).
- 19 Antonio Sánchez-Escalonilla, “Hollywood and the Rhetoric of Panic: The Popular Genres of Action and Fantasy in the Wake

- of the 9/11 Attacks,” *Journal of Popular Film and Television* (2010): 10–20.
- 20 Cituar në Noam Yuran, “Disaster Movies as the Last Remnants of Utopia,” *Ha’aretz* (14 janar 2003): <http://www.haaretz.com/culture/arts-leisure/disaster-movies-as-the-last-remnants-of-utopia-1.22290>. (Parë 2 qershor 2013).
- 21 Blanchot, *The Writing of the Disaster*, 1.
- 22 Fredric Jameson, “The Dialectics of Disaster,” *South Atlantic Quarterly* 101.2 (pranverë 2002): 297–304.
- 23 Po aty, 304.
- 24 Blanchot, *The Writing of the Disaster*, 1.
- 25 Po aty, 9.
- 26 Po aty, 2.
- 27 Cituar në Finsk, “Një Pedagogji në prag të shkatërrimit,” ky vëllim, 50.
- 28 David Foster Wallace, *Infinite Jest: A Novel* (Londër: Abacus, 1996), 374.
- 29 Robert L. Dorit, “A Review of Darwin’s Black Box: The Biochemical Challenge to Evolution, by Michael J. Behe,” *American Scientist* 85,5 (shtat.–tet. 1997): <http://www.americanscientist.org/bookshelf/pub/a-review-of-darwins-black-box-the-biochemical-challenge-to-evolution-by-michael-j-behe>. (Parë 19 korrik 2013).

# A PASSION FOR YES COMING OUT AND AFFIRMATION

Vincent W.J. van Gerven Oei

I would like to offer you today the beginnings of a meditation on the word *yes*, on the gesture of affirmation. We should take great care not to conflate affirmation and saying *yes* – saying it once, twice, or many times over – and in which language? – all too easily. As I will try to elucidate, there is an abyss between saying *yes* and affirming that is not easily crossed, let alone bridged.

One of my entry points will be Jacques Derrida's essay on this word – but is it really a word? – in James Joyce's *Ulysses*,<sup>1</sup> which opens with the question of the translatability of the French *oui*, but which concerns as well – though through different inflections – the English *yes*, Dutch *ja*, or Albanian *po*. One could even say that Derrida grafts the question of translatability as such onto this word, which in French first answers to the *ouïe*, “I hear,” as a response to a call, as the word in which communicability as such is at stake. He reminds us that *yes* also names language itself, not only in the sense of *langue d'oïl* or *langue d'oc*,<sup>2</sup> the two main French dialect groups which derive their names from their respective ancient words for *yes*, but also because “the affirmation of a language through itself is untranslatable.”<sup>3</sup> And indeed names themselves are notoriously untranslatable, because they – especially the proper ones – hook into reality in a way that always suggests a more intimate relation between language and the world than linguists would want us to believe. I would invite anyone who doubts this to drive through the Kosovar countryside and observe the place name signs. The linguistically unstable status of *yes* – as adverb, interjection, or some other outsider category – only adds to its supposedly untranslatable status. And yet, it is the first word of any foreign language we venture to learn.

These issues of translatability and responsibility are further compounded by the question of conditionality: To what extent is a full responsibility which a *yes* would correspond to possible at all? A reading of the word *yes* in our present context would not be complete without at least a marginal mention of the uses of the Albanian word *po*, which not only translates the English *yes* but also introduces conditional sentences



and accompanies the habitual verb form. If I would say “I am talking,” *po flas*, I first of all affirm my own speech act. This is easily turned into a conditional, *po tē flas*, “if I speak.” In this sense – that is, my sense – *yes* does not always answer; it contains a trace of irresponsibility. Every *yes* contains something of a but, an outside or condition to affirmation that we continuously try to erase in repetition. We can think in the same line of Avital Ronell’s reading of Heidegger’s yes-saying to the Nazi party official,<sup>4</sup> or the more general epistemological problem of knowing what you’re saying *yes* to. If we borrow the limited vocabulary of classical speech-act theory, the question then doesn’t become so much “Do you know what you just said?” but rather “Do you know what you just did?”

Both Derrida and Ronell suggest that saying *yes* is “telephonic,” both in the sense that it resounds over a distance and therefore always is affected by distortion and delay, and that the telephone as technological apparatus does not so much add to these inherent obstructions as it stands as a model for them. According to Derrida,

Yes on the telephone can be crossed, in one and the same occurrence, by a variety of intonations whose differentiating qualities are potentialized on stereophonic long waves. They may appear only to go as far as interjection, the mechanical quasi-signal that indicates either the mere presence of the interlocutory *Dasein* at the other end of the line (*Hello, yes?*) or the passive docility of a secretary or a subordinate who, like some archiving machine, is ready to record order (*yes sir*) or who is satisfied with purely informative answers (*yes, sir; no, sir*).<sup>5</sup>

These multiple interferences in saying and hearing saying *yes*, these obstacles that somehow materialize in the telephonic circuit, constitute the traumatic dimension of *yes* that I would like to address today, namely the non-moment at which an individual *yes*, *oui*, *po* or *ja* becomes, constitutes an affirmation. Derrida asserts that in order for a *yes* to carry the value of affirmation, “it must carry the repetition within itself,”<sup>6</sup> yet “[t]his essential repetition lets itself be haunted by an intrinsic threat, by an internal telephone which parasites it like its mimetic, mechanical double, like its incessant parody.”<sup>7</sup> At the same time *yes* “cannot be replaced by ‘approval,’ ‘affirmation,’ ‘confirmation,’ ‘acquiescence,’ ‘consent.’”<sup>8</sup> It is impossible to arrive at an immediacy between saying *yes* and affirmation, the confirmation of this *yes* in one’s own and other people’s memories. *Yes* is always out of joint, and never coincides with the affirmation in and of memory itself. There is only, as Derrida puts it, a “dream of a reproduction which preserves as its truth the living *yes*, archived in the very quick of its voice.”<sup>9</sup>

The gap that Derrida marks between saying *yes* and affirmation that is already operative between speaking, archiving, and commemorating, and which stands as a model for the technologically externalized, but no less internal, telephone, multiplies in the context of television, online video channels, and the currently ubiquitous capturing and recording devices, both private and public. This is precisely because, as Avital Ronell has put it, different from telephony, television – whether on- or offline – “has become the locus of testimony, even if we are faced with false testimony or resolute non-coverage.”<sup>10</sup> Every *yes* on television is inscribed within a testimonial logic, can no longer count on the intimacy of private confession but is subjected to an inevitable

*on the second day after intervening i meet a journalist. talking via perfect translation we still don't communicate with each other. my work is criticized for being too theoretical. i try in vain to explain the participatory intervention in its practice, yet it is not understood. further i am asked for my opinion on albania, on tirana, on the LGBT community... arguing that my stay, though performative in the intervention practice, does not center around me and my personal opinion, leading the conversation back to the theoretical concepts of the imaginary in space and time, voicing a future while envisioning in a newly offered space; the circle goes full stop. no dialogue has come into being.*

*after the interview i wonder about communication differences. how come i can apparently talk to a policeman on the street who does not speak english, engaging with him through the intervention, but fail to communicate the concept of the "reading on disaster" in theory and practice to a journalist?*

The limitation seems to be connected to different understandings of the dialogic. When Mikhail Bakhtin discusses the dialogic relation of languages in his essay "Discourse in the Novel," he states:

All languages of heteroglossia, whatever the principle underlying them and making each unique, are specific points of view on the world, forms for conceptualizing the world in words, specific world views, each characterized by its own objects, meanings and values. As such they all may be juxtaposed to one another, mutually supplement one another, contradict one another and be interrelated dialogically. As such they encounter one another and co-exist in the consciousness of real people.<sup>18</sup>

And yet, further on:

As a living, socio-ideological concrete thing, as heteroglot opinion, language, for the individual consciousness, lies on the borderline between oneself and the other. The word in language is half someone else's. It becomes 'one's own' only when the speaker populates it with his own intention, his own accent, when he appropriates the word, adapting it to his own semantic and expressive intention. Prior to this moment of appropriation, the word does not exist in a neutral and impersonal language [...], but rather it exists in other people's mouths, in other people's contexts, serving other people's intentions.<sup>19</sup>

Having to choose, not only one's own words and their meanings, but also how to connect those own words to the words of the other, how to make an understanding which is dialogical at its best but which nonetheless often triggers a deeper non-understanding of (each) other/s. A dialogue does not solely exist of listening and speaking to one another, but of the consciousness of the boundaries in meaning and perception not only of language but of the world itself. Reflecting on the dialogic in the proceedings of the intervention, i realized

*that i am not only an outsider in language and culture, coming to tirana with my eurocentric upbringing and education, but that my analogies to my work as educational programs curator at the center of contemporary art in tbilisi have brought as much obscure understanding of the perspectives on living conditions and education in the post-communist/post-socialist/post-soviet space as pure eurocentrism could have provided me with.*

*the social situation in tirana within the comparison to the so similar and yet so different tbilisi faked a common ground. students talking about their aim to leave the country as to study abroad – which always implied studying in the "west" –, the brain drain going along with that notion, the wish for a better life in the present and a possible future.*

*my criticism on the state of democracies in the 'west' as well as on the educational systems, which have long lost one of the core principles of wilhelm von humboldt's humanistic ideals: freedom. universities in the west having become factories of producing functioning citizens more than places for free thought.*

*i felt stuck more than in my daily life in tbilisi, lost in a comparison not valid, in the perspective of an intruding other, who aims to use her own agency as to make audible the voices of others.*

*what an absurd arrogance, fully embedded in a neocolonial notion.*

### **Fragmentation**

Yes, *thinking for oneself, this is the key that will undo individualism...* this may seem a bit paradoxical, but it is indeed in thinking for ourselves that we will undo preconceived ideas, that we learn to confront ideas and not merely take them as already established and unquestionable.<sup>20</sup>

It is those individual ideas which claim to be universal because they express our concepts of the world and how it should function, those ideas based on theory or experience, which are essential for our relation to our surroundings as well as to our visions of a future to come, and yet, even if individualism takes it fails to become reality. The world and educational system we live and work in are fragmented ones, albeit fragmented not only in a negative sense, a world and system in pieces, pedagogies in disaster. The disaster which we witness and in which we take part can be seen as a constant, not as an eruptive or more or less sudden collapse. Disaster in its different stages of an ongoing circular movement has been part of both world history and the history of education. How many voices from the past can we name when education is not criticized, not envisioned of becoming something better or more, not striving for an ideal? Walter Benjamin's well known aphorism describes culture in ruins:

A Klee painting named *Angelus Novus* shows an angel looking as though he is about to move away from something he is fixedly contemplating. His eyes are staring, his mouth is open, his wings are spread. This is how one pictures the angel of history. His face is turned toward the past. Where we perceive a chain of events, he sees one single catastrophe which keeps piling wreckage upon wreckage and hurls it in front of his feet. The angel would like to stay, awaken the dead, and make whole what has been smashed. But a storm is blowing from Paradise; it has got caught in his wings with such violence that the angel can no longer close them. The storm irresistibly propels him into the future to which his back is turned, while the pile of debris before him grows skyward. This storm is what we call progress.<sup>21</sup>

Yet, culture and knowledge always build up on ruination, as the educational systems always face disaster. As Yael Navaro-Yashin states, knowledge production is constantly a "subject to ruination."<sup>22</sup> She further describes her metaphor of ruins as both vertical and horizontal, quoting Deleuze and Guattari's dichotomy of the root and rhizome, combining them as a construct of memory, of traces of historical events together with an unforeseen and uncontrollable growth.<sup>23</sup> It is in this sense also that we may consider Tim Ingold's concept of "way-faring," a negotiation of a path through the world, a "storied world [where] things don't exist. They occur."<sup>24</sup> Knowledge production is a process that needs movement and the flexibility in thinking of things not as necessity but as action.

The "Reading on Disaster" was not about knowing what do people think but about which thoughts people, through a dialogue, would like to share.

*ideally i thought that participants who were interested would help me gather the wishes/dreams/desires as to write a collective manifesto which then could be presented by them at the conference. as to step out of even the invisible performance and offer those 20 minutes of presentation time to the voices which i had intended to bring to the conference room. but then it was just me gathering all the written wishes/dreams/desires, including every single one of them into the manifesto as to avoid a manifesto written by only one, speaking for many. the multiplicity of voices all of which with the same value, a fragmentation depicting the questions instead of a manifesto of change.*

A collective, guided by an individual? An invisible performer leading into civil disobedience?

In the manifesto that was the result of the intervention,<sup>25</sup> the I was taken out, completely, even though my invisibility could be traced in the thematic arrangement of the text. It was an attempt at following Roland Barthes's "What is the significance? The sense if it is produced sensually."<sup>26</sup> The manifesto aimed not only to be heard by an unknown audience but to be sensually audible to the voices within.

*before the conference opening i learnt how to make popcorn with a popcorn bike. i was taught how to control gas and electricity, how not to burn the seeds, how to listen to the process.*

*then at the opening, for once the popcorn bike was just a popcorn bike and i was again i. i was handing out small bags of popcorn. to conference participants. to passers-by. together with the 'reading on disaster' manifesto.*

Only one person who had participated in the intervention came to the presentation of the manifesto. Can this be seen as limitation? As justification for the exclusiveness of conference settings? Or as a previously unthought act? A taken agency? Of disobedience?



## Notes

- 1 All quotations in italics derive from my intervention diary and notes as well as from the collected material during the intervention in Tirana.
- 2 Motto intervention day 1: Irit Rogoff, "Academy as Potentiality," in *A.C.A.D.E.M.Y.*, ed. Angelika Nollen (Frankfurt am Main: Revolver, 2006), 14–15.
- 3 Giorgio Agamben, *Potentialities: Collected Essays*, ed. and trans. Daniel Heller-Roazen (Stanford: Stanford University Press, 1999), 178.
- 4 Rogoff, "Academy as Potentiality," 15.
- 5 Gayatri Chakravorty Spivak, "Can the Subaltern Speak?," in *Marxism and the Interpretation of Culture*, ed. Cary Nelson & Lawrence Grossberg (London: MacMillan, 1988), 27.
- 6 Motto intervention day 3: Hakim Bey, *The Temporary Autonomous Zone: Ontological Anarchy, Poetic Terrorism* (Brooklyn: Autonomedia, 1991): [http://hermetic.com/bey/taz\\_cont.html](http://hermetic.com/bey/taz_cont.html)
- 7 Ibid.
- 8 Boyan Manchev, "The Metaseminar: Theses on Education and the Experience of Critical Thought," *Springerlin* 2/09 (2009): [http://www.springerlin.at/dyn/heft\\_text.php?textid=2206&lang=en#top](http://www.springerlin.at/dyn/heft_text.php?textid=2206&lang=en#top)
- 9 Ibid.
- 10 Ibid.
- 11 Merab Mamardashvili, "The Civil Society: An Interview with Merab Mamardashvili," *The Civil Arts Review* 2.3 (1989).
- 12 Motto intervention day 2: Manchev, "The Metaseminar."
- 13 Ibid.
- 14 Ibid.
- 15 Cornelius Castoriadis, *The Imaginary Institution of Society*, trans. Kathleen Blamey (Cambridge MA: MIT Press, 1987), 3.
- 16 Manchev, "The Metaseminar."
- 17 Ibid.
- 18 Mikhail Bakhtin, "Discourse in the Novel," in *Dialogic Imagination*, trans. Caryl Emerson and Michael Holquist (Austin: University of Texas Press, 1975/1992), 291–2.
- 19 Ibid., 293–4.
- 20 "Constitution of Happiness," this volume, 527ff.
- 21 Walter Benjamin, *Illuminations*, trans. Harry Zorn (London: Cape, 1970), 257–8.
- 22 Yael Navaro-Yashin, "Affective Spaces, Melancholic Objects: Ruination and the Production of Anthropological Knowledge," *Journal of the Royal Anthropological Institute* 15 (2009): 7.
- 23 Ibid., 14.
- 24 Tim Ingold, *Being Alive: Essays on Movement, Knowledge and Description* (Abingdon: Routledge, 2011), 160.
- 25 This volume, 295f.
- 26 Roland Barthes, *Le Plaisir du texte* (Paris: Seuil, 1973), 97. My translation.

# NDËRHYRJE “TË LEXOJMË MBI SHKATËRRIMIN”

## IMAGJINARET NË PRAKTIKAT PJESËMARRËSE ARTISTIKE

Katarina Stadler



### Zëra

Si t'iu japim zë të tjerëve? Si të ftojme një zë të nyjëtohet e me tej të dëgjohet. Mes pazëshmërisë dhe pagojësisë time ndërsa punoja në një vend me gjuhë të huaj. E përqëndruar tek përfshirja e zërit/zërave thuajse të padëgjuar në një konferencë akademike.

*gjatë ndërhyrjes “të lexojmë mbi shkatërrimin” zgjedha çdo ditë nga një vend të ndryshëm me qëllim për të krijuar një hapësirë sado të vogël pjesëmarrje të mundshme. biçikleta ime e kokoshkave, si një dhomë lëvizëse seminaresh, përbënte qendrën e atyre hapësirave imagjinare, duke ofruar tekstet e secilës ditë në kopje të shumëfishta, moton e secilës ditë si dhe fletë dhe stilolapsa.*

*punova çdo ditë në vendndodhje, duke ndërhyrë në qytet për të angazhuar të menduarit mbi arsimin, të ardhmen e arsimit në shqipëri. duke mbledhur dëshira/*

ëndrra për të përcjellë jo një zë por shumë zëra, të përmbledhura në një manifest që parapërfytyronte një të ardhme imagjinare të konferencës mbi “pedagogjitë e shkatërrimit.”

për të ndezur kapacitetin për refleksion dhe vizion kisha përzgjedhur disa tekste mbi arsimin dhe/ose prodhimin e dijes; tekste nga Irit Rogoff, boyan manchev, hakim bey, yael navaro-yashin, tim ingold, dhe jacques rancière. prej këtyre teksteve u zgjodhën motot e përditshme në vijim:

POTENCIALITETE; SFERA KRITIKE [...] ËSHTË ME PËRKUFIZIM BOSH; TERRORIZËM POETIK; MES PIRGJEVE TË GËRMADHAVE TË PRODHIMIT TË DIJES; TË LËVIZËSH ËSHTË TË DISH; TË DISH NUK ËSHTË ASGJË. TË BËSH ËSHTË GJITHÇKA!<sup>1</sup>

POTENCIALITETET<sup>2</sup> në fjalë, të menduara me Xhorxho Agambenin, janë njëkohësisht impotencialitete:

Të jesh potencial do të thotë të jesh mangësia e vetvetes, të vihesh në raport me inkapacitetet e tua. Qeniet që jetojnë sipas mënyrës së potencialitetit janë të afta për impotencialitetin e tyre; dhe vetëm kësajohet të bëhen potencialë. Ata mund të jenë sepse ata janë në raport me joqenien e tyre. Në potencialitet, ndjesia është në raport me anestezinë, dija me injorancën, shikimi me errësirën.<sup>3</sup>

Dikotomia e Agambenit mes potencialitetit dhe impotencialitetit nuk është ajo e diçkaje të tillë. Ajo nënkupton përkundrazi t’ia lësh ekskluzivitetin e përkatësisë dhe kategorizimit përkufizimit nëpërmjet analizës së një të huaji, që megjithatë plotëson si potencialitetin dhe impotencialitetin.

*dita e parë e ndërhyrjes, që e kalova përballë universitetit politeknik të tiranës, m’u duk si një shterim. si të ofrosh një hapësirë për kapacitetin potencial për veprim pa u spikatur gjatë kryerjes së kësaj. si të eliminosh zërin prej tregimtari kur mbledh tregimet e të tjerëve.*

*u ula përbri biçikletës time të kokoshkave: impotencialitet. pa bërë, pa ndërhyrë. atje. e pranishme. vetëm vrojtoja: vajza që hipnin në një makinë, pinin duhan, flirtonin përmes xhamave të dritareve. biseda mes studentësh, që nuk kuptoheshin. një fjalim fushate elektorale dhe muzikë shurdhuese dance. gjuhë që përsëri nuk merret vesh, rrahjet [e muzikës] zhurmëmëdha dhe të bezdisshme. e megjithatë. ritmi i të papëlqyerës.*

Një “pedagogji që nuk merret me arritjen por me përpjekjen”<sup>4</sup> siç thotë Irit Rogof. Si koncept pedagogjik thotë diçka që dihet. Por kjo ndërhyrje ishte përqëndruar mbi prurjen e zërave të të tjerëve në një hapësirë ku ata nuk dëgjohen zakonisht. Ku përdorimi i gjuhës dhe titujt e folësve trembin ata që nuk bëjnë pjesë tek elita. Ku kushdo që nuk ka mësuar të flasë në gjuhët e akademisë bëhet një nëntjetër [subaltern] i dijes dhe kësajohet humbet fuqinë për të ngritur zërin.

Problemi qëndron tek fakti se itinerari i subjektit nuk është përvijuar në mënyrë që të ofrojë një objekt joshjeje për intelektualin përfaqësues. [...] Si mund të prekim ndërgjegjen e njerëzve ndërsa hetojmë politikat e tyre? Me çfarë zë-ndërgjegje mund të flasë nëntjetri?<sup>5</sup>

Si t' i shpëtojme statusit të intelektualit përfaqësues, si ta kapërcejmë të folmen për të nëntjerët? Si të ngremë një zëndërgjegje pa u imponuar? Duke dëgjuar. Jo për të dhënë zë por për të dëgjuar zërat. Edhe ata të heshturit. Megjithë argumentin se zërat nuk ekzistojnë. Se ose ata vetë ose të tjerët duhet t' i sjellin në jetë.

*sa të ndryshëm studentët nga universitetet të ndryshëm, fakultete të ndryshëm. studentët e artit që mendojnë se arsimit që po marrin është i pajisur t' i çojë drejt famës; studentët e filozofisë që reflektojnë, pyesin dhe kritikojnë gjithçka; studentët e universitetit privat shqipëtar që paguajnë për pafhtësinë e tyre për të menduar.*

*hyn në lojë gjykimi im ndonëse po përpiqem vetëm të vështroj dhe të grumbulloj. bëhet sa vjen më sfiduese të mos përfshihem në këtë proces.*

Në një praktikë arti që përfshin pjesëmarrje ka gjithmonë një iniciator, një artist ose kurator që përcakton parametrat. Si një antropolog që shtron pyetjen fillestare të kërkimit ky artist ose kurator strukturon praksin në të cilin ftohen më pas pjesëmarrësit. Në atë moment kërkohet fleksibilitet dhe një hapje ndaj improvizimit.

*reflektoj mbi pozicionin tim në këtë situatë, mbi elementin performativ kur jam rrugëve me biçikletën e kokoshkave. po, kjo ka të bëjë me performativitetin, jo në kuptimin e zakonshëm të fjalës, ndoshta as edhe në kuptimin e aktit të rënies në sy me performancën tënde por është një performancë e bërjes së egos tënde, ta bësh veten të padukshme.*

*jo për të mashtruar njerëzit me të cilët ndërvepron, jo për të shtirur praksin pjesëmarrëse. duhet të jesh vetë ti, vetë unë atje me biçikletën e kokoshkave, por në padukshmërinë time duhet të bëhet e qartë se nuk jam unë ajo që ka rëndësi dhe as opinionin im mbi arsimin apo edhe vizionet arsimore në shqipëri.*

*ndjej kufijtë e mi. qysh prej ditëve të para të ndërhyrjes po e shtyj atë biçikletë mes rrugëve me një kollë të rëndë. shiu nuk i thjeshtëzon gjërat, i përkeqëson ato. takoj njerëz të tjerë biçikletash. një që po mbledh shishe tek koshat e plehrave. një që po lëviz ngarkesa të rënda nga një vend tek tjetri. në padukshmërinë time ndjej një lidhje të fortë me ata punëtorë ndonëse motivet tona janë kaq të ndryshme. unë nuk endem rrugëve për të fituar para; e megjithatë, kur takohemi, ne përshëndetemi përherë.*

TERRORIZËM POETIK<sup>6</sup>: "[...] nëse nuk i ndryshon jetën dikujt (përveç artistit) dështon."<sup>7</sup> T' i ndryshosh jetën dikujt. T' i japësh dikujt mundësinë për t' u dëgjuar, a mund t' ia ndryshojë kjo jetën? Ka mundësi e megjithatë, jo. Mosbindja qytetare mund të frymëzohet, por jo të organizohet. Ky është problemi kryesor me të gjitha lëvizjet si "Ne jemi 99 përqindja." Nuk mund të flasim për të tjerët. Nuk mund t' i organizojmë të tjerët. Ndërhyrja "Të lexojmë mbi shkatërrimin" nuk pati asnjëherë për qëllim të ishte terrorizëm poetik në kuptimin e Hakim Bejt. Qëllimi, i qartë qysh prej fillimit, ishte debatimi i arsimit dhe i prodhimit të dijes, me fjalë dhe me qasje pamore.














*ka raste kur gjatë bisedave më të gjata iu ofrova pjesëmarrësve që dukeshin veçanërisht të interesuar ose tek tema ose tek ndërhyrja të merrnin me vete një aparat fotografik\* njëpërdorimsh dhe ta mbanin për nja dy ditë për të dokumentuar qasjen e tyre ndaj arsimit. idetë dhe pritshmëritë që kisha i mbajta qëllimisht të vagullta. që shpesh shkaktoi konfuzion. si mund të rrokësh në mënyrë pamore idetë e tua mbi një temë që zakonisht shprehet me fjalë. sfida që pikërisht ajo. terrorizmi poetik i kthyer mbrapsht. përdorimi i artit dhe i dokumentimit për të shtjelluar filozofinë dhe politikën e arsimit të ardhshëm.*

Grumbullimi i zërave dhe tregimeve, elementi i befasismit kur njerëzit zbulonin biçikletën e kokoshkave, kur ndiheshin të ndarë mes kureshtjes për të zbuluar se për çfarë hynte në punë biçikleta dhe qëllimit për të vazhduar me planet e ditës. Ideali i terrorizmit poetik për të ndryshuar mund të gjendej brenda biçikletës së kokoshkave, ndonëse motivimi për t'i dhënë një zë zërave të tjerë ngeci tek mundësia qoftë edhe për të menduar së bashku. Siç iu përgjigj Bojan Mançev pyetjes “A është e mundur të mendojmë së bashku? [...] Një potencialitet universal i mendimit?”<sup>8</sup> me “Jo, pasi vetëqenësia [singularity] e mendimit, e përjetimit të tij nuk mund të reduktohet në një totalitet; është pikërisht pareduktueshmëria e tij që e bën mendim.”<sup>9</sup> Nuk kishte prarugë tjetër “përveç kësaj eksperience radikale të vetëqenësisë së përbashkët të mendimit, të inteligjencës së përbashkët brenda shumicës”<sup>10</sup> dhe kësaj që hapjes së rrugës, ndryshimit të idesë për shkrimin e një manifesti me pjesëmarrësit që do të paraqitej gjatë konferencës, tek mbajtja si e vetëqenësisë së mendimit dhe të inteligjencës së përbashkët në shumicë duke mos analizuar, mos zgjedhur por duke u përqëndruar tek e fragmentuara.

\* Katër pjesëmarrës i kthyen kamerat e tyre njëpërdorimshme. Një përzgjedhje e imazheve që ata morën tregohet më sipër.



### Imagjinaret

Për t’iu dhënë zërave një kapacitet veprimi duhen shkatërruar kufijtë fizikë dhe duhet krijuar një hapësirë imagjinare. Thjesht imagjinaria shkatërron mundësinë e të pamendueshmes, e redukton atë në koncepte që njihen nga të gjithë. “Pyetja që më lindi qe: do të mund të kishim një situatë shoqërore që zapton ndërgjegjen deri në atë masë sa asnjë pyetje filozofike nuk do të mund të ngrihej më, sa asnjë ide nuk do të mund të na vinte më në mendje pa qenë e kontrolluar nga situata shoqërore.”<sup>11</sup> Konteksti shoqëror paskomunist dhe pro-BE i Shqipërisë, i mendimësisë para-elektorale dhe shqetësimeve paselektorale – sfida për të krijuar një hapësirë që nuk përjashton asnjë prej këtyre nocioneve e megjithatë hap hapësirën menduese për një vizion jashtë, përtej situatës shoqërore, duke kapërcyer rrezikun, që Merab Mamardashvili e kishte përshkruar, e të menduarit brenda kufijve të përcaktuar.

**SFERA KRITIKE** – një sferë mendje-mprehtësie, gjykimi dhe krize (sipas etimologjisë së ‘krisis’) në zemër të sferës publike – ËSHTË ME PËRKUFIZIM BOSH.<sup>12</sup> Ajo është boshllëku i papërshtatshëm në zemër të sferës publike, që nuk i përket asnjë interesi privat, ku ekzistenca politike bën ligjin. Ajo është zemra e zjarrtë por boshë, që nuk i përket askujt, e demokracisë. Ajo nuk përvetëson, por ka rezistencën imanente ndaj çdo lloj përvetësimi.<sup>13</sup>

Lind pyetja nëse demokracia ka vende të papërshtatshme për qytetarët e saj, nëse këto vende, ndonjëherë të dorëzuara vullnetarisht, nuk janë aq të kufizuara sa ato që sugjeron Mamardashvili, që kufizojnë mendimin dhe ndërgjegjen. Një vend i dhënë është domos një vend i kufizuar. Një hapësirë e marrë, imagjinare, mund të zgjasë kufijtë e asaj që jepet (si e dhënë). Ja pra pse pyetja nëse hapësira që ofrohet nëpërmjet ndërhyrjes “Të lexojmë mbi shkatërrimin,” një hapësirë që përcaktohet nga biçikleta e kokoshkave

si një seminar lëvizës, një hapësirë që ndërtohet në mënyrë të vegullt rreth kufizimit të përdorimit të anglishtes si një gjuhë njëfarësoje e përbashkët, tejkaloi të dhënë dhe të përshtatshmen tek një imagjinare të ndarë dhe të ruajtur prej pjesëmarrësve.

Vetëqenësia e hapësirës së ndërhyrë dhe kësaj rrisht të krijuar solli kufizime. “Një gjuhë e vetme nënkupton mungesën e gjuhës, sepse gjuhët janë gjithmonë një shumësi, ato ekzistojnë në një hapje dinamike ndaj njëra-tjetrës, në zbulimin dhe kryqëzimin e tyre.”<sup>14</sup> Kufizimet që në analogji me reflektimet e Bojan Mançevit mbi parimet e komunikimit, përkthimit dhe ndarjes së dijes përmes dhe/ose brenda gjuhës mund të shihen se krijojnë një mungesë, një mungesë që mund të jetë ideale për imagjinaren, që eliminon imazhin e një krijimi të mundshëm, por ngre pyetjet e hesitura. Siç propozon Korneli Kastoriadis në një përkufizim të shkurtër të imagjinare – “Imagjinaria për të cilën po flas nuk është një imazh i saj. Ajo është krijimi (socio-historik dhe psikik) i parreshtur dhe në thelb i papërcaktuar i figurave/formave/imazheve, dhe vetëm në bazë të saj mund të ngrihet çështja e ‘diçkasë.’”<sup>15</sup> – imagjinaria mund të ndërtohet vetëm përmes si mungesës ashtu edhe dialogut, një dialog që Mançev e propozon kur ofron forma të reja komunikimi “mbi të vetmen hapësirë të përbashkët të mundshme – atë të vetëqenësisë, dhe kësaj të papërkthyeshmërisë, të gjuhëve të veçanta.”<sup>16</sup> Për më tepër, ai e përkufizon këtë hapësirë si një sferë “tipari parësor i së cilës është pikërisht hapja e gjuhëve homogjene ndaj shumëfishimit të idomave të veçanta, dhe përmes tyre eksperimentimi me plasticitetin e ekzistencës.”<sup>17</sup>

*ditën e dytë pas ndërhyrjes takoj një gazetare. ndonëse flasim mes një përkthimi të përkryer prapë nuk merremi vesh. puna ime kritikohet si tepër teorike. më kot përpiqem ta shpjegoj ndërhyrjen pjesëmarrëse në praktikimin e saj, prapë nuk kuptohet. më tej pyetem mbi mendimin tim mbi shqipërinë, mbi tiranën, komunitetin LGBT... argumentoj se ndonëse prania ime është performative në praktikimin e ndërhyrjes, ajo nuk përqëndrohet tek unë apo mendimet e mia personale, që e çon bisedimin edhe një herë tek konceptet teorike të imagjinare në hapësirë dhe kohë, t’i japësh zë një të ardhmeje ndërsa përfytyron brenda një hapësire të ofruar rrisht; rrethi rrotullohet. asnjë dialog nuk ka lindur.*

*pas intervistës bluaj në mendje dallimet në komunikim. si është e mundur që unë mund të flas me një polic në rrugë që nuk flet anglisht, ta angazhoj atë përmes ndërhyrjes, por nuk arrij t’ia komunikoj konceptin e “të lexuarit mbi shkatërrimin” në teori dhe në praktikë një gazetareje?*

Kufizimi duket se lidhet me kuptimet e ndryshme të dialogjikes. Kur Mihail Bahtin diskuton raportin dialogjik të gjuhëve në sprovën e tij “Ligjërata brenda novelës,” ai thotë:

*Të gjitha gjuhët e heteroglossia-s, cilido parimi i nënvendosur që e bën secilën prej tyre unike, janë këndvështrime specifike mbi botën, forma për të conceptualizuar botën me fjalë, botëkuptime të ndryshme, secili i karakterizuar nga objektet e tij, kuptimet dhe vlerat e tij. Kështu ato mund të pranëvihen [juxtapose], të plotësojnë njëra-tjetrën, të kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe të ndërliken dialogjikisht.*

Kështu ato ndeshen me njëra-tjetrën dhe bashkekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve realë.<sup>18</sup>

E megjithatë, me tutje:

Si një gjë e gjallë, socio-ideologjikisht konkrete, si mendim heteroglot, gjuha, për ndërgjegjen individuale, gjendet në kufi mes vetes dhe tjetrit. Fjala në gjuhë i përket gjysëm tjetrit. Ajo bëhet e vetë individit vetëm kur folësi e mbush atë me qëllimin e tij, theksin e tij, kur ai përvetëson fjalën, ia përshtat atë qëllimit të tij semantik dhe shprehës. Para këtij momenti përvetësimi, fjala nuk ekziston në një gjuhë asnjëse dhe jopersonale [...], por ekziston në gojët e njerëzve të tjerë, në kontekstet e njerëzve të tjerë, në shërbim të qëllimeve të njerëzve të tjerë.<sup>19</sup>

Të detyrohesh të zgjedhësh, jo vetëm fjalët e tua dhe kuptimet që ato kanë, por edhe si t'i lidhësh ato fjalë me fjalët e tjetrit, si të krijosh një mirëkuptim që në rastin më të mirë është dialogjik e që megjithatë bëhet shtysë për një moskuptim më të thellë të (njëri-) tjetrit/të tjerëve. Një dialog nuk krijohet vetëm duke dëgjuar dhe folur me njëri-tjetrin, por në ndërgjegjësimin për kufijtë në kuptim dhe perceptimin e jo vetëm gjuhës por edhe vetë fjalës. Duke reflektuar mbi dialogjiken në punimet e ndërhyrjes, kuptova se

*nuk jam e huaj vetëm në gjuhë dhe kulturë, duke ardhur në tiranë me edukimin dhe arsimimin tim eurocentrik, por se analogjitë e mia me punën time si kuratore e programeve arsimore në qendrën për artet bashkëkohore në tbilisi më kanë dhënë një kuptim po aq të errët të perspektivave të kushteve të jetesës dhe arsimit në hapësirën paskomuniste/passocialiste/passovjetike sa ai që do më kishte dhënë vetë evrocentrizmi i pastër..*

*situata shoqërore në tiranë brenda krahasimit me tbilisin kaq të ngjashëm e megjithatë kaq të ndryshëm krijoi një terren të përbashkët të rremë. studentë që flasin për qëllimin e tyre për t'u larguar nga vendi për të studiuar jashtë – që gjithmonë nënkuptonte në 'perëndim' –, shterja e trurit që e shoqëron atë nocion, dëshira për një jetë më të mirë në të tashmen dhe për një të ardhme të mundshme.*

*kritika ime e gjendjes së demokracisë në 'perëndim' si dhe e sistemeve arsimore, që ka kohë që kanë humbur një nga vlerat kyçe të idealeve humaniste të wilhelm von humboltit: lirinë. pasi universitetet në perëndim janë shndërruar në fabrika që prodhojnë qytetarë funksionalë më tepër se në vende për mendimin e lirë.*

*u ndjeva më e bllokuar nga ç'ndihem në jetën time të përditshme në tbilisi, e humbur në një krahasim që nuk shkonte, në perspektivën e një tjetri ndërhyrës, që do të përdorë kapacitetin e saj për të vepruar për t'iu dhënë zë zërave të të tjerëve.*

*çfarë arrogance absurde, tërësisht e rrënjësuar në nocionin neokolonial.*

### Fragmentimi

Po, të mendosh me mendjen tënde, ky është çelësi që do të zhbëjë individualizmin... kjo mund të duket pak paradoksale, por vetëm kur të mendojmë me mendjen tonë do të zhbëjmë idetë e paragjykuara, të ballafaqohemi me idetë dhe jo thesht t'i marrim si të mirëqena dhe të padiskutueshme.<sup>20</sup>

Janë ato ide individuale që pretendojnë se janë universale pasi shprehin konceptet tona mbi botën dhe mënyrën se si ajo duhet të funksionojë, ato ide të bazuara në teori ose në përvojë, që janë thelbësore për raportin tonë me atë që na rrethon si dhe për vizionet tona për një të ardhme të mundshme, e megjithatë, edhe nëse individualizmi zë ai nuk arrin të bëhet realitet. Bota dhe sistemi arsimor që ne jetojmë janë të fragmentuara, ndonëse vetëm në një kuptim negativ, një botë dhe një sistem copë-copë, pedagogji në shkatërrim. Shkatërrimi i të cilit ne jemi dëshmitarë dhe në të cilin ne marrim pjesë mund të shihet si një konstante, jo si një kolaps shpërthyes apo pak a shumë i papritur. Shkatërrimi në fazat e tij të një lëvizje të vazhdueshme ciklike ka qenë pjesë si e historisë së botës ashtu edhe e asaj të arsimit. Sa zëra prej të kaluarës mund të emërtojmë nëse arsimit nuk kritikohet, nuk përfytyrohet si diçka më mirë ose më tepër, që nuk përpiqet të arrijë një ideal? Aforizmi i mirënjohur i Valter Benjaminit përshkruan kulturën në rrënoja:

Një pikturë e Klesë e quajtur *Angelus Novus* tregon një ëngjëll që duket sikur është gati për t'u larguar prej diçkaje që po e kundron me vëmendje. Sytë e tij janë të ngulur, goja e hapur, krahët e shpalosur. Kështu e imagjinojmë ëngjëllin e historisë. Fytyra e tij është e kthyer ndaj të kaluarës. Aty ku ne perceptojmë një zinxhir ndodhish, ai sheh një katastrofë të vetme që vë parg njëri mbi tjetrin rrënim mbi rrënim dhe ia hedh ato tek këmbët. Ëngjëlli do të donte të qëndronte, të zgjonte të vdekurit, dhe të bënte një atë që është thyer. Por një furtunë fryn nga Parajsja; ajo është ngatërruar në krahët e tij me kaq dhunë sa që ëngjëlli nuk mund t'i mbyllë. Furtuna e shtyn atë drejt të ardhmes ndaj të cilës është kthyer kurrizi i tij, ndësa gërmadha para tij duket sikur do rroki qiellin. Kjo furtunë është ajo çka ne quajmë progres.<sup>21</sup>

Po, kultura dhe dija gjithmonë ndërtohen mbi rrënoja, ashtu siç sistemet e arsimit gjithmonë përballen me shkatërrimin. Siç thotë Jael Navaro-Jashin, prodhimi i dijes vazhdimisht i "nënshtrohet rrënimit."<sup>22</sup> Ajo e përshkruan metaforën e rrënojes si njëherazi vertikale dhe horizontale, duke cituar dikotominë e Dëlëz [*Deleuze*] dhe Guatarit [*Guattari*] të rrënjës dhe rizomës, duke i kombinuar ato si një konstrukt i kujtesës, i gjurmësh ngjarjesh historike së bashku me një zhvillim të paparashikuar dhe të pakontrollueshëm.<sup>23</sup> Mund të kuptojmë kështu edhe konceptin e "rrugëtimit" të Tim Ingoldit, negocimi i një rruge në botë, një "botë historish [ku] gjërat nuk ekzistojnë. Ato ndodhin."<sup>24</sup> Prodhimi i dijes është një proces që ka nevojë për lëvizje dhe fleksibilitet në mendimin e gjërave jo si nevojë por si aksion.

"Të Lexojmë mbi shkatërrimin" nuk lidhet me të diturit se çfarë mendojnë njerëzit por me mendimet që ata, përmes një dialogu, do të donin të ndanin.

*mendova se pjesëmarrësit që ishin të interesuar do të më ndihmonin të grumbulloja dëshira/ëndrra për të shkruar një manifest kolektiv që ndoshta mund ta paraqisnin më pas gjatë konferencës. për të dalë jashtë edhe performancës së padukshme dhe për t'ua ofruar ato 20 minuta zërave që kisha dashur t'i sillja brenda dhomës së konferencës. por isha vetëm unë ajo që mbledhja gjithë ato dëshira/ëndrra, duke ndërthurr secilën prej tyre brenda manifestit për të evituar një manifest të shkruar nga vetëm një person por*

*që përfaqësonte shumë. shumësia e zërave që kishin të gjithë një vlerë të barabartë, një fragmentim që përshkruante pyetjet në vend të ndryshimeve në manifest.*

Një kolektiv i drejtuar nga një individ? Një performues i padukshëm që çon në mosbindje qytetare?

Në manifestin që qe produkti i ndërhyrjes,<sup>25</sup> unë mungoja, ndonëse padukshmëria ime mund të gjurmohej në organizimin tematik të tekstit. Qe një përpjekje për të ndjekur “Cili është kuptimi? Kuptimi nëse ai prodhohet sensualisht.”<sup>26</sup> Manifesti kishte për qëllim jo vetëm të dëgjohej prej një audience të panjohur por edhe të ishte sensualisht i dëgjueshëm për zërat përbrenda.

*para hapjes së konferencës mësova të bëj kokoshka me biçikletën e kokoshkave. më mësuam si të kontrolloj gazin dhe elektricitetin, si të mos djegë farat, si t’i vësh procesit. dhe më pas, gjatë hapjes, biçikleta e kokoshkave u kthye sërish në një biçikletë të thjeshtë dhe unë u bëra sërish vetvetja. po iu shpërndaja qeska të vogla me kokoshka. pjesëmarrësve të konferencës. kalimtarëve. bashkë me manifestin ‘të lexojmë mbi shkatërrimin.’*

Vetëm një person që kishte marrë pjesë në ndërhyrje erdhi tek paraqitja e manifestit. A mund të shihet kjo si një kufizim? Si justifikim për ekskluzivitetin e hapësirës së konferencës? Ose si një veprim që nuk qe menduar më parë? Një kapacitet veprimi i marrë? Mosbindjeje?

## Shënime

- 1 Të gjitha citimet në kursive janë shkëputur prej ditarit që kam mbajtur gjatë ndërhyrjes në Tiranë si dhe prej shënimeve të mia dhe materialeve që grumbullova.
- 2 Motoja e ndërhyrjes ditën e parë: Irit Rogoff, "Academy as Potentiality," në *A.C.A.D.E.M.Y.*, red. Angelika Nollen (Frankfurt am Main: Revolver, 2006), 14–15.
- 3 Giorgio Agamben, *Potentialities: Collected Essays*, red. dhe përkth. Daniel Heller-Roazen (Stanford: Stanford University Press, 1999), 178.
- 4 Rogoff, "Academy as Potentiality," 15.
- 5 Gayatri Chakravorty Spivak, "Can the Subaltern Speak?," në *Marxism and the Interpretation of Culture*, red. Cary Nelson & Lawrence Grossberg (Londër: MacMillan, 1988), 27.
- 6 Motoja e ndërhyrjes ditën e tretë: Hakim Bey, *The Temporary Autonomous Zone: Ontological Anarchy, Poetic Terrorism* (Brooklyn: Autonomedia, 1991): [http://hermetic.com/bey/taz\\_cont.html](http://hermetic.com/bey/taz_cont.html)
- 7 Po aty.
- 8 Boyan Manchev, "The Metaseminar: Theses on Education and the Experience of Critical Thought," *Springerin* 2/09 (2009): [http://www.springerin.at/dyn/heft\\_text.php?textid=2206&lang=en#top](http://www.springerin.at/dyn/heft_text.php?textid=2206&lang=en#top)
- 9 Po aty.
- 10 Po aty.
- 11 Merab Mamardashvili, "The Civil Society: An Interview with Merab Mamardashvili," *The Civil Arts Review* 2.3 (1989).
- 12 Motoja e ndërhyrjes ditën e dytë: Manchev, "The Metaseminar."
- 13 Po aty.
- 14 Po aty.
- 15 Cornelius Castoriadis, *The Imaginary Institution of Society*, përkth. Kathleen Blamey (Cambridge MA: MIT Press, 1987), 3.
- 16 Manchev, "The Metaseminar."
- 17 Po aty.
- 18 Mikhail Bakhtin, "Discourse in the Novel," në *Dialogic Imagination*, përkth. Caryl Emerson dhe Michael Holquist (Austin: University of Texas Press, 1975/1992), 291–2.
- 19 Po aty, 293–4.
- 20 "Kushtetuta e lumturisë," ky vëllim, 531vv.
- 21 Walter Benjamin, *Illuminations*, përkth. Harry Zorn (Londër: Cape, 1970), 257–8.
- 22 Yael Navaro-Yashin, "Affective Spaces, Melancholic Objects: Ruination and the Production of Anthropological Knowledge," *Journal of the Royal Anthropological Institute* 15 (2009): 7.
- 23 Po aty, 14.
- 24 Tim Ingold, *Being Alive: Essays on Movement, Knowledge and Description* (Abingdon: Routledge, 2011), 160.
- 25 Ky vëllim, 297v.
- 26 Roland Barthes, *Le Plaisir du texte* (Paris: Seuil, 1973), 97.

# MANIFESTO FOR EDUCATION IN ALBANIA

WE are students, professors, people with or without jobs, with children or young ourselves. Who demand.

WE aim for an adequate education of European standard. Meaning better schools, academic freedom, more study possibilities, language classes and choice of language in our studies. As well as a focus on Albanian language and expression. Meaning improved physical environments at universities and most definitely *no corruption*.

WE ask students to be more idealistic and active, work for a common progress in education as well as follow the rules and exercise their rights.

WE ask professors to be more conscious about their teaching and provide students with knowledge and abilities as for them to persevere their interests.


As to increase practical knowledge, sponsor creative thinking and encourage critical thinking WE envision reading groups, platforms for debates and idea exchanging, open lectures with the possibility of students' active participation as well as involvement in cultural events or other events connected to our society.

WE desire exchange. On multiple levels.


WE yearn for creative cooperation of experienced professionals and the young generation. WE long for exchange between students, within the faculties, between different universities in Albania, and internationally.

WE want to study abroad, especially for our MA studies, at European Union or American universities. WE want to live abroad. WE want to travel. As to get to know the world.







My dream is to study in Sorbonne for philosophy.



I wish students to be more idealist, to work for a common good and progress.  
I wish professors to be more conscient on what they do and on what they demand.  
Things can and must be better!



Wish that one day Albanian people knows to decide by themselves what they want really from life



My dream is to work like a social worker all around the world and help people  
Sabina Sejfer ^ ^

As to exchange. As to study. As to come back and let our experiences have an impact on our work and lives. WE wish for more funding possibilities, also from Albanian side, as to be part of the world.

WE are concerned about our knowledge. Concerned about passing exams and finishing our studies. WE are even more concerned about our jobs. WE have so many dreams about our futures. First of all to find a job, ideally a stable one, a good one or even one of our dreams. WE demand jobs to be not only for those with connections. WE think education should prepare us for our futures and provide us with knowledge and experience as to be able to work both in local and international context.

WE desire even more. To become famous for what we are doing, to be known for what WE want to present. Our ideas, our engagement or our home country.

WE can not discuss education apart from our lives. WE believe education and our dreams and wishes for our present and future lives are intertwined. WE want to have a future! WE long for a change in Albania so we all learn how to decide for ourselves and know what we really want from life. WE want to be happy and to live peaceful lives, in freedom with enough money. Together with the people we love.

# MANIFEST PËR ARSIMIN NË SHQIPËRI

NE jemi studentë, pedagogë, njerëz me ose pa punë, me fëmijë ose të rinj vetë. Që kërkojmë.

NE duam një arsimim të standardeve evropiane. Që do të thotë, shkolla më të mira, liri akademike, më tepër mundësi studimi, klasa gjuhe dhe mundësinë për të zgjedhur gjuhën në të cilën studiojmë. Dhe gjithashtu fokus mbi gjuhën shqipe. Që do të thotë, ambiente më të mira në universitetet tona dhe *jo korrupsion*.

NE kërkojmë që studentët të jenë më idealist dhe më aktiv, të punojnë për progresin e përbashkët në arsim si dhe të zbatojnë rregullat dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre.

NE kërkojmë që pedagogët të jenë më të përgjegjshëm kundrejt mësimdhënies së tyre dhe t'iu japin studentëve njohuri dhe aftësi për të ndjekur interesat e tyre.

Për të rritur njohuritë praktike, për të promovuar mendimin krijues dhe për të inkurajuar mendimin kritik. NE imagjinojmë grupe leximi, platforma për debat dhe shkëmbime idesh, leksione të hapura që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve, si dhe përfshirje në evenimente kulturore apo evenimente të tjera që kanë të bëjnë me shoqërinë tonë.

NE kërkojmë shkëmbime. Në një sërë nivelesh. NE dëshirojmë bashkëpunim krijues mes profesionistëve me eksperiencë dhe gjeneratës së re. NE dëshirojmë shkëmbime mes studentëve, brenda fakuleteve, midis universiteteve të ndryshme në Shqipëri, si dhe në nivel ndërkombëtar.

NE duam të studjojmë jashtë shtetit, veçanërisht për studimet Master, në një universitet të Bashkimit Evropian ose të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. NE duam të je-

-forming different groups  
calling them, "reading club"  
they have to discuss about  
different topics of different  
books  
- Një bibliotekë shumë here  
me të moshave njo kjo që  
kemi, të përmbajë një sasi  
te konsiderueshme librash për  
t'u shfrytëzuar njo studentet.

- Kam dëshirë që një ditë  
në shkëpinë time të kemi  
një bibliotekë shumë të  
madhe dhe me librat që  
unë dëshiroj.  
- Ndaj një ditë dua të shkoj  
në Barcelonë

UNE DESHIROJ GË NJË  
DITË TË BËHË NJË AKTOR  
I NJOHUR NË BOTË DHE TË  
PERFAQESOJ VENDIN TIM  
NË PROJEKTE TË MËDHA  
ARTISTIKE

Në Edukimin e të rinjve  
në Universitetin është shumë  
i rëndësishëm edukimi i artëve.  
Në veçanti ai i Musikës si  
Këllëvuar.  
Dëshiroj është që çdo individ  
të ketë mundësi të luaj në  
një instrument muzikor.

tojmë jashtë shtetit. NE duam të udhëtojmë. Që të mund të njohim botën. Që të mund të shkëmbejmë. Që të mund të mësojmë. Që kur të kthehemi eksperiencat tona të kenë një efekt mbi punën dhe jetën tonë. NE duam më tepër mundësi për sponsorizim, edhe nga ana shqiptare, për t'u bërë pjesë e botës.

NE jemi të shqetësuar për njohuritë tona. Të shqetësuar për provimet tona dhe për përfundimin e studimeve tona. NE jemi akoma edhe më të shqetësuar për punët tona. NE kemi kaq shumë ëndrra për të ardhmen tonë. Fillimisht, të gjejmë një punë, sidomos një punë të qëndrueshme, një punë të mirë apo edhe punën që ëndërrojmë. NE kërkojmë që puna të jetë e arritshme jo vetëm për ata që kanë të njohur. NE mendojmë se arsimi duhet të na përgatisë për të ardhmen dhe të na japi njohurinë dhe eksperiencën e nevojshme për të punuar si në një kontekst lokal ashtu edhe në një kontekst ndërkombëtar.

NE dëshirojmë akoma më tepër. Të bëhemi të famshëm për atë që bëjmë, të njihemi ashtu siç NE duam ta paraqesim veten. Idete tona, angazhimin tonë në vendin tonë.

NE nuk mund ta diskutojmë arsimin veç nga jetët tona. NE besojmë se arsimi dhe ëndrrat tona dhe dëshirat për të tashmen dhe të ardhmen tonë janë të nderlidhura. NE duam të kemi një të ardhme! NE dëshirojmë shumë ndryshim në Shqipëri që të mund të mësojmë të vendosim për veten dhe të dimë se çfarë kërkojmë realisht nga jeta. NE duam të jemi të lumtur dhe të jetojmë në paqe, në liri dhe me para të mjaftueshme. Së bashku me njerëzit që duam.

# PHILOSOPHY AND HUMANISTIC EDUCATION J.S. MILL'S CATASTROPHIC PEDAGOGY

Andreas Vrahimis

καὶ πάλιν δι' εἰωθότων ἐτῶν ὥσπερ νόσημα ἤκει φερόμενον αὐτοῖς ῥεῦμα  
οὐράνιον καὶ τοὺς ἀγραμμάτους τε καὶ ἀμούσους ἔλιπεν ὑμῶν, ὥστε πάλιν ἐξ  
ἀρχῆς οἶον νέοι γίγνεσθε.

– Plato, *Timaeus*, 23a–b

It is almost a commonplace nowadays to hear of the end of the humanities, and defenses of the humanities against all kinds of attack abound. A diagnosis might be in place, as an aside, before we begin: though these arguments in defense of the humanities are at the moment in vogue, the position of the attackers is not a dialogical one. Indeed, the attack does not seem to be founded on argument, but rather, in many ways, on unshakeable force – the kind of force that is not able to respond to argument (or even willing to read defenses of the humanities). In short, though there appear to be numerous ways of defending and attempting to fortify the humanities through perfectly valid and sound argument, the onslaught against the humanities does not seem bound either to listen or to respond.

To bring things into perspective, it might help if Plato's words, quoted above, are allowed to remind us here of the extent of the disaster that is the subject of our discussion. Plato's tale, one might recall, at the beginning of the *Timaeus*, is that of Solon's travels to Egypt. In Egypt, Solon is reminded by a local priest of the effect that natural disasters have on the state of human knowledge. The Egyptian priest notes that a civilization that developed next to the Nile could sow the benefits of avoiding the various kinds of natural disasters which he attributes either to excessive fire or excessive water. Thus Egyptians, favored by geography, were able to keep on collecting the surviving recollections of their ancestors' knowledge and know-how. By contrast to the Egyptians, old and wise, the Athenians are in a perpetual state of youthfulness with regard to knowledge, since they keep losing access to their past through recurring disasters. It is those

whom the priest calls unlettered and uncultured (*agrammatous te kai amousous*) that tend to survive such disasters.

The current onslaught against the university presents itself in the guise of a natural disaster: non-negotiable and irrevocable. Thankfully, however, the mode of presentation differs from what is actually the case. Like Plato's natural disasters, the onslaught appears to pave a path towards the prevalence of illiteracy and *amouisia*. There is, however, bound to be at least some remedy for such illnesses. There certainly can be a kind of youthfulness, as Plato's Egyptian priest talks of it, without the loss of "letters" or "culture"; is it not philosophy itself that had turned to this Athenian youthfulness that Plato talks of, seeing its potential for being a virtue rather than a vice?

What follows does not, indeed it could not, purport to completely heal the illnesses that follow the disaster to come. Rather, in response to the realization that the illnesses are, at least to some extent, bound to follow the disaster, this paper attempts to point to a direction that could lead toward what may turn out to be partly therapeutic, if not simply palliative care.

### Clusters

I recently attended a keynote speech by Gayatri Spivak at the Cyprus University of Technology where I was teaching at the time.<sup>1</sup> Aside from her contributions to post-colonial theory, Spivak is also trained as a singer in the Indian Classical Music tradition. Indian Classical Music famously involves what is called a drone (the buzzing background notes) over which a single melodic line is improvised through a very rigorous system of rules (for example on how to ascend or descend a scale, and so on). In her talk, Spivak discussed the relation between drone and improvisation as a kind of metaphor for political activism. Spivak extended the metaphor to talk of "sounding a keynote," and how a keynote needs to somehow resonate with all other speeches that surround it.

Inspired by Spivak's talk of keynotes and music, this article, given as a keynote for the "Pedagogies of Disaster" conference held at Tirana (June 8, 2013), was conceived along a different musical metaphor. Rather than draw on the fascinating tradition of Indian Classical Music, I chose to look to contemporary Western classical music for a metaphor that would help with navigating through the material that follows. One practice that prevails in many twentieth century compositions is the use of so-called "tone clusters."<sup>2</sup> Tone clusters are, roughly speaking, chords made up of notes that are close together. There's a particular kind of cluster that can be produced by a specific technique on the piano. It requires the piano player to strike a large number of piano keys simultaneously. This could be done by using the length of both arms, from hand to elbow, to strike the piano while holding down the sustain pedal.<sup>3</sup> A similar effect can also be achieved if one simply sits on the keys. In effect this turns the piano into a kind of box full of open strings. The open strings end up resonating whatever note is fed to them after the player strikes the cluster.

In this paper, rather than sound one particular "key note," I attempt to strike a number of different notes, and allow them to resonate. Fortunately, unlike in the realm of the physics of sound, it doesn't have to be just one note that is the keynote which resonates. It is not impossible, so to speak, to let a thousand keynotes sound.

### Anti-Psychologism and Anti-Biographism

The first note I'd like to sound has something to do with biography.

Contemporary philosophy has very little, if any, interest in biography or autobiography.

- 8 Malcolm Bull, *Anti-Nietzsche* (London: Verso, 2011), 12.
- 9 *Ibid.*, 26.
- 10 Cf. Dave Beech and John Roberts (eds.), *The Philistine Controversy* (London: Verso, 2002).
- 11 Walter Benjamin, "The Newspaper," in SW2, 742; "The Author As Producer," in SW2, 772.
- 12 Benjamin, "The Author as Producer," 774.
- 13 "Such is the aestheticizing of politics, as practiced by fascism. Communism replies by politicizing art" (Walter Benjamin, "The Work of Art in the Age of Its Technological Reproducibility," in SW3, 122).
- 14 Walter Benjamin, "Theory of Distraction," in SW3, 142.
- 15 Fredric Jameson, *Brecht and Method*, 2nd ed. (London: Verso, 2011), 34.
- 16 Louis Althusser, "Ideology and Ideological State Apparatuses," in *Ideology* (London: Verso, 2008), 25.
- 17 Cf. Bill Readings, *The University in Ruins* (Cambridge MA: Harvard University Press, 1996).
- 18 Martha Nussbaum, *Not For Profit: Why Democracy Needs the Humanities* (Princeton NJ: Princeton University Press, 2010), 2.
- 19 Bull, *Anti-Nietzsche*, 12.
- 20 "Psychology and ethics are the poles around which bourgeois education theory revolves [...] in an undialectical manner. On the one hand, there is the question of the nature of the child (psychology of childhood and adolescence), and on the other, the goal of education: the complete human being, the citizen." (Walter Benjamin, "A Communist Pedagogy," in SW2, 273).
- 21 Bull, *Anti-Nietzsche*, viii; 42.
- 22 *Ibid.*, 51.
- 23 Cf. Benjamin, "Karl Kraus," in SW2.
- 24 Jameson, *Brecht and Method*, 10.
- 25 Benjamin, "Karl Kraus," in SW2, 456.
- 26 Benjamin, "Bert Brecht," in SW2, 368.
- 27 Immanuel Kant, "An Answer to the Question: What is Enlightenment?" in *Kant: Politics Writings*, ed. H.S. Reiss (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), 55.
- 28 That this inverts our habitual way of thinking about "public" and "private" is evident from Kant's own defence of his *Religion within the Limits of Reason* in the preface

- to *The Conflict of the Faculties*, where he rejects the accusation of corrupting the young on the grounds that the book was an academic debate among scholars and unintelligible to the public (i.e. the “public” use of reason) but that as a university professor teaching classes, he refrained from engaging in any discussion of the legislated disciplines of theology and religion (i.e. the “private” use of reason), cf. Immanuel Kant, *The Conflict of the Faculties*, trans. Mary J. Gregor (Lincoln and London: University of Nebraska Press, 1992), 13–19.
- 29 Ibid., 51.
- 30 Walter Benjamin, “On Theoretical Foundations,” trans. Andrew McGettigan and Sami Khatib, *Radical Philosophy* 179 (May/June 2013): 28.
- 31 Friedrich Nietzsche, *Beyond Good and Evil*, eds. Rolf-Peter Horstmann and Judith Norman (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), 92.
- 32 “Don’t start from the good old things but the bad new ones” (Bertolt Brecht, quoted in Walter Benjamin, “Conversations with Brecht,” in *Understanding Brecht*, trans. Anna Bostock [London: Verso, 2003], 121).



# VALTER BENJAMIN DHE INHUMANITETET DREJT NJË KUNDËRNIÇANIZMI PEDAGOGJIK

Methju Çarls

Diskutimi vijues ka për qëllim të jetë një ndërhyrje kritike në debatet e kohëve të fundit mbi idenë e “krizës së humaniteteve,” duke e lexuar simptomaticitetin e krizës si një *kthesë* në kuptimin mjekësor të fjalës. Ai e bën këtë nga perspektiva e veprës së Valter Benjamin, praktika transdisiplinare e mendimit të të cilit është karakterizuar si një “filozofi kundër filozofisë” dhe një “filozofim përtej filozofisë,” dhe qëndron si model për veprimtarinë intelektuale dhe para-akademike që ngrihet këtu.<sup>1</sup> Duke zhvendosur alegorinë e famshme të Benjaminit të Ëngjellit të Historisë nga konteksti i “krizës së kulturës” të shekullit të njëzetë dhe duke e rivendosur atë tek “kriza e arsimit” e ditëve të sotme, ai përpiqet të rindërtojë një kuptim dialektik të pedagogjizimit brenda veprës së Benjaminit, që përdoret për të skicuar konturet e një pedagogjie të riimagjinuar në mënyrë kritike të inhumaniteteve.

## Ëngjëlli i Historisë i Benjaminit si kundërniçanizëm

Do të qe më mirë të mos e përmendnim pikturën *Angelus Novus* nga Pol Kleja [*Paul Klee*] të Benjaminit me të cilën ai identifikoi figurën e tij të Ëngjellit të Historisë, pikërisht sepse familjariteti me të sot nënkupton humbjen e aftësisë së saj për të shokuar. Siç shkruan Suzan Bak-Mors, piktura është bërë “tepër e famshme, fjalët të aplikuara kaq trashë sa nuk mund ta shohim imazhin e Klesë pa cipën e komenteve të Benjaminit mbi të.”<sup>2</sup> Por, në kontekstin e kësaj konference mbi “Pedagogjitë e Shkatërrimit,” është e pamundur të mos kujtohemi për zbulesën turbulluese nga Ëngjëlli të udhës së historisë si një katastrofë e madhe, një pirg kufomash dhe pluhuri që sa vjen e zmadhohet.<sup>3</sup> Për shkak të një katastrofe në veçanti – rrethanat e hidhuara të vetëvrasjes së Benjaminit në 1940-n dhe lidhjet e saj me ngjarjet politike më të gjera që ngrihen në tezat e tij “Mbi konceptin e historisë” – *Angelus Novus* i Klesë, paralajmëron Bak-Mors, është “mbërthyer” prej atyre përcaktimeve historike specifike në mënyrë të tillë që një konceptim filozofik i historisë është ngurtësuar në ontologji. Sot, ne kujtohemi vetëm për krahët e pafuqishëm të Ëngjellit dhe jo për dhëmbët e tij të egër.



Për ta çontologjizuar këtë kuptim të historisë, dhe ndoshta për t'i ridhënë kapacitetin për të ndërhyrë tek nënshtrimi i mendimit bashkëkohor akademik, është e nevojshme ta rihistorizojmë atë, ta sjellim më pranë momentit tonë të tanishëm. Duke marrë parasysh temën e kësaj konference, propozoj ta bëjë këtë jo nëpërmjet një analize të katastrofës politike bashkëkohore por nëpërmjet një rishikimi të terrenit ideologjik mbi të cilin Benjamin negocion reagimin e tij; duke kaluar nga konteksti i krizës së kulturës të fillimit të shekullit njëzetë tek kriza e arsimit në fillim të shekullit njëzet e një.

Pika e parë historiko-filozofike që dua të nxjerr nga tezat “Mbi Konceptin e historisë” është se politizimi i historisë nga Benjamin duhet kuptuar si një përmbysje preçize e një teorie niçane të kulturës. Për t'i dhënë pak kontekst politik këtij pretendimi, duhet vënë re se zhvillimi i mendimit të Fridrih Niçes [*Friedrich Nietzsche*] në vitet 1870, i orientuar rreth krizës moderne të kulturës të kumtuar nga figura e “filistinit kulturor,” është një reagim ndaj fitores pirrike të imperializmit borgjez gjerman me themelimin e Perandorisë prusiane në 1871-shin por edhe ndaj hijes të Komunës së Parisit që u drodh shkurtimisht po atë vit: Niçe mbështetet tek elitizmi kulturor i lashtësisë klasike si një alternativë ndaj “pseudo-kulturave” të socializmit gjerman dhe atij francez.

Duke krentuar rënien e Komunës në një letër të datuar 21 qershor 1871, për shembull, Niçe deklaroi se është me humor të mirë pasi jo gjithçka kishte kapitulluar ndaj asaj që ai quan “nivelimi franko-çifut” dhe “instiktet lakmatarë të *Jetztzeit*-it (tani-koha).”<sup>4</sup> Në mënyrë të ngjashme, tek “Shteti grek” (shkruar në 1871/2), ai thotë:

Kësisoj, ne duhet të mësojmë të identifikojmë si një të vërtetë të hidhur faktin se skllavëria i përket thelbit të një kulture: një e vërtetë që, duhet pranuar, nuk lë asnjë dyshim mbi vlerën absolute të ekzistencës... Dëshpërimi i njerëzve që jetojnë një jetë stërmundimi duhet të rritet për ta bërë prodhimin e botës së artit të mundur për një numër të vogël burrash olimpianë. [...] Çdo moment gllabëron të mëparshmin, çdo lindje është vdekja e qenieve të panumërta, bijimi, jeta dhe vrasja janë të tëra një. Kësisoj ne mund ta krahasojmë kulturën e madhërishe me fitimtarin që pikon gjak, i cili, në procesionin e tij triumfal, tërheq zvarrë, të lidhur pas karrocës së tij si skllavër, të mundurit...<sup>5</sup>

Benjamin nuk e kundërshtoi apo kritikoi këtë konceptim të kulturës në tezat “Mbi Konceptin e historisë,” ku shfaqet Ëngjëlli i Historisë, por nxjerr përfundimin e kundërt politik nga pohimi i tij nga ç’bën Niçe:

Kushdo që ka dalë fitimtar merr pjesë deri sot e kësaj dite në procesionin triumfal në të cilin sunduesit e sotëm shkelin mbi ata që shtrihen përdhe. Sipas praktikës tradicionale, plaçkat e luftës mbarten gjatë procesionit. Ato quhen thesarë të kulturës, dhe një materialist historik [...] nuk mund t’i mendojë pa llahtar. Ato ia detyrojnë ekzistencën e tyre jo vetëm punës së mendjeve të mëdha dhe talenteve që i kanë krijuar, por edhe stërmundimit anonim të bashkëkohësve të tyre. Nuk ka asnjë dokument të qytetërimit që nuk është njëherazi një dokument barbarizmi.<sup>6</sup>

Niçanizmi i përmbysur i Benjaminit ruan një dyshim kritik ndaj kulturës borgjeze dhe një mohim nihilist të vlerave të saj por – për të ndjellë *Meditime të parakohshme* që pati

mjaft influencë mbi Benjaminin e ri – orientohet drejt një kujtimi transhistorik të të shtypurve në vend të harrimit johistorik të Niçes të originave të turpshme të prodhimit kulturor. Vizioni katastrofik i historisë i Benjaminit, një pakt faustian me një Ëngjëll të rënë, bazohet mbi konceptimin e kohës jo si pafundësisht vijuese por si ai *Jetztzeit* revolucionar ose ndërprerje e përjetësisë që Niçe e lidhte me “nivelimin franko-çifut” të pjesëtarëve të Komunës.<sup>7</sup>

### Filistinizmi, ose limitet e nihilizmit

*Kundër-Niça* e Malkom Bullit [*Malcolm Bull*] jo vetëm që angazhohet në një përmbysje të krahasueshme të politikës kulturore niçane por e plotëson këtë me një kritikë imanente të limiteve historike të nihilizmit të vetë Niçes që do të jetë me vlerë – kur lexohet nëpërmjet Benjaminit – për kuptimin e situatës tonë të sotme. Bull argumenton se reflektimet e Niçes mbi filistinizmin kulturor dhe propozimi i tij në lidhje me justifikimin *estetik* të botës nuk përfaqësojnë përmbushjen e nihilizmit por një përpjekje për ta ndaluar ose pezulluar atë, pasi kremtimi i tij i zhvlerësimit të të gjitha vlerave fetare dhe morale nuk shtrihet deri tek sfera e vlerave kulturore dhe estetike. Duke përvijuar mohimin historik të vlerave nëpërmjet paradës fantazmagorike të hijeve që kanë ndjekur Evropën – ateizmi, anarkizmi, nihilizmi, filistinizmi – Bull arrin në përfundimin se “estetikja është thjesht mbetja e lënë pas nga historia e mëparshme e mohimit, dhe filistinizmi negativja që i përkon por që është ende e perealizuar...”<sup>8</sup> Një pjesë e mirë e filozofisë moderne evropiane dhe e teorisë marksiste trashëgojnë këtë pohimi niçan, sugjeron Bull, duke e konceptuar artin jo thjesht si një subjekt i kësaj dialektike por si pozicionin nëpërmjet të cilit dialektika punon.

Megjithatë, pasojat e transvlerësimit nihilist kërkojnë jo vetëm përqaftimin dialektik të filistinizmit, por edhe dijeninë se vetë filistinizmi është vetëm mohimi më i fundit [*most recent*] por jo ai i fundit [*final*] i vlerave. Megjithatë, kur Bull pyet, “ku janë detet e rinj të filistinizmit?” ai e lë këtë dallgë në ardhje të pasestetikes të pazbuluar.<sup>9</sup> Një kthim te puna e Benjaminit është me vlerë këtu, dua të argumentoj, jo vetëm sepse kundër-niçanizmi i saj është i rrallë në shtrirjen deri tek pikat e verbëra të filistinizmit (në kundërshtim me shumë prej teorisë bashkëkohore të majtë, me përjashtim të *Debatit filistin*)<sup>10</sup> por sepse ajo paraprin gjithashtu një lëvizje *përtej* këtij pozicioni në lidhje me pasestetiken. Ajo që më intereson në veçanti tek mendimi i Benjamin-it është se si, sidomos pas kthimit të tij në 1927-n nga një vizite në “tryezën e madhe të laboratorit” që është Moska nën Stalinin, ai angazhohet me projektin politik të filistinizmit në sprova si “Karl Kraus” (1931), “Autori si prodhues [*Der Autor als Produzent*]” (1934), dhe “Vepra e artit në epokën e riprodhueshmërisë së saj teknike [*Das Kunstwerk im Zeitalter seiner technischen Reproduzierbarkeit*]” (1935–39). Ndërsa Niçe, tek leksionet e tij “Mbi të ardhmen e institucioneve tona arsimore [*Über die Zukunft unserer Bildungsanstalten*]” dhe tek *Meditimet e parakohshme*, e identifikoi poshtërimin e kulturës së vërtetë me gazetarinë – që karakterizohet nga politikësia [*politicality*] e saj jetëshkurtër, nivelimin e dallimeve aristokrate dhe korruptimin barbar të stilit artistik – në këto sprova Benjamin sugjeron se kësi elementësh fshehin një moment dialektik politik për masat: “... është në skenën e një poshtërimi të pafund të fjalës – shkurtimisht, gazeta – ku shpëtimi po përgatitet.”<sup>11</sup>

Ishte Bertolt Brecht [*Brecht*], vë në dukje Benjamin, që “qe i pari që iu bëri intelektualëve kërkesën me pasoja të mëdha për të mos furnizuar aparatën e prodhimit pa e ndryshuar atë, sa më shumë të ishte e mundur, në përputhje me socializmin.”<sup>12</sup> Duke e bërë këtë Benjamin thekson nevojën për risi teknike që kanë për qëllim të transformojnë aparatën e prodhimit kulturor borgjez, në interes të turmave, nëpërmjet një procesi që Brecht e quajti *Umfunktionierung* (rifunksionim). Në kontekstin e një kulture letrare, pasojat e kësaj ideje brehtiane detyrojnë një mohim të poshtëritimit niçan të gazetarisë si “pseudo-kulturë” në çdo hap, duke pohuar dobënë dialektike të gazetarisë pikërisht për shkak të kohësisë [*temporality*] së saj jetëshkurtër, socialitetit të saj të lirshëm, dhe tipareve të saj kundërindividualiste dhe prodhuese kolektive.

Ky pozicion, sidomos kur krahasohet me shkrimet e Adornos dhe Horkhajmerit (të cilët mbeten, veçanërisht në vërejtjet e tyre tek “Industria Kulturore,” më afër Niçes), shpesh keqinterpretohet si një pozicion pashpresëshmërisht optimist ose utopik. Por kjo do të thotë të mos shohësh deri në çfarë mase ndërhyrja e Benjaminit, e mbipërcaktuar [*overdetermined*] nga pohimi i kushteve të saj katastrofike, shpalolet nga një pozicion i pashpresë ekstremizmi pesimist ose nihilist, ku pritja e matur mund të duket vetëm si një lluks historik. Nëse një pozicion i tillë është provohet që është i gabuar historikisht, ama, kjo vetëm provon saktësinë e tij diagnostike. Për Benjaminin, momenti historik i krizës ideologjike të kulturës në fund të shekullit të 19-të dhe nga mesi i shekullit të 20-të qe përgatitur nga forcat teknologjike të “masifikimit [*massification*]” dhe kushtet ekonomike të “mallëzimit [*commodification*]”: e para predikohej mbi heqjen qafe të rastësisë [*contingency*] historike të konceptit borgjez të “kulturës” dhe të “veprës së artit” në interesin politik të masave; e dyta varej pikërisht nga mbijetesa e tyre (meqenëse vlera e artit nën kapitalizëm qëndron tek ngjashmëria e antitezës së tij me vlerën e këmbimit [*exchange-value*]; një ngjashmëri që, ironikisht, gjithmonë e më tepër çileson vlerën e tij të këmbimit në tregun bashkëkohor të artit). Pas këtij rasti të humbur historik (simptoma e të cilit është jetëgjatësia e konceptit borgjez të artit dhe kulturës si një kusht për industrinë bashkëkohore të kulturës), arti në shoqëritë bashkëkohore kapitaliste – me gjithë vlerën e tyre të përbrendshme artistike dhe formën ose brendësinë e tyre specifike politike – nuk mund t’i shërbejnë më ndonjë funksioni efektiv politik; radikaliteti kompromentohet si tregueshmëri. Kjo është arsyeja pse, dua të sugjeroj, kriza jonë nuk është më ajo që përvijohet nga arti dhe kultura, çka na detyron të rishikojmë kushtet historike dhe politike të nihilizmit sot.

### Filistinizmi (i vjetër) i ri

Megjithatë, duke e parë veprën e Benjaminit nën dritën e momentit të tashëm historik, kërkesa e tij më e gjerë për rifunksionimin e artit keqkuptohet në mënyrë të drejtpërdrejtë si “politizim [*politicization*].” Ajo që nuk është theksuar në diskutimin e Benjaminit të krizës së shkaktuar nga kushtet teknologjike të kulturës në masë [*mass culture*] është se deri ku ky transformim i artit dhe kulturës nënkupton jo dhe aq politizimin e artit se sa pedagogjizimin e tij.<sup>13</sup> Kur tregohet më specifik, Benjamin e lexon transformimin of vlerës së përdorimit [*use-value*] të artit nën mbizotërimin e vlerës së këmbimit si ndarje më dysh në “vlerë zbatimjeje/tërheqjeje vëmendjeje [*Zerstreung*]” (ose në atë që tjetërkund ai quan “vlerë konsumatori [*Konsumwert*]”) dhe “vlerë arsimore [*Lehrtwert*]”; në veprën e Brehtit, pretendon ai, këto të dyja bashkohen, “duke bërë të

mundur një lloj të ri të të mësuarit.”<sup>14</sup> Mund të përmendim këtu rigjetjen e mëvonëshme të metodës brehtiane nga Fredrik Xhejmsoni [*Fredric Jameson*] si një modernizëm që shpaloset nga sfera e artit tek ajo e pedagogjisë (duke plotësuar detyrën e Marksit për “arsimin e edukatorëve” me mësimë maoiste në lidhje me paevitueshmërinë e ndryshimit).<sup>15</sup> Duke lexuar filistinizmin kundërniçan të Bullit nëpërmjet politikës (brehtiane) kulturore të Benjaminsit në mënyrë skematike tregon se si kjo e dyta paraprin një tjetër zhvendosje historike në vlerë, nga terreni i kulturës në përgjithësi tek fusha më specifike e arsimit.

Lui Altysyer njihet ndoshta më tepër pikërisht për detajimin e një zhvendosje të tillë ideologjike. Në periudhën parakapitaliste, argumenton Altysyer, funksionet tashme të dallueshme të Kulturës dhe Arsimit, ishin bërë grusht që të dyja, bashkë me të tjera, brenda pushtetit mbizotërues ideologjik të Fesë.<sup>16</sup> Por nëse, siç sugjeron Altysyer, Arsimi është bërë tashme Aparatusi Ideologjik Shtetëror mbizotërues nën kapitalizëm, është e rëndësishme të njohim se deri vonë qëllimi kryesor i Arsimit ka qenë kalimi dhe riprodhimi i vetë kapitalit Kulturor (domethënë, Kultura ishte aparati ideologjik themelor i komb-shtetit kapitalist). Nëse Bill Redings është i saktë në pretendimin se institucionalizimi i vetë Studimeve Kulturore ishte simptomatik i zhdukjes së vetë Kulturës në funksionin e saj ideologjik (në një ekonomi dije gjithnjë e më tepër transnacionale dhe multikulturore), mendoj se ajo që jemi duke kaluar sot nuk është kalimi tek një nocion pasideologjik i Arsimit, siç argumentoi Redings tek *Universiteti në Rrënoja*,<sup>17</sup> por lindja e funksionimit të përmbajtur të vetë Arsimit nga sfera më e lartë e Kulturës (e cila prehej më parë në sferën e Fesë), duke prodhuar një “krizë të arsimit” përkuese dhe të drejtpërdrejtë nën kushtet e trashëguara të “masifikimit” dhe “mallëzimit” të saj në rritje.

Si do të mund të bluanim ne mend një kundërniçanizëm të tillë bashkëkohor brenda konjunkturës tonë historike të tanishme, që Marta Nusbaum e ka quajtur një “krizë botërore në arsim” dhe në veçanti një “krizë të humaniteteve”?<sup>18</sup> Ajo që kërkohet sot është një teori kritike e arsimit në masë që heton rastësitë historike të konceptit tonë borgjez të pedagogjisë dhe bën një kërkesë të ngjashme për rifunksionimin e aparatit tonë arsimor nën kushte të tilla kritike. Kjo kërkesë nuk është një zbrapsje reaksionare konceptuale tek një pedagogji thujse-aristokrate, thujse-elitiste, dhe individualiste e vlerave të përjetshme të “kulturës,” “kultivimit,” dhe “karakterit” (thirrja *johistorike* e Niçes për një arsim për Kulturën, që vazhdon të rikumbojë brenda shumë prej mendimit pasniçan në variacionet e tij të majta e të djathta), por përkundrazi një rimendim i aparatusit arsimor nëpërmjet kushteve të tij të “masifikimit” mbi dhe kundër atyre të “mallëzimit.”

Mund të kujtojmë këtu se si fjala gjermane philister nënkuptonte fillimisht jo mohimin e vlerës së artit dhe kulturës – kuptimin që ajo mori më pas nën mbizotërimin e estetikës në arsimin kulturor të shekullit të nëntëmbëdhjetë – por një term më të përgjithshëm përçmues për të dalluar njerëzit e zakonshëm të qytetit nga studentët e arsimuar të universitetit.<sup>19</sup> Polemikasht, një konceptim dialektik i një filistinizmi të ri do të orientohej drejt një refuzimi të elitizmit arsimor (në të gjithë mishërimet e tij pasniçane si “arsim minoritar”), një pohimi të rolit bashkëpunues që luan arsimi në riprodhimin e pabarazive sociale (duke përfshirë përpjekjen për të zgjatur një aparat borgjez jo të refunksionuar në sfera të reja sociale), një tretje në rritje të dallimit mbi

të cilin mbështetet në dallimin e vlerave (përmes një pohimi të “arsimit në masë”), dhe përfaqimit të vlerave, të perceptuara negativisht, të vetë “masifikimit” ndërsa ai transformon formën dhe brendësinë e veprimtarisë akademike. Për të skicuar një prej pasojave të gjera të një perspektive të tillë, mund të fillonim duke vërejtur se konceptet borgjeze dhe humaniste të arsimit janë kryesisht kohore, për sa kohë që ato përquëndohen tek synimi teleologjik i kultivimit.<sup>20</sup> Përkuesi pedagogjik i kuptimit *ndërprerës të Jetzzeit-it* kohor të Benjaminit është, do të sugjeroja, një koncept i hapësinuar [*spatialized*] i zgjerimit arsimor.

### Inhumanitetet

Tek *Kundër-Niçja*, Malkom Bull sugjeron se gjatë gjithë vazhdimësisë [*sequence*] historike të mohimit të vlerave (ateizmi, anarkizmi, nihilizmi, filistinizmi), negativja e munguar përkufizohet vazhdimish si një përmbysje *nënjerëzore* e vlerës pozitive humaniste brenda sistemit ekzistues. Ndërtimi i një pozicioni kundërniçan nga Bulli, i drejtuar kundër rikuperimit të Kulturës dhe epërsisë hierarkike të mbinjerëzit të Niçes, argumenton se “nuk mund të ketë një përgjigje humaniste ndaj Niçes” dhe se ne duhet të heqim dorë “nga ideja se të bërit më shumë se njeri dhe të mendojmë vetëm për t’u bërë diçka më pak.”<sup>21</sup> Strategjia e mëpasshme, pedagogjike, e Bullit për të “lexuar si një humbës” (domethënë, identifikimi – kundër rrymës – me subjektin retorikisht të mjerë të një tregimi [*narrative*] të caktuar) tret kësisoj kufijtë rreth një komunitetit lexuesish, duke i përmbytur ata me nihilizmin kundërsocial të “masës së njerëzve të mjerë e të papushtetshëm që nuk kanë asnjë ndjenjë komuniteti.”<sup>22</sup>

Një nënhumanizëm i tillë paraprihet teorikisht tek figura e “karakterit shkatërrues” që sfaqet në sprovat e Benjaminit të kësaj periudhe dhe që identifikohet si një paraardhës i Ëngjëllit të Historisë. Në sprovën e tij mbi mizantropinë e satiristit bashkëkohor Karl Kraus, për shembull, Benjamin dallon në shkrimet e satiristit dënimin e një njerëzimi të skamur, që duket për Krausin më qartë në gërryerjen e dallimit midis jetës “private” dhe “publike” në gazetari.<sup>23</sup> Benjamin, duke ndërhyrë në brendësi të polemikës së Krausit për të shpëtuar dialektikisht figurën e emancipimit kolektiv, e identifikon reagimin thujasë-niçan të Krausit kundër idealit klasik të njerëzimit (zmbropsjen e tij nga bamirësia [*philanthropy*] tek mizantropia e inskenuar si tërheqja në brendësi të jetës së fiskur private) me një rrëfim [*confession*], në thelb të pavetëdijshëm, të “humanizmit materialist” të Marksit të herët. Ngjashmërisht, do të mund të identifikonim asocialitetin që duket se është një lejtmotiv i veprës së Brehtit – krejt e qartë, për shembull, tek *Manual për banorë qyteti* [*Handbuch für Stadtbewohner*] dhe *Tregime nga Z. Këner* [*Geschichte vom Herren Keuner*] – si “karakterin” e tij “tamam utopik”: një thirrje përtej individualizmit të humanizmit borgjez për një plotësim utopik të individit brenda kolektivit.<sup>24</sup>

Drejt fundit të sprovës së tij mbi Karl Krausin, Benjamin këmbëngul se,

Puna si një detyrë e mbikqyrur – modeli i të cilës është puna politike dhe teknike – shoqërohet me pisllek dhe pluhur, ndërhyr shkatërrimisht tek materia, është gërryese për atë që është arritur ndërkaq dhe kritike ndaj kushteve të saj, dhe në tërë këtë është e kundërta e punës së diletantit që bulbëron në krijimtari [...] Dhe kësisoj çnjeriu [*Unmensch*] qëndron mes nesh si lajmëtari i një humanizmi më

real [...] [Dikush duhet ta ketë] parë *Ëngjëllin e ri* të Klee-së (që parapëlqente t'i çlironte njerëzit duke marrë prej tyre, në vend që t'i kenaqte duke iu dhënë) për të kuptuar një njerëzim që e provon veten nëpërmjet shkatërrimit të tij.<sup>25</sup>

Këtu, figurës së *mbinjerëzit* të Niçes i kundërvihet posthumanizmi i mjerë dhe i kolektivizuar teknologjikisht i *çnjeriut*: e “përbindshmja” ose “çnjerëzorja,” si një pragmatizëm niçan i përmbysur. Për Benjaminin, Breht ishte një trupëzim i tillë i “karakterit shkatërrues”; duke marrë shkas nga pohimi i tij i “një lloj të ri mësimi” të përmbledhur në rifunksionimin pedagogjik të metodës brehtiane, dua ta mbyll duke propozuar se një koncept i pedagogjisë që informohet teorikisht nga ky niçanizëm i përmbysur duhet të bazohet jo në një ide të kohëzuar [*temporalized*] të Humaniteteve por në një imazh të hapësnuar [*spatialized*] të Inhumaniteteve.

### Universiteti anarkik

Ky pretendim mund të shtjellohet, negativisht, kundër vlerës ekzistuese pozitive të arsimit humanist. “Figura e Kënerit,” e Brehtit, “e përqëndron vëmendjen e tij për të treguar se tepria e problemeve dhe teorive, tezave dhe botëkuptimeve, është një trillim dhe fakti se ato anullojnë njëra tjetrën nuk është as aksidental as i bazuar tek vetë mendimi; përkundrazi, ai mbështetet në interesat e njerëzve që i kanë vënë mendimtarët në postet e tyre.”<sup>26</sup> Ajo që sugjerohet këtu është se shumësia e “këndvështrimeve” të rregulluara në kundërshti të cekët me njëra-tjetrën (e mjata kundër të djathtës, pro kundër anti ...), dhe inkurajimi i “opinioneve private,” është funksioni i shpallur i ideologjisë bashkëkohore kapitaliste, që këmbëngul se të gjithë kanë opinionin e tyre por se kësioj asnjë opinion nuk ka më tepër “rëndësi” ose të “vërtetë” se asnjë tjetër. Në dallim nga Altyseri, Breht e propozon këtë si një tezë negative të ideologjisë: se asnjënjëzimi i mendimit *nëpërmjet teprisë së vetë mendimeve* siguron rezultatin e synuar ideologjik të bërjes – paraprakisht – të të gjithë mendimit të *parëndësishëm*. Do të doja ta shtroja përshkrimin e Brehtit si funksionimin bashkëkohor të ideologjisë sot ndërsa ajo i drejtohet sferës arsimore.

Në përgjithësi, ajo përkon me pedagogjizimin jokritik të kushteve sociale bashkëkohore (media, arti, teknologjia, biznesi, dhe vetë arsimit) që një koncept më radikal i Inhumaniteteve kërkon të konkurojë. Paradigma e një ideologjie të tillë paraprihet në *universitetin legjislativ* të idealizuar prej Kantit tek “Përgjigja e pyetjes: Çfarë është Iluminizmi? [*Beantwortung der Frage: Was ist Aufklärung?*]” dhe *Konflikti i fakulteteve* [*Der Streit der Fakultäten*]. Në një artikullim të ndërlikuar të dallimit midis dhe legjitimitetit të përdorimeve “private” dhe “publike” të arsyes, Kanti e konception funksionin kritik të Humaniteteve (kryesisht filozofisë) nën flamurin e parullës së Frederikut II: “Vetëm një sundimtar në botë thotë, ‘Debatoni sa të doni dhe mbi çfarë të doni, por binduni.’”<sup>27</sup> Kjo moto nënkupton një model *laissez-faire* të përdorimit “publik” të arsyes (që do të thotë autonominë e “komunitetit të mësuar” për të debatuar mes tyre, të lirë nga komandat e qeverisë dhe ndikimi i publikut) dhe një koncept autoritar i përdorimit “privat” të arsyes (që do të thotë legjislacionin e qeverisë mbi mësimin e teologjisë, ligjeve, dhe mjekësisë, nëpunësit publikë të së cilës nuk duhet të mendojnë me mendjen e tyre por të ekzekutojnë mësimit e pranuar nga shoqëria që caktohen nga shkollarët).<sup>28</sup>

Kuptimi i rolit të fakultetit më të ulët të Humaniteteve, përfshi filozofinë, zbulon kompleksitetin e kuptimit të Kantit të Iluminizmit, pasi qëllimi i tij parësor është të bëjë zhurmë që qeveria të *ligjërojë* mbi fakultetet më të larta (profesionale) për të parandaluar që ato të çënojnë terrenin e filozofisë kritike dhe kësaj të ndikojnë mbi njerëzit me premtime të pavërteta lumturie. Mbrojtja e Kantit e Humaniteteve përkrah një autonomi *kritikisht legjislativë*, që i ndriçon njerëzit në mënyrë jo të drejtpërdrejtë duke i *mbrojtur* ata nga ndikimi i mësimave [*teachings*] entuziaste të fakulteteve profesionale. Qeveria akuzohet madje se po “autorizon *anarkinë* vetë” kur i lejon fakultetet profesionale të “filozofojnë” dhe kësaj qeverinë vetë të prihet nga animet e njerëzve (*filistinët* në kuptimin origjinal të fjalës) ndërsa ata gënjehen nga sofizmi tundues i ‘biznesmenëve të fakulteteve – klerikët, nëpunësit ligjorë, dhe mjekët – që e kuptojnë një punë të katranosur [*savoir faire*] dhe kanë mirëbesimin e njerëzve.<sup>29</sup>

Kundër tezës negative të ideologjisë të përvijuar më lart, Brehth dhe Benjamin zhvillojnë një version të kritikës së ideologjisë si një “mendim ndërhyrës” që kërkon të përçajë funksionimin e ideologjisë kryesisht duke *prodhuar pasoja*. Kundër privatizimit të liberalizuar të opinionëve, e vërteta konceptohet tani në mënyrë pragmatike – në terma që sjellin ndërmend dijen praktike [*savoir faire*] e shumë-kritikuar të Kantit – si ajo që është e pasur në pasoja shoqërore kolektive.<sup>30</sup> Në një thirrje shoqëruese për “varfërimin e mendimit,” Benjamin deklaron se, “Çdo mendim, me përjashtim të atij që është i realizueshëm në shoqëri, duhet të thyhet.” Ajo që është vendimtare këtu nuk është thjesht një refuzim i “mendimit privat” por i vetë dallimit midis “privates” dhe “publikes” në sferën e mendimit si dhe të veprimit.

Në kundërshtim me *universitetin legjislativ* të Kantit, pragmatizmi i përmbysur niçan i një mendimi të tillë ndërhyrës prodhon atë që Kant mund ta konceptojë vetëm si anarkizëm: transdisiplinaretin spekulativ të filozofimit (përtej fakultetit të Filozofisë), mjegullimin e dallimit midis përdorimeve “publike” dhe “private” të arsyes me shpërberjen e autonomisë akademike, dhe ndërhyrjen e një dije praktike populiste, empirike dhe heteronome në arsyetimin praktik. Ndoshta motoja e këtij universiteti anarkik do të ishte një zhbërje populiste e humanizmit iluminist të Kantit: “*Bini dakord*, por mos u bindni sa të doni.” Në kundërshtim me vizionin e Kantit të Humaniteteve filozofike në *zemër të universitetit legjislativ* (që qorton akademikisht fakultetet profesionale, që janë ato që instruktojnë publikun), universiteti anarkik i gjen *Inhumanitetet* në periferitë e tij që sa vjen e shtrihen, si ajo që tret vetërrethimin e akademisë dhe si objekti që duhet tretur në ndeshjen e tij me *filistinët*.

Niçe e identifikoi procesin e bërjes nën- apo çnjerëzor me projektet revolucionare egalitare të socializmit: “*Degjenerimi i plotë i njerëzimit* deri tek ai që budallenjtë dhe kokëboshët e sotëm socialistë e shohin si ‘njeriun e të ardhmes’ – si idealin e tyre! – ky degjenerim dhe zvogëlim i njerëzimit në kafshën e përkryer të kopesë (ose, siç thuhet, në njeriun në një ‘shoqëri të lirë’) ...”<sup>31</sup> Dokumenti revolucionar socialist i 1796-s, “Komploti i të Barabartëve,” shpalli: “Lëri të gjitha artet të vdesin, nëse nevojitet, për sa kohë që mbetet barazia e vërtetë!” Për ta mbyllur, polemikisht, po sikur – në kontekstin e krizës tonë të humaniteteve në arsim – ne përballemi me një zgjedhje niçane ose brehtiane: të përqfjohmë ose arsimin “e mirë e të vjetër” për Kulturën ose atë “të keq e të ri”<sup>32</sup> të një sistemi arsimor gjithnjë e më tepër të masifikuar, mallëzuar, dhe varfëruar kriza e të cilit mund të fshehë megjithatë një moment dialektik? Ndoshta

është e parakohshme ta formulojmë eksperimentin që na pret në terma kaq brehtianë, por nëse koncepti i arsimit nuk mund t'i aplikohet më gjësë që shndërrohet në një mall, ndoshta do të na duhet ta eliminojmë këtë koncept me kujdes por pa frikë, nëse nuk duam të likuidojmë gjithashtu funksionin e vetë gjësë. Po sikur të deklaronim: “Le të vdesë arsimi, nëse nevojitet,” – duke e matur këtë vdekje kundër konceptit të vjeter, elitist të arsimit – “për sa kohë që mbetet barazia e vërtetë”?



**Shënime**

- 1 Theodor W. Adorno, "A Portrait of Walter Benjamin," në *Prisms*, përkth. Samuel Weber (Cambridge MA: MIT Press, 1983), 235; Howard Caygill, *Walter Benjamin: The Colour of Experience* (Londër dhe Nju-Jork: Routledge, 1998), 119.
- 2 Susan Buck-Morss, "The Gift of the Past," në *The Democratic Imaginary in the Era of Globalization* (Barcelona: Academy of Latinity, 2011), 286–7.
- 3 Khs. Walter Benjamin, "On the Concept of History," në Walter Benjamin, *Selected Writings* [henceforth, SW], Vëll. 4, red. Howard Eiland dhe Michael W. Jennings (Cambridge MA: Harvard University Press, 1999).
- 4 Friedrich Nietzsche për Baron von Gersdorff, 21.6.1871. *Works*, red. Schlechta, III, 1092ff, cited in Georg Lukács, *The Destruction of Reason* (Atlantic Highlands NJ: Humanities Press, 1981), 235.
- 5 Friedrich Nietzsche, "The Greek State," në *On The Genealogy of Morality*, red. Keith Ansell-Pearson (Cambridge: University of Cambridge Press, 2007), 166.
- 6 Benjamin, "On the Concept of History," 391–2.
- 7 Për një diskutim të filozofisë së historisë së Benjaminit, sh. Peter Osborne dhe Matthew Charles, "Walter Benjamin," *The Stanford Encyclopedia of Philosophy*, red. Edward N. Zalta (Botimi i dimrit 2012 Edition), §8.
- 8 Malcolm Bull, *Anti-Nietzsche* (Londër: Verso, 2011), 12.
- 9 Po aty, 26.
- 10 Khs. Dave Beech dhe John Roberts (red.), *The Philistine Controversy* (Londër: Verso, 2002).
- 11 Walter Benjamin, "The Newspaper," në SW2, 742; "The Author As Producer," në SW2, 772.
- 12 Benjamin, "The Author as Producer," 774.
- 13 "I tillë është estetizimi i politikës, siç praktikohet nga fashizmi. Komunizmi përgjigjet duke politizuar artin." (Walter Benjamin, "The Work of Art in the Age of Its Technological Reproducibility," në SW3, 122).
- 14 Walter Benjamin, "Theory of Distraction," në SW3, 142.
- 15 Fredric Jameson, *Brecht and Method*, bot. i 2-të (Londër: Verso, 2011), 34.
- 16 Louis Althusser, "Ideology and Ideological State Apparatuses," në *Ideology* (Londër: Verso, 2008), 25.
- 17 Khs. Bill Readings, *The University in Ruins* (Cambridge MA: Harvard University Press, 1996).
- 18 Martha Nussbaum, *Not For Profit: Why Democracy Needs the Humanities* (Princeton NJ: Princeton University Press, 2010), 2.
- 19 Bull, *Anti-Nietzsche*, 12.
- 20 "Psikologjia dhe etika janë polet përqark të cilave vërtitet teoria borgjeze e arsimit [...] në një mënyrë jodialektike. Nga njëra anë, është çështja e natyrës së fëmijës (psikologjia e fëmijërisë dhe adoleshencës), dhe nga ana tjetër, synimi i arsimit: njeriu i plotë, qytetari." (Walter Benjamin, "A Communist Pedagogy," në SW2, 273).
- 21 Bull, *Anti-Nietzsche*, viii; 42.
- 22 Po aty, 51.
- 23 Khs. Benjamin, "Karl Kraus," në SW2.
- 24 Jameson, *Brecht and Method*, 10.
- 25 Benjamin, "Karl Kraus," në SW2, 456.
- 26 Benjamin, "Bert Brecht," në SW2, 368.
- 27 Immanuel Kant, "An Answer to the Question: What is Enlightenment?" in *Kant: Politics Writings*, red. H.S. Reiss (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), 55.
- 28 Që kjo kthen përmbyës mënyrën tonë të zakonshme të mendimit të "publikes" dhe "privates" është e qartë nga mbrojtja që i bën Kanti librit të tij *Religion within the Limits of Reason* tek parathënia e *The*

*Conflict of the Faculties*, ku ai mohon akuzën se po korrupton rininë me argumentin se libri ishte një debat akademik mes shkollarësh dhe i pakuptueshëm për publikun (d.m.th. përdorimin “publik” të arsyes) por se si një profesor universiteti që jep klasa, ai nuk u përfshi në ndonjë diskutim të disiplinave të ligjëruara të teologjisë dhe fesë (d.m.th. të përdorimit “privat” të arsyes), khs. Immanuel Kant, *The Conflict of the Faculties*, përkth. Mary J. Gregor (Lincoln and Londër: University of Nebraska Press, 1992), 13–19.

- 29 Po aty, 51.
- 30 Walter Benjamin, “On Theoretical Foundations,” përkth. Andrew McGettigan dhe Sami Khatib, *Radical Philosophy* 179 (maj/qershor 2013): 28.
- 31 Friedrich Nietzsche, *Beyond Good and Evil*, red. Rolf-Peter Horstmann dhe Judith Norman (Cambridge: Cambridge University Press, 2003), 92.
- 32 “Mos fillo nga gjërat e mira të vjetra por nga ato të këqijat të reja” (Bertolt Brecht, cituar në Walter Benjamin, “Conversations with Brecht,” në *Understanding Brecht*, përkth. Anna Bostock [Londër: Verso, 2003], 121).



# PEDAGOGY BEYOND THE PERAS THINKING WITH/IN THE PERIPHERY

Nico Jenkins

To discuss, as we have been tasked to do, the concept of pedagogy requires that we first imagine what it is to learn, as well as what it is to be taught before we can even begin to venture forth on what it is to teach, and especially what it is to teach with/in what has been called the disaster. That the modern form of education is tightly constrained and regimented seems obvious, and therefore any thinking about thinking (any thinking about disasters) must inevitably pass *between* the constraints, or *under* the regimes. This movement of thinking is always a call *towards*, and a call *from*. Martin Heidegger, in the two essays discussed here, asks that we attune ourselves well to venture onto this path, to listen before we begin (again) to teach; he asks us to listen to the unnecessary before we begin to discuss the necessary, to listen, *perhaps*, to the silence(s) which lie between thoughts, as much as to the thoughts themselves.

In the third part of Heidegger's *Country Path Conversations*, a dialogue is described between "an older man" and a "younger man" which takes place in the vast Russian forests in the closing days of a devastating war. The dialogue is important significant for a number of reasons. Written in 1944–1945, in the waning days of World War II, "Evening Conversation," as the essay is called, depicts, in a sense, a father's lament; Heidegger's own sons were then missing in the East and presumed dead. The Third Reich lay shattered, as did the dream of authoritarian certainty, in which the modern, existential plea of "What then shall we do?" was never so absent. (We can imagine – *perhaps* – what it is to be certain, even dead certain; to know rather than to doubt, to be sure in the face of uncertainty, to not see even the uncertainty, *to be certain that there is no uncertainty*.) Yet "Evening Conversation," and much of Heidegger's work, especially after *die Kehre*, or "the turn," embodies a reaction against this authority of authoritarianism. This restless *what then shall we do?* includes within it the question of "what then shall we learn?" "what then shall we teach?" and "how should we begin (*again*) to think (*again*)?" It is this concern with incipient thought which we should focus on as we also begin to think and begin to learn. *Again*.

Before pursuing the question of pedagogy (and the thought of pedagogy with/in the disaster) we should pause for a minute to examine the idea of dialogue as central to our project; a dialogue is a form of listening as much as it is a form of saying. It is a celebration of the participatory multivocal over the tyranny of the univocal author. It is a play between participants, both between the speakers named, as well as between author and reader; the dialogue comes to be only *in between*. A dialogue refuses to *say the absolute* (refuses the absolute) and refers the reader to the gaps between the interlocutors, to the relations and space between thoughts as much as to the actual *sayings* of the participants. In a dialogue, as in a performed work, the space between utterances, the gaps, the stuttering of unuttered thoughts, the pauses, hold as much importance as that which is said. Silences, in effect, create the work as much as the babble and chatter of language. It is important interesting to note that especially in Heidegger's later essays, the mode or construct of the univocal is questioned to such a degree that the hegemony of the author – and thereby “the said,” the authority of the fact – is, to a large degree, broken down, subtracted, absented from the text itself, leaving a more pure space for thought, for things to emerge, for things to come.

But this is not an essay on Heidegger's later work, nor even absolutely on Heideggerian terms; rather its aim is to borrow from Heidegger's writings certain key notions from which we can begin to think and question the role of pedagogy. More importantly for us, for the necessity of this address, is a small section of “Evening Conversation” towards the end of the dialogue in which Heidegger broaches what he calls the “necessary unnecessary.” In the dialogue between the two prisoners, the old man and the young man wrestle with the seeming incongruity of the necessity of what Heidegger calls the “unnecessary.” We know that the necessary is that which is expected, that which is formulated, dictated, inscribed and proscribed. The necessary is the absolute, while the unnecessary is that which transcends the necessary, that which makes thinking (to follow Heidegger's concerns), or at least the question of thinking, important.

In the dialogue, the older man says: “The obsession of mere expecting and the greed of accumulating always cling only to what is purportedly necessary.”

The younger man responds that: “They make the eyes of our essence blind to the unnecessary.” And the dialogue continues:

OLDER MAN: And to the fact that the unnecessary remains at all times the most necessary of all.

YOUNGER MAN: Only one who has learned to know the necessity of the unnecessary can appreciate anything at all of the pain that arises when the human is barred from thinking.

OLDER MAN: Thinking is thus the unnecessary, and yet you attribute to thinking a high rank of honor in the essence [*Wesen*] of the human.<sup>1</sup>

The necessary then closes off thinking while the unnecessary defiantly remains open, allows to come forth that which, as Christopher Fynsk mentioned at the beginning of this conference, *has yet to come*.

This concern with the ineffable, transcendent necessity of the unnecessary comes up as well in a more well known essay by Heidegger, “What Calls for Thinking?” As

with the *Country Path Conversations*, “What Calls for Thinking?,” culled from an early 1950s lecture course of the same name, hones in on the idea of learning, of allowing what is to be learned *to be learned*. To achieve this (and perhaps achieve is too strong a word here and we should use instead practice) is to practice a form of surrender to that which already is, and not to that which we seek to form ourselves. Rather than thinking being understood as a willful action, an undertaking, Heidegger seems to direct us more towards this surrender, or letting be, or *gelassen*. He writes that science does not think, that the rational, responsible thinking of procedural, Baconian inductive thinking, does not, in itself “think” and that, famously, we, trapped in this kind of thought, have not even “begun to think.” This specified type of thinking, according to Heidegger, deceives itself into believing that it is “bridge-making,” that it is gathering facts and building connections between them. Heidegger writes that, instead, and in reference to this preferential type of thinking that should concern us, that “there is no bridge here – only the leap.” This leap then is a type of surrender, a falling away from the proscribed and a falling into the unnecessary. Writing some pages further on, Heidegger takes up the theme of the leap again, noting:

The way is long. We dare take only a few steps. If all goes well, they will take us to the foothills of thought. But they will take us to places that we must explore to reach the point where only the leap will help further. The leap alone takes us into the neighborhood where thinking resides [ ... ] In contrast to a steady progress, where we move unawares from one thing to the next and everything remains alike, the leap takes us abruptly to a place where everything is different, so different that it strikes us as strange. Abrupt means the sudden sheer descent or rise that marks the chasm’s edge. Though we may founder in such a leap, what the leap takes us to will confound us.<sup>2</sup>

*Abrupt. Descent. Chasm. Founder. Strange.* When we consider these words in contrast to the practice of contemporary, academic thought with which many of us in this room concern ourselves – either through teaching, thinking or learning – they seem a far cry from the current discourse on pedagogical “best practices.” My own institution, for example, recently took eighteen months to finalize the following statement:

The School of Science and Humanities provides the broad intellectual resources necessary to help students meet the University’s goal of fostering critical self-reflection, qualitative, quantitative, cultural and ethical literacies with an education in the liberal arts. This mission is crucial to student success in pre-professional, professional and graduate work.

Science and Humanities faculty encourage student engagement with local, regional, and global communities and ideas through scholarly endeavors and through pedagogy which provides opportunities for practical application, through creative and critical approaches to general education in the arts and sciences, and through modeling critical awareness, thoughtful inquiry, collegiality and collaboration.<sup>3</sup>

That this statement seems to say absolutely nothing must be obvious, and indeed the gulf (though not the chasm that Heidegger writes about) seems vast between what “calls for thinking” and what is taught today to be thinking. The question then of pedagogy is the same as Heidegger’s; that is, what calls for thinking?

The modern university, bureaucratic and corporate is vastly different from Plato’s quiet olive grove, and even from the *Akademie*’s more contemporary models. It is rather based more on the existential exigencies of profit motive, concerning itself with student excellence (measured in students activities, general happiness and most importantly, retention) and, when it is concerned with the market, it is not the *agora* where Diogenes leaned and loafed, but with the free market and expanding its market share. It is self-referential and its reason for being is not necessarily to foster the thinking that Heidegger “calls” to (and which draws us forth) but rather simply to endure as a source, as well as a draw, of capital. It is self-enclosed and as such defines itself by the *peras* or boundary and builds borders, walls and zones of exclusion which separate itself from the outside world, and which isolate individual departments and faculty from each other. Rather than a matrix, it operates as a series of peripherally connected but deeply separate cells. This in effect enforces – instructs, schools – the isolation from others that is a fundamental trait of alienation, and it is this alienation that is carried forth into the world, into society. What is thought, when it is thought, is often predictable, categorizable, named and above all safe.

Amongst my own students, the predictable is what is craved and what is to be expected. Today’s student in the United States is emerging from a twelve year experiment in goals and outcomes under a project called “No Child Left Behind,” a flagship policy developed under the administration of George W. Bush. Standardization is not limited to the United States however; it is a crisis that seems to be emerging across the developed (and developing) world. It is a project meant to concretize the experience of education (and thus thinking) in predictable goals and outcomes and in doing so denies the existence of the unnecessary (viewing it as just that) in favor of the supposedly necessary, which is manifested in the form of standardized testing, anticipated results, and the promise of a job (an activity to take one quietly through one’s life until death) within the apparatus of a moribund, yet tightly controlled and managed, economy. There is little, if no room for the unknown, and certainly even less for leaping. Having learned this in their formative years, I see in my students (future nurses, police officers, physical therapists and pharmacists in one institution, electrical engineers and chemists in another) a profound lack of interest in taking risks, in creative (versus critical) thinking; analysis – of a text or a situation – when practiced, is limited to seeking a quantifiable answer, and there is little concern, amongst students, faculty or certainly administrators to practice what Hölderlin (whom I read through Heidegger) calls “a sign that is not read.”

The disaster of standardized, predictable education, the negation of creative thinking, doesn’t allow for questioning of one’s own existence. In that case, as in totalitarianism, everything is a certainty and there is no fear, because all is prescribed. Students are programmed through standardized education to close down any empathic movement (the movement of the unnecessary) and in this way we lose one of the fundamental as-

pects of humanity. When we no longer turn towards others, we are no longer necessary, but rather instead secondary, replaceable.

Everyone knows that these institutions [prisons, hospitals, schools, etc.] are finished, whatever the length of their expiration periods. It’s only a matter of administering their last rites and of keeping people employed until the installation of the new forces knocking at the door. These are the societies of control, which are in the process of replacing disciplinary societies [...] There is no need to invoke the extraordinary pharmaceutical productions, the molecular engineering, the genetic manipulations, although these are slated to enter into the new process. There is no need to ask which is the toughest or most tolerable regime [...] There is no need to fear or hope, but only to look for new weapons.<sup>11</sup>

It is a minor change, but the hope of unlimited finity is replaced in the latter text with only the need for new weapons. It is not merely a rhetorical shift away from hope. Deleuze’s development of this notion of control marks a closure of the possibilities of the third form he outlines in the Foucault text. The fold of the outside now constitutes only a new mechanism of power to individualize (or dividualize as Deleuze calls it) its methods of domination. Instead of treating workers as a mass they are now made to compete with each other for salaries. Deleuze sees the machines and technologies associated with such a movement arising from the same “third generation machines” and information technology that marked the moment of hope in the text on Foucault. Deleuze goes on in the “Postscript” to invoke both the closure of the future in the non-event of neoliberal capitalism and the unlimited finity of this situation stating, “Control is short-term and of rapid rates of turnover, but also continuous and without limit, while discipline was of long duration, infinite and discontinuous. Man is no longer man enclosed, but man in debt.”<sup>12</sup> It is now completely negative; the unlimited finity no longer marks new possibilities but rather the unlimited debt and resilience of the current global system.

This reconsideration of both the closure of the future and hope for an unlimited finity is striking. While it may be that this shift is merely a result of historical pessimism, it seems also to reflect Deleuze’s reading of Shannon. At the very least, it is possible to read Shannon against this shift in Deleuze. Deleuze and Guattari in *A Thousand Plateaus* refer to Shannon’s work, though not by name, saying:

The most general schema of information science posits in principle an ideal state of maximum information and makes redundancy merely a limitative condition serving to decrease this theoretical maximum in order to prevent it from being drowned out by noise. We are saying that the redundancy of the order-word is instead primary and that information is only the minimal condition for the transmission of order-words (which is why the opposition to be made is not between noise and information but between all the indisciplines at work in language, and the order-word as discipline or “grammaticality”).<sup>13</sup>

Immediately, two problems with their reading of information theory should be noted. First, for Shannon noise and information are not opposed. Noise, in adding uncertainty to the message, increases the raw information (even if for a particular engineering problem this added information is undesirable). Second, there is no reason to assume that redundancy is secondary in Shannon's formulation. While it is true that redundancy does decrease the amount of information transmitted across a channel, Shannon sees it as important as any element in communicating information. Deleuze and Guattari's reading assumes that Shannon envisions some ideal system with zero redundancy, but that would only be a possible solution to a system with no noise. What Shannon's discovery realizes and makes it so powerful is that the condition of zero noise is highly unlikely; thus any effective communication system requires redundancy. The breakthrough that Shannon makes is by recognizing the noisy condition and hence the condition requiring redundancy for communication as the mathematically interesting case.

In missing this, and reading Shannon as placing redundancy second, Deleuze and Guattari end up downplaying the radical nature of Shannon's discovery especially in terms of the relationship between the inside and outside. Speaking again of information theory in *A Thousand Plateaus*, they say, "In fact, there must not be any exterior [...]. One can make subjective choices between two chains or at each point in a chain only if no outside tempest sweeps away the chains and subjects."<sup>14</sup> It is here that the implication of this reading of Shannon becomes apparent. For Shannon the message is selected as part of a random process, not unlike Deleuze's dice-throw, and not by a subject. By making noise a primary part of the system, Shannon admits the necessity of the outside rather than a subject who chooses. In its most radical, Shannon's work is not the closure of the outside but instead the exact opposite. It is the mathematical theory of that "outside tempest that sweeps away both chains and subjects."

We can return then to the discrepancy between the text on Foucault and the "Postscript." In *Foucault* the future appears open as a result of the hoped-for unlimited finity, but in the "Postscript" Deleuze sees in our situation precisely the discipline and closure he and Guattari see in information theory. Ultimately, Deleuze in the "Postscript" seems to fall into the closure of the future catastrophe outlined above. While it is not the total cyber-catastrophe of all information systems, it is a similarly structured micro-catastrophe of technology enabled complete control. Deleuze ends the "Postscript" with a grim future with very few options. While he does make some suggestions for future research and resistances, they pale in comparison to the hope of an unlimited finity. Thus, I think it is ultimately necessary to read Shannon against this closure that operates even here in Deleuze's work. Shannon in writing randomness, chaos and entropy into the heart of these technologies should serve as a reminder that even in the heart of catastrophe and control there are always entropic possibilities. In the entropic realizations of Shannon's work there exists a reading of technology and communication that ultimately point back to the hope of Deleuze's earlier text.

Not only does this lesson of Shannon suggest a relation to the forces of technology and capitalism, but it also speaks to the future of academia and its exteriors (which Deleuze differentiates from the completely outside). First, I think it calls for a program of thought and inquiry that would attune itself to the notion of unlimited finity, especially as it produces possibilities out of the entropy of a closed set of options. I believe

it calls for a program of thinking, of learning from the world and its outside, that does not attempt to pre-empt the unknown; to try to know the world too early but rather opens itself up to the communicative thought of the outside. Instead of “going kinetic” against the unknown as the Bush Doctrine suggests, we must prepare instead to think the unknown in all its radicality only at the moment the message arrives. Moreover, precisely at this moment where technology along with the University and its exteriors themselves appear closed, ossified, stagnant and over coded by cheap technological and managerial tricks that attempt to sell off education and gut it of all its prospects, we must hold open the possibility that at the very heart of this closure, and indeed within all communicative and technological systems still lie new combinations, new thoughts, new outsides, new unlimited finities, and new pedagogies.



## Notes

- 1 James Adams, "Virtual Defense," *Foreign Affairs* (May/June 2001). (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1987 [1980]), 79.
- 2 Joseph K, "The Joseph K Guide to Tech Terminology: Eligible Receiver," *The Crypt Newsletter* (December/January 1998–9): <http://www.thehackademy.net/madchat/vxdevl/vxmags/crptlt52/CRYPT52.TXT>
- 3 John Arquilla, "Interview John Arquilla," *Frontline* (March 4, 2003): <http://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/cyberwar/interviews/arquilla.html>
- 4 Brian Massumi, "The Remains of the Day," in *Histories of Violence* (2012): <http://historiesofviolence.com/reflections/brian-massumi-the-remains-of-the-day/>
- 5 For more on the connections between cybernetics and French Theory see Céline Lafontaine, "The Cybernetic Matrix of 'French Theory,'" *Theory, Culture & Society* 24.4 (2007): 27–46.
- 6 Claude Shannon and Warren Weaver, *The Mathematical Theory of Communication* (Urbana: University of Illinois Press, 1971 [1949]). It is worth noting that in the short space of a year the title was changed from "a theory" to "the theory," suggesting the importance of Shannon's discovery.
- 7 Norbert Wiener, *Cybernetics: or the Control and Communication in the Animal and the Machine*, 2nd ed (Cambridge MA: MIT Press, 1961 [1948]), 11.
- 8 Gilles Deleuze, *Foucault*, trans. Sean Hand (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1988 [1986]), 117.
- 9 *Ibid.*, 132.
- 10 Originally in French: *L'Autre Journal* 1 (May 1990).
- 11 Gilles Deleuze, "Postscript on the Societies of Control," *October* 59 (Winter 1992): 4.
- 12 *Ibid.*, 6.
- 13 Gilles Deleuze and Félix Guattari, *A Thousand Plateaus*, trans. Brian Massumi

# KATASTROFA KIBERNETIKE DREJT NJË PEDAGOGJIE TË ENTROPISË

Xhustin Xhouk

Një nga vezullimat më të herëta të impaktit të mundshëm të një lufte të hapur kibernetike u shfaq në qershor të 1997-s. Mendohet se atë muaj një skuadër e vogël hakersh, duke përdorur mjete dhe programe në dispozicion të të gjithëve, arriti të depëronte në rrjetin elektrik të nëntë qyteteve amerikane, sistemet e tyre të emergjencës dhe një numër rrjetesh mjaft të rëndësishme të Pentagonit duke përfshirë këtu edhe ato rrjete që menaxhonin zinxhirët e furnizimit të ushtrisë dhe strukturës komandë-dhe-kontroll. Sipas Xhejms Adamsit që ka shkruar gjatë mbi këto sulme:

Hakera arritën gjithashtu të infektinin sistemin njerëzor komandë-dhe-kontroll me një nivel paralizues mosbesimi. Urdhërat që duket se vinin nga gjeneralët në komandë ishin të rremë, po ashtu siç ishin të rreme edhe lajmet mbi krizën dhe instruksionet nga autoritetet e komandës civile. Për pasojë, askush në zinxhirin e komandës, nga presidenti e poshtë, nuk mund të besonte asgjë. Ky grup hakersh që po përdornin resurse që ishin në dispozicion të të gjithëve që i aftë ta pengonte SHBA-në të bënte luftë në mënyrë efektive.<sup>1</sup>

Fatmirësisht, këto sulme, që janë quajtur “Eligible Receiver,” u ndërmorrën nga Agjensia e Sigurimit Kombëtar (ASK) të SHBA-së si një test i panjoftuar i infrastrukturës dixhitale ushtarake dhe civile. Sulmuesit, që po punonin si pjesë e një “No-Notice Interoperability Program,” u instruktuan vetëm të tregonin se çfarë që e mundur pa dëmtuar gjë.

Ndonëse ushtria nuk paraqiti evidencë qenësore mbi “Eligible Receiver,” me përjashtim të intervistave me mediat dhe dëshmime në kongres, për ca kohë “Eligible Receiver” u perceptua si një vezullim i luftës së ardhshme dhe natyrës së errët të teknologjive tona dixhitale. Sigurisht që kishte nga ata që ishin të bindur se nuk bëhej fjalë për gjë tjetër veç gogolit më të fundit të kompleksit media-sigurim. Tek *Crypt Newsletter*, një publikim hakeri prejardhja dhe historia e të cilit ka marrë rrjedhën e modemeve “dial-up” por që vazhdon të ekzistojë në pjesë të ndryshme të internetit, Josef K i refe-









rohet “Eligible Receiver” si “Një histori Pentagoni fantazmash e përsëritur *ad nauseum* për gazetarët dhe ata që tremben lehtë ku pretendime qesharake dhe tërësisht të pazazuara në lidhje me kërcënimet nga hapësira kibernetike paraqiten si akte mahnitëse tekno-prestidigjitorësh të kryera nga ushtarë kibernetikë që punojnë brenda një loje lufte tepër të klasifikuar.”<sup>2</sup>

Ndonëse qëllimi i Josef K-së ishte ta shpërfillte “Eligible Receiver,” ligjëratat që e rrethon atë duket se vazhdon të tregojë një histori interesante fantazmash, sidomos nëse ajo trajtohet si e tillë dhe lexohet jo si një histori e pabazë por si një mit që funksionon edhe pa prova. Xhon Arkilla, një teoricien ushtarak që jep mësim tek Us Naval Postgraduate School, përmbledh saktësisht gjendjen e raportit publik me ndodhinë gjatë një interviste ku thotë, “Eligible Receiver është një ndodhi e klasifikuar mbi të cilën nuk mund të flas. Ajo që mund të them është se kur njerëzit thonë se nuk ka prova mbi seriozitetin e kërcënimit kibernetik, Eligible Receiver është sipas meje një provë bindëse e natyrës së kërcënimit që na kanoset.”<sup>3</sup> Ky pretendim kafkaesk është kuptimplotë: ai nuk mund të thotë se çfarë ndodhi, por ekzistenca e “Eligible Recovery,” ndonëse e klasifikuar, verifikon pikën që ai do të bëjë. E parë nga një këndvështrim i tillë, kjo ndodhi shfaqet jo si një sulm kundër sistemeve ushtarake të informacionit por, përkundrazi, si një sulm kundër besimit që ne kemi tek sistemet dixhitale që gjithnjë e më tepër përbëjnë stofën e jetës së përditshme. Ndoshta ajo që duhet të marrim nga pretendimet e Adamsit se askush, nga Presidenti e poshtë, nuk mund të besonte asgjë, është një paralajmërim se edhe ne që jemi jashtë lojës së luftës nuk mund të besojmë më asgjë duke filluar nga Presidentin e poshtë. Pak imagjinatë duhet për të sugjeruar se rezultati i nënkuptuar është një shembje sociale e përmasave katastrofike. Në fakt, shembja e gjithë sistemit mund edhe të ketë filluar ndërkaq. Ajo që është në lojë tek “Eligible Receiver” nuk janë pra vetëm teknologjitë ushtarake të komunikimit por e gjithë shoqëria.

Sistemet kompjuterike, veçanërisht kur shihen si pajisje për ruajtjen e të dhënave, funksionojnë për të garantuar se regjistrimi i të kaluarës do të vazhdojë të ekzistojë në të ardhmen. Ndonëse kompjuterat shpesh teorizohen si pajisje për përlllogaritje apo makina komunikimi, është e qartë se në shoqërinë bashkëkohore ata shërbejnë për të ruajtur informacione mbi të kaluarën për [në] të ardhmen. Çdo gjë që vë në dyshim sigurinë e kompjuterave në të ardhmen e minon atë edhe në të tashmen. Kësisoj, ardhmëria [futura] e një sulmi “real” si “Eligible Receiver” infekton besimin që ne kemi tek këto sisteme në të tashmen. Për ta konceptuar këtë situatë sipas termave të Virilios: databaza është shpikja e aksidentit të të dhënave. Për më tepër, “Eligible Receiver” e shtyn këtë mundësi akoma më thellë në sferën e një katastrofe të të dhënave të militarizuara. Jo vetëm që është e mundur që sistemet tona kompjuterike do të dështojnë në të ardhmen, por është e mundur se ato janë tashmë të kompromentuara. Sado që ky test i panjoftuar mund të ketë qenë një test i sigurimit ushtarak, ai është gjithashtu një test i besimit që ne kemi tek bota dixhitale. Dhe nuk bëhet fjalë vetëm për sistemet tona dixhitale, pasi ne do të mund t’i shtonim kësaj katastrofe dixhitale një katastrofë për çdo sistem në të cilin fiksohen [embedded] jetët tona: shembje ekologjike, flluska spekulative, sëmundje që janë rezistente ndaj trajtimeve, shembje tregjesh, nxehta e planetit, fundi i universitetit, etj.

Shpërfillja përqeshëse e Josef K shfaqet pra, si predikimi i një njeriu të urtë e të panjohur i mosbesimit tonë dixhital, për të na siguruar se këto ndodhi janë thjeshtë fan-

tazma për të tmerruar ata që mashtrohen lehtë dhe që në fakt nuk kanë për të ndodhur ndonjëherë. Shpërfillja e plotë e kësaj historie fantazmash dyfishon të ardhmen: nga njëra anë, mundësia e shembjes totale dhe nga ana tjetër besimi i plotë dhe aftësia ripërtëritëse. Ajo dyfishon po ashtu strukturën e besimit dhe të skepticizmit. A janë besimtarët ata që e vënë besimin mbi botën tonë teknologjike apo ata që i besojnë verbërisht fjalëve të ushtrisë se katastrofa është prapa derës? Nëse ne nuk mund t'i besojmë "askujt nga Presidenti e poshtë," si mund t'iu zëmë besë atyre që vënë në pikëpyetje këtë besim?

Katastrofa e ardhme bëhet imanente për këto teknologji, jo për shkak të ndonjë paevitueshmërie por pikërisht për shkak të papërcaktueshmërisë së saj. E ardhmja bëhet e dyjore por gjithashtu probabilistike, për sa kohë që ne nuk mund ta dimë nëse jemi të dënuar ndaj katastrofës ose jo. Ajo nuk është thjesht e panjohur por përmban si katastrofën e mundshme ashtu edhe jondodhinë e të përditshmes dixhitale. Kësisoj e ardhmja duket e mbyllur. Ajo është ose një e ardhme e shembjes totale të sistemeve ose jondodhia e vazhdimimit të kapitalizmit neoliberal. Kjo strukturë dyjore kaplon të ardhmen duke mbyllur mundësinë për kuptime të reja dhe forma të reja të mendimit. Të japësh mësim dhe të mësosh në hapësirën e kësaj mbylljeje kërkon një pedagogji që duhet të jetë një pedagogji shkatërrimi, por njëkohësisht një pedagogji e jondodhisë. Brajn Masumi, në një artikull të 2012-s e përcakton mirë këtë mbyllje kur përshkruan efektin e doktrinës Bush dhe të parapritjes [*preemption*] mbi politikën globale: "E vetmja siguri që ke është se duhet të veprosh tani për të bërë gjithçka të mundshme për të parapritur të mundshmen. Në fjalorin e Donald Ramsfeldit, Sekretarit të Mbrojtjes së Bushit, e vetmja gjë e sigurtë është se ti duhet të "bëhesh kinetik," megjithëse "ti në të vërtetë nuk di dhe nuk ke se si të dish dhe e di se nuk di."<sup>4</sup> Katastrofa nuk e fshin rendin ekzistues; përkundrazi, ajo vë në pikëpyetje të tashmen simbolike dhe kësisoj lë rendin e tanishëm, së bashku me besimin tonë dixhital, si alternativën e vetme. Për më tepër, i bën thirrje rendit ekzistues të veprojë në mënyrë parapritëse, kundër katastrofës, të jetë gjithmonë gati për t'u bërë kinetik kundër të ardhmes së panjohur. Ajo shndërrohet në një dedikim jo ndaj mundësisë së të ardhmes por thjesht mbijetesës së të tashmes. E vetmja e ardhme që ka rëndësi tani është e ardhmja që është ndërkaq këtu, e ardhmja e rrisë së vazhdueshme kapitaliste për të cilën ne jemi gjithnjë me vonesë. Çdo e ardhme tjetër është e humbur për ne.

Megjithë shfaqjen e kësaj mbylljeje, ekziston ndoshta mundësia që një tjetër lexim i situatës së tanishme është ndërkaq i koduar brenda botës tonë gjithnjë e më komunikuese e më të kontrolluar. Në 1948-n, në tekstin e tij *Kibernetika ose kontrolli dhe komunikimi tek kafshat dhe makinat* [*Cybernetics or Control and Communication in the Animal and Machine*], Norbert Uiner [*Wiener*] skicoi elementet bazë të një shkence të re të sistemeve të quajtur kibernetikë, që synonte të eksploronte shkencën dhe studimin e sistemeve, strukturave të tyre, rregullave të tyre, attributeve të tyre dhe mundësitë e tyre në një numër të madh disiplinash nga teknologjia te biologjia te shoqëria. Termi kibernetikë i referohet fjalës greke *kybernētēs* që do të thotë drejtues ose guvernator. Mbështetësit e saj më të hershëm, duke përfshirë Uiner, besonin se ajo do të shndërrohej në shkencën e shkencave. Ndonëse ka akoma valë të zhvillimit të kibernetikës, shumica e planeve të saj më madhështore u shembën dhe arritjet matematikore dhe shkencore të bëra nën emrin e kibernetikës janë transferuar në fusha të tjera duke përfshirë teorinë e komuni-



kimit, inxhinierinë, kriptografinë, sistemet komplekse, analizën e rrjeteve, etj. Një nga pikat ku u përqëndrua kibernetika ka qenë përshkrimi i informacionit dhe komunikimit brenda sistemeve. Uiner së bashku me Klod Shenonin [*Claude Shannon*] zhvilluan matematikën mbi të cilën mbështetet kuptimi bashkëkohor i sistemeve të komunikimit, duke përfshirë internetin, telefonat celularë, teknologjitë e enkriptimit dhe sistemet e ngjeshjes së informacionit [*information compression systems*]. Në shumë pikëpamje si tuata në të cilën ndodhemi, me ngritjen e kapitalizmit komunikues dhe të shoqërive të kontrollit, i detyrohet po aq historisë së kibernetikës sa shkencës që mundësoi shumë teknologji si të paqes dhe të luftës. Për më tepër, edhe e ashtu-quajtura “Teori franceze” i është mjaft borxhlie kibernetikës pasi ajo pati ndikim mbi mendimtarë të panumërt, duke përfshirë Roman Jakobson, Levi-Straus, Lakan, etj., për të mos përmendur qëndrimet më kritike të Hajdegerit dhe Derridasë mbi këtë shkencë.<sup>5</sup> Do të mund të thonim pra se kibernetika nënvijon një pjesë të mirë të mbylljes së të ardhmes në të cilën ndodhemi, por shpresa ime është të sugjeroj se në zemrën e kësaj mbylljeje ka një tjetër mundësi.

Ndonëse Uiner dhe Shenon e zhvilluan së bashku atë që tani quhet teori komunikimi, përshkrimi abstrakt matematikor i Klod Shenonit i kanaleve të komunikimit dhe kapacitetit të tyre për informacion është bërë standardi në këtë fushë. Në 1948-n, Shenon, që kishte punuar mbi sisteme kriptografike gjatë luftës, publikoi një artikull tashmë legjendar tek *Bell Systems Technical Journal* të titulluar “Një Teori matematike e komunikimit [*A Mathematical Theory of Communication*].” Vitin që pasoi një libër i bazuar mbi këtë artikull, me një parathënie disi më të lehtë për t’u lexuar (dhe gjithashtu pakëz më filozofike) të shkruar nga Uaren Uiveri, u publikuar si *Teoria Matematike e Komunikimit*.<sup>6</sup> Përpara përshkrimit matematik të Shenonit, mundësitë e komunikimit të një kanali të caktuar, që mund të ishin sinjale radio, një linjë telegraf, ose tani një kabëll fibre optike, përcaktoheshin kryesisht nga inxhinierët në mënyrë eksperimentale. Shenon arriti të përcaktonte kufirin e sipërm të çdo kanali për të mbartur informacion. Kësisoj puna e tij është shndërruar në bazën e mendimit bashkëkohor mbi komunikimin, të paktën si një problem inxhinierik.

Një nga arritjet madhore të Shenon qe të konsideronte një sistem komunikimi si midis një pikënisjeje dhe një pikëmbërritjeje (duke shtuar transmetuesit dhe marrësit). Duhet vënë re se për Shenon kjo ishte thjesht një çështje e suportit material të komunikimit, dhe jo të kuptimit që ai kishte. Unë do t’i mbahem këtij dallimi këtu, megjithëse do të kisha shumë për të thënë mbi marrëdhënien midis informacionit dhe kuptimit. Sidoqoftë, Shenon e teorizoi përzgjedhjen e mesazhit si një proces rastësor [*random*]. Nëse krijimi i mesazhit trajtohet si rastësor atëherë sasia e informacionit që përmban mesazhi është rezultat i rastësorisë [*randomness*] së përzgjedhjes së tij. Sa më e madhe hapësira e mundshme e mesazhit, ose numri i mesazheve të mundshëm, aq më rastësore është përzgjedhja dhe kësijoj aq më shumë informacion mund të komunikohet. Për më tepër, probabiliteti i secilit mesazh ndikon mbi informacionin total që mund të transmetohet përgjatë një kanali të caktuar. Një shembull i thejshhtë e vërteton bukur këtë. Në anglishten e shkruar është shumë e rrallë që një  $q$  të pasohet nga ndonjë shkronjë tjetër përveç  $u$ -së. Kësijoj,  $u$ -ja, duke qenë mjaft e përcaktuar [*determined*], na jep shumë pak informacion shtesë. Shënues të tjerë gjuhësorë, shkronja, etj., shfaqin veti të ngjashme. Duhet vënë re se pretendimi nuk është asnjëherë se këta janë të

pavlefshëm. Përkundrazi, shtimi i teprisë [*redundancy*], siç e quan Shenon, është kritik që të arrish të dërgosh një mesazh përgjatë një kanali të zhurmshëm pasi atëherë mesazhi nuk mbështetet tek mbërritja sakllam e çdo tingulli apo pjese të tij. Në të njëjtën kohë, sa më e madhe tepria aq më e vogël sasia e informacionit që mund të transmetohet. Siç ndodh me mungesën e informacionit që na jep një  $u$  që vijon pas një  $q$ -je, një burim informacioni që transmeton vetëm një seri njëshash nuk do të na jepte asnjë informacion.

Formula që zhvilloi Shenon për të përshkruar sasinë e informacionit tek një mesazh ose përgjatë një kanali varet pra mbi probabilitetin që një meshazh i caktuar, ose një pjesë e këtij mesazhi, do të përzgjidhet. Shenon zgjodhi ta quajë sasinë e informacionit, ose mund të thonim rastësorinë e mesazhit, entropi. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të ngjashmërisë midis formulës së tij dhe formulës statistikore për entropinë termodinamike, por përfaqësonte gjithashtu modelimin e sistemeve të komunikimit si procese rastësore. Ndonëse termi entropia-Shenon është bërë standard në fushë për përshkrimin e sasisë së informacionit brenda një mesazhi apo të informacionit të transmetueshëm përgjatë një kanali, besoj se kjo lloj terminologjie bën një pretendim interesant dhe të rëndësishëm filozofik dhe ideologjik. Të sugjerosh se informacioni, dhe ndonëse ky nuk është kuptim në vetvete, të paktën mundësia për të komunikuar kuptimin, mbështetet mbi procese entropike rastësore është goxha radikale. Sipas këtij përkufizimi del se madje edhe zhurma i shton informacion një mesazhi pasi ajo rrit rastësorinë. Duhet pranuar se skemat enkodimi mund të minimizojnë efektin e zhurmës tek një mesazh, por megjithkëtë përfundimi se edhe zhurma shton sasinë e informacionit të një mesazhi mbetet disi shokues. Ajo që kjo do të thotë, dhe që është kaq radikale, është se në punën e Shenonit vetë mundësia e informacionit kushtëzohet nga mosdija jonë, ose nga dija jonë gjithmonë e pjesshme. Në punën e Shenonit, njohuria mbi mesazhin nuk mund të ekzistojë përpara në kohë por vetëm në momentin kur mesazhi merret. Dhe jo vetëm kaq, sikur të kishim njohuri mbi të para kohe nuk do të përfitonim asgjë dhe, sipas përkufizimit, nuk do të kishte mesazh. Ky nuk është një proces jashtë kontrolli por një komunikim që ndërsa punon me një hapësirë të kufizuar mesazhi duhet të jetë i hapur ndaj mosparashikueshmërisë së tij. Ndonëse Shenon natyrisht nuk e konceptoi kurrë si të tillë, do të mund ta lexonim punën e tij si një manifest matematik të mosdijes; të jetesës në një botë që nuk mund ta njohim. Në një farë kuptimi kemi arritur kështu tek pika e Masumit e përmendur më lartë, por tani bota domosdoshmërisht, dhe veçanërisht ndërsa teknologjitë komunikuese zënë rrënjë, e fut rastësorinë dhe mosdijen në vetë rregullat e saj.

Përshkrimi i kësaj pune nga Norbert Unieri në tekstin e tij *Kibernetika*, na jep një ide se sa radikale ishin pretendimet e Shenonit. Uiner, që ishte duke punuar mbi përshkrimet e ngjashme matematikore që i referoheshin drejtpërdrejtë punës së Shenonit thotë tek hyrja e *Kibernetikës*:

Nocioni i sasisë së informacionit puthitet shumë natyrshëm me një nocion klasik në mekanikën statistikore: atë të entropisë. Ashtu si sasia e informacionit në një sistem tregon nivelin e tij të organizimit, po ashtu entropia e një sistemi tregon nivelin e tij të çorganizimit; dhe njëra është thjesht negativja e tjetrës.<sup>7</sup>

Tek përshkruan lidhjen midis informacionit dhe entropisë, Uiner nuk është i aftë ta përshkruajë komunikimin si të kushtëzuar nga entropia. Në vend të kësaj ai e zhbën përshkrimin duke pretenduar se informacioni dhe entropia e kundërshtojnë në vend që ta përshkruajnë njëra-tjetrën. Ndonëse kjo divergjencë në terminologji është përmendur shumë pak, dhe disa tekste flasin për “Entropia Shenon–Uiner [*Shannon–Wiener Entropy*],” ajo sugjeron sa radikal ishte zbulimi i Shenonit dhe sa shumë e sfidoi ai dëshirën e Uinerit për ta parë kibernetikën si atë që bashkonte komunikimin me kontrollin.

Nën këtë dritë, puna e Shenonit na jep një mësim të rëndësishëm, dhe madje edhe një pozicion filozofik, mbi teknologjinë, mendimin dhe të ardhmet e tyre përkatëse. Duke e përvijuar këtë mësim, ne arrijmë, nëpërmjet Shenonit, tek një moment tepër deleuzeian. Për Dëlëzin subjekti, e brendshmja dhe mendimi vetë janë gjithmonë një palë e jashtësisë. Në tekstin e tij mbi Fukonë [*Foucault*] ai zhvillon idenë se vetë mendimi është një rastësi rastësore [*random chance*], duke e krahasuar atë me hedhjen e një zari. Kësisoj mendimi është gjithmonë një mendim i jashtësisë. Dëlëz thotë, “Arto [*Artaud*] i kundërvinte të lindurës [*innate*] dhe të fituarës [*acquired*] ‘gjenitalen,’ gjenitalitetin e mendimit në vetvete, një mendim që vjen nga jashtë dhe është më larg se çdo botë e jashtme, dhe kësisoj më afër se çdo botë e brendshme. A duhet quajtur kjo jashtësi Rastësi?”<sup>8</sup> Trajtimi i Shenonit i komunikimit si një proces entropik mbështetet pra mbi një strukturë të ngjashme, komunikimi vetë bëhet një mendim i jashtësisë. Komunikimi në tërësi dhe teknologjia e komunikimit palosin jashtësinë entropike për nga brenda, duke krijuar një mundësi që ekziston jo në një vend, por në hapësirën midis dy vendeve. Edhe një hapësirë mesazhi e mbylluar apo e kufizuar, si një zar që ka vetëm gjashtë faqe, prapë së prapë palos procese kaotike rastësore brenda vetes.

Ky nuk është vetëm mësimi i zbulimit të Shenonit, por gjithashtu ai i praktikës së tij. Shenon nuk u nis me qëllimin për të krijuar një botë entropike, ai e gjeti atë duke pritur, një mundësi ose një mesazh nga një hapësirë e kufizuar mesazhi. Bashkimi midis entropisë termodinamike dhe informatike shfaqet si riprodhimi i një strukture matematikore. Ai duket si një mundësi rastësore në vetë ndërtimin e universit. Në një farë kuptimi bëhet e pavendosshme nëse teoria matematikore e komunikimit e Shenonit është mendimi i tij apo i universit. Ndoshta ajo vetë shfaqet si një linjë komunikimi midis të dyve. Një proces entropik rastësor që e tregon veten vetëm pasi dërgohet dhe merret. Një mendim i universit i palosur brenda Klod Shenonit.

Ndërsa teknologjitë e komunikimit shumëfishohen dhe kthehen në teknologji të kontrollit, mbikëqyrjes, luftës dhe katastrofës, mësimi i Shenonit është se edhe ndërsa e ardhmja mbyllet fort rreth në një jashtësi entropike është megjithatë gjithmonë aty. Në mes të mbylljes ka gjithmonë mundësi. Kjo nuk do të thotë se disa, nëse jo shumica e këtyre mundësive, nuk mund të jenë po aq ose më të tmerrshme dhe më të llahtarshme se sistemi global i sotëm, por ai prapë na fton të mendojmë, teorizojmë, dhe të mësojmë mundësitë e tyre në ballafaqim me katastrofën e ardhme dhe atë të tanishmen; qoftë kjo katastrofa e një lufte kibernetike globale apo ajo e universitetit. Dëlëz, tek shtojca e tekstit të tij mbi Fukonë, publikuar në 1986-n, thotë diçka të ngjashme:

Puna e shpërndarë duhej të rigrumbullohej tek makinat, kibernetika dhe teknologjia e informacionit të brezit të tretë. Cilat do të ishin forcat në lojë, me të cilat forcat brenda njeriut do të hynin në një raport? Nuk do të nënkuptonte më të rritësh deri në pafundësi apo fundmësinë por një fundmësi të pakufizuar, duke ndjellë kësajsoj çdo situatë force ku një numër i fundshëm përbërësish prodhojnë një larmi praktikisht të pakufizuar kombinimesh [...] Forcat brenda njeriut hynë në një raport me forcat prej nga jashtë, ato te silikonit që tejkalon karbonin, ose përbërësit gjenetikë që telkalojnë organizmin, ose agramatikalitetet që tejkalojnë shënjesin [...] është ardhja e një forme të re që nuk është as Perëndia as njeriu dhe që, shpresohet, nuk do të jete më e keqe se dy format e mëparshme.<sup>9</sup>

Dëlëz përvijon këtu, nja dyzetë vjetë më vonë, mësimin e Shenonit: edhe kur gjithçka, duke përfshirë të ardhmen, duket e mbyllur, ka gjithmonë një fundmësi të pakufizuar, një hapësirë entropike komunikimi që mbart brenda vetes një palë të pakontrollueshme të jashtësisë.

Ndërsa pretendon se “shpresohet” se një fundmësi e pakufizuar do të jetë më e mirë se format e mëparshme është një ndjenjë modeste, është e habitshme se sa pozitive është ajo, duke patur parasysh tendencën e Dëlëzit për të theksuar sa kollaj mund të shemben sistemet mbi veten e tyre duke shkaktuar pasoja akoma më të këqija. Kjo notë shpresëplotë me të cilën Dëlëz mbyll tekstin e tij mbi Fukonë ndryshon dramatikisht nga diskutimi i tij i temave të ngjashme tek “Pasthënie mbi shoqëritë e kontrollit” i publikuar katër vjetë më vonë në 1990-n.<sup>10</sup> Në këtë tekst të shkurtër Dëlëz përvijon llojin e ri të shoqërisë që ai beson do të zëvendësojë shoqëritë disiplinare të shtjelluara nga Fukoja në veprën e tij. Dëlëz thotë për këto shoqëri:

Të gjithë e dinë se këto institucione [burgje, spitale, shkolla, etj.] kanë marrë fund, cilado qoftë kohëzgjatja e periudhave të tyre të skadimit. Tani është thjesht çështje e dhënies së riteve të fundit dhe të mbajtjes së njerëzve në punë për sa kohë që forcat e reja që po trokasnin tek dera nuk janë instaluar akoma. Këto janë shoqëri kontrolli, që janë duke zëvendësuar shoqëritë disiplinare [...] Nuk ka nevojë të ndjellim prodhimet e jashtëzakonshme farmaceutike, inxhinierinë molekulare, manipulimet gjenetike, ndonëse këto do të hynë në procesin e ri. Nuk ka nevojë të pyesim se cili është regjimi më i ashpër dhe ai më i tolerueshmi [...] Nuk ka nevojë të kemi as frikë e as shpresë, por vetëm të kërkojmë armë të reja.<sup>11</sup>

Ndryshimi është i vogël por shpresa për një fundmësi të pakufizuar është zëvendësuar në tekstin e dytë me nevojën për armë të reja. Nuk është thjesht një zhvendosje retorike. Zhvillimi i Dëlëzit i këtij nocioni të kontrollit shënon një mbyllje të mundësive të formës së tretë që ai përvijon në tekstin mbi Fukonë. Pala e jashtësisë përbën tani vetëm një mekanizëm të ri pushteti për të individualizuar (ose ndarë [individualize] siç e quan Dëlëz) metodat e saj të mbizotërimit. Në vend që t’i trajtojë punëtorët si një masë, ata detyrohen tani të garojnë për rrogat e njëri-tjetrit. Sipas Dëlëzit makinat dhe teknologjitë që lidhen me një lëvizje të tillë dalin prej po atyre “makinave të brezit të tretë” dhe teknologjive të informacioni që shënonin momentin e shpresës në tekstin mbi Fukonë. Tek “Pasthënia” Dëlëz ndjell si mbylljen e të ardhmes në jondodhinë e

kapitalizmit neoliberal ashtu edhe fundmësinë e pakufizuar të kësaj situate duke konstatuar, “Kontrolli është jetëshkurtër dhe ka ritme të shpejta qarkullimi, por gjithashtu i vijueshëm dhe pa kufij, ndërsa disiplina ishte jetë-gjatë, e pafund dhe e pavijueshme. Njeriu nuk është më njeriu i rrethuar, por njeriu në borxh.”<sup>12</sup> Ajo është tani tërësisht negative; fundmësia e pakufishme nuk shënon më mundësi të reja por borxhin e pafund dhe aftësitë ripërtëritëse të sistemit të sotëm global.

Ky rishikim si i mbylles së të ardhmes ashtu edhe shpeshës për një fundmësi të pakufizuar është habitës. Ndonëse ka mundësi që kjo zhvendosje është vetëm pasojë e një pesimizmi historik, ajo duket se reflekton gjithashtu leximin e Dëlëzitet të Shenonit. Është e mundur të paktën ta lexojmë Shenon kundër kësaj zhvendosjeje tek Dëlëzi. Dëlëz dhe Guatari i drejtohen punës së Shenon tek *Një Mijë Rrafshnalt*, ndonëse jo vetë atij me emër:

Skema më e përgjithshme e shkencës së informacionit presupozon në parim një gjendje ideale të maksimumit të informacionit dhe e bën teprinë vetëm një kusht kufizues që shërben të zvogëlojë këtë maksimum teorik për të ndaluar që ai të mbytet nga zhurma. Ne po themi përkundrazi se teprica e fjalës së rendit është parësore dhe se informacioni është vetëm kushti minimal për transmetimin e fjalëve të rendit (që është arsyeja pse kundështia që duhet bërë nuk është ajo midis zhurmës dhe informacionit por midis të gjitha jodisiplinave që veprojnë në gjuhë, dhe fjalës-rend si disiplinë ose “gramatikalitet”).<sup>13</sup>

Duhen vënë re menjëherë dy probleme me leximin e tyre të informacionit. I pari, për Shenonin zhurma dhe informacion nuk janë të kundërta. Zhurma, duke i shtuar pasiguri mesazhit, rrit informacionin e papërpunuar (edhe nëse për një problem të caktuar inxhinierik ky informacion i shtuar është i padëshirueshëm). I dyti, nuk ka arsye për të supozuar se tepria është dytësore në formulimin e Shenonit. Ndonëse është e vërtetë se tepria zvogëlon sasinë e informacionit që transmetohet përgjatë një kanali, për Shenonin ajo është po aq e rëndësishme sa çdo element tjetër në komunikimin e informacionit. Leximi i Dëlëz dhe Guatari presupozon se Shenon përfytyron ndonjë sistem ideal me zero tepri, por kjo do të ishte një zgjidhje e mundshme vetëm në rastin e një sistemi pa zhurmë. Ajo që tregon zbulimi i Shenonit dhe që e bën atë kaq të fuqishëm është se kushti i mungesës së plotë të zhurmës ka shumë pak gjasa për t’u përmbushur; kështu, çdo sistem komunikimi efektiv kërkon tepri. Arritja e Shenonit ndodh sepse ai pohon se kushti i zhurmshëm dhe kështu kushti që kërkon tepri për komunikim është rasti më interesant nga pikëpamja matematikore.

Duke mos e kapur këtë, dhe duke e lexuar Shenonin sikur ai e vë teprinë në vend të dytë, Dëlëz dhe Guatari minimizojnë rëndësinë e natyrës radikale të zbulimit të Shenonit, veçanërisht nga pikëpamja e raportit midis brendësisë dhe jashtësisë. Duke folur përsëri mbi teorinë e informacionit tek *Një Mijë Rrafshnalt*, ata thonë, “Nuk duhet madje të ketë asnjë jashtësi [...]. Mund të merren vendime subjektive midis dy zinxhirëve ose në çdo hallkë të një zinxhiri vetëm nën kushtin se asnjë stuhi e jashtme nuk fshin zinxhirët dhe subjektet.”<sup>14</sup> Këtu pasoja e këtij leximi të Shenonit bëhet mëse e qartë. Për Shenonin përzgjedhja e mesazhit është pjesë e një procesi rastësor, të ngjashëm me hedhjen e zarit të Dëlëzitet, dhe nuk bëhet nga një subjekt. Duke

e bërë zhurmën një pjesë parësore të sistemit, Shenon pranon domosdoshmërinë për një jashtësi dhe jo atë për një subjekt që zgjedh. Në versionin e saj më radikal puna e Shenonit nuk qëndron tek mbyllja e jashtësisë por pikërisht tek e kundërta. Ajo është teoria matematikore e asaj “stuhie të jashtme që fshin si zinxhirët ashtu edhe subjektet.”

Tani mund t’i kthehemi mospërputhjes midis tekstit mbi Fukonë dhe “Pasthënies.” Tek *Fuko* e ardhmja shfaqet e hapur si rezultat i fundmësisë së pakufizuar, kurse tek “Pasthënia” Dëlëz dallon tek situata jonë pikërisht disiplinën dhe mbylljen që ai dhe Guatari dallojnë në teorinë e informacionit. Tek “Pasthënia” Dëlëz duket sikur bie brenda mbylljes së katastrofës së ardhme të skicuar më sipër. Ndonëse ajo nuk është katastrofa kibernetike totale e të gjithë sistemeve të informacionit, ajo është një mikro-katastrofë e kontrollit total të mundësuar teknologjikisht me një strukturë të ngjashme. Dëlëz e mbyll “Pasthënien” me një të ardhme të zymtë me pak mundësi. Ndonëse ai bën disa sugjerime mbi kërkime dhe rezistenca të ardhshme, ato zbehen në krahasim me shpresën e një fundmësie të pakufizuar. Kështu, mendoj se është e domosdoshme ta lexojmë Shenon kundër kësaj mbylljeje që vepron edhe në veprën e Dëlëzit. Shenon, duke e futur rastësorinë, kaosin dhe entropinë në zemër të këtyre teknologjive, duhet të shërbejë si një përkujtesë se edhe në zemrën e katastrofës dhe kontrollit ka gjithmonë mundësi entropike. Në kuptimet entropike të punës së Shenonit ekziston një lexim i teknologjisë dhe komunikimit që në fund të fundit na drejtojnë tek shpresa e tekstit të mëhershëm të Dëlëzit.

Ky mësim që na jep Shenon sugjeron jo vetëm një lidhje midis forcave të teknologjisë dhe kapitalizmit por flet gjithashtu për të ardhmen e akademisë të jashtmes së saj (që për Dëlëzin ndryshon nga ajo që është tërësisht e jashtme). Në rradhë të parë, besoj se ai bën thirrje për një program mendimi dhe vëzhgimi që do të harmonizohej me nocionin e një fundmësie të pakufizuar, sidomos teksa prodhon mundësi prej entropisë së një bashkësie të mbyllur mundësish. Besoj se bën thirrje për një program të mendimit, të mësimin prej botës dhe jashtësisë së saj, që nuk tenton apo parapret të ardhmen; për ta njohur botën tepër shpejt por përkundrazi hapet ndaj mendimit komunikues të jashtësisë. Në vend që të “bëhemi kinetikë” kundër të panjohurës siç sugjeron Doktrina “Bush,” ne duhet të përgatitemi të mendojmë të panohurën në tërë radikalitetin e saj vetëm në momentin që mbërrin mesazhi. Për më tepër, pikërisht në këtë moment kur teknologjia së bashku me Universitetin dhe pjesët e tij të jashtme duken të mbyllura, të eshtëzruara, të ndenjura dhe të mbikoduara nga hile të ulëta menaxheriale që përpiqen ta shesin arsimin dhe t’i zhvasin të gjithat perspektivat, ne duhet të mbajmë hapur mundësinë se në zemër të kësaj mbylljeje, dhe në fakt brenda të gjithë sistemeve komunikuese dhe teknologjike ka kombinime të reja, mendime të reja, jashtësi të reja, fundmësi të pakufizuara të reja dhe pedagogji të reja.

## Shënime

- 1 James Adams, "Virtual Defense," *Foreign Affairs* (maj/qershor 2001). 14 Po aty, 219–20.
- 2 Joseph K, "The Joseph K Guide to Tech Terminology: Eligible Receiver," *Crypt Newsletter* (dhjetor/janar 1998–9): <http://www.thehackademy.net/madchat/vxdevl/vxmags/crptlt52/CRYPT52.TXT>
- 3 John Arquilla, "Interview John Arquilla," *Frontline* (4 mars 2003): <http://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/cyberwar/interviews/arquilla.html>
- 4 Brian Massumi, "The Remains of the Day," në *Histories of Violence* (2012): <http://historiesofviolence.com/reflections/brian-massumi-the-remains-of-the-day/>
- 5 Për lidhje të mëtejshme midis kibernetikës dhe teorisë franceze, sh. Céline Lafontaine, "The Cybernetic Matrix of 'French Theory,'" *Theory, Culture & Society* 24.4 (2007): 27–46.
- 6 Claude Shannon dhe Warren Weaver, *The Mathematical Theory of Communication* (Urbana: University of Illinois Press, 1971 [1949]). Ia vlen të vihet re se një brenda rreth një viti titulli u ndryshua nga "një teori" në "teoria," që sugjeron rëndësinë e zbulimit të Shenonit.
- 7 Norbert Wiener, *Cybernetics: or the Control and Communication in the Animal and the Machine*, bot. i 2-të (Cambridge MA: MIT Press, 1961 [1948]), 11.
- 8 Gilles Deleuze, *Foucault*, përkth. Sean Hand (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1988 [1986]), 117.
- 9 Po aty, 132.
- 10 Origjinalisht në frëngjisht: *L'Autre Journal* 1 (maj 1990).
- 11 Gilles Deleuze, "Postscript on the Societies of Control," *October* 59 (dhimër 1992): 4.
- 12 Po aty, 6.
- 13 Gilles Deleuze dhe Félix Guattari, *Mille Plateaux: Capitalisme et schizophrénie* (Paris: Minuit, 1980), 100.

# FACULTY IN WITHDRAWAL NOT TO KNOW AND THE UNCERTAINTIES OF SELF- INSTITUTIONALIZATION

Tijana Stevanović

## Introduction

The best “tendency” is wrong if it does not prescribe the attitude with which it ought to be pursued.<sup>1</sup>

These words produced some eighty years ago, still speak to us with the fresh “pedagogical” attitude Benjamin himself deliberately sought to inhabit when writing about the revolutionary intellectual. No matter how finished the objects of production may seem to appear, what seemed more urgent, he argued, has been to uncover the techniques of production’s own potentialities for exposing the organizational complex of fabrication within. If the institutional dimension of constructing subjectivities were acknowledged as a continuing existence of the bourgeois apparatus, it would be possible for the functional distinction between products and producers to ultimately crack open and evaporate. Central to his project on the disappearance of the author through careful dissemination, Benjamin praised Brecht’s *Umfunktionierung* as an idea of transforming actively institutions and instruments of production by radical intellectuals: “It’s not a question of being against the institution: We are the institution.”<sup>2</sup>

Forming any sense of progressiveness starts with recognizing that we are simultaneously the products and producers; institutions are not oppositional to, but part of ourselves. In an age of deep mistrust in public educational systems, we have become confined to the attempts at reforming the way in which we approach education itself by turning away from the institutional environment toward various forms of communal endeavors to overcome these (always to a certain extent) dictated contexts through a constant questioning of their (and our own) institutional tendencies. By means of an analysis of two different practices – which both rejoice in disappearance and the creation of voids, constantly surrounded by catastrophes that are not occupied but rather elaborated – I would like to address the following questions:



What is the invisible in productive pedagogical relations that makes it possible for its constitutional practices to always be singularized, appropriated, presented, and commonly perceived only as productive of a fixed, finished object without acknowledging all the affects and production conditions that support it? What are the singularizing intentions that support the idea of the authorial power, reiterated even in the projects motivated by insurgencies? Can we think of self-institutionalization as a perpetual practice of self-criticality, one which involves the constant questioning of power structures from which it emerges?

### **A Critical Assembly**

The Copenhagen Free University has never wanted to become a fixed identity and as a part of the concept of self-institutionalisation we have always found it important to take power and play with power but also to abolish power. This is why the Copenhagen Free University closed down at the end of 2007.<sup>3</sup>

This text engages with the different practices of Faculty of Invisibility (FOI) and Copenhagen Free University (CFU), in order to question to what extent their self-institutionalization and constant re-composition, may show the operative examples of subversion not as a singled out experience, but rather as the insurgence of a space of crisis and inhabitation that facilitates criticality rather than criticism. FOI and CFU are both composite assemblages of people and activities evading representation. However, they also claim a gesture of withdrawal integral to their permanent processes of their self-institutionalization. The Faculty of Invisibility, established in 2006, is still operational although not embedded in a physical space, whereas Copenhagen Free University officially seized to exist in 2007 after six years of being located at the founders' two apartments in Copenhagen. "We have won!"<sup>4</sup> was their simple, final declaration, where they recall: "a mattress became a residency, the bedroom a cinema, the living room a meeting space, the workroom an archive, our flat became a university."<sup>5</sup> They also claim that

There have been no singular end products; of importance were all the various experiences and conclusions that people carried into their own lives and networks after taking part in the activities at the CFU. This is why we haven't published papers or dissertations to wrap up the research projects that we have worked with. We found that the research and the knowledge spun at the CFU did not need a closure. But the institution did.<sup>6</sup>

This resignation from producing knowledge and the emphasis on sharing is, then, manifested through the CFU's invisibility and the unrepresentability of the relations and networks that were created through sharing experiences. It relies on the communication of the affective sides of knowledge. For communication may happen only, as Jean-Luc Nancy proposes, through experience, not through work or operation.<sup>7</sup> This experiential side is what suggests communication as a way of "unworking" the institutional order. On these grounds, the CFU wanted to enable the communication of myriad desires, "fluctuated passions and affective instabilities" as they emphasize, instead of their sublimation into a singular body.

The Faculty of Invisibility constitutes and assembles itself upon invitations of institutions and individuals. It also invites tutors who are at the same time students of other departments, such as the Department of Haunting, the Department of Reading, the Department of Doubt, the Department of Uncertainty, whereas CFU initially opened their door to whomever was in need of discussing the non-institutionalized knowledge economy. It involved talks, screenings, several hours long real-time TV streaming of non-action, of dwelling inside, cooking, and sleeping in the same apartment. These difficult and sometimes awkward symbolic and real inhabitations and cohabitations are the first step, I believe, to put into force forms of what Irit Rogoff explains as “Deleuzian criticality.”<sup>8</sup> She describes this concept as being always situated within the power structures, and impossibility of completely disentangling from them:

Criticality is then a recognition that we may be fully armed with theoretical knowledge, we may be capable of the most sophisticated modes of analysis but we nevertheless are also living out the very conditions we are trying to analyse and come to terms with. Therefore, criticality, is a state of duality in which one is at one and the same time, both empowered and disempowered, knowing and unknowing. [...] In theoretical terms we have moved from Criticism, to critique to criticality, to the actual inhabitation of a condition in which we are deeply embedded as well as being critically conscious.<sup>9</sup>

Criticality is, she understands, the full acknowledgment of the situatedness in certain system of power; of all the levels above and below, and using the experience of this “uncertain ground of actual embeddedness” in bringing together “that being studied and those doing the studying, in an indelible unity” she continues.<sup>10</sup> This is what I believe should be understood in the two modes of inhabitation here – criticality of departments that do not occupy study rooms but our understanding of relations with/in institutions, of inhabitation itself through living-in-and-with an educational institution. These long-term projects attempt to embody standpoints that are primarily to be assessed by their potentiality of the self-negating power. For instance, FOI embraces the uncertainty of its own framework of working bodies, and takes it as one of its rare solid points upon which it institutionalizes as a practice. This, in turn, allows for the renewal, reworking, and criticality of its production:

Teksa çështja e praktikës ka dalë në plan të parë, duket se alkimia është tanimë një emblemë për studime që kanë synojnë të përmbledhin një grupim të gjërë praktikantësh dhe formash dije natyrore në histori të ndryshme mbi lindjen e “shkencës së re” në periudhën e herët moderne. *Njëherazi e dhënë pas librave, përvojore [experiential], dhe eksperimentale, alikimia i reziston me kokëfortësi çdo përpjekje për t’i ndarë veçmas historitë e shkrimit e këndimit, të krijuarit dhe të vepruarit. Në fakt, ajo kërkon që këto angazhime të ndryshme me natyrën, marrëdhëniet midis tyre, dhe njerëzit e të gjitha shtresave që i krijuan ato, të mbeten në lojë në çdo version të historisë së saj. Në këtë kuptim, alkimia ofron një model për të menduar mbi shkencën moderne të herët, sidomos duke marrë parasysh punën e kohëve të fundit që ka shqyrtuar kryqëzimin e formave shkollare, artizanale dhe sipërmarrëse të dijes.*<sup>19</sup>

Siç tregojnë këto studime mbi alkiminë,<sup>20</sup> sajimi dhe dija sipërmarrëse ishin thellësisht të fiksuara në kulturën artizanale dhe tregëtare të periudhës së Rilindjes dhe i shërbenin vizioneve të ndryshme mbi shoqërinë. Këmbëngulja e tanishme mbi dizajnin dhe sipërmarrjen në fusha të ndryshme rigjallëron këto ndërveprime komplekse midis shkencës, komunitetit, biznesit dhe madje edhe artit dhe argëtimit. “Projekti Universitas” bën thirrje për të lidhur dizajnin dhe shkencën, si dhe për daljen e kulturave bashkëpunuese dhe artizanale të prototipeve në hapësira hakerash, duke mishëruar aspirata paramoderne dhe duke rigjallëruar aftësinë e shkencës për të prodhuar konvergjenca krijuese dhe imagjinuese. Sajimi dhe hapja si e shoqërisë ashtu edhe e shkencës ndaj pikëpamje-

ve më pluraliste mbi të ardhmen do të thotë eksperimentim dhe bashkëpunim. Ndërveprimet unike dhe konvergencat midis praktikës shkencore dhe krijimit komunitar që mbështeten tek një rigjallërim i sajimit ofrojnë një model më elastik, më demokratik por gjithashtu më eksperimental për të vepruar dhe marrë vendime. Këto kolektiva eksperimentale që testojnë lidhje të ndryshme me teknologjitë më të reja shqyrtojnë lidhjen midis policave dhe dizajnit të përfytyruar më herët tek koncepti i kozmopolitikës.<sup>21</sup> Në vend të ndarjes së pushteteve dhe domeneve të dijes dhe veprimit, policave dhe kërkimit, etikës dhe shkencës, format publike të pjesëmarrjes tek shkencat, si *DIY-bio*, ose kultura alternative R&D e hapësirave hakerash, na frymëzojnë të rishikojmë funksionin e ndarjeve të ngjashme në jetët tona politike, sociale dhe shkencore.

### Prototipe artizanale dhe filozofike për shkatërrimin

“Pedagogjia e shkatërrimit” janë tamam si përpjekjet e “Projektit Universitas” për të rishikuar universitetin modern dhe ndarjen e tij të disiplinave për t’i bërë ato më të rëndësishme, por edhe reflektuese, kritike dhe paraprake për shoqërinë. Në këtë kuptim, ne nuk e humbëm kurrë vazhdimësinë me të kaluarën dhe thjesht po perifrazojmë një dikotomi të vjetër midis *epistēmë-s* dhe *technë-s*, reflektimit dhe veprimit, arsyes teorike dhe asaj praktike. Në vend që të kërkojmë dhe të pretendojmë autonominë e shkencave apo të humaniteteve, mund të përiqeshim të kujtoheshim për këto gjenealogji komplekse që na çojnë pas në kohë tek çështja e tinkering dhe e arteve mekanike dhe ndoshta edhe më herët. Përpara se Akademia Mbretërore e Arteve të bëhej një model për të gjithë ndërveprimet e ardhshme midis shkencës dhe shoqërisë, dhe përpara se të lidhej me universitetin, artet mekanike dhe filozofia natyrore po eksperimentonin me forma të ndryshme për të lidhur shkencën që po shfaqej me atë që quhej “oborri” (politika, shoqëria). Gjenealogjia e këtyre ndërveprimeve plurale midis shkencës, universitetit dhe shoqërisë na ofron një perspektivë të çmuar mbi situatën e tanishme si një shans në vend që të pranojmë fundin e vlerave ontologjike, sociale dhe etike dhe të aspiratave për hir të treguesve të performancës. Këto ndërveprime paramoderne na ndihmojnë t’i kuptojmë hapësirat e hakerve e sotëm dhe kulturën e tyre të prototipeve si orvatje për të krijuar komunitete më elastike që ballafaqohen me kriza të ndryshme (si rrezatimi atomik, siguri ushqimore, mbikëqyrje, etj.). Unë përdor prototipe dhe modele të tilla në punën time si mësuese dhe sajuese, pasi ato mbështesin angazhimin aktiv me teknologjitë si një formë *elenchos*-i kundër pranimit pasiv të konsumerizmit. Këto prototipe janë artizanale, ato mbartin gjithmonë një histori unike të individit apo grupit që i krijoi dhe i ofroi ato si një veglëri [*kit*] që të tjerë të mund të përfshiheshin dhe të kontribonin. I quaj filozofike pasi ato e bëjnë të mundur për këdo të dëshmojë dhe të përjetojë prodhimin e dijes përqark këtyre mjeteve dhe të reflektojnë mbi to.

Shembulli që vërteton këtë “pedagogji” mund të ishte “NeuroNetworking Workshop” në Pragë në prill 2012,<sup>22</sup> që i përdori prototipet si forma *elenchos*-i teknologjik që përfshinin “të huaj” në një diskutim dhe dizajn që reflektonin mbi çështje neuroetike. Ky workshop dyditor bashkoi studentë dhe akademikë të interesuar në çështje të Komunikimit të Shkencës, Policave, Dizajnit, por edhe të Shkencës, Teknologjisë, dhe Shoqërisë (Charles University, National Singapore University), anëtarë të Hapësirës së hakerve në Pragë (Brmlab.cz) të përfshirë në ndërtimin e neuromodulatorëve që prekin funksionet cognitive, si dhe artistë dizajnera nga CIANT, Prague (Center for Art

and New Technologies), që punojnë me të dhëna të trurit. Puna u konsultua gjithashtu me neuroshkencëtarë, ekspertë policash dhe të industrisë nga MB, SHBA, dhe Singapori, dhe u dokumentua pjesërisht në formën e një wiki, që po mbeshtet projektet në vazhdim. Së bashku ne krijuam një sajim dizajni mbi neuromodulatorët, “Citizen Oxygen Monitoring Agency (COMA),” që restauroi biopolitikën e Fukosë [Foucault], por edhe një propozim për një treg për të dhënat e trurit si dhe një veglëri DIY për të ndarë të dhëna EEG/EMG/ECG (MindSpy.org). Prototipet ishin konkretë (modele dhe neuromodulatore ekzistues), por gjithashtu konceptualë (sajim dizajni), dhe reflektimet tona dhe eksperiencat jonë me to ndodhën paralelisht, dhe një pjesë e kërkimit vazhdon të zhvillohet në Pragë dhe Singapor.

### Përfundim

Agamben i përshkroi paradigmat si një qëndrim në vend të një metodologjie, që bashkon reflektimin dhe praktikën në një qark hermeneutik ose një “formë jete” (*forma vitae*). Ato frymëzojnë kushdo që i performon, rishikon, teston, dhe në një mënyrë të ngjashme njerëzit gjithashtu ndërtojnë dhe testojnë veglëri prototipesh. Të fitosh një depërtim ose eksperiencë me ndërtimin e një vegle është më shumë se të pranosh diçka si një përfaqësim të caktuar, që duhet thjesht të përsëritet, ose të blesh një produkt dhe ta përdorësh atë vetëm sipas instruksioneve të manualit. Të ndërtosh një mjet nga një veglëri ose duke përdorur një paradigme është një performancë që thekson vetëqenësorinë e saj në vend të përkryeshmërisë së saj duke të bërë gjithashtu pjesë të një komuniteti:

*Të paktën deri tek Shën Benedikti, rregulli nuk përfaqëson një normë të përgjithshme por komunitetin e gjallë (koinos, bios, cenobio) që rezulton prej një shembulli dhe ku jeta e çdo murgu ka tendencën që në caqet e saj të bëhet paradigmatiske – domethënë, të përbëjë një forma vitae [...] paradigmi nënkupton një lëvizje që shkon nga vetëqenësoria tek vetëqenësoria dhe, pa e lënë kurrë vetëqenësorinë, transformon çdo rast vetëqenësor në një ekzemplar të një rregulle të përgjithshme që nuk mund të shtrohet kurrë apriori.<sup>23</sup>*

Prototipet, siç i kam kuptuar dhe ndjekur rreth e qark botës që në 2010-n, formojnë komunitete të tilla të gjalla dhe globale rreth hapësirave hakerash dhe nëpërmjet përdorimeve të ndryshme të wikis dhe mediave të tjera sociale. Ato janë vegla mësimi dhe kërkimi, që i shërbejnë si synimeve dhe nevojave individuale si atyre kolektive. Ato janë si shqyrtime të të ardhmeve të mundshme, mbi të cilat ne duhet të negociojmë dhe të vendosim duke sajuar aktivisht dhe duke ndjekur prodhimin e tyre. Ato nuk janë thjesht vegla që dizajnerët përdorin për të mbledhur kërkesat e përdoruesit, testuar ide për produkte të ardhshme apo përmirësuar veglat ekzistuese, por edhe vegla për të imagjinuar, negociuar dhe fuqizuar. Për më tepër, ato përdoren jo vetëm nga dizajnerët dhe inxhinierët, por edhe nga *geeks*, amatorë të shkencës, ëndërrimtarë dhe sajuesit për qark botës. Ato mund të thyejnë idhuj si “çekiçi” i Niçes [Nietzsche], por gjithashtu mund të rivendosin një ndjenjë raporti me botën e objekteve të bëra nga njeriu si kana e Hajdegerit [Heidegger]. Ato shpesh shprehin dhe “bëjnë” atë që filozofët janë përpjekur të arrijnë nëpërmjet objekteve të tjera “metaforike” në shkrimet e tyre. Ato mund











të jenë si dardha e Maos, të cilën na duhet ta provojmë e ta hamë për të ndryshuar botën dhe për të kuptuar se si mendimi dhe veprimi ynë formojnë historinë:

Njeriu nuk mund të njohë ansjë fenomen pa rënë në kontakt me të, domethënë në qoftë se jeta e tij (praktika) nuk zhvillohet në kushtet e këtij fenomeni. [...] *Në qoftë se don të fitosh dituri, merr pjesë në praktikën që ndryshon realitetin. Në qoftë se don të dish shijen e dardhës, duhet ta ndryshosh atë – ta përtpypësh.* [...] Në qoftë se don të njohësh teorinë dhe metodat e revolucionit, huhet të marrësh pjesë në revolucion. Të gjitha dijet e vërteta burojnë nga eksperiencia e drejtpërdrejtë.<sup>24</sup>

Ato janë gjithashtu si “barkat” e Sent-Eksyperisë [*Saint-Exupéry*] që na bëjnë të mallohem për “pamatësinë e pafund të detit,” të ëndërrojmë dhe të krijojmë vizione për një të ardhme, që ndoshta nuk është e arritshme në të tashmen por që na frymëzon të marrim sfida të mëdha: “Nëse do të ndërtoosh një anije, mos i dërgo njerëzit të mbledhin dru e mos iu cakto detyra e punë por mësoju të mallohen për pamatësinë e pafund të detit.” Kjo është arsyeja pse reagimi ynë ndaj krizave dhe një propozim për “pedagogjinë” është të ndërtojme prototipe, veçmas dhe së bashku, dhe të angazhohemi me të gjitha format ekzistuese të materialitetit dhe kontekstet e tyre komplekse ligjore, ekonomike dhe sociale. Ha dardhat e Maos, pi me kanën e Hajdegerit, shkërmoq idhuj me çekiçin e Niçes dhe lundro me barkat e Sent-Eksyperisë, por mos u mjafto thjesht me leximin mbi to!

## Shënime

- 1 Emilio Ambasz dhe N.Y. York. *The Universitas Project: Solutions for a Post-Technological Society* (Nju-Jork: The Museum of Modern Art, 2006), 299. Theksimi im.
- 2 Sh. Lloyd L. Weinreb, *Natural Law and Justice* (Cambridge: Harvard University Press, 1987).
- 3 Ambasz dhe York, *The Universitas Project*, 31. Theksimi im.
- 4 Sh. Jean-François Lyotard, *The Postmodern Condition: A Report on Knowledge* (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1984).
- 5 Kevin Poulsen, "MIT Moves to Intervene in Release of Aaron Swartz's Secret Service File," *Wired* (18 korrik 2013): <http://www.wired.com/threatlevel/2013/07/mit-swartz-intervene> (Parë 20 korrik 2013).
- 6 United States Holocaust Memorial Museum, "Martin Niemöller: First they came for the Socialists...": <http://www.ushmm.org/wlc/en/article.php?ModuleId=10007392> (Parë 20 korrik 2013).
- 7 Jacques Rancière, *The Ignorant Schoolmaster: Five Lessons in Intellectual Emancipation* (Stanford: Stanford University Press, 1991), 64–5. Theksimi im.
- 8 Giorgio Agamben, *The Signature of All Things: On Method*, përkth. Kevin Attell (Nju-Jork: Zone Books, 2009), 11–12. Theksimi im.
- 9 Giorgio Agamben, "What is a Paradigm" (2002): <http://www.egs.edu/faculty/giorgio-agamben/articles/what-is-a-paradigm/> (Parë July 22, 2013). Theksimi im.
- 10 Agamben, *The Signature of Things*, 32. Theksimi im.
- 11 Sh. Lisa Jardine, *Francis Bacon: Discovery and the Art of Discourse* (Londër: Cambridge University Press, 1974); Glen R. Driscoll, Paolo Rossi dhe Sacha Rabino-vitch, "Francis Bacon: From Magic To Science." *The American Historical Review* 74.3 (1969): 979.
- 12 Sh. Antonio Pérez-Ramos, "Francis Bacon And The Disputations Of The Learned." *The British Journal for the Philosophy of Science* 42.4 (1991): 577–88.
- 13 Sh. Larry Stewart, Robert K. Faulkner dhe John E. Leary. "Francis Bacon And The Project Of Progress," *The American Historical Review* 100.4 (1995): 1245.
- 14 Sh. Tara Nummedal, "Words and Works in the History of Alchemy." *Isis*, 102.2 (2011): 330–7; William Royall Newman, *Promethean Ambitions: Alchemy and the Quest to Perfect Nature* (Çikago: University of Chicago Press, 2004).
- 15 Sh. Pérez-Ramos, "Francis Bacon."
- 16 Po aty.
- 17 Sh. Pamela H. Smith, *The Business of Alchemy: Science and Culture in the Holy Roman Empire* (Princeton: Princeton University Press, 1994).
- 18 Sh. Newman, *Promethean Ambitions*.
- 19 Nummedal, "Words and Works in the History of Alchemy," 331.
- 20 Sh. Nummedal, "Words and Works in the History of Alchemy"; Newman, *Promethean Ambitions*.
- 21 Sh. Bruno Latour, *Politics of Nature: How to Bring the Sciences into Democracy* (Cambridge MA: Harvard University Press, 2004).
- 22 "NeuroNetworking – Hackteria. Design for NeuroNetworking: How to Interact over Brain Data?" (Pragë, 27–30 prill 2012): <http://hackteria.org/wiki/index.php/NeuroNetworking> (Parë 22 korrik 2013).
- 23 Agamben, *The Signature of Things*, 21–2. Theksimi im.
- 24 Mao Ce-Dun, "Në Lidhje me praktikën," në *Vepra të zgjedhura*, Vëll. 1 (Instituti i Historisë së Partisë, 1963), 359–60. Theksimi im.



# THE NECESSITY OF EDUCATION HOW CAN ONE STILL BE AN ALTHUSSERIAN IN THE WAKE OF BADIOU?

Sina Badiei

In his essay, “Ideology and the Ideological State Apparatus,”<sup>1</sup> Althusser proclaims the educational apparatus to have become what the church or religious apparatus was in the Middle Ages. That is to say, the educational apparatuses are the ones where people are more effectively than anywhere else subjected to becoming subjects, in the negative sense of this term used in Althusser.

The main reason he cites for this choice is that “no other ideological state apparatus has the obligatory (and not least, free) audience of the totality of the children in the capitalist social formation, eight hours a day for five or six days out of seven.”<sup>2</sup> Yet if we were to accept what Althusser tells us, we can’t, overlook another phenomenon which has been emerging in our epoch; I am here referring to an article in one of the issues of *The Economist* magazine where concerned parents were advised not to send their children to schools at all and to have them study only and only computer programming from the earliest years if they wanted them to become successful in IT professions. What can we make of this paradox?

Putting aside many easy ways to resolve this, it seems to me that the best approach might be to read Althusser against himself. According to Althusser, ideology is not a domain which ought to be overcome in order for us to become capable to see the underlying reality. It is through and by means of these ideologies that reality is accessible to us, *ipso facto* a reality without ideology is not imaginable. This leads Althusser to posit that

historical materialism cannot conceive that even a communist society could ever do without ideology. [...] So ideology is not an aberration or a contingent excrescence of History, it is a structure essential to the historical life of societies.<sup>3</sup>

Does *The Economist* magazine’s call to parents to abstain from sending their children to school mean that another ideological state apparatus (ISA) has taken the leading role?



Or does it mean that, to be even more of a typical analytic theoretician, there has never been, neither in Althusser's time nor in the present conjuncture, a dominant ISA and that many ISAs work hand in hand to impose a certain ideological vision?

It might be more judicious that from this contradiction, of an order manifestly undermining its most dominant ideological inculcator, without seemingly having one in stock to replace it, we draw more radical conclusions. The most sweeping of these is to posit the insufficiency of Althusser's understanding of ideology. Althusser achieves a lot by relinquishing the simple Marxist vision according to which we ought to get behind ideology to see the true reality. He moves on the right track by admitting the necessity of the so-called Symbolic and Imaginary as much as the Real. Yet what remains problematic is his way of apprehending the relation between the three. That is to say, what Althusser is missing is Lacan's attitude, who posits the Real no longer as a positive existing reality, but only as the limit of the Imaginary and the Symbolic. In other words, it is not enough to posit that the Symbolic/Imaginary axis is as indispensable as the Real, that the Real is only conceivable through the intermediacy of ideology. If there be a positive Real out there, the quest at reaching it first hand and with no intermediary can never be expected to be so convinced as to give itself up. It is only through Lacan's manner of perceiving the Real as only the limit of the Symbolic that one fully appreciates the necessity of ideology. Put differently, it is only through Lacan that we sufficiently grasp that by losing the Symbolic, we end up losing the Real itself.

In Althusser, in spite of the presence of similar currents and tendencies, by continuing to hypothesize the Real of the forces of production, one gets stuck in the ideological dream of overcoming ideology. But if this is how things are, and if we try not to abandon Althusser's contribution on this point, how should we think of him?

I think that if the so-called forces of production and their corresponding relations are not the Real, they are themselves parts of the Symbolic structure of any society. In this light, the immanent laws of capital, if not expressive of the Real of a certain historical epoch, at least represent the dominant ideology at work. And here we would be getting into the realm of religiosity. This idea is by no means a novelty on my behalf. There are clear allusions to it in Benjamin's short essay "Capitalism as Religion," and in Simmel's *Philosophy of Money*, and indeed other places. But It exists more than anywhere else in Marx himself, for example in his reference to the existence of an asceticism in capitalism which transcends even those of Abrahamic religions:

Accumulate, accumulate! This is Moses and the prophets! [...] Therefore save, save, i.e. reconvert the greatest possible portion of surplus value or surplus product into capital! Accumulation for the sake of accumulation, production for the sake of production: this was the formula in which classical economics expressed the historical mission of the bourgeoisie in the period of its domination [...] If, in the eyes of classical economics, the proletariat is merely a machine for the production of surplus value, the capitalist too is merely a machine for the transformations of his surplus value into surplus capital.<sup>4</sup>

Notwithstanding that there is indeed no class outside ideology, it is not the case that all classes are subject to the same ideology. Let me then add that if the lower classes are

entitled to be worked on by a certain ideology, it is not at all true that the ruling classes are subjected to the same exact ideology, not even in the sense of occupying the dominant positions within that ideology. Still, in spite of this non-unity, there is conjunction between these various ideologies, so a sort of totality within this non-homogeneity. Maybe if we read Althusser accurately, we may find in him an attempt to theorize what would be the science of the Symbolic, that is, that which makes the relations between these different ideologies, and their interaction with other social variables, thinkable.

Accordingly, we should stop taking Althusser at his words, so as not to commit the mistakes for which Badiou rightfully takes Althusser to task, such as having attributed to Marx the founding of the science of History, thus ascribing to History a totality which it certainly does not have. However, by thinking effectively Althusser's endeavor, in the light of more recent theoretical interventions,<sup>5</sup> what we may discern is an understanding of history not as the Real but as the Symbolic. In other words, Althusser is not giving us a theory of being, but a theory of appearance, and this does not deviate significantly from Badiou's own strives in *Logics of Worlds*.

Nonetheless, this point cannot be fully supported without first interrogating the way in which any analysis of a Symbolic order is intertwined with the Real as that which lays bare the falsity of the Symbolic order's pretensions to totality. Badiou formulates our problematics very accurately:

If, as Lacan says, the Real is the impasse of formalization, as we saw when we ran up against the limit as return, we must venture from this point that formalization is the im-passe of the Real.<sup>6</sup>

Elsewhere he explicates this point in more penetrating fashion by exposing his predilection for dialectics:

What are the heresies of materialism? The mechanistic one isolates the metaphor of the reflection. It imagines adequation without remainder. It sticks to repetition. The dynamicist one does the same with the asymptote. Universalizing the doctrine of the remainder, it poses that all is flux, tendency, approximation. For this heresy, every unified configuration is an illusion, or even a "totalitarian" threat.<sup>7</sup>

The problem that we are facing then is one of the determinant aspects of a Symbolic structure versus the Real of a revolution that undermines the structure's reductive supremacy, that which renders inoperative its tendency to swallow its elements' potentiality in toto.

Whereas in Lacan and Badiou it is the act that should be given primacy, I think that in Althusser, following Lenin, one tends to state the non-primacy of the two processes: the attempt, on the one hand, whether scientific or not, to grasp the complex system of causality at work in any Symbolic One; the one-sided insistence, on the other hand, on subjectivity as that which, beyond any possibility of knowledge vis-à-vis the present conjuncture, throws its whole support and capacity behind the event that has revealed the impotence of the structure's totalizing forces, thus participating in the possible unfolding of a new order. Althusser could recognize this point, that is, the significance

of positing the non-primacy of any of these two processes, due to his familiarity with the dilemma in which Lenin had found himself: he had faced, on the one hand, the mechanistic conventionality of the Second International, according to which the Russian revolution was not communist because it did not conform to the so-called laws of historical development supposedly propounded in *Capital*; on the other hand, he had encountered different left wing communists, who in extreme cases, like Gramsci's, considered the same revolution to have taken place against *Capital*, the book, that the revolution had everything to do with the voluntary and conscious action of men, of the masses, and not a book with its scientific pretensions. Lenin's position, according to Althusser, was that "Marxist theory is produced by a specific theoretical practice, outside the proletariat, and that Marxism must be 'imported' into the proletariat."<sup>8</sup>

Here, indeed, "imported" carries an external overtone, in the sense of having to occupy a place during the revolutionary period without having necessarily emerged from within this period itself. Yet, like Lenin, Althusser announces the radical autonomy of the epistemological labor, thus declaring flawed any attempt in reducing scientific knowledge to one of adequation.

Let us briefly analyze one of the more recent embodiments of this sort of theory. I am alluding to the Nyquist–Shannon sampling theorem in signal processing, arguably the cornerstone of today's digitalization. This theory intends to give us the means to determine the minimum number of samples, necessary to be taken from any given signal, in order for us to then be able to reconstruct it exactly as it was. Thus at the heart of this theory lies the idea that there exists a fundamental redundancy in the real world.

The empirical idea of knowledge operates along the same lines, which is why empiricism is deeply embedded within the tradition of skepticism. This is because empiricism is not only always critical of theory for being abstract; it is equally critical of reality for having a lot of superfluity. Seen in this light, even empiricism's critique of theory as abstract can be interpreted as having to do with its apprehension of reality as being indefinite. For empiricism then, there exists an essential inconsistency in the real world, on the one hand it has so much redundancy, on the other it is also indefinite. Hence empiricism moves within a vicious circle, which is not even a profound one, for it is its very idea of the redundancy of the real world that makes the mirror theory of knowledge feasible in the first place. But then again, because of the second feature of the real world, its indefiniteness, this very possibility, too, should be repudiated as insufficient, hence the position of skepticism.

Thought of in this manner, Althusser's repudiation of the idea that the ideal of any theory of knowledge is one of perfect adequation, and that precisely because of this ideal any theory is always abstract, is not only a defense of theory and its autonomy, but it equally defends reality from the way that empiricism apprehends it as redundant. This is why for Althusser we have two totally separate realms, theory and reality, with no simple way of linking them together.

This observation can be appreciated even better if we try to trace Althusser's intellectual lineage. If we did, we would find a lot of influence exerted on him by Feuerbach. This might seem strange as we tend to think of Feuerbach as one of the central figures of humanism and of Althusser as a hardcore anti-humanist. However, a close reading

of Feuerbach's *The Essence of Christianity* reveals that in Feuerbach, too, we have the concomitant presence of many, even conflicting, patterns.

According to Feuerbach, perhaps the best place to inquire about the essence of Christianity is through its idea that God has created the world out of nothing. For Feuerbach, this is not even intended as a cosmological or scientific statement, on the contrary, it expresses the value of the world for the Christian consciousness. So if the world was created, by pure force of will and imagination, out of nothing, this means that the world, in its present composition, still carries this value of nothingness.

Creation out of nothing is the highest expression of omnipotence: but omnipotence is nothing else than subjectivity exempting itself from all objective conditions and limitations [ ... ] nothing else than the ability to posit everything real as unreal – everything conceivable as possible: nothing else than the power of the imagination, or of the will as identical with the imagination.<sup>9</sup>

Put differently, if the world was created out of nothing by the pure force of will, it can also go back to nothing by the same pure force. And this is what we find at work in many other Christian doctrines and dogmas. So, for example, the conversion of water to wine is not really a conversion but the creation of the wine out of nothing. Nowhere can this be better comprehended than in the typical retort of religious people against atheists, that they have not yet, in their life, found themselves confronted with the misfortunes of the causal system at work in the world. So only a drowning person who does not know how to swim would want by all means that the system of causality at work, according to which the drowning person should die, be abolished, i.e. reduced to nothing.

The Christian, the religious Providence, is quite another than that which clothes the lilies and feeds the ravens. The natural Providence lets a man sink in the water, if he has not learnt to swim; but the Christian, the religious Providence, leads him with the bond of omnipotence over the water unharmed.<sup>10</sup>

The essence of religion is thus to posit the absolute value of subjective will and imagination, and the nothingness of the objective causal system over against which the subject finds himself. So to be an atheist, one should loudly proclaim the non-nothingness of the structural causal system at work in the symbolic domain:

[T]he much-belied doctrine of the heathen philosophers concerning the eternity of matter, or the world, thus implies nothing more than that Nature was to them a theoretic reality.<sup>11</sup>

Althusser's defense of the theoretical stance towards the object as opposed to the subjective reduction of its significance to nothing moves along much the same lines. Besides, just as Feuerbach tells us that "the nothing out of which the world was produced, is a still inherent nothingness,"<sup>12</sup> Althusser, too, informs us that various historical ac-

counts about the origin of the world are nothing but the retroactive reconstitution of that history according to the present understanding of it.

Instead of the ideological myth of a philosophy of origins and its organic concepts, Marxism establishes in principle the recognition of the givenness of the complex structure of any concrete "object," a structure which governs both the development of the object and the development of the theoretical practice which produces the knowledge of it. There is no longer any original essence, only an ever-pre-giveness, however far knowledge delves into its past.<sup>13</sup>

If we concur that the most impressive characteristic of modern science is its embracing of non-linear complex causality instead of the classical linear, simple causality, then Althusser's theory of knowledge conforms to this modern vision. But then precisely because the causal order is of a non-linear nature, there exists no easy way of explicating in what sense its analysis can be of use for the day-to-day life of people, and by analogy, how the knowledge of the Symbolic order can serve the interests of the revolutionaries. Still, despite not just being a Marxist but equally a Communist, Althusser could not theorize or at least sufficiently address the necessary link that should be "forged" between the two orders. He simply tells us, following Lenin, that the link ought to be "fabricated" "somehow."

I am thus inclined to think that one way to redeem Althusser today is by adding to his theory of knowledge a dose of Lacan's logic of the feminine, that of non-all. Seen in this way, Althusser's true shortcoming may have been his failure to rhetorically posit the independence of reality. He should have been more careful to emphasize the independence of reality in its disjunction from the theoretical work. And this is strange coming from someone who otherwise postulates the eternal pertinence of ideology.

Having said this, let us not forget Althusser's great dialectical breakthrough, which is his positing of heterogeneity as that which is primary and unity as that which comes in the second place. It is only when unity loses its primordial status that one really abandons historicism. And thus the true dialectical inversion of the religious story of the Fall does not take place when one postulates the primacy of action over theory, of the dynamism of reality over the reductive tendencies of thought. On the contrary, we move beyond the suffocating grip of unity when we opt for a different order of preference between unity and difference. Instead of unity being primary and heterogeneity secondary, a true dialectical insight, by positing the secondary, thus emerging, nature of unity does away with any premature propensity for unity, which claims unity to have been interrupted and pleads for a quick restoration of it. The emerging unity, if it is not then of a reductive order, and if it is not a necessary return, à la classical interpretations of Hegel, viz. an unfolded individuated return, to an already existing prior unity, cannot be but a work in progress and as such it is not the positive outcome that is of interest. What can this be then but the co-constructive aspect of the unity, a co-construction?

Instead of *Mitsein* this unity is then *Mitarbeit*, because the simple fact of being together is nothing beyond positing the anteriority of heterogeneity. Heidegger was at least consistent in propounding this state as one of a return to an order which had existed, for being-together is for him both the primary state and the future state to come,

the two separated by a reductive “forgetful” unity. Yet as Marxists we do not support any such return, for the fundamental case for having rejected the originality of unity was the renunciation of anything that would push us out of the dialectical process, even if it is in the guise of a return to a fully heterogeneous past which might have been. In the words of Badiou:

Missing from this argument are the thoughts of an effective destruction of the old law and the observation that what recomposes itself can no longer in anyway be the same. In this way, the real of the subject guarantees consistency without the mediation of the imaginary. Even the impasse of the political subject does not restore the old rule. That is what the Marxist debate is all about. In the USSR, we have neither an “interrupted” revolution, nor I don’t know what totalitarian rendition of the bourgeois world, under the repetitive concept of the modern state. We have a new bourgeoisie.<sup>14</sup>

With that in mind, then maybe what we need is not so much a deconstruction of educational pretensions, or exposing the ignorance of the school master, or merely laying bare the metaphysics of the unity, but instead an education which is more and more a co-education, for indeed we all need to be disciplined. And not disciplined according to I don’t know whose imaginary idea, but according to the Real of the common work in progress of the organization of education.

## Notes

- 1 Louis Althusser, *Lenin & Philosophy & Other Essays*, trans. Ben Brewster (Monthly Review Press, 1971), 152.
- 2 *Ibid.*, 156.
- 3 Louis Althusser, *For Marx*, trans. Ben Brewster (London: Verso, 2005), 232.
- 4 Karl Marx, *Capital*, Vol. 1, trans. Ben Fowkes (Penguin Classics, 1990), 742.
- 5 Among others, I would like to emphasize the works of Lacan, Badiou, Balibar and Žižek.
- 6 Alain Badiou, *Theory of the Subject*, trans. Bruno Bosteels (London: Continuum, 2009), 23.
- 7 *Ibid.*, 206.
- 8 Louis Althusser & Étienne Balibar, *Reading Capital*, trans. Ben Brewster (London: Verso, 2009), 156.
- 9 Ludwig Feuerbach, *The Essence of Christianity*, trans. George Eliot (New York: Dover, 2008), 85.
- 10 *Ibid.*, 87.
- 11 *Ibid.*, 97.
- 12 *Ibid.*, 92.
- 13 Althusser, *For Marx*, 199.
- 14 Badiou, *Theory of the Subject*, 246.

# NEVOJA PËR ARSIM SI MUND TË VAZHDOJMË TË JEMI ALTYSERIANË PAS BADIUSË?

Sina Badiji

Në sprovën e titulluar “Ideologjia dhe aparatet ideologjike shtetërore”<sup>1</sup> Altysyer deklaroi se aparati arsimor ka zënë vendin që kisha ose aparati fetar kishte në Mesjetë. Kjo do të thotë se aparatet arsimore janë ato ku më shumë se kudo tjetër njerëzit i nënshtrihen bërjes subjekt, në kuptimin e keq të kësaj fjale në përdorimin i saj prej Altysyerit.

Altysyer e justifikon këtë me faktin se “asnjë aparat ideologjik shtetëror nuk ka si publik në formimin shoqëror kapitalist tërësinë e fëmijëve për nga tetë orë në ditë dhe pesë ose gjashtë ditë në javë, një publik që është njëkohësisht i detyruar dhe falas.”<sup>2</sup> Po ta merrnim për të mirëqenë atë që thotë Altysyer atëherë do të duhej të merrnim në konsideratë edhe një fenomen që ka filluar të shfaqet në kohët tona; po i referohem një artikulli të publikuar në një numër të revistës *The Economist* ku prinderit e shqetësuar për këtë çështje këshilloheshin të mos i dërgonin fare në shkollë fëmijët e tyre dhe t’i bënin ata të studjonin vetëm programin kompjuteri sa më herët në mënyrë që me kohë ata të bëheshin profesionistë informatike të suksesshëm. Si mund ta trajtojmë një paradoks të tillë?

Duke vënë mënjane mënyrat e thjeshta për të zgjidhur këtë paradoks, mendoj se qasja më e mirë do të ishte të lexonim Altysyerin kundër vetvetes. Sipas Altysyerit ideologjia nuk është diçka që duhet kapërcyer në mënyrë që ne të bëhemi të aftë për të parë realitetin. Përkundrazi, realiteti është i kapshëm vetëm nëpërmjet këtyre ideologjive, *ipso facto* nuk mund të imagjinohet një realitet pa ideologji. Kjo e bën Altysyerin të propozojë se:

Materializmi historik nuk mund të konceptoj as edhe një shoqëri komuniste pa ideologji. [...] Pra ideologjia nuk është një anomali apo një rritje rastësore e Historisë por një strukturë thelbësore e jetës shoqërore të çdo shoqërie.<sup>3</sup>

A është thirrja që revista *The Economist* iu bën prindërve të mos i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë një shenjë se një tjetër aparat ideologjik shtetëror (AIS) ka marrë rolin



kryesor? Apo është ajo një shenjë se, për t'u treguar teoricien analitik akoma më tipik, nuk ka pasur kurrë, as në kohën e Altysorit dhe as në konjunkturën e tanishme, një AIS mbizotëruese dhe se shumë AIS punojnë krah për krah për të imponuar një vizion ideologjik të caktuar?

Do të ishte më mirë sikur nga kjo kontradiktë, e një rendi që haptazi minon indoktrinuesin e tij kryesor, në pamje të parë pa pasur një zëvendësues të menjëhershëm për të, të nxirrnim përfundime më radikale. Më gjithëpërfshirësja prej tyre do të ishte ajo se konceptimi i ideologjisë prej Altysorit nuk është i plotë. Altysor bën përparime të mëdha kur heq dorë nga vizioni i thjesht marksist sipas të cilit për të arritur tek e vërteta duhet të kapërcejmë ideologjinë. Ai është në rrugën e duhur kur pohon rëndësinë e të ashtuquajturës Simbolikes dhe Imagjinare po aq sa atë të Reales. Ajo që mbetet problematike është mënyra se si ai e koncepton marrëdhënien midis këtyre të trejave. Domethënë, ajo që i mungon Altysorit është qëndrimi i Lakanit [*Lacan*], për të cilin Realja nuk përbën më një realitet ekzistues pozitiv por cakun e Imagjinare dhe të Simbolikes. E thënë ndryshe, nuk mjafton të presupozojmë se aksi Simbolik/Imagjinare është po aq i rëndësishëm sa Realja, se realiteti nuk mund të konceptohet veçse përmes ndërmjetësimit të ideologjisë. Nëse ekziston një realitet pozitiv ne nuk mund të presim që kërkimi për ta arritur atë në mënyrë të drejtpërdrejtë e të menjëhershme dhe jo nëpërmjet ideologjisë të dorëzohet lehtë. Vetëm nëse e perceptojmë Realen si Lakan, domethënë si cakun e Simbolikes, do të arrijmë të kuptojmë domosdoshmërinë e ideologjisë. E thënë ndryshe, vetëm nëpërmjet Lakanit arrijmë të rrokim se kur humbasim simboliken humbasim edhe Realen.

Ndonëse tendenca të ngjashme i gjejmë edhe tek Altysori, nëse vazhdojmë të hipotezojmë se forcat e prodhimit janë Realja rrezikojmë të mbetemi të burgosur brenda ëndrrës tërësisht ideologjike të kapërcimit të ideologjisë. Nëse puna qëndron vërtetë kështu, dhe nëse duam të përpiqemi të mos e braktisim kontributin e Altysorit mbi këtë pike, si duhet të mendojmë për të?

Mendoj se nëse të ashuquajturat forca prodhimi dhe marrëdhëniet përkatëse mes tyre nuk janë Realja, ato janë pjesë e strukturës simbolike të çdo shoqërie. Nga ky këndvështrim ligjet imanente të kapitalit, ndonëse nuk përfaqësojnë më Realen e një epoke të caktuar historike, përfaqësojnë së paku ideologjinë mbizotëruese të kësaj epoke. Na bie pra të futemi në botën e fesë. Kjo nuk është një ide origjinale e imja. Benjamin i referohet po kësaj ideje tek sprova e tij e shkurtër "Kapitalizmi si fe," Simmel gjithashtu tek *Filozofia e parasë*, për të mos përmendur të tjerë. Këtë ide e ndeshim më shumë se kudo tjetër në veprën e vetë Marksit, si për shembull në momentin ku ai përmend ekzistencën e një lloji asketizmi në Kapitalizëm i cili tejkalon atë të feve abrahamike:

Grumbulloni! Grumbulloni! Ne jemi Mojsiu dhe Profetët! Pra kurseni, kurseni, d.m.th., rikëmbeni pjesën me të madhe të mundshme të vlerës së shtuar ose të mallit të shtuar në kapital! Grumbullim për hir të grumbullimit, prodhim për hir të prodhimit: kjo ishte formula me të cilën ekonomia klasike shprehu misionin historik të borgjezisë gjatë periudhës së saj të sundimit [ ... ] Nëse, në sytë e ekonomisë klasike, proletariati është vetëm një makinë për prodhimin e vlerës së

shtuar, kapitalisti është gjithashtu vetëm një makinë për transformimin e vlerës së shtuar në kapital.<sup>4</sup>

Ndonëse është e vërtetë se asnjë klasë nuk i shpëton dot ideologjisë, nuk është e vërtetë që të gjitha klasat i nënshtrohen të njëjtës ideologji. Më lejoni pra të shtoj se nëse klasat e ulëta meritojnë nga një ideologji e caktuar, nuk është e thënë që klasat mbizotëruese t'i nënshtrohen të njëjtës ideologji, as edhe në kuptimin që ato zënë pozicionet mbizotëruese brenda asaj ideologjie. Megjithë mungesën e një uniteti ideologjik ka disa pika bashkimi midis ideologjive të ndryshme, pra një lloj tërësie mes këtij johomogjeniteti. Nëse ndjekim Altyserin me kujdes ndoshta do të mund të gjenim tek ai një përpjekje për të teorizuar atë që do të mund ta quanim shkencë e Simbolike, domethënë, atë që mundëson për mendimin marrëdhëniet midis këtyre ideologjive dhe ndërveprimet e tyre me ndryshore të tjera sociale.

Gjithashtu, ne duhet të mos i besojmë verbërisht Altysorit, që të mund të evitojmë ato gabime për të cilat Badiu [*Badiou*] më të drejtë e kritikon atë, si për shembull, argumentin se Marksi është themeluesi i shkencës së historisë dhe se rrjedhimisht historia ka një tërësi të cilën ajo në fakt nuk e ka. Nga ana tjetër, nëse përpjekjet e Altysorit i shqyrtojmë duke u nisur nga ndërhyrjet e mëpasshme filozofike mbi këtë pikë,<sup>5</sup> ne mund të dallojmë trajtat e një konceptimi të Historisë jo si Realja por si Simbolikja. E thënë ndryshe, Altysor nuk na propozon një teori të qenies por një teori të dukjes dhe kjo nuk devijon shumë nga përpjekjet e Badiusë në *Llogjikat e botëve*.

Do ta kishim të vështirë të shtjellonim këtë pikë pa hetuar fillimisht mënyrën se si çdo analizë e një rendi Simbolik ndërthuret me Realen si të ishte ajo që vë në pah fallcitetin e pretendimeve të rendit Simbolik kundrejt tërësisë. Badiu e ka formuluar këtë problematikë mjaft saktë:

Nëse, siç thotë Lakan, Realja është impasi i formalizimit, siç pamë kur u ndeshem me cakun si kthim, nuk na mbetet veçse të supozojmë se formalizimi është impasi (*im-passe*) i Reales.<sup>6</sup>

Badiu e ka shtjelluar këtë pikë më thellë gjatë, duke shfaqur kështu parapëlqimin e tij për dialektikën:

Cilat janë herezitë e materializmit? Ai mekanicist izolon metaforën e reflektimit. Ai imagjionon një barazvlefshmëri pa mbetje. Nuk i ndahet përsëritjes. Ai dinamicist bën të njëjtën gjë me asimptotën. Duke universalizuar doktrinën e mbetjes ai propozon se gjithçka është fluks, tendencë dhe përafersi. Për këtë herezi çdo konfigurim i unifikuar është një iluzion, apo edhe një kërcënim totalitar.<sup>7</sup>

Problemi me të cilin ballafaqohemi sot është ai i aspekteve përkatëse të një strukture Simbolike kundër Reales së një revolucioni që minon epërsinë reduktive të strukturës, atë që shfuqizon tendencën e saj për të gllabëruar potentialitetin e elementeve të saj në tërësi.

Mendoj se, duke ndjekur Leninin, tek Altysori, në kundërshtim me Lakanin dhe Badiunë tek të cilët akti është parësor, tendenca është për të theksuar jopërparësinë

e këtyre dy proceseve: nga njëra anë përpjekja, shkencore apo jo, për të rrokur sistemin shkakësor që vepron brenda çdo Njëje Simbolike; nga ana tjetër, këmbëngulja e njëanshme mbi subjektivitetin si diçka që përtej çdo mundësie për të njohur konjunkturën e tanishme jep të gjithë mbështetjen dhe kapacitetin e tij për një event i cili zbulon pafuqinë e forcave totalizuese të kësaj strukture, duke marrë pjesë në këtë mënyrë në shpallosjen e një rendi të ri. Altyser arriti ta kuptojë një gjë të tillë, domethënë, rëndësinë e pohimit të joparësisë të secilit prej këtyre proceseve, falë familjaritetit të tij me po atë dilemë që kishte munduar edhe Leninin: nga njëra anë, Lenini u ballafaqua me konvencionalitetin mekanistik të Internacionales së Dytë, sipas të cilës Revolucioni rus nuk kishte qenë një revolucion i vërtetë komunist pasi ai nuk përputhej me të ashtuquajturat ligje të zhvillimit historik që thuhet se gjenden te *Kapitali*; nga ana tjetër, ai kishte takuar komunistë të një lloji tjetër që në raste ekstreme, si për shembull në rastin e Gramshit [*Gramsci*], mendonin se po ky revolucion kishte ndodhur në kundërshtim me *Kapitalin*, librin, dhe se revolucioni ka të bëjë mbi të gjitha me punën e lirë dhe te ndërgjegjshme të njerëzve, të masave, dhe aspak me pretendimet shkencore të një libri. Sipas Altyserit qëndrimi i Leninit ishte se “teoria marksiste është produkt i një praktike të caktuar teorike, jashtë proletariatit, dhe se marksizmi duhet të ‘importohet’ brenda proletariatit.”<sup>8</sup>

Fjala “importohet” vërtetë që ka nuanca të përjashtme në këtë kontekst, domethënë në kuptimin që ajo duhet të ketë një vend gjatë periudhës revolucionare pa qenë domosdoshmërisht produkt i asaj periudhe. E megjithatë, ashtu si Lenini, Altyser shpall autonominë radikale të punës epistemologjike duke shpallur kështu si të rreme çdo përpjekje për të reduktuar dijen në barazvlefshmëri.

Le të analizojmë shkurtimisht një nga mishërimet e kohëve të fundit të kësaj teorie. E kam fjalën për teorinë e mostrave [*sampling theory*] të procesimit të sinjaleve të Nykwist–Shenonit [*Nyquist-Shannon*], për të cilën mund të themi se është një nga gurët themelorë të dixhitalizimit të botës së sotshme. Kjo teori ka për qëllim të na pajisë me mjetet e nevojshme për të përcaktuar numrin më të vogël të mostrave që duhet të marrim nga çdo sinjal për ta rindërtuar atë më pas krejtësisht ashtu siç ishte. Pra në thelbin e kësaj teorie qëndron ideja se në botë ekziston një tepri e paevitueshme.

Ideja empirike e dijes funksionon në të njëjtën mënyrë dhe kjo është arsyeja pse empirizmi është i rrënjosur në traditën e skepticizmit. Kjo ndodh sepse empirizmi nuk është gjithmonë kritik ndaj teorisë për shkak se ajo është abstrakte; ai është po aq kritik ndaj realitetit për arsye se ai ka shumë tepricë. Nga ky këndvështrim, kritika e empirizmit kundrejt abstraksionit të teorisë mund të interpretohet si diçka që ka lidhje me realitetin si të papërcaktuar. Pra për empirizmin ekziston një inkonsistencë thelbësore në botën reale, nga njëra anë ajo ka shumë tepricë, nga ana tjetër ajo është e papërcaktuar. Kështu pra empirizmi lëviz brenda një rrethi vicioz, që nuk është as i thellë, sepse është vetë ideja e tepricës në botën reale që mundëson teorinë pasqyruese të dijes. E megjithatë, për pasojë të aspektit të dytë të botës reale, papërcaktueshmërinë e saj, vetë kjo mundësi duhet të mohoet si e pamjaftueshme, ja pra dhe skepticizmi.

Nëse i konceptojmë gjërat kështu i bie që kur Altyser mohan idenë se idealja e çdo teorie të njohurisë është barazvlefshmëria, dhe se pikërisht si pasojë e kësaj idealeje çdo teori është gjithmonë abstrakte, ai jo vetëm që mbron teorinë dhe autonominë e saj, ai mbron gjithashtu realitetin nga mënyra se si empirizmi e kupton atë, si tepri. Kjo

është arsyeja pse për Altyserin kemi dy sfera, tërësisht të ndara, teoria dhe realiteti, dhe asnjë mënyrë për t'i lidhur ato me njëra tjetrën.

Do të mund ta vlerësonim këtë akoma më shumë sikur të përpiqeshim të ndiqnim trashgiminë intelektuale të Altysorit. Po ta bënim këtë do të dallonim ndikimin e madh të Fojerbahut [*Feuerbach*]. Kjo mund të duket e çuditshme pasi ne jemi mësuar ta shikojmë Fojerbahun si një nga figurat qëndrore të humanizmit kurse Altyserin si një antihumanist të palekundur. Megjithatë, një lexim i hollësishëm i *Qenësia e krishtërimit* të Fojerbahut tregon se edhe tek ai gjejmë praninë e njëkohësishme të shumë motiveve, madje edhe kundërshtuese.

Sipas Fojerbahut, pika më e mirë prej ku mund të fillojmë të hulumtojmë mbi thelbin e krishtërimit është ideja se Zoti e krijoi botën nga hiçi. Për Fojerbah ky nuk është një pohim kozmologjik apo shkencor, përkundrazi, ai përcjell vlerën që ka bota për ndergjegjen e krishterë. Dhe nëse bota u krijua prej hiçi vetëm falë forcës së vullnetit dhe të imagjinatës kjo do të thotë se edhe sot e kësaj dite bota vazhdon të mbart vlerën e këtij hiçi.

Krijimi prej hiçi është shprehja më e lartë e plotfuqisë: por plotfuqia nuk është veçse subjektiviteti që përjashton vetveten prej të gjitha kushteve objektive dhe kufizimeve [ ... ] asgjë tjetër veçse aftësia për të shpallur gjithçka të vërtetë të pavërtetë – çdo gjë të menduar të mundur: asgjë tjetër veçse fuqia e imagjinatës, ose e vullnetit si identik me imagjinatën.<sup>9</sup>

E thënë ndryshe, nëse falë forcës së vullnetit bota u krijua nga hiçi, falë po kësaj force ajo mund të kthehet prapë në një hiç. Kjo pasqyrohet në shumë doktrina e dogma të tjera të krishtera. Për shembull, shndërrimi i ujit në verë nuk është në fakt shndërrim por krijimi i verës prej hiçi. Arrijmë ta kuptojmë këtë më qartë se kudo tjetër në përgjigjen tipike që njerëzit fetarë iu japin ateistëve se në jetën e tyre ata nuk janë përplasur akoma më fatkeqësitë e sistemit shkakësor që vepron mbi botën. Kështu pra, vetëm dikush që është duke u mbytur dhe që nuk di të notojë do të donte me çdo kusht që sistemi shkakësor sipas llogjikës të së cilit ky njeri duhet të vdesë të eliminohet, domethënë, të shndërrohet në një hiç.

Providenca e krishterë, fetare, ndryshon prej asaj që vesh zambakët e ushqen korbat. Providenca natyrore e lë njeriun të mbytet nëse ai nuk di të notojë; kurse e krishterja, fetarja, e nxjerr atë prej ujit me besëlidhjen e plotfuqisë shëndoshë e mirë.<sup>10</sup>

Pra qenësia e fesë është të pohojë vlerën absolute të vullnetit subjektiv dhe të imagjinatës dhe asgjënë e sistemit objektiv shkakësor mbi dhe kundër të cilit subjekti gjen veten. Domethënë, për të qenë ateist dikush duhet të shpallë joasgjënë e sistemit objektiv shkakësor që vepron në sferën Simbolike:

Doktrina shumë e keqkuptuar e filozofëve të pafe lidhur me pafundësinë e materies, apo të botës, nuk nënkupton gjë tjetër veçse për ta Natyra ishte një realitet teorik.<sup>11</sup>

Mbrojta që Altyser i bën qëndrimit teorik kundrejt objektit në kundërshtim me reduktimin subjektiv të domethënies së tij në zero merr pak a shumë të njëjtën formë. Për më tepër, ashtu siç Foerjebah na thotë se “hiçi prej të cilit u krijua bota është një hiç ende i përbrendshëm”<sup>12</sup>, Altyser na informon se raportet e ndryshme historike mbi origjinën e botes nuk janë gjë tjetër veçse rindërtimi retroaktiv i asaj historie sipas kuptimit të tanishem të saj.

Në vend të mitit ideologjik të një filozofie origjinash dhe koncepteve organike të saj, marksizmi vendos si princip njohjen e dhënësisë [*givenness*] të strukturës komplekse të çdo “objekti” konkret, një strukturë që qeveris si zhvillimin e objektit ashtu edhe zhvillimin e praktikës teorike që prodhon dijen e tij. Nuk ka më një esencë origjinale, vetëm një gjithnjë-paradhënësi [*ever-pre-givenness*], sado thellë në të kaluarën e saj të zhytet dija.<sup>13</sup>

Nëse pranojmë se tipari më impresionues i shkencës moderne është përqafimi i një sistemi shkakësor kompleks dhe jolinear në vend të sistemit klasik linear, atëherë teoria e Altyserit mbi njohurinë përputhet me këtë vizion modern. Por pikërisht pse rendi shkakësor është i një natyre jolineare nuk ekziston një mënyrë e thjeshtë për të shpjeguar se si analizimi i tij mund t’iu hyjë në punë njerëzve në jetën e tyre të përditshme, dhe, për analogji, se si njohja e rendit Simbolik mund t’i shërbejë interesave të revolucionarëve. Sidoqoftë, ndonëse Altyser ishte jo vetëm marksist por edhe komunist, ai nuk mundi të teorizojë ose të paktën të trajtojë plotësisht lidhjen e nevojshme që duhet të vendoset midis këtyre rendeve. Ai thjesht na thote, duke ndjekur Leninin, se lidhja duhet “shpikur” “në një farë mënyre.”

Pra unë mendoj se një mënyrë për të shpëtuar Altyserin sot do të ishte sikur ti shtonim teorisë së tij të dijes një dozë nga llogjika femërore e Lakanit, atë të jogjithçkasë [*non-all*]. E parë kështu, e meta e vetme e Altyserit mund të ketë qenë falimentimi i tij për të pohuar në mënyrë retorike autonominë e realitetit. Ai duhet të kishte qenë më i kujdesshëm dhe të theksonte autonominë e realitetit në ndarjen e tij prej punës teorike.

Megjithatë, le të mos harrojmë arritjen e madhe dialektike të Altyserit, që është pohimi se heterogjeniteti është primar dhe uniteti ai që vjen pas. Vetëm kur uniteti humb statusin e tij të kryehershëm mund të braktisim historicizmin. Kështu pra, përmbysja e vërtetë dialektike e fabules së Rënies nuk ndodh kur ne shpallim parësine e të bërit mbi teorinë, e dinamizmit të realitetit mbi tendencat reduktive të mendimit. Përkundrazi, ne arrijmë të shpëtojmë prej shtrëngimit mbytës të unitetit vetëm kur zgjedhim një tjetër rend parapëlqimi mes unitetit dhe dallimit. Në vend që të jetë uniteti parësor dhe heterogjeniteti dytësor, një depërtim i vërtetë dialektik, duke pranuar natyrën dytësore, pra emergjente, të unitetit eliminon çdo tendencë të pamatur drejt unitetit, e cila na thotë se uniteti është ndërprerë dhe kërkon rindërtimin e tij. Uniteti emergjent, nëse ai nuk është i një rendi reduktiv, dhe nëse ai nuk është një kthim i domosdoshëm, alla interpretimeve klasike të Hegelit, d.m.th. një kthim i individualizuar që shpallet, nuk mund veçse të jetë një punë në zhvillim e sipër dhe si e tillë përfundimi pozitiv nuk përbën më interes. Ç’mund të jetë kjo atëherë veçse aspekti bashkëkonstruktiv i unitetit, një bashkëkonstruksion?

Në vend të *Mitsein* (meqenie), pra, ky unitet është *Mitarbeit* (bashkëpunim), për arsyen e thjeshtë se të qenit bashkë nuk është asgjë veçse pohimi i pararendësisë së heterogjenitetit. Të paktën Hajdeger [*Heidegger*] ishte konsistent kur e shpallte këtë gjendje si një kthim tek një rend që kishte ekzistuar, sepse bashkëqenie është për të njëkohësisht gjendja fillestare dhe ajo e ardhmja, të ndara nga një unitet “harrues” reduktiv. Por ne si marksistë nuk e pranojmë një kthim të tillë, pasi argumenti kryesor për mohimin e origjinalitetit të unitetit ishte mohimi i çdo gjëje që do të na shtynte jashtë procesit dialektik, edhe kur ky merr formën e një kthimi tek një e kaluar tërësisht heterogjene që mund të ketë ekzistuar. Në fjalët e Badiusë:

Ajo që mungon në këtë argument është mendimi mbi shkatërrimin të rendit të vjetër dhe vërejtja se ajo që rindërton vetveten nuk mund të jetë kurrësesi e njëjta gjë. Në këtë mënyrë, e vërteta e subjektit garanton vijueshmëri llogjike pa ndërmjetësimin e imagjinare. As impasi i subjektit politik nuk e rivendos rendin e vjetër. Debati marksist ka të bëjë pikërisht me këtë. Në BRSS, nuk kemi as një revolucion të “ndërprerë,” as nuk e di çfarë versioni totalitar të botës borgjeze, nën konceptin përsëritës të shtetit modern. Kemi një borgjezi të re.<sup>14</sup>

Duke pasur këtë parasysh, ndoshta ajo që nevojitet nuk është çndërtimi i pretendimeve arsimore, ose të zbulojmë injorancën e mësuesit, ose thjesht të zhveshim metafiziken e unitetit, por një arsim që është gjithnjë e më tepër një bashkarsim, pasi të gjithë ne kemi nevojë të disiplnohemi. Dhe jo të disiplnohemi sipas idesë imagjinare të nuk di se kujt, por sipas Reales së punës të përbashkët në vazhdimësi të organizates së arsimit.











**Shënime**

- 1 Louis Althusser, *Lenin & Philosophy & Other Essays*, përkth. Ben Brewster (Monthly Review Press, 1971), 152.
- 2 Po aty, 156.
- 3 Louis Althusser, *For Marx*, përkth. Ben Brewster (Londër: Verso, 2005), 232.
- 4 Karl Marx, *Capital*, Vol. 1, përkth. Ben Fowkes (Penguin Classics, 1990), 742.
- 5 Mes të tjerëve, do të doja të theksoja veprën e Lakanit, Badiusë, Balibarit dhe Zhizhekut.
- 6 Alain Badiou, *Theory of the Subject*, përkth. Bruno Bosteels (Londër: Continuum, 2009), 23.
- 7 Po aty, 206.
- 8 Louis Althusser dhe Étienne Balibar, *Reading Capital*, përkth. Ben Brewster (Londër: Verso, 2009), 156.
- 9 Ludwig Feuerbach, *The Essence of Christianity*, përkth. George Eliot (Nju-Jork: Dover, 2008), 85.
- 10 Po aty, 87.
- 11 Po aty, 97.
- 12 Po aty, 92.
- 13 Althusser, *For Marx*, 199.
- 14 Badiou, *Theory of the Subject*, 246.

# THE UNIVERSITY MUST BE TRANSCENDED

Nick Skiadopoulos

## *Pedagogies en l'état*

It seems that I am not the only one here among us who linked the title of this conference to Maurice Blanchot's last work *L'Écriture du désastre* – a text that begins with the following phrase: “Le désastre ruine tout en laissant tout en l'état.”<sup>1</sup> The modality of disaster is thus to ruin everything while leaving everything *in state*. Destruction is not disposal, what is destroyed is not transferred to some place arranged specifically for that purpose. If there is a place reserved for disaster it is only that of the ruin: what is destroyed *remains* there, on the same ground that once supported its coherency.

But what of the state of our pedagogies? As much as I hate to utter banalities, pedagogy (from Plutarch to Rousseau and up to the field of philosophy of education) is a word charged with agents, spaces, ceremonies, and unnamable desires. And whereas it can be distinguished from the administrative aspect of education, in that it assumes a more or less personal relationship between the educator and the educated, I take this distinction to be overtly metaphysical. Both pedagogy and its administrative aspect are technologies that can be viewed and analyzed on the same, immanent level. Pedagogy is administrative exactly because it is performative and administration is pedagogical in that it involves several forms of discipline. The strict distinction between a pedagogical and an administrative aspect of education is thus a mere illusion. But it is a highly interesting one, exactly because it takes itself to be real, leading us to believe that had the balance between the administrative and the pedagogical been disturbed in favor of the former, humanities could face the danger of their destruction.

Most of us are affiliated with a particular university or institution of higher learning. We find our place there because our very field was constructed primarily through this institution. And we find ourselves in the position to witness the gradual extinction of our objects by the very institution that once brought them to life. Partaking in the destruction of our very pedagogies, right there at the ruin of the university: literally and inescapably *en l'état*. In order to justify this paradoxical position we often point to some

distant but operant, bureaucratic system that cares only about what is quantifiable, applicable and assessable. And it would not be far from reality if we identified several governmental and administrative factors as responsible for this situation. In such a manner that all these symptoms would be interpreted as an “invasion of values” foreign to the ones required by the pedagogies of humanities.

But is this due to some obscene capitalistic spirit spreading over a university that was once free from its influence, as Max Weber thought almost a century ago?<sup>2</sup> I would be very reluctant to adhere to such a truism. And this because throughout the history of modern political systems (from capitalism to nationalist socialism and communism) the humanities have been one with the institution of the university, an institution that not merely sanctioned but literally bred most of the thinkers we cherish today. So maybe the pedagogies of humanities are not independent from the modern University, regardless of its political foundations. They did not constitute a different sphere; their practices were not organized outside its walls. And this is why what is happening today in relation to humanities cannot be described as some form of abolition through the invasion of some alienating mindset. It should be rather thought as a form of self-mutilation, the guilty disposal of something that sprang out of the university and now rests like a sublated fossil: a ruin. A ruin not of humanities, but of something else: given that the humanities were only possible within the University this “something” is what is *left* from their mutilation. It is what humanities themselves have to leave behind in their self-deceiving refusal to perish.

In short, there seems to be a part of the humanities that no longer belongs to them. One that managed to emerge from within the university, under the epistemological pretext that their study offered and, now that humanities are near extinction it can finally escape the institution that once produced it as a residue.

### Epistemological Anxiety

During the 19th century the birth of the *Geisteswissenschaften*, *sciences humaines* or “humanities” was related to an epistemological question. Certainly the humanities were established as an object that was epistemologically distinct from one of the natural sciences. But if they managed to distance themselves, it was exactly because they had to be all about the knowledge of something.<sup>3</sup> This should not be taken to mean that humanities in their historical development implied some form of ontological, transcendental, or even epistemic unity. It is of no importance whether their epistemological status was founded on something else rather than man (a structural relation, a biological function, a transcendental principle unrelated to man).<sup>4</sup> What is important is that humanities were and still remain tied to an epistemological question.

At the same time the object of humanities was fundamentally opaque from the very beginning, as it presented itself both as something to be known and as something not possible to be known.<sup>5</sup> Due to this fundamental ambiguity, the humanities were always in need of an epistemic legitimization that the natural sciences *de facto* enjoyed. This need for legitimization did not only produce a plurality of objects and methods. It also gave rise to types of thought that transcended or simply bypassed the epistemological question: interpretative sociology, critical theory, fundamental ontology, questions related to power, writing, and the historical construction of subjectivity are some exam-

ples. But whereas new problematics were opened and novel objects were constructed, all these attempts were institutionally registered under some humanities department. And this happened because these new problematics were produced in a residual manner, inside the university and within the disciplinary domain of humanities. The university was their institutional and material condition of possibility. And although it can be argued that they managed to survive outside its walls, they only did so in a state of misery that redeemed itself only when they belatedly found their place back to the university: the works of Nietzsche, Marx, and Benjamin are exemplary of this symptom.

But is the university such an inescapable and indispensable condition? Is any attempt to exit it a predetermined failure (of recognition, of esteem, of legitimization)? Or is it that these residual forms of thought failed to produce their institutional equivalent? To answer this question one must first look at the disciplinary politics that these objects raised *within* the university as they posed a certain disciplinary anxiety: for they could neither be subsumed under humanities nor be described in terms of some unitary “paradigm.” And this anxiety was not only disciplinary; it was also administrative: let us recall here Lyotard’s *La Condition postmoderne*, a text commissioned by the University Council of Quebec and subtitled “A report on knowledge.”<sup>6</sup> Most importantly let us not forget that this anxiety quickly assumed the form of politics *proper*. Popper’s libel against Marx and Hegel,<sup>7</sup> Hayek’s attack against the intellectuals and their relation to socialism,<sup>8</sup> the replacement of “political theory” with cold-war “political science” (a shift that Leo Strauss related to the dire future of liberal democracy<sup>9</sup>) and the scientific approach to collective decision making with Arrow and Buchanan,<sup>10</sup> all these were attacks not only in the name of scientific knowledge, but also in the name of the democratic values that scientific knowledge supposedly implied. In such a fashion that any thought departing from the epistemological question related to the humanities, was deemed irrational and potentially totalitarian. It therefore seems that these new problematics were produced within the University and at the same time disrupted its disciplinary, institutional and political functions.

But this refuge to politics was not only a privilege of the “adversary.” For, as it often happens with anxiety, it did not only affect its subject but also its very object. It is therefore of no surprise that many intellectuals related to these residual objects were politically involved to the point that this involvement made their thought easily identifiable for their adversaries. It would be trivial to remind us here of Heidegger, Sartre or May ’68. Or to speak about forms of left radicalism related to particular philosophers. But perhaps it is also suspicious of me to imply that thought or philosophy should take its distance from politics. This is not what I am trying to say. *What I am suggesting is that a thought departing from the traditional problematic of humanities should lead to equally novel forms of political thought rather than obstinately reforming political ideas that preceded its moment. Above all, it should first situate politics within its very institutional and disciplinary environment.*

Unfortunately, as in the realm of politics this residual thought did not manage to bring about a novel political theory, so in the institutional realm of the university it did not manage to produce novel forms of pedagogical institutions.

It is to this latter problem that I will now turn.

### Familiar ruins

The ruin of the university inscribes the trace of its pedagogies. Practices, memories, and expectations are part of this very trace – but it is highly doubtful whether they belong to our generation. A great part of today's younger scholars were educated by professors who experienced a time of great expectations (I am mostly referring to the period between the late '60s and the mid '80s). The pedagogies responsible for their intellectual formation were defined by the promises and expectations of their professors, who thought they could introduce novel educational techniques in order to reform the University. In that respect, these expectations were highly paradoxical: on the one hand they raised the question of politics before the question of institutions and on the other they claimed the implementation of certain politics on the institutions of the very political system they criticized. They did not take over the University in order to turn it into something else. They did not build a Christian church on the ruins of some pagan temple. Rather they tried to change the function of the institution while maintaining the institution as it stood.

The most notorious example is Vincennes, the educational aftermath of a great political mobilization, tagged as *gauchiste* from its very beginnings. Vincennes can be seen as the common effort (in the sense of a pedagogical community) of a great part of French intellectuals until then scattered around the great Universities of Paris. In terms of concrete practices, it struggled to bring about radical changes (reforms that extended from the curriculum and the way classes were delivered to the manner by which students were graded and diplomas were awarded). But in retrospect there was a very problematic aspect to this story, namely that this effort had to follow (rather than prepare) a particular political mobilization. And this is why Vincennes did not raise the question of a novel institution but that of the reform an old one: when the quality of its philosophy program was questioned – “Did the *gauchiste* university conform to the standards of education as defined by the State? Should its graduates be allowed to teach at the *secondaire*?” – Vincennes simply struggled for institutional legitimization. This otherwise reformed establishment remained an institution that fulfilled a particular educational function within a modern State. What is even more surprising is that philosophers who were very vigilant in relation to questions of power and governance defended this reform expressing rather naïve beliefs such as the one stated by Michel Foucault: “if questions such as these were posed in a philosophy class, it is clear that its traditional foundations would be profoundly transformed.”<sup>11</sup>

How are we to explain this surprising naiveté? And how can we explain that it persisted many years after the institutional failure of Vincennes, in celebrated texts such as the “University without condition” by Jacques Derrida?<sup>12</sup> In the face of the Bologna process, of the recent budget cuts and closings of entire departments, are we to believe that the University will unconditionally allow a never-ending reform in the name of Humanities? Or are we to believe that the University functions under some Habermasian discourse ethics where “at any moment a new face can suddenly appear and a new idea can unexpectedly arrive”?<sup>13</sup> How is it possible for these *maîtres penseurs* to neglect the very history of the University, the very fact that it emerged from the institution of the Church and came to replace it as the institutional embodiment of society's relation to truth? How did they allow themselves to approach it almost *sub specie aeternitatis*?

I would dare to say that the reason for this neglect lies in the fact that the thought of this generation was nourished *within* the university and by means of a critical reaction to the epistemological question. Of course this was not an easy task – but at least it was not impossible. It demanded a former generation that was already there to sanction such questionings. There could never be a Foucault or a Derrida without a Canguilhem, an Hyppolite, or an Althusser. Today, however, the generation of our professors is institutionally disarmed. Not necessarily because it proved to be conformist, but because it brought the University to its limits – limits that are anything but unconditional. Historically, the very material condition of our professors' generation has become their biggest enemy. But the responsibility does not weigh on them. Rather, it weighs on us. In the name of what our professors tried to achieve, we are the ones who are now called to put forward what they failed to do: to transcend the university.

### Pedagogies Beyond – Recognition

Can we pretend that such dislocation (if not transcendence) has not taken place? Given the affiliation of many of my friends and present participants to institutions such as the European Graduate School, the Le Collège International de Philosophie or the Jan Van Eyck Academie it would be a great omission if I did not take them into consideration. And indeed, these structures seem to take over from the university the pedagogies of the aforementioned residual disciplines and welcome them in a novel institutional environment. But how certain are we that these institutions are innovative rather than emulative? The reason for my bad faith lies in the fact that many of their administrative traits bear the sign of a certain *mauvaise conscience*. Allow me to explain myself.

Most of the institutions above have a structure which is highly reminiscent of University departments: some award Master's and PhD degrees for which a student is asked to pay a relatively high amount of tuition fees. Within such a condition, they need to legitimize the importance of their degrees both to their clients and to academia. Others try to gain legitimacy by establishing relations with particular universities and departments, channeling their work back to the institution they wish to evade. Of course I am quite aware that institutional legitimization of some sort along with the necessary networking are much important factors for funding. And as a matter of fact I take funding to be one of the most serious of issues regarding the future of our pedagogies. Not simply because the existence of any institute is dependent on it, but mainly because the funding of institutes should not stand in the way of what those institutes try to achieve.

Let me be clear on this: the pedagogies we have been talking about are not to be dealt with as a nearly extinct species just because they cannot survive outside an institution that either is or looks like the university. If the institution that nourished them can no longer afford them it is because they are mature enough to escape their breeding ground – not because they are particularly wasteful. In a very traditional language, the institution must be the means for the pedagogy's goals. In a more modern one, it must be their expression. So if a novel institutional setting is too expensive for them, then maybe the problem lies not in their "nature" (their aristocratic setting in some prestigious, expensive, and innovative establishment) but in the way we interpret this nature institutionally. Our pedagogies need not involve buildings. They need not involve visas and stamps. They need not involve tuition fees, academic writing, publication



records, term papers, and ECTS points. They might not even involve degrees. This does not mean that they do not involve anything at all, but that *they need not involve all those things unnecessary to their strict discipline, which exhausts itself in the much complex tasks of learning how to read and learning how to write.*

If the goal of our pedagogies is to carry on a mode of thinking and writing that is rendered almost impossible from the practices of the modern University and if our attempts to keep it alive are so costly as to endanger the very pedagogies of this thought, then maybe we should not simply give up the university but the very notion of material space that a traditional institution both implies and requires. Maybe the theoretical step beyond the epistemological question needs to find its counterpart in an institutional step towards a novel type of space. As banal as it may sound, maybe the cyberspace should accommodate our pedagogies from now on. Open access journals, such as *continent.*, online lectures such as the ones published online by EGS, innovative practices such as MOOCs (Massive Open Online Courses) are very modest beginnings compared to the already open possibilities offered by the medium. This conference is already a step beyond, given that it is materially grounded on the existence of an online, open access journal created in order to bypass certain academic obstacles that stand in the way of our thinking and writing. It would therefore not be an exaggeration to say that the possibility of an independent and autonomous institute, with worldwide participations from both professors and students, with an engaging curriculum, public lectures, seminars, readings, publishing structures and most of all the opportunity to produce autonomous, original work worthy of its pedagogy is right in front of us. It needs no alibi, no apology and no legitimization.

It only requires that we emerge from the ruins of the University.

## Notes

- 1 Maurice Blanchot, *L'Écriture du désastre* (Paris: Gallimard, 1980), 7.
- 2 "In very important respects German university life is being Americanized, as is German life in general. This development, I am convinced, will engulf those disciplines in which the craftsman personally owns the tools, essentially the library, as is still the case to a large extent in my own field." Max Weber, "Science as a Vocation" in *Essays in Sociology*, ed. and trans. H.H. Gerth and C. Wright Mills (New York: Oxford University Press, 1946), 131.
- 3 For this case, Windelband's 1894 rectorial address is exemplary: philosophy appears at once as a form of thought above and beyond all other disciplines and at the same time tied to the epistemological question of knowledge and its possibility. Cf. Wilhelm Windelband, "Rectorial Address Strassbourg," *History and Theory* 19.2 (Feb. 1980): 169–85.
- 4 In that sense Foucault's argument regarding the "death of man" should not be taken to imply the end of humanities. Rather, it is through the proliferation of humanities that this end is achieved. Cf. Michel Foucault, *Les mots et les choses* (Paris: Gallimard, 1965), 355–98.
- 5 In the neo-Kantian tradition this question was reflected in the problem of the *hiatus irrationalis* (a term borrowed by Fichte), viz. the problem of reconciling the particular character of cultural objects and works with universal categories related to the possibility of them being known by the human intellect. Cf. Heinrich Rickert, *The Limits of Concept Formation in Natural Science: A Logical Introduction to the Historical Sciences*, ed. and trans. Guy Oakes, (Cambridge: Cambridge University Press, 1986), viii–ix.
- 6 Jean-François Lyotard, *La Condition postmoderne: Rapport sur le savoir* (Paris: Minuit, 1979).
- 7 Karl Popper, *The Open Society and Its Enemies*, vols. 1 & 2, 5th ed. (revised) (Princeton: Princeton University Press, 1966).
- 8 Friedrich Hayek, "Intellectuals and Socialism," *The University of Chicago Law Review* 16.3, (Spring, 1949): 417–33.
- 9 Cf. Leo Strauss, "An Epilogue," in *An Introduction to Political Philosophy: The Essays by Leo Strauss*, ed. Hilail Gildin (Detroit: Wayne State University Press, 1975) 125–55.
- 10 On this very interesting historical-disciplinary question see Sonja Amadae, *Rationalizing Capitalist Democracy* (Chicago: University of Chicago Press, 2003) and John G. Gunnell, *Between Philosophy and Politics: The Alienation of Political Theory* (Amherst: University of Massachusetts Press, 1986).
- 11 Michel Foucault, "Le piège de Vincennes," interview with P. Lorient, *Le Nouvel Observateur* 274 (Feb. 9–15), 33–5, republished in *Dits et Écrits*, vol. 1, text 78 (Paris: Gallimard, 2001).
- 12 Jacques Derrida, *L'Université sans condition* (Paris: Galilée, 2001).
- 13 Jürgen Habermas, "The Idea of the University: Learning Processes," *New German Critique* 41, Special Issue on the Critiques of the Enlightenment (Spring–Summer, 1987): 3–22.



# UNIVERSITETI DUHET TEJKALUAR

Nik Skiadopulos

## *Pedagogjitë en l'état*

Është e qartë se unë nuk jam i vetmi këtu mes nesh që ka bërë lidhjen midis titullit të kësaj konference dhe veprës së fundit të Moris Blanshosë [*Maurice Blanchot*] *Shkrimi i shkatërrimit* [*L'Écriture du désastre*] – një tekst që fillon me frazën vijuese: “Le désastre ruine tout en laissant tout en l'état – Shkatërrimi rrënon gjithçka, por duke lënë gjithçka të paprekur.”<sup>1</sup> Modaliteti i shkatërrimit është të rrënojë gjithçka duke lënë gjithçka *en l'état*.<sup>\*</sup> Shkatërrimi nuk është flakje tutje, ajo që shkatërrohet nuk transferohet në ndonjë vend që ekziston apostafat për atë punë. Nëse ka ndonjë vend të rezervuar për shkatërrimin kjo është vetëm rrënoja: çfarë shkatërrohet *mbetet* atje, në të njëjtin vend që një herë e një kohë mbështeste koherencën e saj.

Por ç'mund të themi për gjendjen e pedagogjive tona? Megjithëse urrej të them banalite, pedagogjia (duke filluar nga Plutarku, duke vazhduar me Russonë [*Rousseau*], e deri tek sfera e filozofisë së arsimit) është një fjalë e ngarkuar me aktorë, hapësira, ceremoni dhe dëshira pa emër. Dhe ndonëse ajo mund të dallohet prej aspektit administrative të arsimit, sepse ajo nënkupton një marrëdhënie pak a shumë personale midis mësuesit dhe nxënësit, për mua ky dallim është ca si tepër metafizik. Si pedagogjia ashtu dhe aspekti administrativ i saj janë teknologji që mund të vërehen dhe të analizohen në të njëjtin plan imanent. Pedagogjia është administrative pikërisht sepse ajo është performative dhe administrata është pedagogjike sepse ajo përfshin forma të ndryshme disipline. Pra dallimi definitiv midis aspekteve pedagogjike dhe administrative të arsimit është thjesht një iluzion. Ama ai është një iluzion mjaft interesant, pikërisht sepse ai mendon se është i vërtetë, duke na bërë të mendojmë se nëse balanca midis administratives dhe pedagogjikes do të ishte lëkundur në favor të së parës, humanitetet do të mund të përballeshin me kërcënimin e shkatërrimit të tyre.

\* *Shën. i përkth.* – Sh. shën. në f. 121.

Shumica prej nesh kanë lidhje të ngushta me një universitet të caktuar apo me një institucion të arsimit të lartë. Ne e gjejmë vendin tonë aty sepse vetë fusha jonë është ndërtuar kryesisht ndërmjet këtij institucioni. Dhe në e gjejmë veten në pozicionin e dëshmitarit të zhdukjes graduale të objekteve tona prej vetë institucioneve që i sollën ato në jetë. Një pjesmarrës tjetër në shkatërrimin e pedagogjive tona, aty në mes të rrënojës së universitetit: mirëfilli dhe në mënyrë të pashmangshme *l'état* (shtet). Në përpjekje për të justifikuar këtë pozicion paradoksal shpesh i drejtohem një sistemi burokratik, të largët por sidoqoftë funksional, që mendon vetëm për atë që është e matshme, e aplikueshme dhe e vlerësueshme. Dhe nuk do të ishte larg të vërtetës nëse do të identifikonim disa faktorë qeveritar dhe administrativ si përgjegjës për këtë situatë. Në mënyrë të tillë që të gjitha këto simptoma do të ndërpriteshin si një pushtim vlerash të huaja prej atyre të kërkuara prej pedagogjive të humaniteteve.

Po a është kjo pasojë e përhapjes të një shpirti të ndyrë kapitalist brenda po atij universiteti që njëherë e një kohë kishte qenë i lirë prej tij, siç mendonte Maks Veber pothuajse një shekull më parë?<sup>2</sup> Do të ngurroja ta pranoja një pseudo të vërtetë të tillë. Dhe kjo për arsye se gjatë gjithë historisë të sistemeve politike moderne (nga kapitalizmi te nacional-socializmi te komunizmi) humanitetet kanë qenë njësh me institucionin e universitetit, një institucion që jo vetëm sanksionoi por gjithashtu polli shumicën e mendimetarëve që ne vlerësojmë sot. Pra pedagogjite e humaniteteve ndoshta nuk janë të pavarura nga Universiteti modern, pavarësisht nga themelet e tij politike. Ato nuk përbënin një sferë tjetër; praktikat e tyre nuk organizoheshin jashtë mureve të tij. Dhe kjo është arsyeja pse ajo çka po ndodh sot me humanitetet nuk mund të përshkruhet si një lloj shfuqizimi përmes pushtimit nga një mentalitet i tëhuajsuar. Përkundrazi, ajo duhet menduar si një lloj vetëgjymtimi, flakja tutje, prej ndjenjës së fajit, të diçkaje që mbiu nga universiteti dhe tani pushon si një fosil i vetëpërtëritur [*sublated*]: një rrënojë. Rrënojë jo e humaniteteve por e diçkaje tjetër: duke qenë se humanitetet mund të ndodhnin vetëm brenda Universitetit kjo “diçka” është ajo çka *mbetet* prej gjymtimit të tyre. Është ajo çka vetë humanitetet duhet të lënë pas në refuzimin e tyre vetëmashtrues për t’u shuar.

Shkurtimisht, me sa duket ekziston një pjesë e humaniteteve që nuk iu përket më atyre. Një pjesë që arriti të lind nga brenda universitetit, nën pretekstin epistemologjik që ofronte studimi i tyre dhe tani që humanitetet janë afër zhdukjes ajo mund të arratiset prej institucionit që e prodhoi si një mbetje.

### Ankthi epistemologjik

Lindja në shekullin e 19-të e *Geisteswissenschaften*, *sciences humaines* ose “humaniteteve” ishte e lidhur me një çështje epistemologjike. Padyshim që humanitetet u vendosën si një objekt që nga pikëpamja epistemologjike ndryshonte prej atij të shkencave natyrale. Por nëse ato arritën të distancohen, kjo që pikërisht sepse ato kishin të bënin me dijen e diçkaje.<sup>3</sup> Me këtë nuk duhet të kuptojmë se humanitetet, gjatë zhvillimit të tyre historik, përbënin ndonjë tërësi ontologjike, transhendentale ose epistemike. Pak rëndësi ka nëse statusi i tyre epistemologjik u themelua mbi diçka tjetër dhe jo njeriun (një lidhje strukturore, biologjike, një parim transhental që nuk ka të bëjë me njeriun).<sup>4</sup> Ajo që është e rëndësishme është se humanitetet ishin dhe vazhdojnë të jenë të lidhura me një çështje epistemologjike.

Nga ana tjetër, qysh në fillim objekti i humaniteteve ka qenë, në thelb, i paqartë pasi ai e prezantoi veten si diçka që duhej njohur dhe njëkohësisht si diçka që nuk mund të njihet.<sup>5</sup> Falë kësaj paqartësie rrënjësore, humanitetet kanë pasur gjithmonë nevojë për legjitimizimin epistemik që, *de facto*, shkencat natyrore e kanë pasur gjithmonë. Kjo nevojë për legjitimizim nuk prodhoi vetëm objekte dhe metoda të shumta. Ajo u bë gjithashtu shkak për ato lloje mendimi që kapërcyen ose thjesht anashkaluan çështjen epistemologjike: sociologjia interpretuese, teoria kritike, ontologjia rrënjësore, çështje të lidhura me pushtetin, të shkruarit dhe natyrën historike të subjektivitetit janë disa shembuj. Por ndonëse u çelën problematika të reja dhe u ndërtuan objekte të reja, të gjitha këto përpjekje kishin një karakter institucional pasi ato u zhvilluan brenda një departamenti ose tjetrit të humaniteteve. Kjo ndodhi sepse këto problematika u prodhuan në mënyrë të mbetur, brenda universitetit dhe gamës disiplinore të humaniteteve. Universiteti ishte kushti institucional dhe material i mundësimit të tyre. Dhe ndonëse mund të argumentohet se ato arritën të mbijetonin jashtë mureve të universitetit, ato arritën ta bënin këtë në një gjendje mjerimi dhe arritën të rimëkëmben vetëm kur, më në fund, e gjetën prapë vendin brenda universitetit: veprat e Niçes [Nietzsche], Marksit dhe Benjaminin janë shembuj ekzemplarë të kësaj simptomë.

Po a është universiteti një kusht kaq i nevojshëm dhe i pashmangshëm? A është çdo përpjekje për të dalë prej tij e destinuar të falimentojë (nga pikëpamja e njohjes, vlerësimit dhe legjitimizimit)? Apo mund të themi se këto forma të mbetura mendimi nuk arritën të prodhojnë institucionet që iu përshtateshin? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje duhet që fillimisht të analizojmë politikat disiplinore që këto objekte ngriten brenda universitetit pasi ato shkaktuan një lloj ankthi disiplinor: ato nuk mund të përfshiheshin brenda humaniteteve apo të përshkrueshin sipas një paradigme të vetme. Dhe ky nuk ishte vetëm një ankth disiplinor; ai ishte gjithashtu një ankth administrativ: le të rikujtojmë *Kushtin postmodern* të Liotarit, një tekst i porositur prej Këshillit Universitar të Quebec-ut dhe i nëntitulluar “Një raport mbi situatën e dijes.”<sup>6</sup> Mbi të gjitha le të mos harrojmë se ky ankth shumë shpejt mori trajtat e politikës së mirëfilltë. Shpifjet e Poperit [Popper] kundër Marksit dhe Hegelit,<sup>7</sup> sulmi i Hajekut [Hayek] kundër intelektualëve dhe lidhjes së tyre me socializmin,<sup>8</sup> zëvendësimi i “teorisë politike” me “shkencat politike” të Luftës së Ftohtë (një zhvendosje që Leo Straus [Strauss] e ka lidhur me fatin e trishtueshëm të demokracisë liberale<sup>9</sup>) dhe qasja shkencore ndaj vendimmarrjes kolektive e Errouit [Arrow] dhe Bjukenanit [Buchanan],<sup>10</sup> të gjitha këto ishin sulme jo vetëm në emër të diturisë shkencore por gjithashtu në emër të vlerave demokratike që dituria shkencore gjoja nënkuptonte. Në mënyrë të tillë që çdo mendim që nisej prej çështjes epistemologjike që lidhet me humanitetet u quajt i paarsyeshëm dhe potencialisht totalitar. Pra me sa duket këto problematika të reja u prodhuan brenda universitetit dhe njëkohësisht çekuilibruan funksionet e tij disiplinore, institucionale dhe politike.

Por kjo arratisje drejt politikës nuk ishte vetëm një privilegj i “kundërshtarit.” Sepse, siç ndodh rëndomtë me ankthin, ai nuk preku vetëm subjektin e tij por edhe objektin e tij. Nuk duhet të habitemi atëherë që shumë intelektualë të lidhur me këto objekte të mbetura ishin të përfshirë në politikë deri në atë pikë ku kjo përfshirje e bëri mendimin e tyre lehtësisht të identifikueshem për kundërshtarët e tyre. Do të qe bajate të përmendim këtu Hajdegerin [Heidegger], Sartrin apo Majin e 1968-s. Ose të flisnim

për lidhjet midis formave të radikalizmit të majtë dhe filozofëve të caktuar. Por ndoshta dëshira ime për të distancuar mendimin ose filozofinë nga politika është po aq e dyshimtë. Por kjo nuk është ajo që unë po përpiqem të bëj. *Ajo që jam duke sugjeruar është se një mendim që nisët prej problematikës tradicionale të humaniteteve duhet të na çojë drejt formash mendimi politik po aq të reja në vend që të reformojë idetë politike që paraprind momentin e tij. Mbi të gjitha, fillimisht ai duhet ta vërë politikën mes ambientit të saj institucional dhe disiplinor.*

Fatkeqësisht, siç ndodh në sferën e politikës ky mendim i mbetur nuk arriti të sillte një teori politike të re, kështu që në sferën institucionale të universitetit ai nuk arriti të prodhojë forma të reja institucionesh pedagogjike.

Ky është problemi të cilit do t'i kthehem tani.

### Rrënoja të njohura

Rrënoja e universitetit skicon gjurmët e pedagogjive të tij. Praktika, kujtime, dhe pritshmëri janë pjesë të vetë kësaj gjurme – por është për t'u dyshuar nëse ato i përkaasin brezit tonë. Një pjesë e mirë e shkollarëve të rinj të sotshëm u arsimuan prej pedagogëve të cilët përjetuan një kohë me pritshmëri të mëdha (po i referohem kryesisht periudhës midis fundit të viteve '60 dhe mesit të viteve '80). Pedagogjijtë përgjegjëse për formimin e tyre intelektual u cilesuan nga premtimet dhe pritshmëritë e pedagogëve të tyre, të cilët mendonin se mund të fusnin teknika të reja arsimit në Universitet për ta reformuar atë. Përsa i përket kësaj pike, këto pritshmëri ishin mjaft paradoksale: nga njëra anë ato ngritën çështjen e politikës para asaj të institucioneve dhe nga ana tjetër ato kërkuan zbatimin e politikave të caktuara brenda institucioneve të po atij sistemi politik që kritikonin. Ato nuk e zaptuan Universitetin për ta kthyer atë në diçka tjetër. Ato nuk ndërtuan një kishë të krishterë mbi rrënojat e ndonjë tempulli pagan. Jo, ato u përpoqën të ndryshonin rolin e institucionit duke e mbajtur atë ashtu siç ishte.

Shembulli më famëkeq është Vincennes, pasoja arsimore e një mobilizimi të madh politik, etiketuar *gauchiste* qysh prej fillimeve të saj. Vincennes mund të shihet si produkti i përbashkët (në kuptimin e një komuniteti pedagogjik) i një pjese të madhe të intelektualëve francez deri në momentin kur ata u shpërndanë nëpër Universitetet e mëdha të Parisit. Praktikisht, ajo u përpoq të sjell ndryshime radikale (reforma që shtriheshin nga programi mësimor dhe mësimdhënia e deri tek mënyra si vlerësoheshin studentët dhe diplomat që ata fitonin). Por, në retrospektivë, kjo histori kishte një aspekt mjaft problematik, domethënë, që kësaj orvatje iu desh të ndiqte (në vend që të pregatiste) një mobilizim të caktuar politik. Kjo është edhe arsyeja pse Vincennes nuk ngriti çështjen e një institucioni të ri por atë të reformës së një institucioni të vjetër: kur cilësia e programit të saj të filozofisë u vu në pikëpyetje – “A i plotësonte universiteti *gauchiste* standardet arsimore të përcaktuara nga Shteti? A duhen lejuar të diplomuarit e saj të japin mësim në të mesmen?” – Vincennes thjesht luftoi për legjitimizim institucional. Ky ent që përndryshe ishte i reformuar mbeti një institucion që përmbushte një funksion të caktuar arsimor brenda një Shteti modern. Ajo që është akoma më e habitshme është se filozofët që ishin shumë vigjilent rreth çështjeve që kishin të bënin me pushtetin dhe qeverisjen e mbrojtën këtë reformë duke shprehur besime naive si ai i Fukosë: “nëse pyetje të tilla do të shtroheshin në një klasë filozofie, është e qartë se themelet tradicionale do të transformoheshin thellësisht.”<sup>11</sup>

Si ta shpjegojmë këtë naivitet të habitshëm? Si ta shpjegojmë faktin që ai zgjati për shumë vite pas falimentimit institucional të Vincennes, në tekste të mirënjohur si “Universiteti pa kusht” i Zhak Derridasë?<sup>13</sup> Të ballafaquar me procesin e Bolonjës, prerjet e buxhetit të kohëve të fundit dhe mbylljen e departamenteve të tëra, mos duhet vallë të besojmë se Universiteti do të vazhdojë të lejojë, në mënyre të pakushtëzuar, një reformë pa mbarim në emër të Humaniteteve? Apo duhet të besojmë se Universiteti funksionon sipas ndonjë etike ligjërimi habermasiane ku “në çdo moment një fytyrë e re mund të shfaqet befasishtë dhe një ide e re të mbërrij papritur”?<sup>13</sup> Si është e mundur që këta *maitres penseurs* lënë pas dore vetë historinë e Universitetit, faktin se ai lindi nga institucioni i Kishës dhe me kohë e zëvendësoi atë si mishërimi institucional i marrëdhënies së një shoqërie me të vërtetën? Si ia lejuan ata vetes të marrin një qasje thuasje *sub specie aeternitatis*?

Do të merrja guximin të thoja se arsyeja për këtë neglizhim është se mendimi i këtij brezi u formua *brenda* universitetit dhe nëpërmjet një reagimi kritik ndaj pyetjes epistemologjike. Natyrisht që kjo nuk ishte një punë e lehtë – por të paktën nuk ishte as e pamundur. Asaj i duhej një brez i mëparshëm që ishte ndërkaq aty që të sanksiononte këto hulumtime. Nuk mund të kishte pasur një Fuko ose një Derrida pa një Kangilem [*Canguilhem*], një Hipolit [*Hyppolite*] ose një Altyser [*Althusser*]. Kurse sot brezi i pedagogëve tanë është i çarmatosur nga ana institucionale. Jo sepse ky brez doli konformist por sepse ai e shtyu Universitetin deri tek caqet e tij – caqe që janë gjithçka veçse të pakushtëzuar. Historikisht, vetë rrethanat materiale të brezit të pedagogëve tanë janë bërë armiqtë e tyre më të mëdhenj. Por përgjegjësia nuk bie mbi ta. Përkundrazi, ajo bie mbi ne. Në emër të asaj që pedagogët tanë u përpoqën të arrinin jemi ne ata që sot na bie përsipër të bëjmë atë që ata nuk mundën: të kapërcejmë universitetin.

### Pedagogji përtej – njohjes

A mund të pretendojmë se një zhvendosje (nëse jo një kapërcim) i tillë nuk ka ndodhur tashmë? Duke patur parasysh lidhjet që shumë prej miqeve të mi dhe pjesëmarrësit e pranishëm kanë me institucione si “European Graduate School,” “Le Collège International de Philosophie” apo “Jan Van Eyck Academie,” do të ishte e pafalshme të mos i merrja ato në konsideratë. Dhe vërtetë që duket sikur këto struktura kanë marrë përsipër prej universitetit pedagogjitë e disiplinave të mbetura të sipërpërmendura dhe i kanë mirëpritur ato në një ambient të ri institucional. Sa të sigurt jemi ama se këto institucione janë risiprurëse dhe joemulative? Arsyeja për dyzimin tim qëndron në faktin se shumë nga trajtat e tyre administrative japin shenjat e një *mauvaise conscience*. Më lejoni të shpjegojem.

Shumica e institucioneve të lartpërmendura kanë një strukturë që na kujton shumë atë të departamenteve të Universitetit: disa japin diploma masteri dhe doktorata për të cilat një student duhet të paguaj një shumë relativisht të madhe parash. Në rrethana të tilla, ato janë të detyruara të legjitimizojnë rëndësinë e programeve të tyre para klientëve të tyre si dhe akademisë. Të tjerë përpiqen të fitojnë legjitimitet duke ndërtuar marrëdhënie me universitete dhe departamente të caktuara, duke e rifutur punën e tyre brenda institucionit të cilit duan t’i shmangen. Sigurisht që unë jam i ndërgjegjshëm për faktin se një lloj legjitimizimi institucional së bashku me krijimin e nevojshëm të marrëdhënieve janë faktorë të rëndësishëm për financimin. Dhe në



fakt mendoj se financimi është një nga çështjet më të rëndësishme përsa i përket së ardhmes së pedagogjive tona. Jo vetëm sepse ekzistenca e çdo instituti varet prej tij, por kryesisht sepse financimi institucioneve nuk duhet t'i pengoj ato të arrijnë atë që duan.


Kështu, propozoj të zëvendësojmë çdo lloj analize që lidhet me shkatërrimin me vendimin për të krijuar vendndodhje të reja, vende “gjetkë,” vende prej të cilave ne mund të paraprijmë, vende të cilat duhen ndërtuar. Që t’i gjejmë emrin kohës tonë na duhet të krijojmë vende të reja. Kjo do të jetë hipoteza ime e parë. Do ta quaj hipoteza e Nikos [*Nico*],

\* *Shën. i përkth.* – “Diç na u-kalp në mbretëri të Danemarkës.” Përkthyer nga Fan S. Noli.

për arsye që janë të kuptueshme, pasi qysh në prezantimin e tij të parë ai na bëri thirrje “të ekzaminojmë papërgjegjshmërinë e mësimit [teaching] të filozofisë inferemiereve dhe policëve,” të “ndeshemi me të menduarit në treg dhe në rrugë.” Dhe tani *hipoteza e Nikos dhe Nikut* [Nick], pasi Nik na kujtoi se nëse duam të bëjmë diçka duhet thjesht të fillojmë, se nuk na duhet asgjë tjetër veç vendimit tonë të përbashkët.

Ndoshta diagnoza më e thellë të cilën të gjithë ne këtu e ndajmë është mospërputhja midis shkollimit ekzistues dhe të menduarit. Në fund të viteve gjashtëdhjetë, Lakan [Lacan] e cilësoi ligjëratën e Universitetit si “ligjëratën e dijes.” Ai kishte vënë në dukje që më parë tensionin dhe konfliktin që ekziston midis dijes dhe të vërtetës, midis dijes dhe mendimit: dija ishte diçka e ngjashme me shpurjen dëm të së vërtetës ose me kufomën e mendimit. E megjithatë, asokohe Universiteti dhe shkolla vazhdonin të ofronin dije pa bllokuar mendimin. Sot, përkundrazi, ajo që ne përjetojmë është se institucionet arsimore shkatërrojnë të menduarit, në nivele të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme: por ato funksionojnë pirkërisht kështu. Rrjedhimisht, ne kemi ndjesinë se *të japësh mësim do të thotë të luftosh për të rindërtuar aftësitë e përbashkëta të të menduarit*. Pra, *të menduarit duhet të përbëjë thelbin e çdo lloj praktike të re shkollimi*. Kjo hipotezë e dytë duhet quajtur *hipoteza e Julias*, pasi ajo shtroi pyetjen: “prej ku mund t’i bëjmë thirrje këtij lloj mendimi sot? Të mendojmë të menduarit sot?”<sup>5</sup>

Në fakt, hipoteza e Julias përmban dy pyetje: pyetjen e “të menduarit, sot,” dhe pyetjen e “mendimit të së sotmes.” Ne duhet jo vetëm të rindërtojmë aftësitë e përbashkëta të të menduarit por edhe të krijojmë kapacitete të reja për mendimin e të sotmes. Ky propzim thëllon diagnozën dhe për pasojë edhe detyrën tonë: institucionet ekzistuese të shkollimit jo vetëm që nuk e ushqejnë të menduarit, ato pengojnë mendimin. Megjithë deklaratat zyrtare mbi domosdoshmërinë e përshtatjes së Universitetit dhe shkollave me botën e sotme është më se e qartë se këto nuk prodhojnë as një mendim as edhe një dije të vërtetë të kësaj bote. Kjo është një nga arsyet pse unë mendoj se institucionet arsimore tashmë kanë marrë fund – edhe në ato raste kur ato vazhdojnë të mbijetojnë, dhe sidomos kur ato transformohen për t’u përshtatur me botën ekzistuese. Kjo hipotezë e tretë duhet të na shtyjë *të braktisim çdo reflektim që majftohet me hetime kritike dhe të na hedhë në pyetje që kanë të bëjnë me pohimin, imagjinatën dhe sajimin*: Çfarë jemi ne të aftë të skicojmë si aksin e një mësimdhënie të re? Kjo hipotezë e meriton të quhet *hipoteza e Adamit*: a nuk është pikërisht ai, mes tërë nesh, që në mënyrë pasionante bëri thirrje për “një hapësirë që të mund të strehojë shfaqjen e imagjinatës së pamposhtur”?

Megjithatë, “sot” nuk është e vetmja gjë që duhet të mendojmë. Ne duhet të ripërvetësojmë një histori të kaluar akoma të heshtur dhe të hapim të tashmen tonë ndaj një të ardhmeje. Dua të them: ne duhet të krijojmë forca të reja, fuqi të reja, për të ndikuar mbi atë që do të vijë. Puna jonë e përbashkët duhet të na përforcojë, secilin prej nesh, në ballafaqimin me realitetet shkatërruese në të cilat jetojmë të gjithë ne. Disa çështje vihen në lojë këtu: *a vazhdojnë të jenë të ashtuquajturat Humanitete një manual për t’u bërë përsëri njeri? Si mund të punojmë për konstruktive demokratike që luftojnë monopolet e pushtetit? Si do ta përballojmë dhunën ndaj mosdijes, dhe të mësojmë të krijojmë prej një mosdijshmërie [unknowability] imanente? A do të jemi të zotët të sajojmë një “arsim mërgimtar” për të gjithë, në vend të përfshirjes sociale për më të dobët, për “njeriun nën njeriun nën njeriun,” – portretin e fuqishëm të të cilit Stevens [Stevens] e skicon në fund të poe-*

zisë së tij të mahnitshme të fundit të viteve tridhjetë: “Owl’s Clover”? Sigurisht që këtij grupimi të katërt pyetjesh mund t’i vinim disa emra, por unë do të propozoj ta quajmë *hipoteza e Vinsentit* [Vincent] për ta falenderuar atë që imagjinoi, dhe organizoi takimin tonë këtu: një vend i parë ku këto çështje kyçe mund të fillojnë të diskutohen.

Tani do të doja të futem më në brendësi të tre pikave:

1. Çfarë mund të mësojmë prej ekzistencës historike të Universitetit dhe shkollës?
2. A duhet t’i mbrojmë Humanitetet, apo të sajojmë një grupim të ri disiplinash johumane?
3. Cilat do të mund të ishin disa parime dhe orientime fillestare?

### Çfarë mund të mësojmë prej ekzistencës historike të Universitetit dhe shkollës?

Mao e kishte për zakon të thoshte se: nëse duam të hetojmë një çështje, duhet të fillojmë me studimin e historisë së saj. Unë do të ndjek këtë metodë. Mendoj se sot historia na duhet për t’iu kundërvënë një lloj “esencializimi” të së tashmes. Ajo që unë quaj “esencializim” është një mënyrë për të transformuar gjithçka që ekziston sot në esenca të përjetshme, të vlefshme edhe për çka ekzistonte më parë. Ne na duhet historia për të zbutur shikimin dhe për t’u bërë më imagjinativë. Duhet të shtoj se nuk e shoh Historinë si të tillë si një çështje faktesh objektive. Siç e kuptoj unë, kur punoj me të, Historia lidhet me vetëqenësi [singularities] dhe ndërprerje. Unë jam e interesuar në “processus,” në atë që shfaqet dhe atë që mbaron – domethënë: në identifikimin e vazhdimësive si momente problematike të asaj që ekziston.

Në vendet Perëndimore, Universiteti ka ndërkaq dy fytyra: Universitetin e Mesjetës, dhe Universitetin Modern Evropian. Asnjë lloj vazhdimësie midis këtyre dy fytyrave. Të dyja qenë sajime rastësore [contingent] dhe vetëqenësore. Përpyekja e parë mendore e jona duhet të jetë të pranojmë që as universiteti e as shkolla nuk janë institucione të përherëshme: mjeshtrit dhe nxënësit kanë ekzistuar gjithmonë, ndërsa universiteti dhe shkolla jo. Ato filluan dikur dhe do të mbarojnë dikur. Dhe unë jam e bindur se *universiteti dhe shkolla kanë marr fund tashmë, edhe pse diçka vazhdon të ekzistoj nën këta emra*. Ne nuk duhet ta ndajmë fatin e universitetit prej fatit të shkollave të mesme. Në Francë, për shembull, institucionet e mesme janë bërë vende shtypëse dhe shkatërruese për dy të tretat e vajzave dhe djemve të rinj: vitin që shkoi, 900.000 prej tyre kishin lënë shkollën dhe kishin mbetur pa asnjë lloj shkollimi. Ne nuk mund të imagjinojmë se Universiteti do të mund të mbijetojë kur arsimi i mesëm tashmë i kundërvihet rinisë.


Kjo nuk do të thotë se ne nuk mund të bëjmë më asgjë në universitet ose në shkollë. Por ne duhet të jemi të dijenishëm se klasa është shkalla e çdo aksioni të mundshëm, dhe se ajo nuk ka aftësinë për të transformuar institucionin në tërësi. Kjo është ndoshta një prej arsyeve pse unë nuk i përkita kurrë asnjë universiteti, dhe dhashë mësim vetëm në vende ku njerëzit ishin vullnetarë: “Collège international de philosophie” në Paris, “European Graduate School,” “Atelier La Vignette” në Montpellier...

Nuk është ky vendi për t’u futur në detaje rreth Universitetit të Mesjetës, por mendoj se është e rëndësishme të kujtojmë dhe të theksojmë disa tipare të lindjes dhe fatit të tij.<sup>3</sup> Në origjinat e Universitetit të Mesjetës gjejmë ekzistencën e njerëzve endacakë, që











ndiqnin ata që zgjidhnin si mjeshtrit e tyre, mjeshtrit e tyre intelektualë. Këta mjeshtrë jepnin mësim në lloj-lloj vendesh, duke qenë se ata vetë ishin mjeshtrë endacakë. Abellar, për shembull, ishte njëri prej tyre, dhe i famshëm për mësimin e “dialektikës”: faktin se ai i bazonte argumentet e tij vetëm mbi resurset e mendjes së tij, duke refuzuar çdo kthim ndaj traditës dhe autoriteteve.

Në thelbin e lëvizjes që do të çojë drejt krijimit të universiteteve të mirëfillta, gjejmë ato që unë propozoj t’i quajmë tri pohime emancipuese:

I PARI: pohimi se “on ne peut croire ce qui ne se comprend pas” – “dikush nuk mund të besojë atë që nuk është e kuptueshme.” Kjo do të thotë: ne duhet të çlirohemi prej mbizotërimit të besimit, dhe ndikimit të Kishës. Ose, siç thotë Bernardi nga Chartres: “Je refuse de suivre en captif la chaîne d’une autorité affabulatrice – Unë refuzoj të burgosem në zinxhirët e sajimeve imagjinare të cilitdo autoriteti.”

I DYTI: bindja se të gjithë punëtorët njerëzor duhet t’i përkasin të njëjtës tërësi, një bashkësie unike. Fshatarët dhe artizanët nuk duhen veçuar prej artistëve dhe intelektualëve. Kjo ide ka pasoja të mëdha në shfaqjen e degëve të reja në shkollim: fizika, mekanika, ekonomia dhe, sigurisht, dialektika, iu bashkangjiten disiplinave të mëparshme – gramatikës, retorikës, aritmetikës, muzikës, gjeometrisë dhe astronomisë. Emri “Artet Liberale” mishëron teknikën e zgjuar e çfarë do të thotë “të bësh.” Kështu pra, të mendosh dhe të bësh janë të lidhura ngushtë.

I TRETË: Shumësia e origjinave, dhe shumësia e kohëve. Çdo vend mësimi është ndërkombëtar, mjeshtrit dhe nxënësit vijnë prej gjithandej, dhe mjeshtrave më të përgatitur iu lejohet të japin mësim kudo. Universitetet nuk kanë as nevojë t’i përmbahen mësimi të lartë: pjesëmarrësit e tyre shkojnë nga tetë deri në tredhjetë e pesë/dyzet vjeç.

Në fakt, lindja e Universitetit Mesjetar mbështetet nga një tendencë kolektive vigoroze të cilën Zhilber [*Gilbert*] nga Tournai e ka përmbledhur mjaft mirë: “Jamais nous ne trouverons la vérité si nous nous contentons de ce qui est déjà trouvé – ne kurrë nuk kemi për ta gjetur të vërtetën nëse kënaqemi me atë që kemi gjetur.” Dhe, “la vérité est ouverte à tous, elle n’a pas encore été possédée tout entière – e vërteta është e hapur për këdo, askush asnjëherë nuk ka qenë pronari i saj.” Kjo tendencë ekziston si një pjesë e veçantë e qytetit, megjithëse nuk ka një vend të saj, ndërtesa të mirëfillta, duke u strehuar në kisha apo kuvende. Në Paris, artizanët, tregëtarët dhe njerëzit e varfër përbënin “Qytetin e Madh”; fisnikëria, Oborri dhe Kisha përbënin “Qytetin”; dhe studentët dhe shkollat e tyre ishin “Universiteti.” Sigurisht, ato janë pjesë e zhvillimit urban, e lëvizjes së përbashkët, e organizimit të zanateve të ndryshme nëpër qytete. Por instistoj: lëvizja është pikësëpari intelektuale. Ajo mbart vendime të reja dhe kritike për intelektualizmin. *Një vullnet tërësisht i ri intelektual do të shprehet, dhe ekzistenca e tij paraprin ekzistencën e çdo institucioni zyrtar, apo iniciative shtetërore.*

Kjo është kaq e vërtetë sa, kur këto vendime morën fund, natyra e universitetit ndryshoi thellësisht: në shekullin e 14-të, kur Shtetet, Papat dhe Mbretërit krijuan një numër të madh universitetesh, mësimdhënia bëhet mendjengushtë, amullohet. Ky

është momenti kur njerëz si Rabële [*Rabelais*], Montenjë [*Montaigne*], ose poeti Fransua Vilon [*François Villon*] tallën hapur “Sorbonagres” dhe “Sorbonicoles” (siç i quan Rabëleu). Qysh prej këtij momenti, “Sorbonne” mishëroi një dije të rremë. Krijuesit dhe mendimtarët nuk ishin më të lidhur me universitetin. Për një periudhë të gjatë, arsimimi dhe shkollimi ranë edhe një herë në duart e Kishës. Të kujtojmë se si, në fund të shekullit të 18-të, njerëz si Hegel, Hëlderlin [*Hölderlin*] dhe Sheling [*Schelling*] u shkolluan nëpër seminare, – domethënë, në kolegje trainimi për priftërim (“Stift” në Tübingen, ku ata u takuan, kishte për qëllim të përgatiste meshtarë). Dhe të kujtojmë se si, për njerëzit e pasur, shkollimi ishte një biznes mësuesish privat, – (dhe pikërisht e vetmja mënyrë që gjeti Hëlderlin për t’iu shmangur përgjegjësisë së tij për të priftëruar).

Çfarë mund të nxjerrim prej mënyrës se si lindi Universiteti Mesjetar? *Mendoj se duhet të fiksojmë faktin se pretendimet e reja intelektuale, parimet të reja në lidhje me dijen dhe mendimin, janë origjina e vërtetë e çdo institucioni të ri arsimor.* Më pas do të përpiqesha t’ju tregoja se si mësimsdhënia dhe shkollimi janë gjithmonë të lidhura, jo me historinë e zakonshme të Shtetit, por me vendime emancipuese kritike, që mundet (ose jo) t’i imponohen Shtetit. Në fakt, do të doja të komentoja se pse Regan ishte i justifikuar kur shtroi pyetjen në vitet tetëdhjetë: “Pse duhet të subvencionojmë kuriozitetin intelektual?” Kjo është një pyetje e vërtetë: Pse duhet një Shtet të subvencionoj kuriozitetin intelektual? Ne kemi një përfytyrim naiv të Shtetit kur imagjinojmë se arsimimi dhe shkollimi janë gjithmonë një prej funksioneve të tij. Dhe sidomos sot, kur Shtetet Perëndimore po shpëputen prej të gjitha funksioneve të tyre pozitive.

Universiteti Modern është produkt i Revolucionit Francez<sup>3</sup>: fillimisht përmes krijimit të “Shkollave Qëndrore” [*Ecoles centrales*] jetëshkurtra – të organizuara pas debatesh të gjata dhe të ndërlikuara në Konventën revolucionare –; më pas, përmes sajimit të “Instituteve të Larta Shkencore,” të krijuara prej parimeve të Humboltit [*Humboldt*] pas të njëjtës vazhdimësie. Me “Shkollat Qëndrore,” të gjitha shkencat që fetë dhe kishat kishin dëbuar prej arsimit papritmas hynë në shkollë: mbi të gjitha, studimi i dukurive natyrore dhe fizike, si dhe ai i fenomeneve historike dhe sociale. Një tjetër risi e madhe ishte ekzistenca e mësimeve falas: çdo student mund të zgjidhte klasat të cilat ai donte të frekuentonte dhe të organizonte lirisht planin e vet mësimesor. Kjo mundësi lidhej me bindjen e re se dija nuk duhej konceptuar më si një sistem hierarkik ekskluziv por si kërkim i lirë dhe i pakufizuar.

Disa vite më vonë, Humbolt parashtroi një ide që do të mund ta quanim themelin aksiomatik të universitetit Modern: studentët kishin nevojë për mësues, por mësuesit kishin akoma më tepër nevojë për studentë, sepse *dija është diçka tërësisht e hapur, asnjëherë e përfunduar, vazhdimisht në zhvillim.* Mësuesit dhe studentët janë, potencialisht, të barabartë: për më tepër, *mungesa e dijes nuk është diçka negative; përkundrazi, ajo luan një rol vendimtar dhe aktiv në prodhimin e dijes.* Në fakt, një dallim madhor po shfaqej: ai midis “dijs” dhe “mendimit.” Por, të paktën në momentin e themelimit të tij, Universiteti Modern duhet kuptuar si një vend ku zhvillimii aftësisë të secilit për të menduar ishte një objektivi kyç. Roli i luajtur prej atyre që nuk kanë dije konsiderohet thelbësor për të rinovuar dijen dhe për ta mbajtur atë të hapur.

Do të shtoj se ekzaktësisht e njëjta situatë shpjegon lindjen e arsimit laik, pa pagesë dhe të detyruar të fundit të shekullit të 19-të në Francë: në 1871, përgjatë gjashtëdhjetë ditëve që vazhdoi, Komuna e Parisit e kishte shpallur ndërkaq këtë lloj arsimit të

detyruar për të gjithë fëmijët, nga gjasthë deri në pesëmbëdhjetë vjeç, – duke përfshirë edhe krijimin e shkollave për vajzat, dhe sajimin e shkollave të para profesionale ku punëtorëve iu kërkohet të jepnin mësim. Njerëzit u ngritën kundër fesë, kundër individualizmit, kundër Rendit, Familjes dhe Pronës Private, të cilat ishin motoja e ushtrive Franceze dhe Prusiane që ata duhet të përballnin. Kështu Komuna e Parisit vendosi se mësimdhënia duhet të bazohet mbi metoda eksperimentale dhe shkencore, dhe duhet të ketë si pikënisje vrojtimin e fakteve – fizike, intelektuale ose morale.

Një tjetër temë madhore ishte: të gjithë duhet të jenë të aftë të kalojnë nga shkolla tek vendi i punës, dhe të zhvillojnë mendjen ndërkohë që fitojnë jetesën e tyre:

Il faut qu'un manieur d'outil puisse écrire un livre [...] sans pour cela se croire obligé d'abandonner l'état ou l'établi. Il faut que l'artisan se délasse de son travail journalier par la culture des arts, des lettres ou des sciences, sans cesser pour cela d'être un producteur\* – Duhet që një punëtor krahu të mund të shkruaj një libër [...] pa besuar se është i detyruar të braktisë morsën ose stolin e punës. Duhet që artizani të bëjë pushim nga puna e tij e përditshme nëpërmjet kulturës dhe artit, letrave ose shkencave, pa pushuar ama së qeni një prodhues.

Do të dalloni këtu idenë marksiste të punëtorit polivalent, – në pritisje të njerëzimit polivalent –, dhe refuzimit të çdo lloj ndarjeje midis punës së krahut dhe punës intelektuale. Me gjithë shtypjen e përgjakshme të Komunës prej të njëteve burra që do të krijonin Republikën e Tretë mbi rrënojat e saj, Shteti i mëparshëm duhej të ndryshonte: për sa i përket arsimit, ai duhet të ngrinte shkollimin laik, pa pagesë dhe të detyruar – të imagjinuar dhe shpallur pikërisht nga Komuna e Parisit. Pse e theksoj këtë pikë të fundit? Sepse këtu *ne gjejmë një fill që do të mund ta ndiqnim: risitë arsimore janë të lidhura me vazhdimësi empancipuese dhe progressive. Mund të ndodh që Shteti të jetë i interesuar në këto risi, por origjina e tyre nuk i përket aparatit shtetëror*. Kjo duhet të na japi zemër, të na inkurajojë të promovojmë idetë tona mbi arsimin. (Dhe justifikon plotësisht faktin se këtu ne nuk duhet të diskutonim vetëm përpjekje pedagogjike, por edhe disa eksperiencia të reja politike dhe artistike.)

Për më tepër, jo vetëm fillimet por edhe qëllimet e Universitetit Modern vareshin nga rrethana politike. Me këtë kam ndërmend një sprovë të fortë të Alessandro Russos, “Fatet e Universitetit [*Destini dell' università*]” publikuar në revistën *Polygraph* në 2007, në një numër të veçantë të saj (titulli i të cilit ishte: “Ka Studentë brenda Universitetit”). Jam dakord me vizionin e Alessandro Russos për vazhdimësinë e fundit **pozitive** të universitetit Modern: në Evropë dhe në Amerikën e Veriut, universitetet ishin në kulmin e tyre gjatë viteve 1945–1965 për arsye politike që kishin të bënin me Luftën e Ftohtë. Fusha e betejës nuk ishte vetëm ushtarake, ajo ishte gjithashtu civile, një ballafaqim paqësor e megjithatë mjaft serioz: Shtetet Perëndimore duhet të tregoheshin të barabarta me Shtetet Socialiste, për sa i përkte arsimit dhe shkollimit. Dhe në vitin 1945 ato ishin shumë larg sistemeve Socialiste të arsimit.

Do të mbroj idenë se ajo që i dha fund universitetit Modern nuk është neo-liberalizmi, por lëvizjet politike të viteve shtatëdhjetë kudo në botë, – që nga lëvizjet Perëndimore e deri te Revolucioni Kulturor kinez. Në fakt, sot liberalizmi është duke shkatërruar *po ato vende që ndërkaj ishin deklaruar të dala nga përdorimi nga këto lëvizje, kur ato*

*u ngritën kundër botëve ekzistuese (kapitaliste dhe socialiste).* Studentët e mobilizuar dhe punëtorët kërkuar vende të tjera ku mund të mësonin të gjithë bashkë. Zhvillimet më vendimtare ndodhën në Kinë: kur mijra punëtorë pretenduan se as Shteti Socialist dhe as Partia Komuniste nuk e dinin se çfarë është në lojë për puntorët në fabrikat socialiste.

Në fjalët e mia, do të thoja se, nga pikëpamja e këtyre punëtorëve, Shteti Socialist dhe Partia Komuniste nuk jepnin më një dije të vërtetë që do të mund të identifikonte një figurë të re të fabrikës dhe të punës. Mendimi duhej hapur edhe një herë, dhe kjo nënkuptonte se cilido duhej të bëhej i aftë për të menduar vetë se çfarë shtegjesh të reja duheshin sajuar. Siç e dini, çështja shkaktoi trazira të mëdha dhe hapi një boshllëk, një hendek, në politikë. Dhe ky boshllëk vazhdon të jetë këtu... Kjo është një pike madhore. Sepse ai nuk është vetëm një boshllëk në dhe brenda politikës, ai është gjithashtu një boshllëk që ka të bëjë me njerëzimin, një boshllëk që heshtazi sa vjen e zmadhohet, duke na lënë përballë një lloj caku. Shumë njerëz sot përjetojnë një figurë të dëshpëruar të punës së tyre. Si mundet puna intelektuale të jetë e qartë dhe e fortë kur çdo lloj tjetër pune është e dëshpëruar? Poetët kinezë e kanë përjetuar një boshllëk të tillë. Le të dëgjojmë Meng Lang, që shkruajti në vitet tetëdhjetë: “Poetët jetojnë në pikat e verbëra të historisë. Kushdo që ka një vizion historik nuk mund t’i shohë ata. Vetëm në shekullin e njëzetë, njerëzimi zbuloi ekzistencën e këtyre pikave të verbëra në histori. Poetët i kanë zbuluar ato.” Për mua, këto pika të verbëra iu referohen vendeve, ose momenteve, kur njerëzimi zbulon se është ballë për ballë me boshllëkun prej të cilit është brumosur – duke iu dashur të vendosë si do të mund, nëse do të mund, të vazhdojë të sajohet vetveten. A do ta kalojmë këtë limit? A do të mundim të hidhemi përtej vetvetes?

#### **Të Mbrojmë Humanitetet, apo të krijojmë një grupim të ri disiplinash johumane?**

Do guxoja të thoja se kriza e disiplinave që quhen “Humanitetet” ka të bëjë me paafëtesinë e tyre totale për ta zhvilluar këtë pyetje më tej. Biologjia, ekonomia, gjuhësia, sociologjia, letërsia dhe filozofia akademike kishin për qëllim të zhvillonin diçka të ngjashme me një vizion të bashkuar të njerëzimit. Do të thoja: një vizion të njerëzimit si të “plotë” – një “njerëzishmëri e plotë.” Duket sikur tashmë një vizion i tillë nuk ekziston më. Ose se ai mbijeton si një figurë e vdekur, pa fuqi, pa ndikim. Ose, akoma më keq, se ai është bërë velloja e neveritshme e natyrës së vërtetë të botës në të cilën ne jetojmë. Dhe mendoj se kjo është arsyeja kryesore pse këto disiplina mund të sulmohen kaq lehtë, dhe të hidhen mënjandë, prej Shteteve neoliberales kudo.

Le të dëgjojmë një mbështetëse të të ashtuquajturave “Humanitete,” dikë që është njëkohësisht e ndërgjegjshme për krizën në të cilën ato ndodhen dhe në ankth për të rivendosur ekzistencën e tyre. Cilat janë argumentat? Do të frymëzohem prej një libri të Marta K. Nusbaumit *Jo për fitim: Pse demokracia ka nevojë për Humanitetet* [*Not for Profit: Why Democracy Needs the Humanities*].

Sot, në shumë kolegje dhe universitete programet në humanitete ose në artet liberale tkurren, kur nuk priten fare, në favor të një fokusi mbi teknologjinë dhe trainimin e ngushtë profesional.

Duket si një konstatim i thjeshtë. Por ne duhet t’i kushtojmë vëmendje ndarjes që pranohet dhe vepron këtu: nga njëra anë (ana e drejtë), humanitetet; nga ana tjetër (ana



e gabuar), teknologjia dhe trainimi profesional. Po pse duhet ta përçmojmë teknologjinë dhe trainimin profesional? Unë nuk jam e gatshme t'ju a dorëzoj ato armikut! E megjithatë kjo ndarje paraqitet sikur ka vlerë në vetvete, dhe natyrisht i bashkangjitet një diagnoze pesimiste:

Nëse përplasja e vërtetë e qytetërimeve është një përplasje brenda shpirtit njerëzor – kur lakmia dhe narcizimi luftojnë kundër respektit dhe dashurisë – atëherë të gjitha shoqëritë moderne po humbasin shumë shpejt betejën ndërsa ushqejnë forcat që çojnë në shkatërrimin e kulturës së barazisë dhe respektit.

Nuk jam aspak e bindur se diçka e tillë, përplasja e qytetërimeve, ekziston, dhe jam akoma më pak e sigurt se do të arrija të njihja versionin e saj e majtë – “një përplasje brenda shpirtit njerëzor.” Kështu që nuk habitem aspak me faktin se prognoza mbi këtë sëmundje është pesimiste: “ne po humbasim betejën.” Kultura e barazisë, respektit dhe dashurisë po humbet betejën para lakmisë dhe narcizimit. Dhe humanitetet janë vendi i fundit ku barazia, respekti dhe dashuria kultivohen. Ne mund të qeshim me një vizion kaq hipokrit të “qytetërimit” tonë pasi ne duhet të kundërpërgjigjemi menjëherë se barazia, respekti dhe dashuria nuk janë realitete mbizotëruese në botët tona! Por, them padashur, këtu thuhet diçka e rëndësishme në lidhje me luftën midis asaj që Frojd quajti “shtysën e vdekjes” dhe “shtysën e jetës.” Në mënyrë paradoksale, është “death wish” që e shtyn njerëzimin përpara, ndërsa e ashtuquajtura “shtysë e jetës” është konservatorja. Dhe kjo mund të jetë një arsye pse lakmia dhe narcizimi mund të jenë më të forta se sa barazia, respekti dhe dashuria, në përgjithësi kur këto mbeten abstraksione të pastra dhe të zbehta.

Pas kësaj paranteze, le t'i rikthehemi analizës së mbrojtëses së Humaniteteve: “Humanitetet dhe artet po hidhen mënjanë në pothuajse çdo vend të botës.” Kjo do të ishte një shenjë e luftës globale midis njerëzimit [*humanization*] dhe çnjerëzimit [*dehumanization*]. Citoj edhe një herë:

Sot, bota jonë pothuajse gëlon me masakra: torturë, terrorizëm, genocid [...] por si mund të luftohen krime të tilla ose të zvogëlohen në mungesë të kultivimit të njerëzimit dhe të qenit njeri – që është pikërisht qëllimi i humaniteteve.

Përsëri ndihem e shtangur: në rradhë të parë prej përshkrimit të ftohtë dhe diskriminues të masakrave të botëve tona. Tre lloje masakrash (torturë, terrorizëm, genocid): lista është e tmerrshme, por e kufizuar, jo e plotë. Për shembull, nuk gjejmë këtu “burrat dhe gratë që bëjnë një jetë stërmundimi” të përshkruar prej Niçes [*Nietzsche*]. Lista është e tmerrshme, por në çdo rast është e pamundur të identifikohen përgjegjësitë. Në fakt, lista është ndërtuar në mënyrë të tillë që të na japë ndjesinë se e keqja vepron në botët tona, por jo të identifikojmë atë që është prishur në to. Dhe që të përballojmë këto masakra, çfarë kemi? Një armë: “humanitetet,” sepse ato spozohet të jenë “kultivimi i njerëzimit dhe njerëzishmërisë.” Të shkretat humanitete! Nuk është për t'u habitur nëse ato humbasin betejën, edhe nëse beteja e tyre nuk do të qe t'i luftonin këto krime por thjesht t'i “zvogëlonin” ato (kujdesi nuk është asnjëherë i tepërt në raste të

tilla!). Por ende nuk kemi arritur në fund të habitjeve tona: në çfarë konsiston “praktika njerëzuese e humaniteteve”?

E thënë filozofikisht, prodhimi i humaniteteve është një e mirë e përbrendshme, në kuptimin se kultivimi i tyre – ashtu si leximi i poezisë dhe luajtja e fyellit – mbart në vetvete një dobi: që është, transformimi i vazhdueshëm dhe njerëzimit i praktikuesit.

Kështu, kundër torturës, terrorizmit dhe genocidit, do të na duhet të kemi besim në këto transformime të praktikuesve. Poetët dhe muzikantët do të vlerësojnë... Humanitetet supozohet të zhvillojnë tre figura kyçe: *Bildung*, kundër rritjes së theksit mbi objektivat e karrierës. Kundër thënieve idologjike, kultivimi i gjykimit të matur: “Lidhur ngushtë me rolin e gjykimit, dhe në shumë pikëpamje strumbulli i humanizmit është konceptimi i bonsensit; si një kapacitet që ushqehet në një komunitet ose kontekst social.” Dhe – së fundi por jo më pak e rëndësishme – kundër përlëvdimit të pafre të privatizimit dhe pëfitimit privat, ndjeshmëri të përbashkët: “Një vullnet për t’i dhënë parësi jo njohjes [*cognition*] abstrakte dhe universale, por eksperiencës praktike, të ushqyer në mënyrë etike në një kontekst social.”

Duke përmbledhur, ne duhet të mbështetemi tek Humanitetet për arsimin e njerëzve për Demokraci, dhe ky arsim do t’i kundërvihej arsimit për Përfitim. Problemi qëndron se: Demokracia vetë është figura kryesore politike, figura qeverisëse, e Përfitimit! Kështu pra dobësia e përbrendshme e këtij pozicioni është e qartë. Ai është thjesht i përmalluar për atë që në frëngjisht ne e quajmë një “shpirt suplementar,” ose “pakëz shpirt” për Shtetet Demokratike – atë që Jonas e quan “demokratizëm”

Është mëse e vërtetë se sot shumica e Shteteve nuk kanë nevojë për kuriozitetin intelektual, vetëm për përshtatjen e njerëzve me punët që ofron ekonomia, dhe natyrën e kësaj pune, – kur puna vetë është bërë diçka e rrallë dhe e shkatërruar. Por unë u habita kur Xhon (që me të drejtë presupozon se “kurioziteti duhet t’i rikthehet klasës që me të drejtë mund ta përballojë të jetë kurioze”) imagjinoi se kjo klasë do të ishte klasa a lartë, klasa mbizotëruese. Nëse nuk gabohem kur e lidh kuriozitetin me dëshirën për emancipim, atëherë ata që mund ta përballojnë të jenë kurioz janë... ne, dhe kushdo tjetër që do të interesohet në risajimin e botëve të tjera. E megjithatë “emancipimi” nuk është një emër i mirë: sepse ajo që ne duhet të mësojmë prej tretjes së humaniteteve është pikërisht se njerëzimi nuk duhet menduar më si “plotësi.” Tani ne duhet të ndërtojmë mbi një boshllëk, dhe duke qenë të ndërgjegjshëm se njerëzimi nuk është veçse një boshllëk. “Njeriu pa cilësi,” tha Muzil, “kafsha pa attribute” ose “kafsha e pahijshme,” Ruso [*Rousseau*] tha, – me përjashtim të aftësisë së saj për të luajtur dhe për të imituar aftësi të tjera shtazore...

Ne urrejmë çnjerëzimin e botëve tona, por pyetja është: prej ku mund të kthehet njerëzimi? Parashtrova idenë për të krijuar një grupim të ri disiplinash johumane. Kjo kërkon një devijim dhe një korigjim të vogël.

### Shtatë parime për të filluar?

Përballë kohëve tona të deziluzionuara, ka një kthim të utopisë: çdo utopi përbëhet prej përpjekjesh për të përshkruar dhe organizuar të gjitha aspektet e një jete të re apo

të një bote të re. Duhet ta keni të qartë se nuk po flas për të imagjinuar një utopi çfarëdo, po flas për formulimin e parimeve. (Parime që janë të mijat kur jap mësim, dhe që mund të na ndihmojnë të ndajmë disa orientime të para kudo që ndodhemi.) Po flas për parime sepse mendoj se është tepër herët, tepër shpejt, për të krijuar disiplina të reja të johumaniteteve. (Megjithëse disa prej nesh ndërkaq janë duke dhënë mësim mbi gjëra që nuk kanë emër.) Por nuk është tepër shpejt për të diskutuar një grupim hipotezash mbi çka duhet të zhvendosim ose mbi çka është zhvendosur në intelektualizim në tërësi, kur ai përpiqet të përballojë kushtet e reja çnjerëzore të njerëzimit?

Në fakt, kam besim se momenti ynë është i ngjashëm me momentin që Altyster përshkruan në një tekst të shkëlqyer mbio Makiavelin, prej të cilit kam marrë hua titullin e leksionit tim. Po iu jap përkthimin tim të këtij teksti të shkurtër:

Mu kujtua Makiaveli, metoda e të cilit (rrallëherë e konstatuar por gjithnjë e përdorur prej tij) është se “të mendosh” duhet të jetë gjithmonë të mendosh prej pikave radikale, që do të thotë prej një pozicioni ku ti e shtron tezën “në skaj,” një pozicion ku, vetëm për të bërë të mundur mendimin, ti vendos të zësh vendin e të pamundurës. Çfarë bëri Makiaveli? Për të ndryshuar diçka në historinë e vendit të tij, dhe rrjedhimisht në mendjen e lexuesit të cilin ai do ta provokojë të mendojë atë që dëshiron, Makiaveli shpjegon se secili duhet të mbështetet vetëm në kapacitetet e veta, që do të thotë, në asgjë – as në një Shtet ekzistues as në një Princ ekzistues – por në të pamundurën që nuk ekziston [për Makiavelin, një Princ i ri në një Shtet të ri].<sup>6</sup>

Ne duhet të mbështetemi në kapacitetet tona, domethënë: në asgjë, përveç asaj që ne do ta quajmë të pamundurën joekzistuese tonën. Kjo nënkupton gjithashtu se detyra jonë e përbashkët duhet të jetë ta bëjmë këtë të pamundur joekzistuese të ekzistojë, fillimisht në mendjet tona, më pas në mendjet e lexuesve tanë, duke i provokuar ata të mendojnë atë që dëshirojnë. Ne duhet të krijojmë dëshirën për të, dashurinë për të, sepse kjo e pamundur joekzistuese do të ekzistojë vetëm nëse ajo dëshirohet dhe dashurohet dhe duhet.

Duhet të jap një tjetër saktësim. Ato që unë quaj “parime” këtu janë diçka mjaft e veçantë: i imagjinoj si disa pika magnetike, që orientojnë busulla të reja, duke hapur kështu trajektore të reja. Ato nuk janë pika rreth të cilave ne duhet të angazhohjmë një mësimdhënie teorike. Ato janë në fakt pika përmes të cilave ne duhet të kalojmë herë pas here kur mendojmë. I deduktova këto “parime” kryesisht prej poetëve – ata që më njohin nuk do të habiten – shtatë parime për të filluar.

1. Në vitin 1974, Robin Blejzer foli për “ata tre armiqtë e mendjes: psikologjia, sociologjia, dhe antropologjia.” Ai shtoi: “Në thelb ky është universiteti.” E gjithë kjo na “përfshin në një realizëm naiv,” “Që reduktohet gjithmonë në shprehjen e një njeriu, shprehjen e personalitetit [...]. Çfarë gomarllëqesh.” Cilët janë “armiqtë e mendjes” për ne sot? Lufta jonë nuk mund të kufizohet me kundërshtimin midis mendimit dhe dijes – kjo ekzistonte edhe në kohën e Universitetit Evropian modern. Ajo merret me një tjetër kundërshtim, atë midis mendimit dhe opinionëve, që sot është një kundërshtim midis mendimit dhe informacionit/komunikimit. I kritikuar ndërkaq prej Platonit,

opinionit merr një rëndësi të re, pikërisht sepse tani ai lidhet me çiftin komunikim/informacion. Ne duhet t'i kundërvëmë jo vetëm të vërtetën dijes, por drejtpërdrejt çiftin dije/e vërteta opinionit. Kjo është një zhvendosje mjaft e madhe. Kur e vërteta dhe dija iu kundërvunë njëra tjetrës, askush nuk e imagjinonte se gjithçka dihej; dija mbeti e hapur ndaj të vërtetës. Tani, të gjithë mund të kenë opinione mbi gjithçka, të bazuara mbi komunikimin universal, d.m.th. qarkullimin e informacionit. Dhe dija është mbyllur, nuk është më një proces në vazhdim e sipër.

Për ta sqaruar këtë ide, do të mbështetem në dallimin që bën Blejzer midis asaj që ai quan “të jesh duke folur” dhe “të kesh qenë folur.” Në vitet shtatëdhjetë, ai e bëri këtë dallim në lidhje me poezinë, por është prekëse të kuptosh se sot i përshtatet situatës tonë globale. Citoj:

Të jesh duke folur do të thotë se ti je në skaj të krijimit të realitetit, me këtë dua të them se ti je duke krijuar realitetin, ti ke marrë përsipër atë përgjegjësi dhe atë detyrë. Dhe ti je në skaj. Gjithmonë. Dhe e panjohura është aty dhe format e saj janë të jashtëzakonshme. Ai skajim është tmerrësisht i rëndësishëm. [...] Tani, të kesh qenë folur nënkupton se ti atëherë bie në sociologji dhe antropologji e kështu me rradhë, se ti je gjithnjë duke rënë në atë që është folur prej kulturës. [...] Të kesh qenë folur do të thotë të bësh pjesë e asaj që është folur dhe kështu të mos flasësh.<sup>7</sup>

Dhe Blejzer vazhdon: kur ti fillon të besosh se ti nuk je më në të tanishmen, por në

diçka që është tjetër dhe tjetërkund, dhe matematicientët e quajnë atë zero, “tjetërkund.” Kur fillon ta kuptosh atë, ajo është një tjetërkund prej një të ardhmeje të kaluar, nuk është tani, është tjetërkund. Dhe atëherë e kaluara ime dhe e ardhmja ime janë gjërat të cilat unë duhet të nderoj... por ajo zero është tjetërkund.

Me duket se këto fjalë mund të rikumbojnë me vullnetin e Kristofer Finskut [*Christopher Fynsk*] për të përcaktuar një vend tjetër, të ri, për shkollimin: në skajet e politikës, tjetërkund. Do t'i rikthehem kësaj çështje të një vendi “tjetërkund” kur t'i drejtohem pyetjes së shumësive. Thjesht kurseni energjinë me të cilën Blejzer pohon kërkesën për të qenë tjetërkund, dhe jo “tani,” nëse doni të flisni dhe jo të keni qenë folur. Të flasësh sigurisht që kërkon aftësi të reja pohuese, që nuk lindin nga mohimi dhe kritika. Siç tha Kaejro [*Cairo*], ne duhet të “mësojmë të çmësojmë” me poetët ashtu si me filozofët dhe matematicienët. Të mësojmë gjithashtu me ata të luftojmë me gjuhën, me patejdukshmërinë e saj, të mësojmë të dallojmë midis mpërhtësisë dhe tejdukshmërisë. Dhe me teatrin dhe artin, të mësojmë të dashurojmë të pamundurur joekzistuese.

II. “TË PUNOJMË GJITHMONË ME ERRËSIRËN, TË PANJOHURËN, DHE TË PAKUP-TUESHMEN” (ROBIN BLEJZER) Kjo duhet të jetë motoja jonë e përgjithshme: të mos i kemi frikë, por të punojmë me to dhe të udhëtojmë përmes tyre. Jo që të mbetemi në errësi, por që kurrë të mos harrojmë të panjohurën, – të zbulojmë vazhdimisht se

ne akoma nuk po kuptojmë atë që duhet të kuptojmë. Botët janë të gjëra, dhe ne ende dimë shume pak se çfarë jemi të aftë të bëjmë.

III. IMPERSONALITETI Këtu Mallarme [*Mallarmé*] dhe Pessoa [*Pessoa*] duhet të jenë mjeshtrat tanë: Mallarme për arsye se atij iu desh të zhduket nga gjuha, që gjuha të mund të flasë rishitazi, “dhe për pasojë të flasë burrërisht sërish” (Blejzer – natyrisht, nënvizon fjalën “burrërisht”). Pessoa sepse heteronimet e tij treguan përfundimisht ndarjen midis personalitetit dhe ligjëratës së tij nga një anë, dhe absoluten nga ana tjetër: çdo heteronim mbart një punë të re poetike, dhe vetë Fernando Pessoa nuk është asgjë veçse një prej këtyre heteronimeve, ndërsa të katërta punët poetike së bashku ndërtojnë një figurë të re dhe komplekse të së vërtetës. Gjysëm-heteronimi, Bernardo Soares, duke shkruar një prozë, komenton: “Në këtë botë do të ketë gjithmonë një luftë që do t’i kundërvëjë atij që do atë që nuk është sepse ajo ekziston, atë që do atë që është sepse ajo nuk ekziston.” Dhe shton: në këtë luftë, as fitorja as vendimi nuk janë të mundura.

IV. PAFUNDËSIA Të mësojmë me Leopardin të duam pafundësinë. Një pafundësi e vendosur gjithnjë midis vetëqenësorive. Xhastin Xhouk foli për “të fundmen e pafund.” Kështu pra një diskutim është hapur tashmë: pafundësi e përcaktuar apo një fundmësi e pafund?

V. RASTËSIA Stivens, tek “Dy ose tre ide,” thotë:

Të shohësh perënditë të shpërbëhen në ajër dhe të treten si re është një nga përvojat e mëdha njerëzore. Ato nuk është se shkuan përtej horizontit për t’u zhdukur për një farë kohe, apo sikur ishin mundur prej perëndish të tjera më të fuqishme dhe më të ditura. Ato thjesht u bën asgjë.<sup>8</sup>

Shpërbërja e perëndive na lë me presupozimin e të vërtetës si një sajim [*fiction*], me kërkesën për të krijuar atë që Stivens e quan “sajimin suprem.”

VI. SHUMËSIA Kundër asaj që unë quaj “tanishmëri,” atë që Blejzer quan presionin e të tanishmes, ne duhet të ndërtojmë një kompleksitet të kohës, të bërë prej shtresash heterogjene, ashtu siç bëri Dante në “Komedinë” e tij vetëm për të kuptuar kohën e tij. Kjo aludon për vështirësinë e bashkëkohësisë, të kërkesës për të qenë dhe për të mos qenë bashkëkohor me kohën tonë. Këtu kemi një kohësi që duhet ta jetojmë.<sup>9</sup> Bashkëkohësia kërkon një “tjetërkund.”

VII. “ËSHTË E PATOLERUESHME TË TOLEROHESH” Do të përfundoj me parimin e polemik, një nga konstatimet më vigoroze të Pazolinit [*Pasolini*]. Kundër korrektesës politike, gjithashtu kundër opinionit se “gjithçka është politikë,” dhe duke sfiduar “studimet kulturore,” do të doja të kujtoheshim për pyetjen e Zhan Zhënesë [*Jean Genet*]: “De quelle couleur c’est, un Noir? – Cila është ngjyra e një zezaku?”

Ideja është se ne mund t'i përdorim këto parime kudo, kur përpiqemi të krijojmë vende të reja, ose kur akoma japim mësim në shkolla të vjetra dhe universitete. Të paktën nëse ju bini dakord se mësuesit dhe nxënësit duhet të jenë, siç shkruan Stivens:

*Mendimtarë pa mendime përfundimtare  
Në një kozmos përherë fillestar.<sup>10</sup>*

## Shënime

- 1 Louis Althusser, "Soutenance d'Amiens," June 1975, në *Positions* (Paris: Les Editions sociales, 1976), 133: "[...] je me souvenais de Machiavel, dont la règle de méthode, rarement énoncée, mais toujours pratiquée, est qu'il faut penser aux extrêmes, entendons dans une position où l'on énonce des thèses-limites, où, pour rendre la pensée possible, on occupe la place de l'impossible. Que fait Machiavel ? Pour changer quelque chose dans l'histoire de son pays, donc dans l'esprit des lecteurs qu'il veut provoquer à penser pour vouloir, Machiavel explique à la cantonade qu'il faut compter sur ses propres forces, c'est à dire en l'espèce, ne compter sur rien, ni sur un Etat ni sur un Prince existants, mais sur l'impossible inexistant: un Prince nouveau dans une Principauté nouvelle."
- 2 Jacques Le Goff, *Les intellectuels au Moyen-Age* (Paris: Seuil, 1957).
- 3 Dominique Julia, *Les trois couleurs du tableau noir/La révolution* (Berlin, 1981).
- 4 Jacques Rougerie, *Paris libre 1871* (Paris: Seuil, 1971), 168–71: "Dans le court temps qui lui fut imparti, la Commune fit parfois autant, sinon plus, que n'accomplira la 3ème République en trente ans."
- 5 *Shën. i red.* – Përkthyer si Alessandro Russo, "Destinies of the University," përkth. Roberta Orlandini, *Polygraph* 21 (2009). Sh. <http://clubpolitico.altervista.org/7destinyofuniversity.html>
- 6 Althusser, "Soutenance d'Amiens," 133. Sh. shën. 1 përcitimin në frëngjisht.
- 7 Robin Blaser, në *The Capilano Review* 6 (Fall 1974). E kam zbuluar këtë libër falë Matthew Beckmann – një student në EGS.
- 8 Wallace Stevens, "Two or Three Ideas," në *Collected Poetry and Prose* (Nju-Jork: The Library of America, 1996), 842.
- 9 Stéphane Mallarmé, "Quant au livre / L'action restreinte," *Variations sur un sujet* (Paris: Pléiade), 372: "Mal informé celui qui se crierait son propre contemporain, désertant, usurpant, avec impudence égale, quand du passé cessa et que tarde un futur, ou que les deux se remmèlent perplexément en vue de masquer l'écart."
- 10 Wallace Stevens, "July Mountain" nga "Late Poems," në *Collected Poetry and Prose* (Nju-Jork: The Library of America, 1997), 476.

# CONSTITUTION OF HAPPINESS

Edited and proposed by the student group at the Atelier de Théâtre de  
La Vignette – University of Montpellier III Paul Valéry, 2012–2013

Translated from French by Drew Burk

## Article 1: Equality

We want equality because, without it, it is impossible to develop our abilities.

We are made to believe that we are not capable of reflection. But one must first of all understand that the student is not stupid and that knowledge is not merely acquired through academic learning. (It is possible to learn outside of academic institutions via our own personal experiences.) We have to steer clear of the idea that a student can no longer work or study after being deemed to have a lack of abilities when, in reality, students have equal abilities to those of the teacher.

We are presented with an already constituted knowledge; we are in its shadow. However, knowledge is not already constituted, it has to be reinvented. Knowledge is perpetual reinvention in order for a new invention of the thing itself to reemerge (a perpetual reorganization of the void). Each discipline has decisive acts in which we would like to participate.

## Article 2: Undoing Individuality

To be an individualist is to think on a case-by-case basis concerning one's own interests and not to think community, i.e. the richness of all the things we can share and make common. Individualism is also linked to the idea of duty.

This huge machine that is the university brings together an enormous amount of students who don't all know each other despite following the same courses of study. The rhythm of courses is often intense. One has to rapidly change classrooms, quickly grab a bite to eat, and then hurry home immediately after class. We merely cross each other's paths every now and then and exchange a glance, but *we do not talk to each other enough*. We have neither the time nor the opportunity to get to know each other better. This situation creates separate groups of individuals each standing apart from the other. There is also a lack of motivation and self-confidence for approaching others.



Moreover, in most cases, students have enormous *pressure* to succeed and this breeds competition where we often don't help each other out enough. The university pushes us toward this rivalry above all during the competitive exams at the end of one's undergraduate studies or master's degree. This is also seen in applying for graduate funding and scholarships or post-doctoral research posts as well as in striving to gain specific honors for one's thesis. When we have an idea, we hold it close like a precious resource and don't share it, we often want all the glory for ourselves, or we are afraid of what others will say about it. Perhaps we often put this pressure on ourselves, and perhaps we also must change our way of looking at things. The university needs to rime with helping each other, pooling common ideas, discussions, and solidarity.

In changing their way of looking at things, we want students to rediscover the desire to learn and reflect. We also want the way courses are taught to change. We want the teacher to arrive in class demonstrating desire for the material presented, and not merely to come to "teach a course," but to familiarize us with a theme, to make us want to explore different areas of research. Various subjects such as literature, mathematics, theatre, history... should be learned differently, perhaps even in *starting from a position of zero knowledge*, in questioning the world and its founding principles. One must reflect and reinvent knowledge.

Thus we believe that the university should be a gathering place of exchanges and not individuality. We want students to be able to more easily gather together and exchange ideas in order to open their minds and learn to *think for themselves... Yes, thinking for oneself, this is the key that will undo individualism...* this may seem a bit paradoxical, but it is indeed in thinking for ourselves that we will undo preconceived ideas, that we learn to confront ideas and not merely take them as already established and unquestionable. Thanks to thinking by ourselves, we can become emancipated from society, and gather at a place in the heart of the university in order to reflect together and not merely within our own area of studies, but we can reflect on other areas of study as well: we need each other in order to move forward. We can wake up the virtues in all of us, even in those students who don't have a desire to reflect: virtues such as curiosity, self-confidence, enthusiasm, sensitivity, and suspicion concerning ready-made ideas. Every one of us has the ability to do this: to take time for reflection. It is up to us to provide ourselves with the means to do so.

In order to be capable of thinking for ourselves, we have to appeal to our experience and cultivate ourselves, read, listen to others, be curious in every area of study. To think for oneself during a heated discussion is the desire to share our truth. It is different than the false, pseudo-truth that the university wants to force on us, and which doesn't help us to live better. The new, we have appropriated it; we have given it importance, legitimacy, and a new existence. Life is revealed to us, as we understand it.

### **Article 3: Exiting the University**

We want to exit the university in order to learn a discipline from the very moment of its creation. The ways in which the courses we are taking are taught don't allow us to do this.

We must find the keys that allow us to understand a discipline in the same way that we visit an exhibit at a museum and we don't have the necessary grounding for understanding it.

A discipline generally has several origins, every population provides part of this origin and thus we should explore all the origins, understand them, and put them together. For example, math was developed thanks to Arabic cultures and the ancient Egyptians. Literature as well has various origins.

The goal then is to research and learn how a discipline emerged, how the first thinkers perceived it, and ask what usefulness it might have in our own society...

Thus we can think about a *prosopopoeia of disciplines*: the discipline asks its creator: "why have you created me?"

With this same goal in mind, we want to exit the university in order to make an inquiry alongside those who do not have knowledge in a specific discipline. Let's use the example of literature: we could pass out several different genres of literature to workers or others who have not had access to knowledge in the same way we have, and we can ask them what literature is for them, we can ask them what they think of the text we provided them. They will surely see different things in the literature than us. We can learn from them and see how, without any particular specialty of knowledge, one can learn and apprehend a text. (Such as returning to the zero level of knowledge in reading a text by Shakespeare.) We will discover various points of view and this will show how learning and knowledge production is within each person's grasp.

We must also inquire into how those working in the same academic disciplines as our own in other countries where the ways of thinking and doing are different. Example: a chemist in France works with new technological advancements and a chemist in Guinea works on helping children suffering from malnutrition.

Each academic discipline is like an art form. They were developed by creative and scientific acts, revealing the genius of the human being, the human being's force of thinking and seeing the world. We can thus apprehend a discipline in confronting it with artistic disciplines such as cinema and theatre in order to see how they are perceived.

### **The Gathering Place**

We would like a gathering place for students outside of the university where we could recreate the actions that created a discipline or we will redefine them starting again from zero.

Example: meeting up in the city center and asking ourselves how things would be different if this or that discipline didn't exist or was not there. We could also, without any specific preference to a certain area, create a discipline or reinvent one.

Another example: we could create a project that, thanks to the collaboration of various disciplines, would provide a service to everyone. This would have to be a project that would strive to be long term. Example: a useful object, where we would have mathematicians and sociologists... No, we don't want sociologists! We would bring together philosophers, mathematicians, cabinetmakers, technicians, and graphic artists who would work on it.



# KUSHTETUTA E LUMTURISË

Hartuar dhe propozuar nga grupi i studentëve të Ateliesë së Teatrit të La Vignette – Universiteti Montpellier III Paul Valéry, 2012–2013

## Neni 1: Barazia

Duam të kemi barazi sepse pa të, është e pamundur të tregojmë aftësitë tona.

Na bëjnë të besojmë se nuk jemi të aftë për të reflektuar. Por në fillim duhet pranuar se nxënësi nuk është budalla dhe se dija nuk fitohet vetëm me mësimet shkollore (Nga eksperiencat tona personale, është e mundur të mësosh edhe jashtë institucionit të shkollës). Duhet bërë çmos që nxënësi mos të punojë më i zhvlerësuar, për shkak të mohimit të aftësive të tij, ndërkohë që aftësitë tona janë të njëjta me ato të pedagogëve.

Na paraqesin disa dije si të krijuara tashmë dhe ne duhet të jemi nën hijen e tyre. Mirëpo, dijet nuk janë të krijuara, ato duhet të rikrijohen. Dijet janë një rizbulim i vazhdueshëm që mundësojnë shfaqjen e një krijimi të ri të vetë gjëjës (riorganizimi i vazhdueshëm i boshit). Çdo disiplinë përmban akte vendimtare ku ne duam të marrim pjesë.

## Neni 2: Mposhtja e individualitetit

Të jesh individualist, do të thotë të mendosh rast pas rasti për interesat e tua dhe jo për atë që kemi të përbashkët, pra për pasurinë e të gjithëve, atë që mund ta ndajmë së bashku. Individualizmi lidhet gjithashtu me idenë e detyrës.

Universiteti, kjo makineri e madhe, mbledh një numër të madh studentësh, të cilët, ndonëse janë në të njëjtën degë, nuk njihen të gjithë me njëri-tjetrin. Ritmi i mësimit ndonjëherë është mjaft intensiv, duhet të ndërrosh sallë sa më shpejt, po ashtu duhet të hash me shpejtësi dhe pastaj të kthehesh në shtëpi menjëherë pas mësimit. Ne vetëm kryqëzohemi me njëri-tjetrin në rrugë, shkëmbejmë herë pas here ndonjë vështrim, por *nuk flasim sa duhet*. Nuk kemi as kohën dhe as rastin për t'u njohur më mirë. Si pasojë, krijohen grupe individësh që rrinë më vete nga njëri-tjetri. Ka gjithashtu një *mungesë motivimi dhe besimi në vetvete* për të shkuar drejt të tjerëve.

Për më tepër, studentët kanë një *presion* të fortë për të dalë mirë me mësim. Po ashtu, tek një pjesë e madhe jona lind ndjenja e konkurrencës dhe në këtë mënyrë nuk ndihmojmë – ose jo aq sa duhet – njëri-tjetrin. Universiteti na nxit drejt këtij rivaliteti, sidomos kur konkurset janë çelësi në fund të bachelorit apo masterit, si dhe gjatë dhënies së bursave të studimit sipas meritës së temës, apo nëse ka vende të lira pune pranë studuesve në fund të doktoratës. Kur kemi ndonjë ide, ne e përvetësojmë atë si një aset të çmuar, nuk e ndajmë me të tjerët, ndonjëherë duam gjithë lavdinë për vete apo kemi frikë nga vështrimi i të tjerëve. Ndoshta ne ia imponojmë vetes këtë presion dhe duhet që të ndryshojmë mënyrën se si i shohim gjërat dhe universiteti, si vend kërkimor, rimon me *ndihmën e ndërshjelltë*, me bashkimin e ideve, diskutimeve, solidaritetit.

Ne duam që studentët të rigjejnë dëshirën për të mësuar dhe reflektuar duke ndryshuar mënyrën se si i shohin gjërat, por gjithashtu *mënyra e dhënies së mësimit* duhet të ndryshojë. Ne do të donim që pedagogu të vijë në mësim dhe të tregojë interesin e tij për lëndën dhe jo të vijë thjesht për “të dhënë mësim,” por të na familjarizojë me një temë, si dhe të na përcjellë dëshirën për të eksploruar fusha të ndryshme. Ai duhet të ketë dëshirën që të na përcjellë dijet e tij. Lëndët e ndryshme si letërsia, matematika, teatri, historia, etj., duhet të mësohen ndryshe, ndoshta *duke rifilluar nga zero*, duke bërë pyetje mbi botën, mbi bazën e parimeve. *Dijet duhen rikrijuar* dhe duhet reflektuar mbi to.

Për këto arsye, ne mendojmë që universiteti duhet të jetë *vendi i takimit*, i shkëmbimit dhe jo i individualitetit. Ne duam që studentët të mund të takohen më shumë me njëri-tjetrin, të ndajnë idetë e tyre, për të hapur mendjet e tyre dhe për të *mësuar se si të krijojnë mendimin e tij...* Po, *të krijojnë mendimin tënd, ky është çelësi për të luftuar individualizmin...* Ndoshta mund të duket paradoksale, por pikërisht me këtë lloj të menduari, ne zhbëjmë idetë e paraformuara, mësojmë se si të krahasojmë idetë dhe jo t’i marrim ato si të mirëqena dhe të padiskutueshme. Në sajë të tij, ne mund të emancipohemi nga shoqëria, të takohemi në një vend brenda universitetit për të reflektuar së bashku, jo vetëm në fushën tonë të studimit, por dhe në fusha të tjera. Ne kemi nevojë për të tjerët që të ecim përpara. Ne mund të *zgjojmë disa virtyte te të gjithë ne, madje dhe te studentët që nuk kanë dëshirë të reflektojnë*: virtyte të tilla si kurioziteti, vetëbesimi, mosbesimi tek idetë e krijuara tashmë, entuziazmi, ndjeshmëria. Ne të gjithë i kemi aftësitë për ta bërë këtë gjë, si dhe për të marrë kohë për të reflektuar. Ne duhet t’i sigurojmë mjetet.

Për të qenë të aftë që të krijojmë mendimin tonë, duhet të vëmë në përdorim *eksperiencën tonë*, si dhe të kultivohemi, të lexojmë, të dëgjojmë të tjerët, të jemi kuriozë për të gjitha fushat. Të kesh mendimin tënd gjatë një debati, do të thotë të kesh dëshirë që të ndash *të vërtetën* tonë. Ajo është e ndryshme nga pseudo e vërteta që duan të na imponojnë, e cila na duket e gabuar, e pasaktë dhe që nuk na ndihmon të jetojmë më mirë. Ne e kemi përvetësuar të renë, e kemi krijuar atë duke i dhënë rëndësi, ligjshmëri dhe një ekzistencë të re. Ajo na e tregon jetën ashtu siç e kuptojmë ne atë.

### Neni 3: Të Dalësh nga universiteti

Ne duam të dalim nga universiteti për të kuptuar një disiplinë që nga akti i krijimit të saj sepse mësimet që ne marrim dhe mënyra se si ato jepen, nuk na mundësojnë që ta bëjmë këtë gjë.

Ne duhet të gjejmë çelësat që na bëjnë të mundur të kuptojmë një disiplinë, ashtu siç ndodh kur vizitojmë një ekspozitë në ndonjë muze, por që nuk kemi bazat e nevojshme për ta kuptuar atë.

Përgjithësisht një disiplinë ka shumë origjina sepse çdo popull ka kontribuar për të, ka sjellë diçka ta tyren. Për këtë arsye ne duhet të kërkojmë të gjitha origjinat, t'i kuptojmë ato dhe t'i grupojmë së bashku. Për shembull, matematika është zhvilluar falë arabëve dhe egjiptianëve të lashtë. Edhe letërsia ka shumë origjina.

Pra, qëllimi është që të kërkojmë dhe të mësojmë se si është shfaqur një disiplinë, si e kanë konceptuar mendimtarët e parë dhe cila është dobja e saj në shoqërinë tonë...

Atëherë mund të flasim për *prozopopenë e disiplinave*: disiplina pyet krijuesin e saj dhe i thotë: "Përse më krijove?"

Për këtë qëllim, ne duam të dalim nga universiteti dhe të bëjmë një anketim tek ata që nuk kanë njohuri në një fushë të caktuar. Marrim si shembull letërsinë: Ne mund t'u tregojmë punëtorëve ose personave që nuk kanë njohuri si tonat shembuj të ndryshëm të gjinive letrare dhe t'i pyesim se çfarë është për ta letërsia, çfarë mendojnë ata për tekstet e paraqitura. Pa dyshim që ata do t'i shikonin gjërat ndryshe dhe ne do të mund të mësonim nga ata, të shihnim se si mund të kuptohej një tekst pa pasur njohuri të veçanta (me njohuri në shkallën zero, ashtu si në tekstin e Shekspirit). Në këtë mënyrë, ne do të kishim këndvështrime të tjera dhe kjo do të tregonte që tekstet janë për të gjithë.

Duhet gjithashtu të pyesim personat që punojnë në të njëjtën disiplinë me tonën, por që ndodhen në vende të tjera ku mënyrat e të menduarit dhe të zbatuarit janë të ndryshme. Për shembull: një kimist që punon për progresin e teknologjive të reja në Francë dhe një kimist tjetër që punon për të ndihmuar fëmijët që vuajnë nga keqshqyerja në Guine.

Çdo disiplinë është si një art, ato zhvillohen nga akte krijuese dhe shkencore dhe tregojnë shpirtin e njerëzve, forcën e të menduarit dhe mënyrën se si e shohin botën. Pra, mund të kuptohet një disiplinë duke e krahasuar me disiplina artistike si kinemaja, teatri, për të parë se si perceptohen ato.

### Vendi i takimit

Ne duam një vend takimi për studentët jashtë universitetit, atje ku do të krijonim vepri-min që ka shpikur një disiplinë, ku do ta ripërcaktonim atë duke nisur nga zero.

Shembull: të takohesh në një qytet, në sheshin kryesor të tij dhe të pyesësh veten se si do të ishin gjërat nëse një disiplinë e caktuar nuk do të ekzistonte. Po ashtu, në ndonjë vend tjetër çfarëdo – preferohet të jetë bosh –, ne do të mund të krijojmë një disiplinë apo të rishpikim një tjetër.

Shembull tjetër: mund të krijojmë gjithashtu një projekt që do t'i shërbente të gjithëve, në sajë të bashkëpunimit të disiplinave të ndryshme. Ky duhet të jetë një projekt që t'i rezistojë kohës, një projekt afatgjatë. Shembull: krijimi i një objekti të nevojshëm, i cili do të përfshinte matematikanë, sociologë... jo! Filozofë!, zdrukthëtarë, teknikë, artistë grafie... të cilët do të punonin së bashku.



# Bashkimi European

PROBLEME TË KRIJIMIT DHE TË FORCIMIT TË PUSHTETIT POPULLOR  
SË SHKËZITË DHE SË SHKËZITË

LIBRI 4 ■ KONCEPTI DHE SISTEMI BASHKËKOHOR  
DHE SË SHKËZITË

EDUKOJME SI EDUKOJME?  
PËR SHKËZITË

PËR SHKËZITË

EDUKOJME SI EDUKOJME?  
PËR SHKËZITË

POPULLSIA SHQIPTARE E KOSOVES  
GJATE SHEK. XV-XVI

SELAMI  
PUNAJA

OPULLSIA E SHQIPERISE

Dialoge për multikulturalitetin  
PËR SHKËZITË

YE ENI TË SPANJËS  
PËR SHKËZITË

BIBLIOTEKA  
5/4









# TRANSLATOR'S NOTE

Jonida Gashi

The idea of doing something with it comes early on. I will photograph the papers. Not all of them, perhaps, but at least some of them, certainly my favorite ones. As it turns out, I don't bother printing most of the papers and the idea of photographing my computer screen seems imbecilic. I also remember that I am a terrible photographer who does not even have the added benefit – in my case very much needed – of a half decent camera. I think all kinds of things that I no longer remember throughout July and at the end of the month announce that when it is all over, I will be handing out awards. (We are nearing the end of September now and I have forgotten which awards I intended to give to whom or how I was going to go about the whole thing.) *I think also about the implications of the fact that for so many authors English is not their first language.* Vincent suggests I write something instead. I decide to attempt it.

I have an uneasy relationship with what, after Andreas Vrahimis, I would like to call “autobiographism.” In short, I don't like it. Over two years ago now, an editor, rather casually I might add, suggested that my argument might be better framed if anchored in events and experiences drawn directly from my life. I can still recall the feeling of alarm mixed with disgust that overcame me. And yet, I have already succumbed to it here, “autobiographism” that is, am indulging in it right now and intend to do so for the remainder of this (thankfully, for all concerned) brief note. The reasons for this are numerous, but I want to briefly mention two of them, namely, that the lure of the autobiographical is in this instance intimately connected to the task at hand, writing about translating: that something like an autobiographical impulse tends to characterize writing about translating; and that it resonates with our theme here, pedagogical disasters, these being disasters that have affected so many of those who have contributed to this

volume, myself included, on a personal level, which can be seen in many of the contributions and I think sensed in those where there is no mention of a personal disaster.

There are, admittedly, many kinds of “autobiographism” when it comes to writing about translating. There is the kind of “autobiographism” that comes from the translator’s attachment to the text, as in the case of Haruki Murakami’s “Translator’s Afterword,” where the Japanese novelist devotes many pages to his history, both as a reader and as a writer, with *The Great Gatsby*. This is my least favourite kind of “autobiographism” and I suppose that I am lucky to be quite safe from succumbing to it since I do not feel such an attachment to any of the texts I have translated in this volume, wonderful though many of the texts included in this volume are and wonderful though the attachment to a text often is. There is then the kind of “autobiographism” that amounts to a contemplation of one’s relationship to the language(s) involved in the task of translating. I am more sympathetic towards this kind of “autobiographism,” a prime example of which is Derrida’s “Monolingualism of the Other,” where the philosopher reflects on his relationship with the French language as an Algerian Jew. I will return to this text later. Finally, there is the kind of “autobiographism” that is a symptom of the difficulty of writing about translating in general terms. This is probably the most interesting kind of “autobiographism” and perhaps also the most difficult one to tackle. I will touch on it briefly at the end of this note when I address the relationship between thinking and writing.

A dear friend, R.O., a linguist and an Englishman to boot, tells me shortly before I leave London about his “trauma” at having been translated into Korean without his permission. Following my departure, when I tell him I will be translating the proceedings of a conference on disastrous pedagogies, he gives me a stern lecture on the subject. I wonder if he thinks I’m not up to the task. This is after all the same person who on numerous occasions has told me that I am “basically bilingual,” which is apparently “very rare,” and given that he is a linguist and teaches university students how to write for a living, I have always assumed that he knows what he is talking about on matters such as these. That said, whether I am bilingual or not does not concern me very much. What does concern me is the very idea of bilingualism; that such a thing might exist at all. As it turns out, at the time of writing I have spent exactly half of my life immersed in one language (Albanian) and the other half, the second half, immersed in the other (English). While this is perhaps nothing more than a fortuitous accident of timing, the fact is that the history of my relationship with these languages is crammed with bifurcations, doublings, symmetries, etc. Albanian is for me the language of literature, or rather prose. By contrast, English is the language of scholarly work. (It is also, however, the language of poetry, because it is only after I move to London that I begin to develop an interest in poetry.) Similarly, while Albanian is the language of my childhood, English is for me the language of love. I could keep going. In short, my supposed bilingualism endlessly refers me back to a maddening monolingualism.

With the exceptions of Matthew Charles, Edith Doron, Oliver Feltham, Christopher Fynsk, Adam Staley Groves, Nico Jenkins, Justin Joque and John Van Houdt, the rest of our authors are nonnative speakers, which would be more than half of them: Judith Balso, Sina Badiei, Vincent W. J. van Gerven Oei, Julia Hölzl, Denisa Kera, Urok Shirhan, Nick Skiadopoulos, Jonas Staal, Katharina Stadler, Tijana Stevanovic, and Andreas Vrahimis. There is nothing particularly unusual about this. Having been by now to countless academic conferences I can testify to the prevalence of such or similar situations – the ratio between the native and nonnative speakers varies. I think most people would. Which is not to say that the operation is always a smooth one. I remember attending, in 2010, a conference in Paris organized by the Department of Anglophone Studies at the Sorbonne. Although the conference was “international,” not only did all the French speakers present in French, most of the non-French speakers presented in French too. The situation that followed was comical. Most of the French participants and members of the audience found it difficult to follow the presentations in French of the non-French speakers (issues to do with their accent I was told); the non-French speakers who could not understand French, on the other hand, found it impossible to follow the proceedings – a colleague I was travelling with happened to belong to the latter group and I distinctly remember him lubricating himself with copious amounts of free wine every lunchtime to help get through the long afternoons; I scribble on a piece of paper: “What were they thinking?” to which his, perhaps impossibly English, reply was “What were *we* thinking?” That said, more often than not the operation does go smoothly. So smoothly in fact that up until I began to translate the proceedings of the “Pedagogies of Disaster” conference it had never occurred to me that the translation of texts written in a language that is not the writer’s native language would pose a unique and complex set of problems.

If the task of the translator, as Benjamin suggests, consists in “finding that intended effect upon the language into which he is translating which produces in it the echo of the original,”<sup>1</sup> I will obviously have inevitably failed in my task. Everything I translate comes in English, of course, but insofar as we can speak of an “original” language then that is also, depending on the author, Dutch, French, German, Serbian, etc. Thus, on the one hand, the best that I can hope for is to be able to produce something like the echo of an echo: an echo, in Albanian, of the echo, in English, of the “original” language, whatever that may be. However, any attempt to produce an echo of an echo is destined to fail – rather like the translation of a translation is an impossible task, as Benjamin rightly points out. On the other hand, given that my knowledge of most of these other languages (with the exception of French) is virtually nonexistent, the idea that I might have approached the task at hand, of producing in Albanian the echo of the “original” in English, in a programmatic, let alone systematic, fashion – which to my mind forms a separate question from the possible success or failure of the attempt – is absurd. To put it in other words, I am not certain that the task of the translator was in my case, in this case, even an option, which of course raises the question of the precise nature of my task. Let me make my position clear: I am perfectly aware that I have not been translating literature or poetry here – It could be argued that Adam Staley Groves’ “Sandyhook University: Poetic Violence, Scope, and Style of Imagination,” for instance, is not only about poetry but also better read as poetry, but still ... – literature, and poetry in par-

ticular, being precisely what Benjamin had in mind in “The Task of the Translator.” Let me then put aside all questions relating to “translatability,” bound up as they are, at least as Benjamin understands the term, with the “quality” of the language, and consider instead the relationship between thinking and writing, which is ultimately what is at stake in translation, as Benjamin also points out.

I can still recall parts of a conversation had with S.C. towards the end of the second semester of my first year as a doctoral student. I had been all too happy to read for far too long, he said, insisting that the time had come to start writing. He was sympathetic; he did understand that given the nature of what I was writing about – repetition, return, fragmentation, sameness, difference (or as I preferred to call it: the ‘new’), etc. – finding something, or a place, with or at which to begin was not easy; everything seemed to (was) implicated in everything else – how to choose?; he insisted, however, that I had to begin somewhere, and that it did not really matter where; the beginning is, after all, always arbitrary, in my case perhaps more so than in others, but still... I do not think that I was entirely unaware that the time had come to start writing, however, I seemed to still entertain the mad hope that before I did so I would be able to sort through my thoughts: clarify a few things, establish some kind of order. I recall saying out loud: “I know what I think.” (A blatant lie if there ever was one.) To which S.’s rather bemused reply was: “You don’t know what you think until you’ve written it down.” I am reminded of this conversation while reading Foucault’s *Speech Begins After Death*, where he makes a similar remark about his own relationship with writing, or, rather, his experience of the relationship between thinking and writing: “When I begin to write an essay or a book, or anything, I don’t really know where it’s going to lead or where it’ll end up or what I’m going to show. I only discover what I have to show in the actual movement of writing, as if writing specifically meant diagnosing what I wanted to say at the very moment I begin to write.”<sup>2</sup> Preceding these words is an account of how he came to finally enjoy writing during a prolonged stay in Sweden. Unable to communicate with those around him due to his poor Swedish and English, writing, in his own language of course, became something of a relief and an outlet for him and, finally, a pleasure too. He speaks then of the “thickness” of the French language, its “consistency,” the fact that it “wasn’t simply like the air we breathe, an absolutely imperceptible transparency,” because it had “its own laws, its corridors, its paths of facility, lines, slopes, coasts, asperities; in other words a physiognomy,” thus forming a “landscape where one could walk around and discover in the flow of words, around sentences, unexpectedly, points of view that hadn’t appeared previously.”<sup>3</sup> All languages have, of course, a physiognomy that is their own; “laws,” “corridors,” “paths of facility,” “lines,” “slopes,” “coasts” and “asperities,” etc., in short, the “accessories,” as Mallarmé called them, of thinking, that speak of the “diversity of idioms on earth” that “prevents everybody from uttering the words which otherwise, at one single stroke, would materialize as truth”; which prevents thinking from becoming “writing without accessories.”<sup>4</sup> But thinking is already “writing without accessories,” as Mallarmé also points out, and I think that there is something to be said here for Derrida’s monolingualism: “I have only one language; it is not mine.”<sup>5</sup> That is to say, the experience of monolingualism, as opposed to that of, say, a beloved mother tongue or native language or what Derrida calls a language of one’s own, instead of paralyzing thinking – “Yes, I only have one language, yet it is not

*mine*.”<sup>6</sup> – allows a glimpse into the being of thinking as “writing without accessories.” Now, Derrida qualifies this with: “When I said that the only language I speak is not mine, I did not say it was foreign to me.”<sup>7</sup> But the condition of foreignness is no less interesting than that of dispossession for all that. While I certainly do not think that, like a good translation, according to Benjamin’s definition that is, it gives us a glimpse of the “language of truth,” truth being what all thought strives for, I do think that it gives us a glimpse of the other side of the coin, as it were, that is, nonsense. In short, it opens up thinking to the disaster. Not thinking as *a* disaster or *the* disaster but thinking as that which at every step is threatened with failure. I’ve tried to suggest that most of us experience this most acutely in writing: having to discover what you have to say as you “say” (write) it obviously implies the possibility that in the end you might have nothing to say at all. This threat is compounded when we write in a foreign language. The fact that we continue to write, however, be it in one or more languages, and especially today when the institutions that are supposed to foster thinking are faced with so many disasters, amounts to a continual affirmation of the victory of thinking over the (possibility of) disaster. And perhaps my modest task here, our task here – with Vincent – has been to (re)sound the echo of that victory.



**Notes**

- 1 Walter Benjamin, *Illuminations*, trans. Harry Zohn (London: Pimlico, 1999), 77.
- 2 Michel Foucault, *Speech Begins After Death*, trans. Rober Bononno (Minneapolis: University of Minnesota Press, 2013), 46.
- 3 Ibid., 32.
- 4 Cited in Benjamin, *Illuminations*, 78.
- 5 Jacques Derrida, *Monolingualism of the Other or The Prosthesis of Origin*, trans. Patrick Mensah (Stanford: Stanford University Press, 1998), 1.
- 6 Ibid., 2.
- 7 Ibid., 5.

# SHËNIM I PËRKTHYESËS

Jonida Gashi

Përkthyer nga Marsi Gjonçaj

Ideja për të bërë diçka me to më vjen herët. Kam për t’i fotografuar sprovat. Ndoshta jo të gjithat, por të paktën disa prej tyre, pa dyshim ato që më kanë pëlqyer më shumë. Por si përfundim nuk marr mundimin t’i shtyp shumicën prej tyre dhe ideja e fotografimit të ekranit të kompjuterit më tingëllon paksa idiote. Gjithashtu, më bie ndërmend që jam një fotografe e tmerrshme e që nuk mund të përfitoj as nga një aparat fotografik gjysmë i hairit (i domosdoshëm në rastin tim). Mendoj lloj-lloj gjërash që nuk më kujtohen më përgjatë korrikut dhe në fund të muajit shpall se, pasi gjithçka të jetë kryer, kam për të ndarë çmime. (Shtatorit po i vjen fundi ndërkaq dhe kam harruar se çfarë çmimesh kisha ndërmend t’i jepja kujt dhe sesi kisha ndërmend ta bëja këtë.) *Mendoj gjithashtu edhe për faktin se shumë prej autorëve nuk e kanë anglishten gjuhën e tyre të parë.* Vinsenti më sugjeron të shkruaj diçka. Vendos ta provoj.

Kam një marrëdhënie të paretshme me atë që, pas Andreas Vrahimis, do ta quaja “autobiografizëm.” Me pak fjalë, nuk më pëlqen. Rreth dy vjet më parë, një botues, disi shkujdesshëm, më këshilloi se ndoshta argumenti im mund të inkuadrohej më mirë nëse kapej pas ngjarjesh ose përvojash të marra drejtpërdrejt nga jeta ime. E kam ende të gjallë ndjenjën e alarmit të përzierë me neveri që më kaploi. E megjithatë, unë i jam dorëzuar atij, “autobiografizmit,” ndërkaq këtu, dhe do të vazhdoj ta bëj këtë përgjatë këtij teksti (fatmirësisht) të shkurtër. Arsyet për këtë vendim janë të shumta, por dua të përmend shkurtimisht dy prej tyre. Në këtë rast, joshja e autobiografikes është ngushtësisht e lidhur me detyrën që kam në dorë, shkrimin rreth përkthimit: se një impuls i tillë autobiografik priret të karakterizojë shkrimin rreth përkthimit; dhe se ai rikumbon me temën tonë këtu, katastrofa pedagogjike, katastrofa këto që kanë prekur shumë prej atyre që kanë kontribuar në këtë volum, duke përfshirë edhe vetë mua, në

një nivel personal, gjë që mund të shihet në shumë prej kontributeve dhe ndihet në ato ku nuk përmendet ndonjë katastrofë e një natyre personale.

Ka, pa dyshim, shumë lloje “autobiografizmi” kur vjen rasti për shkrimin rreth përkthimit. Është ai lloj që rrjedh nga afrimiteti i përkthyesit me tekstin, si në rastin e “Pasthënia e përkthyesit” të Haruki Murakamit, ku novelisti japonez i kushton shumë faqe historisë së tij, si lexues por edhe si shkrimtar, me *Getsbin e Madh*. Ky është lloji im më pak i parapëlqyer i autobiografizmit dhe ndoshta jam me fat që në një farë mënyre nuk rrezikoj të bie në një grackë të tillë duke qenë se nuk jam veçanërisht e lidhur me asnjërin prej teksteve që kam përkthyer, sado të mrekullueshëm janë shumë prej këtyre teksteve dhe sado i mrekullueshëm mund të jetë afrimiteti me një tekst. Pastaj është ai lloj autobiografizmi që ka të bëjë me soditjen e marrëdhënies së përkthyesit me gjuhën/-t e përfshira në përkthim. Këtë lloj autobiografizmi e kam disi më përzemër, një shembulli domethënës i të cilit është “Njëgjuhësia e tjetrit [*Le Monolingualisme de l'autre*]” i Derridasë, ku filozofi reflekton mbi marrëdhënien e tij me gjuhën frënge si një hebre nga Algjeria. Do t’i kthehem këtij teksti më vonë. Së fundmi, është lloji i autobiografizmi që është një simptomë e vështirësive të shkrimit rreth përkthimit në terma të përgjithshëm. Ky është ndoshta lloji më interesant dhe më i vështiri për t’u trajtuar. Kam për ta prekur atë në fund të këtij shënimi, kur t’i drejtohem çështjes së marrëdhënies mes mendimit dhe të shkrimit.

Një mik i dashur, R.O., gjuhëtar dhe anglez për më tepër, më tregon, pak para se të largohem nga Londra, për “traumën” që pësoi kur mësoi se ishte përkthyer në gjuhën koreane pa lejen e tij. Pas largimit tim, kur i them se do të përkthej materialet e një konference mbi pedagogji katastrofike, ai më mban një leksion të ashpër mbi këtë temë. Vras mendjen, nëse ai mendon se nuk jam në lartësinë e detyrës. Ai është, në fund të fundit, i njëjti njeri i cili në shumë raste më ka përsëritur që unë zotëroj praktikisht dy gjuhë, çka na qenka mesa duket një gjë shumë e rrallë. E duke qenë se ai është gjuhëtar dhe e fiton jetesën duke u mësuar studentëve si të shkruajnë, gjithnjë kam menduar se di ç’flet mbi çështje të tilla. Thënë kjo, fakti në zotëroj shumë mirë dy gjuhë nuk më shqetëson shumë. Ajo që më shqetëson është vetë ideja e dygjuhësisë; që një gjë e tillë mund të ekzistojë. Tani që po shkruaj, kam kaluar saktësisht gjysmën e jetës sime zhytur në një gjuhë (shqip) dhe gjysmën tjetër, në gjuhën tjetër (anglisht). Ndonëse kjo ndoshta nuk është asgjë më tepër se një rastësi kohore fatlume, fakti qëndron që historia ime me këto dy gjuhë është e mbushur me të tilla bigëzime, dyfishime, simetri, etj. Për mua shqipja është gjuha e letërsisë, e prozës më saktë. Nga ana tjetër, anglishtja është gjuha e punës shkollare. (Është gjithashtu, gjuha e poezisë, pasi vetëm me t’u transferuar në Londër fillova të interesohesha për poezinë). Ngjashëm, teksa shqipja është gjuha e fëmijërisë sime, anglishtja është për mua gjuha e dashurisë. Mund të vazhdoja më tutje. Me pak fjalë, dygjuhësia ime e supozuar, më drejton pafundësisht tek një njëgjuhësi shkalluese.

Me përjashtim të Methju Çarlsit, Edit Doronit, Oliver Felthamit, Kristofer Finskut, Adam Stejli Grouvizit, Niko Xhenkinsit, Xhastin Xhoukut dhe Xhon Van Hautit, pjesa tjetër e autorëve nuk e kanë anglishten gjuhën e tyre amtare; dhe janë më shumë se gjysma: Zhydit Balso, Sina Badiji, Vinsent V. J. van Herven Uj, Julia Hëlçël, Denisa Kera, Urok Shirhan, Nik Skiadopulos, Jonas Stal, Katarina Stadler, Tijana Stevanoviq, dhe Andreas Vrahimis. Nuk ka asgjë të pazakontë këtu. Si dikush që ka marrë pjesë në konferenca pa fund, mund të dëshmoj se një situatë e tillë mbizotëron – raporti mes folësve amtarë dhe atyre jo amtarë ndryshon. Shumica e njerëzve do ta konfirmonin këtë. Që nuk do të thotë se gjërat shkojnë gjithnjë vaj. Mbjaj mend në 2010-n, kur ndoqa një konferencë në Paris të organizuar nga Departamenti i Studimeve Anglofone tek Sorbonne. Megjithëse konferenca ishte “ndërkombëtare,” jo vetëm që folësit francezë referuan në frëngjisht, por edhe një pjesë e mirë e folësve të huaj referuan gjithashtu në gjuhën frënge. Situata në vijim ishte komike. Shumë nga pjesëmarrësit dhe publiku francez ndoqën me vështrësi prezantimet në frëngjisht të folësve që nuk e kishin frëngjishten gjuhën amtare (për shkak të theksit, siç më thanë). Nga ana tjetër, ata që nuk kuptonin mirë frëngjisht e patën thujtë të pamundur të ndiqnin punimet – kolegu me të cilin po udhëtoja bënte pjesë tek ky grup dhe e mbaj mend sesi gjatë drekave pinte sasi të mëdha vere me qëllim që t’i përballonte më lehtë pasditet e gjata; i shkruaj në një copë letër “Ç’u ka thënë mendja vallë?” e ai më përgjigjet “Po neve ç’na tha mendja?” Thënë kjo, në shumicën dërrmuese të rasteve gjërat shkojnë vaj. Aq sa në fakt, para se të filloja të përktheja materialet e konferencës “Pedagogjite e shkatërrimit” nuk më kishte shkuar fare në mendje që përkthimi i teksteve në një gjuhë të ndryshme nga gjuha amtare e autorit do të shpërfaqte një grupim problemesh komplekse e unike.

Nëse detyra e përkthyesit, siç sugjeron Benjamin, është “të paraqesë në gjuhën në të cilën përkthen të njëjtin efekt që prodhon tek ajo jehonën e origjinale” atëherë unë, pa dyshim dhe domosdoshmërisht që kam dështuar në punën time. Sigurisht, unë po përkthej nga anglishtja, por për aq sa mund të flasim për një gjuhë “origjinale,” atëherë, në varësi të autorit, ajo është gjithashtu holandisht, frëngjisht, gjermanisht, serbisht etj. Kësisoj, nga njëra anë, në rastin më të mirë unë mund të shpresoj të prodhoj diçka të ngjashme me jehonën e një jehone: një jehonë në shqip, të jehonës në anglisht të gjuhës origjinale, cilado qoftë ajo. Mirëpo, çdo përpjekje për të riprodhuar jehonën e një jehone është e destinuar të dështojë, po ashtu si përkthimi i një përkthimi është një detyrë e pamundur, siç thekson me të drejtë Benjamins. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se njohuritë e mia të këtyre gjuhëve të tjera (me përjashtim të frëngjishtes) janë thujtë jo ekzistuese, ideja që mund t’i jem qasur detyrës time këtu, riprodhimit të jehonës në shqip të jehonës së origjinalit në anglisht, në mënyrë programatike e jo më sistematike (që për mua është një çështje që duhet parë veçmas nga ajo e suksesit apo dështimit të saj të mundshëm), është krejt absurde. Thënë ndryshe, nuk jam e sigurt që detyra e përkthyeses në rastin tim, në këtë rast, ishte qoftë edhe një alternativë – çka, detyrimisht ngre pyetje mbi natyrën e saktë të punës sime. Më lejoni ta bëj pozicionin tim të qartë: jam krejtësisht e ndërgjegjshme që këtu nuk kam përkthyer prozë ose poezi – mund të diskutohet për shembull se “Sandyhook University: Poetic Violence, Scope, and Style of Imagination,” i Adam Staley Groves, nuk është thjesht një tekst *mbi* poezinë, por njëherazi një tekst i lexuar më mirë *si* poezi, por gjithsesi... – dhe proza dhe veçanërisht poezia ishin ato çka kishte në mendje Benjamin tek “Detyra e përkthyesit.”

Le t'i lëmë pra, mënjanë të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me "përthyeshmërinë" të lidhura siç janë ato, të paktën në përkufizimin e Benjaminit të termit, me "cilësinë" e gjuhës dhe të marrim parasysh marrëdhënien ndërmjet të menduarit dhe të shkruarit. Kjo është pikërisht edhe ajo çka është në lojë në këtë rast, siç thekson Benjamin.

Ende kujtoj pjesë të një bisede me S.C. diku nga fundi i semestrit të dytë të vitit të parë të doktoraturës. Ishte bërë ca si tepër kohë që po kënaqesha vetëm me lexim, më tha, duke këmbëngulur se kishte ardhur koha që të filloja të shkruaja. Ai u treguar i kuptueshëm; e dinte mirë se duke parë natyrën e asaj për të cilën po shkruaja – përsëritjen, rikthimin, fragmentimin, njëjtësinë, ndryshimin (ose siç më pëlqente ta quaja "të renë") etj, të gjeja diçka, një vend nga t'ia nisja nuk ishte e lehtë; gjithçka dukej sikur ishte (ishte) e lidhur me gjithçka tjetër – si të zgjidhja?; ai këmbënguli, megjithatë, që unë të filloja nga diku, pak rëndësi kishte se ku; fillimi është, në fund të fundit, gjithnjë arbitrar, në rastin tim akoma më shumë, por gjithsesi... Nuk mendoj se isha tërësisht e pandërgjegjshme që kishte ardhur koha të filloja të shkruaja, por megjithatë vazhdoja të ushqeya shpresën e çmendur se para se të filloja t'i hidhja në letër, do të mund t'i shoshitja disi mendimet e mia: të sqaroja disa gjëra, të vendosja një lloj rendi. Mbay mend që thashë me zë të lartë: "E di se çfarë mendoj!" (Një gënjeshtër e hapur.) Përgjigja e zbavitur e S. ishte: "Askush nuk e di se çfarë mendon sa pa e shkruar." Kjo bisedë më vjen në mendje teksa lexoj *Ligjërimi fillon pas vdekjes* [*Speech Begins After Death*] të Fukosë, ku autori thotë diçka të ngjashme në lidhje me marrëdhënien e tij me shkrimin, ose më saktë me përvojën e tij të marrëdhënies midis mendimit dhe shkrimit. "Kur unë filloj të shkruaj një sprovë apo një libër ose çfarëdo qoftë, nuk e di se ku do të dalë, ku do të mbërrij apo se çfarë do tregoj. Unë vetëm zbuloj çfarë kam për të treguar në çastin që shkruaj, sikur shkrimi nënkupton specifikisht diagnostikimin e asaj çka doja të thoja pikërisht në momentin kur nis të shkruaj."<sup>3</sup> Përpara kësaj, Fuko tregon sesi më në fund filloi t'i gëzohej procesit të të shkruarit për hir të një vizite të përzgatur në Suedi. Duke mos qenë në gjendje të komunikonte me njerëzit që e rrethonin për shkak të anglishtes dhe suedishtes së tij të varfër, të shkruarit (në gjuhën e tij padyshim) u kthye në një lloj lehtësimit e shkarkimi për të dhe më në fund në një kënaqësi. Në vijim ai flet për "trashësinë" e gjuhës frënge, "konsistencën" e saj, faktin që ajo nuk ishte thjesht si "ajri që thithim, një tejdukshmëri absolutisht e padukshme," sepse ajo kishte "rregullat e veta, korridoret, rrugët, linjat, shpatet, brigjet, ashpërsinë e vet; me fjalë të tjera një fizionomi," duke formuar kështu "një peizazh ku dikush mund të sorollatej e të zbulonte papritmas, në rrjedhën e fjalëve, rreth fjalive, pikëvështrime të panjohura më parë."<sup>3</sup> Sigurisht, të tëra gjuhët kanë një fizionomi të tyre, "rregulla," "korridore," "rrugë," "linja," "shpate," "brigje" dhe "ashpërsi" etj, domethënë "aksesorët," siç i quante Malarme, të mendimit, që flasin për "shumëllojshmërinë e gjuhëve mbi tokë" që "pengon çdokënd të artikulojë fjalët, të cilat përndryshe, me një goditje të vetme do të materializoheshin si e vërteta"; çka nuk e lejon mendimin të kthehet në "shkrim pa aksesore."<sup>4</sup> Por, nënvizon Malarme, mendimi është në fakt "shkrim pa aksesore" dhe unë mendoj se këtu duhet thënë diçka për njëgjuhësinë e Derridasë: "Unë kam vetëm një gjuhë; ajo nuk është e imja."<sup>5</sup> Kjo për të treguar, se përvoja e njëgjuhësisë, përkundër asaj së, le të themi, gjuhës së dashur të nënës, gjuhës amtare, ose të asaj që Derrida quan gjuhën që të përket, në vend se ta paralizojë mendimin – "Po, unë e kam një gjuhë, e megjithatë ajo nuk është e imja"<sup>6</sup> – na lejon të hedhim një shikim në qenien e mendimit si "shkrim pa

aksesorë.” Derrida vazhdon e cilëson: “Kur unë them që e vetmja gjuhë, e cila flas nuk është e imja, nuk them që më është e huaj.”<sup>7</sup> Por gjendja e huajshmërisë nuk është më pak interesante se ajo e shpronësimit. Ndonëse unë sigurisht nuk mendoj se, si një përkthim i mirë, (sipas përkufizimit të Benjaminit) ajo na jep një shikim të “gjuhës së të vërtetës,” ku e vërteta është ajo çka mendimi orvatet të arrijë, unë mendoj se na jep një vegullim të anës tjetër të medaljes, si të thuash, le të themi absurditetit. Shkurt, ajo e hap mendimin ndaj shkatërrimit. Jo vetë mendimin si *një* katastrofë apo si *katastrofa*, por të mendimit si ajo çka në çdo hap kërcënohet nga dështimi. Jam përpjekur të sugjeroj se secili prej nesh e përjeton këtë më së fortë gjatë shkrimit: të të duhet të zbulosh çfarë ke për të thënë në çastin që “e thua” (shkruan) qartësisht nënkupton mundësinë që në fund të mos kesh mos kesh gjë për të thënë. Ky kërcënim shumëfishohet kur ne shkruajmë në gjuhë të huaj. Fakti që ne gjithsesi vazhdojmë të shkruajmë, në një apo më shumë gjuhë, dhe veçanërisht sot kur institucionet e mendimit kërcënohen nga kaq shumë shkatërtime, nënkupton një miratim të vazhdueshëm të fitores së mendimit mbi (mundësinë e) katastrofës. Dhe ndoshta këtu, detyra ime modeste, detyra jonë – së bashku me Vinsentin – ka qenë (ri)kumbimi i jehonës së kësaj fitoreje.

**Shënime**

- 1 Walter Benjamin, *Illuminations*, përkth. Harry Zohn (Londër: Pimlico, 1999), 77.
- 2 Michel Foucault, *Speech Begins After Death*, përkth. Rober Bononno (Minneapolis: University of Minnesota Press, 2013), 46.
- 3 Po aty, 32.
- 4 Cituar në Benjamin, *Illuminations*, 78.
- 5 Jacques Derrida, *Monolingualism of the Other or The Prosthesis of Origin*, përkth. Patrick Mensah (Stanford: Stanford University Press, 1998), 1.
- 6 Po aty, 2.
- 7 Po aty, 5.







# PEDAGOGJITË E SHKATËRRIMIT

Redaktuar nga Vinsent V.J. van Herven Uj,  
Adam Stejli Grouvz & Niko Xhenkins

Vinsent V.J. van Herven Uj · Hapja	35
Kristofer Finsk · Një Pedagogji në prag të shkatërrimit	49
Oliver Feltham · Çshoqërimi i shkollës: Arsimi dhe zona e aksionit	87
Adam Stejli Grouvz · Universiteti “Sandy Hook”:	
Dhuna poetike, fusha e veprimit dhe stili i imagjinatës	119
Julia Hëlcël · Një Thirrje për të menduar (shkatërrimin)	135
Xhon Van Haut · Retorika e shkatërrimit: T’i Mbijetojmë fundit të humaniteteve	163
Vinsent V.J. van Herven Uj · Një Pasion për po-në: Dalja hapur dhe pohimi	185
Edit Doron · Mirëpritja e të huajit:	
Nga përfshirja sociale tek arsimi mërgimtar	205
Urok Shirhan · “Occupy Baghdad”: Mbi Pushtimin e imazheve	231
Jonas Stal · Arti pas demokratizmit: Pedagogjia e Samitit të Ri Botëror	257
Katarina Stadler · Ndërhyrje “Të Lexojmë mbi shkatërrimin”:	
Imagjinaret në praktikat pjesëmarrëse artistike	281
Manifest për arsimin në Shqipëri	297
Andreas Vrahimis · Filozofia dhe shkollimi humanist:	
Pedagogjia katastrofike e J. S. Millit	315
Methju Çarls · Valter Benjamin dhe Inhumanitetet:	
Drejt një kundërnicanizmi pedagogjik	343
Niko Xhenkins · Filozofia përtej perasë: Të Mendojmë me periferinë	363
Xhastin Xhouk · Katastrofa kibernetike: Drejt një pedagogjie të entropisë	385
Tijana Stevanoviq · Fakulteti në zbrapsje:	
Mosditja dhe pasiguritë e vetëinstitucionalizimit	413
Denisa Kera · Mbi prototipet: A duhet të hamë dardhën e Maos, të lundrojmë varkën e Sent-Eksyterisë, të pimë me kanën e Hajdegerit apo të përdorim çekanin e Niçes për t’iu përgjigjur Krizës?	439
Sina Badiji · Nevoja për arsim:	
Si mund të vazhdojmë të jemi altyerianë pas Badiusë?	463
Nik Skiadopulos · Universiteti duhet tejkaluar	483
Zhydit Balso · Compter sur l’impossible inexistant ·	
Të mbështetesh mbi të pamundurën joekzistuese	509
Kushtetuta e Lumturisë	531
Jonida Gashi · Shënim i përkthyeses	545

Fotografi nga Diego Kosentino & Marko Maxi  
Përkthime nga Jonida Gashi

TIRANË, SHQIPËRI  
6–8 QERSHOR 2013



*Pedagogies of Disaster*

Jenkins, Nico; van Gerven Oei, Vincent W.J.;  
Groves, Adam Staley

punctum books, 2013

ISBN: 9780615898711

<https://punctumbooks.com/titles/pedagogies-of-disaster/>

<https://www.doi.org/10.21983/P3.0050.1.00>